

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

Doktorant
Violeta Buza

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës doktrale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Departamentin e Shkencave Sociale, me profil **Pedagogji**, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Petrit Muka

Numri i fjalëve: 54117

Tiranë, gusht 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

Violeta Buza

Abstrakti

Për një proces të suksesshëm dhe ngritjen e cilësisë në të nxënë, vlerësimi konsiderohet ndër shtyllat kryesore të punës në arsim. Pasi sistemi i vlerësimit është i përcaktuar në bazë të Kurrikulës së Kosovës, vërehen hapa konkretë drejt ndryshimeve pozitive. Në

Kurrikulën shkollore të Kosovës është i planifikuar për realizim edhe Vlerësimi Formues (për nxënie), përmes të cilit vërehet mënyra e të nxënit, angazhimit, përparimit të nxënësve si dhe sigurohet kthimi i informacioneve nga ana e mësimeve dhe prindërve për vështirësi ose përmirësime, duke dhënë rezultate të reja në procesin e të nxënit.

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i nxënësve në mënyrë sistematike për nxënie të qëndrueshme gjatë procesit të të nxënit dhe argumentimi i punës së suksesshme të mësimeve, ku si pjesë përbërëse e planifikimit dhe hartimit të planit mësimor duhet të jetë Vlerësimi Formues (për nxënie). Ky vlerësim lehtëson punën e mësimeve në identifikimin e dobësive të nxënësve apo përparimit të tyre, angazhon nxënësit në eliminimin e vështirësive në mënyrë sistematike dhe informon prindërit për suksesin - mosuksesin e fëmijëve.

Ky studim ka karakter hulumtues, prandaj për marrjen e të dhënave të mjaftueshme dhe analizimin e tyre është përdorur metodologjia mikse - metoda sasiore, përmes pyetësorit dhe metoda cilësore, përmes intervistave dhe vëzhgimit në orë mësimore në tri shkolla të Komunës së Gjakovës. Kjo metodologji ndihmon në marrjen e të dhënave të pritshme në procesin e të nxënit të efektshëm dhe cilësor përmes mësimeve si planifikues i mirë i strategjisë së mësimdhënies, duke përfshirë planifikimin e objektivave, teknikave, formave

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

e metodave mësimore, duke konsideruar vlerësimin e nxënësve si pjesë të rëndësishme të procesit mësimor.

Përmes analizës së të dhënave kuptojmë se edhe sot një numër i madh i mësimdhënësve, përkundër angazhimit dhe punës së palodhshme ende nuk paraqesin ndonjë plan konkret për planifikimin dhe aplikimin e disa formave të vlerësimit në procesin mësimor, në veçanti Vlerësimin Formues.

Arrijmë në një përfundim se përmes aplikimit të Vlerësimit Formues (për nxënie), mësimdhënësit identifikojnë mënyrat më të mira që të ndihmojnë nxënësit në marrjen e njohurive të reja dhe përmirësimin e të nxënit në njërën anë, ndërsa të raportojnë nëse të nxënit është realizuar në mënyrë efektive në anën tjetër. Prandaj, arrihet në një konkludim se bashkëpunimi në mes mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve duhet të jetë më aktiv dhe të theksojë rëndësinë e të nxënit të nxënësve përmes sigurimit dhe komunikimit të informacioneve të mjaftueshme në forma të ndryshme.

Fjalët kyçe: Vlerësim, Vlerësim Formues, nxënës, mësimdhënës, prindër, të nxënë.

Abstract

For a successful process and an increase in the learning quality assessment is considered to be among backbones of the work in education. Since the assessment system is defined according to Kosovo Curriculum, concrete steps toward positive changes are noticed. In the Kosovo School Curriculum, the Formative Assessment (for learning) is also planned for realization, by which the way of learning, engagement and progress of students is noticed as well as the feedback from the teachers and parents is provided for difficulties or improvements giving new results in the learning process.

The purpose of this study is the evaluation of students in a systematical way for learning during the learning process and the argumentation of the successful work of the teacher where as a component of planning and development of the curriculum must be the Formative Assessment. This assessment facilitates the teacher's work in identifying the students' weaknesses or strengths, engages students in the elimination of difficulties in a systematical way and informs parents for the success-failure of children.

This study has a researcher character therefore in order to get enough data and their analysis the mixed methodology has been used – quantitative method through questionnaire, and qualitative method through interview and observation in classes in three schools of Gjakova Municipality. This methodology helps in getting expected data in the process of effective and qualitative learning through the teacher as a good planner of the teaching strategy involving the planning of learning objectives, techniques, forms and methods while considering the assessment of students an important component of the learning process.

By data analysis we realize that even today a great number of teachers despite their engagement and tireless work still don't present any concrete plan for planning and application of some assessment forms in the learning process, particularly the Formative Assessment.

We arrive to the conclusion that by applying the Formative Assessment (for learning) teachers identify the best ways to help students obtain new knowledge and improve learning on one hand, while on the other hand reporting if learning is realized in an effective way. Therefore, we arrive to the conclusion that the cooperation between teachers, parents and students must be more active and emphasize the importance of students' learning by providing and communicating sufficient information in different forms.

Key words: assessment, Formative Assessment, student, teacher, parent, learning.

DEDIKIMI

Me përkushtim të veçantë për familjen time dhe njerëzit e mi më të dashur.

Për prindërit e mi, Salih (i cili fizikisht nuk gjendet më në mesin tonë) dhe Fatmire, të cilët
më mbështetën me gjithë forcën dhe më krijuan mundësinë që të arrij këtë sukses.

Bashkëshortit Kastriotit dhe djemve - Gurit e Luftarakut, për gjithë dashurinë dhe
përkushtimin e tyre.

Mirënjohje - Falenderime

Shumë njerëz më udhëhoqën, orientuan dhe inkurajuan në gjithë vitet e studimit tim.

Shumë falënderime dhe mirënjohje për të gjithë ata që ndanë me mua frymëzimin, motivimin, lodhjen, mërzitjen dhe arritjet.

Falënderoj udhëheqësin shkencor, prof. dr. Petrit Muka për udhëheqjen, sugjerimet dhe mbështetjen në çdo hap të punës sime, i cili më ka ofruar besim dhe mbështetje, duke më inkurajuar në çdo hap. Ai ka qenë për mua një drejtues i jashtëzakonshëm disertacioni.

Falenderim i veçantë edhe për të gjithë profesorët dhe kolegët e departamentit të Pedagogjisë të Universitetit European të Tiranës për dëgjimin, inkurajimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm, në veçanti prof. asoc. dr. Tomi Treska për këshillat e nevojshme gjatë gjithë ditëve doktorale.

Falënderoj po ashtu në mënyrë të veçantë prof. dr. Eda Vula, e cila më orientoi drejt punës hulumtuese dhe prof. ass. dr. Blerim Saqipi për gatishmërinë e tij, i cili gjatë gjithë punës sime më këshilloi për të përmbushur qëllimin e këtij disertacioni.

Falënderime për familjen dhe të afërmit e mi të cilët më mbështetën gjatë kohës së studimeve.

Ky disertacion do të ishte i përealizueshëm pa ndihmën edhe të drejtorëve, mësimdhënësve dhe nxënësve të tri shkollave fillore “Zekeria Rexha”, “Selman Riza” dhe “Z. L. Marku” të Komunës së Gjakovës, ku unë realizova hulumtimin. Pra, falënderime të veçanta për tri shkollat fillore të Komunës së Gjakovës, ndaj kontributi i të gjithëve më ndihmoi që të arrij sukses në punën hulumtuese.

Falënderoj po ashtu kolegët, nxënësit e mi dhe prindërit e tyre që më kuptuan dhe më mbështetën edhe në kohën kur unë nuk isha pranë tyre.

Gjithë kjo punë u arrit me ndihmën dhe mbështetjen e bashkëshortit tim Kastriotit dhe dy fëmijëve - Guri dhe Luftaraku, të cilët më frymëzuan me përkushtimin, sakrificën dhe dashurinë e tyre, duke nxitur tek unë dëshirën për të ecur përpara.

Falënderime për të gjithë ata që u bënë pjesë e këtij studimi, duke i dhënë një vlerë konkrete dhe reale punës sime.

Suksesi në përgatitjen e këtij disertacioni arrin më shumë vlerë pasi ne u munduam që së bashku të arrijmë deri tek ky hap i rëndësishëm, andaj ju falënderoj nga zemra.

Ideja për për zgjedhjen e temës dhe hulumtimit rreth saj:

- Sfidat dhe vështirësitë në vlerësim gjatë shkollimit tim fillor e të mesëm, po ashtu edhe gjatë studimeve ku pothuajse gjithmonë ishte i pranishëm Vlerësimi Përmbledhës;
- Trajnimet e ndryshme pas luftës në Kosovë për ngritjen e cilësisë në të nxënit e nxënësve e në veçanti trajnimi “Vlerësimi për nxënie”;
- Përballja me nxënës gjatë punës sime si mësimdhënëse e gjuhës angleze dhe mësimdhënëse, e po ashtu edhe puna me studentë si ligjëruese për lëndë pedagogjike.

PËRMBAJTJA

Deklarata e autorësisë.....	ii
Abstrakti.....	iii
Abstract	v
Mirënjohje– Falënderime.....	viii
Përmbajtja	x
Lista e tabelave dhe diagrameve.....	xii
Lista e shkurtimeve dhe fjalorit.....	xvii
I. Hyrja.....	1
1.1. Përshkrimi i situatës.....	1
Përcaktimi teorik i nocioneve bazë.....	7
Nocioni nxënës.....	7
Nocioni të nxënë	7
Nocioni vlerësim.....	8
Nocioni Vlerësim Formues (Vlerësim për nxënie).....	10
Nocioni motivim i nxënësve.....	11
1.2 Organizimi i përmbajtjes së kapitujve.....	13
II. Shqyrtimi i literaturës për planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues.....	18
2.1. Qëllimi dhe faktorët e të nxënit.....	18
2.2. Roli i Kurrikulës – si faktor në të nxënit e nxënësve.....	20
2.3. Shkolla – faktor i të nxënit të nxënësve.....	27
2.3.1. Mësimdhënësi faktor kyç i procesit të të nxënit.....	30
2.3.2. Ndikimi i metodave të mësimdhënies në motivimin dhe rimotivimin e nxënësve.....	35
2.3.3. Nxënësi – faktor i të nxënit.....	39
2.4. Vlerësimi në procesin e të nxënit si faktor pozitiv.....	41
2.4.1. Vlerësimi i bazuar në matje e kontroll njohurish.....	44
2.4.2. Vlerësimi - faktor motivues i të nxënit të nxënësve.....	46
2.5. Planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues (për nxënie) dhe Vlerësimit Përmbledhës (i të nxënit).....	49
2.6. Vlerësimi Formues faktor pozitiv dhe ndikues në motivimin - rimotivimin e nxënësve.....	54
2.7. Bashkëpunimi në mes mësimdhënësve në shkollë për aplikimin e Vlerësimit Formues dhe Vlerësimit Përmbledhës për sigurimin e informacionit rreth përparimit apo ngecjes së nxënësve	59
2.7.1. Kriteret e suksesit – planifikimi dhe zbatimi i tyre	61
2.7.2. Vëzhgimi i nxënësve gjatë orëve mësimore dhe dhënia e feedbackut (informacionit kthyes) në mënyrë sistematike për anët e forta dhe të dobëta të nxënësit	63
2.7.3. Portfolio e nxënësit	72
2.7.4. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë	74

2.8. Koncepti i mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve mbi ndryshimin, krahasimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues për të nxënë të suksesshëm	77
--	----

III. Metodologjia e studimit.....	80
3.1. Nevoja për këtë studim.....	80
3.2. Objekti i hulumtimit.....	81
3.3. Detyrat e hulumtimit.....	82
3.4. Qëllimi i hulumtimit	83
3.5. Parashtrimi i problemit.....	84
3.6. Rëndësia e studimit për aplikimin e Vlerësimit Formues në shkollë.....	86
3.7. Objektivat e hulumtimit.....	87
3.8. Pyetjet kërkimore.....	88
3.9. Hipotezat kërkimore.....	89
3.10. Variabla	90
3.11. Metodatat e hulumtimit.....	90
3.12. Metoda kërkimore e përdorur	91
3.13. Popullata e studimit	92
3.14. Kampionimi.....	94
3.15. Instrumentet e kërkimit	95
3.16. Kufizimet e metodologjisë	98
3.17. Hartimi i kërkimit	99
3.18. Historiku i kërkimit– përshkrimi i fazave të kërkimit.....	100
3.19. Procedura.....	101
3.20. Hartimi i instrumenteve të kërkimit	102
3.21. Mbledhja dhe analiza e të dhënave	104
3.22. Konsiderata etike	105
IV. Hulumtimi empirik – Rezultatet e analizës së të dhënave.....	106
4.1. Prezantimi i gjetjeve në shkollë – rezultatet e pyetësorit.....	106
4.2. Rezultatet e intervistës me drejtorë.....	159
4.3. Rezultatet e intervistës me nxënës	162
4.4. Rezultatet e intervistës me mësimdhënës	169
4.5. Rezultatet nga vëzhgimi në klasë	175
V. Diskutime mbi gjetjet	186
5.1. Të dhënat e studimit për mendimet rreth përparësive të aplikimit të Vlerësimit Formues.....	187
5.2. Të dhënat për punën që realizohet në klasë përmes Vlerësimit Formues	190
5.3. Shembuj pozitivë nga disa klasë të vëzhguara, të cilat aplikojnë Vlerësimin Formues	199
5.4. Të dhënat nga pyetësori të paraqitura në dy nivele - nivelin e lartë dhe nivelin e ulët.....	202
5.4. Ndërlidhja e anës teorike me të dhënat nga hulumtimi	207

5.5. Përfundimi për rezultatet nga analiza e të dhënave	210
5.6. Rezultate nga hulumtime të tjera krahas studimit doktorat	213
VI. Konkludime dhe rekomandime.....	220
6.1. Rekomandime.....	226
6.1.1.Rekomandime për MASHT.....	226
6.1.2.Rekomandime për shkollën.....	227
6.1.3. Rekomandime për mësimdhënës.....	227
6.1.4. Rekomandime për prindër.....	229
6.1.5. Rekomandime për nxënës.....	230
○ Bibliografia	232
Shtojca 1.....	240
Pyetësi për mësimdhënës.....	240
Pyetjet e intervistës me drejtorë	244
Pyetjet e intervistës me nxënës	244
Pyetjet e intervistës me mësimdhënës	245
Vëzhgimi në klasë	245
Shtojca 2	
Grafikët e pyetësit	247
Shtojca 3	
Transkriptet e intervistës me drejtorë	270
Transkriptet e intervistës me nxënës	273
Transkriptet e intervistës me mësimdhënës.....	281
Transkriptet e vëzhgimit në klasë	288

LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE

Lista e figurave:

Figura 1.1: Modeli i bashkëveprimit nga Taba	23
Figura 1.2 Parimet e Tyler-it - Qëllimet arsimore që duhet të arrihen.....	24
Figura 1.3 Përbërësit e procesit mësimor sipas autoriteteve të sotme: metoda bihejvioriste e mësimdhënies dhe të mësuarit.....	25
Figura 1.4 Përmirësimi i të nxënësve në shkollë.....	27
Figura 2.1 Procesi i Vlerësimit Formues.....	36
Figura 3.1 Format e vlerësimit – Vlerësimi Formues dhe Vlerësimi Përmbledhës.....	42

Figura 3.2 Nivelet e vlerësimit.....	44
Figura 3.3 Mundësitë që ofrojnë Vlerësimi Formues dhe Vlerësimi Përmbledhës.....	51
Figura 3.4 Vlerësimet standarde për të nxënë e nxënësve.....	54
Figura 4.1 Mundësitë pozitive që ofron aplikimi i Vlerësimit Formues.....	57
Figura 4.2 Sistemi efektiv i aplikimit të Vlerësimit Formues	58
Figura 5.1 Informatat kthyesë që janë dhënë nga mësimdhënësit para trajnimit.....	65
Figura 5.2 Informatat kthyesë të dhëna nga mësimdhënësit pas trajnimit.....	66
Figura 5.3 Mendimet e nxënësve për informacionin kthyes.....	67
Figura 6.1 Qëllimi i kriterëve të suksesit për procesin e të nxënë.....	69
Figura 6.2 Shembuj nga feedback-u i dobishëm për detyrën me Shkrim të Anës.....	70
Figura 7.1 Ndërlidhja e objektivave, përmbajtjes, metodave dhe vlerësimit plotësuar me kriteret e suksesit dhe informatën kthyesë	205

Lista e tabelave:

Tabela 1 Numri i kampionit për hulumtim	94
Tabela 1.1 Trajnimi i Mendimit Kritik për Lexim dhe Shkrim.....	107
Tabela 1.2 Trajnimi për Mësimdhënësi Mentor.....	107
Tabela 1.3 Trajnimi i Vlerësimit Formues (për nxënie).....	108
Tabela 1.4 Trajnimi i Edukimit për të Drejtat e Fëmijës.....	108
Tabela 1.5 Trajnimi Hap pas Hapi.....	108
Tabela 1.6 Trajnime të tjera.....	109
Tabela 2.1 Vlerësimi Përmbledhës (i të nxënë).....	110
Tabela 2.2 Vlerësimi Formues (për nxënie).....	110
Tabela 3.1 Vlerësimi nënkupton njohuri të ndryshme.....	111
Tabela 4.1 Vlerësimi me notë.....	112
Tabela 4.2 Vlerësimi me fjalë.....	112
Tabela 4.3 Vlerësimi me notë dhe me fjalë.....	113
Tabela 5.1 Bashkëpunimi me kolegë për probleme të ndryshme me nxënës.....	114
Tabela 5.2 Bashkëpunimi me kolegë për planifikimin dhe realizimin e planit mësimor...114	
Tabela 5.3 Bashkëpunimi me kolegë për të nxënë cilësor të nxënësve.....	115
Tabela 5.4 Bashkëpunimi me kolegë për aplikimin e formave të ndryshme të vlerësimit.....	115
Tabela 6.1 Instrumentet e vlerësimit – vlerësimi me teste.....	116
Tabela 6.2 Instrumentet e vlerësimit – vlerësimi me gojë.....	116
Tabela 6.3 Instrumentet e vlerësimit – vlerësimi në tabelë.....	117
Tabela 6.4 Instrumentet e vlerësimit – vlerësimi përmes detyrave në fletore.....	117
Tabela 7.1 Format e vlerësimit që i motivojnë nxënësit – Vlerësimi Formues.....	118
Tabela 7.2 Format e vlerësimit që i motivojnë nxënësit – Vlerësimi Përmbledhës.....	119

Tabela 7.3 Format e vlerësimit që i motivojnë nxënësit–Vlerësimi Formues dhe Përmbledhës.....	119
Tabela 8.1 Për marrjen e të dhënave vlerësimi mbështetet në punën individuale të nxënësit.....	120
Tabela 8.2 Për marrjen e të dhënave vlerësimi mbështetet në punën në grup të nxënësit.....	121
Tabela 8.3 Për marrjen e të dhënave vlerësimi mbështetet vetëm në gjysmëvjetor.....	121
Tabela 8.4 Për marrjen e të dhënave vlerësimi mbështetet në fund të vitit shkollor.....	121
Tabela 8.5 Për marrjen e të dhënave vlerësimi mbështetet në vlerësimin sistematik.....	122
Tabela 9.1 Aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në përmirësimin e të nxënësve.....	123
Tabela 9.2 Aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në njohjen e shkallës së suksesit.....	123
Tabela 9.3 Aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në bashkëpunim me prindër.....	124
Tabela 10.1 Aplikimi i Vlerësimit Formues forcon motivimin e nxënësve.....	125
Tabela 10.2 Aplikimi i Vlerësimit Formues ndihmon nxënësit të përmirësohen.....	125
Tabela 10.3 Aplikimi i Vlerësimit Formues zhvillon tek nxënësit vetëvlerësimin.....	126
Tabela 10.4 Aplikimi i Vlerësimit Formues identifikon të arriturat e nxënësve.....	126
Tabela 10.5 Aplikimi i Vlerësimit Formues fokusohet se si mësojnë nxënësit.....	127
Tabela 10.6 Aplikimi i Vlerësimit Formues është pjesë e planifikimit efektiv.....	127
Tabela 10.7 Aplikimi i Vlerësimit Formues përkrah të kuptuarit e qëllimeve dhe kritereve.....	128
Tabela 11.1 Me vlerësimin e realizuar mësimdhënësit janë të motivuar për punë.....	129
Tabela 11.2 Me vlerësimin e realizuar nxënësit janë të motivuar për punë.....	129
Tabela 11.3 Me vlerësimin e realizuar nxënësit dhe prindërit janë të motivuar.....	130
Tabela 12.1 Vlerësimi Formues aplikohet në lëndën e gjuhës shqipe.....	130
Tabela 12.2 Vlerësimi Formues aplikohet në lëndën e matematikës.....	131
Tabela 12.3 Vlerësimi Formues aplikohet në lëndët e shkathhtësisë.....	131
Tabela 12.4 Vlerësimi Formues aplikohet në lëndën njeriu dhe natyra.....	132
Tabela 12.5 Vlerësimi Formues aplikohet në lëndën edukate qytetare.....	132
Tabela 12.6 Vlerësimi Formues aplikohet në të gjitha lëndët.....	132
Tabela 13.1 Vlerësimi Formues në klasë aplikohet për çdo njësi mësimore.....	133
Tabela 13.2 Vlerësimi Formues në klasë aplikohet për disa aktivitete.....	134
Tabela 13.3 Vlerësimi Formues në klasë aplikohet për çdo kapitull.....	134
Tabela 13.4 Vlerësimi Formues në klasë aplikohet një here në javë.....	134
Tabela 13.5 Vlerësimi Formues në klasë aplikohet një here në muaj.....	135
Tabela 13.6 Vlerësimi Formues në klasë aplikohet në çdo tremujor.....	135

Tabela 13.7 Vlerësimi Formues në klasë aplikohet në gjysmëvjetor	135
Tabela 14.1 Vlerësimi Formues aplikohet në klasë duke planifikuar kriteret e suksesit.....	136
Tabela 14.2 Vlerësimi Formues aplikohet në klasë duke vlerësuar nxënësit njëri tjetrin.....	136
Tabela 14.3 Vlerësimi Formues aplikohet në klasë duke dhënë informatën kthyesë.....	137
Tabela 14.4 Vlerësimi Formues aplikohet në klasë duke dhënë nxënësit informatën kthyesë njëri – tjetrit.....	137
Tabela 14.5 Vlerësimi Formues aplikohet në klasë duke bërë nxënësit vetëvlerësim.....	138
Tabela 15.1 Përmes Vlerësimit Formues kuptohet nëse nxënësit e kanë kuptuar mësimin.....	140
Tabela 15.2 Përmes Vlerësimit Formues kuptohet nëse nxënësit kanë nevojë për përsëritje.....	129
Tabela 15.3 Përmes Vlerësimit Formues kuptohet nëse nxënësit kanë nevojë për rifreskim të lëndës.....	140
Tabela 16.1 Format e ndryshme të vlerësimit janë të rëndësishme për nxënësit.....	141
Tabela 16.2 Format e ndryshme të vlerësimit janë të rëndësishme për prindërit.....	141
Tabela 16.3 Format e ndryshme të vlerësimit janë të rëndësishme për përcjelljen e shënimeve të plota në klasat më të larta.....	142
Tabela 16.4 Format e ndryshme të vlerësimit janë të rëndësishme për prindërit, që t’u jepen informata.....	142
Tabela 16.5 Format e ndryshme të vlerësimit janë të rëndësishme për zhvillimin psikomotorik të nxënësve.....	143
Tabela 17.1 Komunikimi me prindër realizohet me shkrim përmes fletore së nxënësit.....	144
Tabela 17.2 Komunikimi me prindër realizohet me shkrim përmes takimeve individuale me prindër.....	144
Tabela 17.3 Komunikimi me prindër realizohet me prindër në tremujore.....	145
Tabela 17.4 Komunikimi me prindër realizohet përmes bisedës telefonike.....	145
Tabela 17.5 Komunikimi me prindër realizohet edhe përmes formave tjera.....	146
Tabela 18.1 Komunikimi me prindër realizohet për përmirësimin e suksesit.....	147
Tabela 18.2 Komunikimi me prindër realizohet për kryerjen e detyrave të shtëpisë me rregull nga nxënësit.....	147
Tabela 18.3 Komunikimi me prindër realizohet për motivimin e nxënësve për nxënie cilësore.....	148
Tabela 18.4 Komunikimi me prindër realizohet për bashkëpunim mes nxënësve.....	148
Tabela 18.5 Komunikimi me prindër realizohet për qëllime të tjera.....	149
Tabela 19.1 Aplikimi i disa formave të vlerësimit ndikon pozitivisht në procesin mësimor.....	150

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

Tabela 19.2 Aplikimi i Vlerësimit Formues motivon nxënësit për nxënie cilësore.....	150
Tabela 19.3 Aplikimi i disa formave të vlerësimit ndikon në motivimin e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm.....	151
Tabela 19.4 Për aplikimin e Vlerësimit Formues a mendoni se duhet planifikuar kriteret e suksesit.....	151
Tabela 20.1 Korelacioni mes pyetjes 11.2 me 16.1.....	152
Tabela 20.2 Korelacioni mes pyetjes 11.3 me 18.1/18.2	153
Tabela 20.3 Korelacioni mes pyetjes 17.1 me 18.1/18.2	154
Tabela 20.4 Korelacioni mes pyetjes 10.1-10.7 me pyetjen 19.1 – 19.4	155
Tabela 1.1.1 Përgjigjet e drejtorëve të kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve.....	159
Tabela 2.1.1 Përgjigjet e nxënësve të kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve.....	162
Tabela 3.1.1 Përgjigjet e mësimeve të kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve....	169
Tabela 4.1.1 Vëzhgimet në klasë të kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve.....	175

Lista e grafikëve:

Grafiku 4.1 Ndikimi i metodave të reja në suksesin e nxënësve	37
Grafiku 4.2 Metodatat tradicionale në të nxënësit e nxënësve.....	38
Grafiku 5 Informacionet e mësimeve Vlerësimin Formues	213

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

Shkurtesa

MAShT – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

VPN – Vlerësimi për nxënie

VIN – Vlerësim i të nxënit

VF – Vlerësimi Formues

VP – Vlerësimi Përmbledhës

KK – Kurrikula e Kosovës

PZSHH - Planit Zhvillimor të Shkollës

JiTT – (Just in time teaching and learning) - Të mësuarit në kohën e duhur

MKLSH – Mendimi kritik për lexim dhe shkrim

MM – Mësimdhënës mentor

IPK- Instituti Pedagogjik i Kosovës

KKK- Korniza e Kurrikulit të ri të Kosovës

KEC- Qendra për Arsim e Kosovës

FNV – Fëmijë me nevoja të veçanta

Kapitulli I: Hyrje

1.1. Përshkrimi i situatës

Në bazë të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës është bërë planifikim për realizimin e suksesshëm të mësimdhënies dhe të nxënësve, përmes të cilit vërehet përkushtim i madh për përparimin e nxënësve. Koncepti kryesor është arritja e një të nxënës cilësor duke arritur tek rezultatet pozitive të nxënësve përmes aplikimit të formave të ndryshme të vlerësimit, e në veçanti Vlerësimit Formues, përmes të cilit arrihet të sigurohet kthimi i informacioneve nga ana e mësimdhënësve dhe prindërve për përmirësimet e nevojshme, duke dhënë rezultate të reja në procesin e të nxënësve. Psikologjia pedagogjike, nga ana e saj studion formimin e personalitetit të nxënësve, përvetësimin e shprehive e shkathtësive nga ana e nxënësve si dhe analizon përmirësimin e punës mësimore edukative. (Abdiu, 2010)

Ekzistojnë shumë faktorë të cilët kontribuojnë në të nxënësve të qëndrueshëm dhe cilësor të nxënësve, ku një ndër faktorët kryesorë të zhvillimit të rregullt të procesit mësimor është edhe vlerësimi.

Vlerësimi duhet të jetë pjesë e planifikimit të shkollës që para fillimit të vitit shkollor, në mënyrë që të arrihet një të nxënës cilësor për nxënësit përmes formave të ndryshme të vlerësimit dhe metodave të shumta të punës. Procesi i vlerësimit duhet të jetë në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies “proces përcjellës i ecures së nxënësit në zhvillim”(Zajazi, 2003:749), i lidhur ngusht me mbledhjen e informatave dhe të jetë lehtësues i pjesëmarrësve në proces, i cili paraqet hallkën kryesore në procesin e të nxënësve si proces i mbledhjes, analizimit dhe interpretimit të të dhënave. Është e rëndësishme që mësimdhënësit të planifikojnë qëllimin dhe objektivat për realizimin e orës mësimore ku

gjatë procesit mësimor duhet të sigurojnë material kthyes me qëllim të korrigjimit të gabimeve në mësimdhënie, planifikimit dhe realizimit të orës mësimore si dhe kritereve për vlerësim të të nxënësve. “Qëllimi i të nxënësve është elementi i parë aktiv i vlerësimit formativ në klasë ... pa qëllimet e të nxënësve, fëmijët janë viktimë e tekeve të mësimdhënësve”. (Murchan, Shiel & Vula, 2011, p.29) Mësimdhënësi duhet të bëjë planifikimin e vlerësimit që nga plani vjetor, mujor dhe ditor i punës së tij, për të arritur plotësimin e qëllimit dhe objektivave mësimore. Si pjesë përbërëse e planifikimit duhet të jetë edhe Vlerësimi Formues për të marrë parasysh informacionet paraprake që kanë nxënësit, në mënyrë që të njohin se ku ata kanë vështirësi, për t'i eliminuar ato. Në një studim të realizuar nga Gipss (1997) vërejmë se nga aplikimi i Vlerësimit Formues arrihet një ndërveprim në mes mësimdhënësit dhe nxënësit, nga e cila kuptohet një ndërlidhje bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të mësimdhënies dhe të nxënësve. (Bell, Beverly & Cowie, Bronwen, 2002) Po ashtu, pjesë e rëndësishme e procesit mësimor për ngritjen e cilësisë në të nxënë është edhe planifikimi i informimit të prindërve nga ana e mësimdhënësve për të arriturat e nxënësve në mënyrë sistematike në të gjitha lëndët mësimore.

Disa nga arsyet pse e bëjnë këtë studim të rëndësishëm janë të ndryshme si:

1) Evidentimi i aplikimit të Vlerësimit Formues në shkolla dhe ndikimi i kësaj forme të vlerësimit në të nxënësve të qëndrueshëm, reflektim cilësor, strukturimin e mësimdhënies, komunikimit dhe bashkëpunimit me prindër dhe përmirësimin e të nxënësve të nxënësve;

2) Evidentimi i zbatimit të pjesshëm dhe ndikimi i Vlerësimit Formues në të nxënë e qëndrueshëm dhe reflektim cilësor;

3) Evidentimi i aplikimit të Vlerësimit Formues nëse arrin që të bëjë informimin e nxënësve me kohë dhe nëse ndikon në riplanifikimin e ndryshimeve të nevojshme për strukturimin e mësimdhënies gjatë procesit mësimor;

4) Evidentimi i mënyrës së informimit të nxënësve, nëse ndikon në rritjen e cilësisë së komunikimit dhe bashkëpunimit me prindër për të arritur përmirësimin e të nxënë të fëmijëve të tyre;

5) Evidentimi i Vlerësimit Formues dhe mësimdhënësve si variabël i pavarur dhe ndikimi i tyre në përgatitjen e nxënësve dhe reflektimin cilësor si variabël i varur për ngritjen e cilësisë në të nxënë e qëndrueshëm.

Nga një pjesë e madhe e studiuesve dhe hulumtimeve për vlerësimin arrihet në një përfundim se ka mjaft mangësi rreth planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues, të cilat mangësi duhet plotësuar gjatë procesit të të nxënë. Po ashtu, mënyra apo forma e vlerësimit të nxënësve nuk zbatohet në një mënyrë të prerë në të gjitha shkollat, kur dihet se vlerësimi paraqet një përshkrim të gjërave që kanë ndodhur për një periudhë të caktuar. Sipas Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës “Arsimi në Kosovë ka për qëllim zhvillimin e dijes, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike”. (MASHT, 2011:15) Kjo u mundëson nxënësve që të jenë të vetëdijshëm, përgjegjës, kreativë, motivues, të pavarur e të aftë që në të ardhmen të aftësohen t’i shërbejnë shoqërisë në përgjithësi. Për të dhënë një rezultat të mirë nxënësit duhet të përgatiten të jenë komunikues të mirë, duke shkëmbyer informacione dhe përvoja

të ndryshme pozitive, duke krijuar besim tek vetja e tyre dhe duke krijuar besim tek të tjerët për t'u zhvilluar si personalitete në orientim drejt të ardhmes së tyre. Nxënësit duhet të përgatiten për menaxhimin e kohës, të njohin përparësitë dhe mangësitë e tyre, duke kontribuar për përmirësimin e punës dhe tejkalimin e vështirësive të ndryshme, të arrijnë të vlerësojnë dhe të vetëvlerësojnë për punën e pavarur me përgjegjësi drejt arritjes së qëllimit të vënë.

“Për një “nxënës të suksesshëm” shkolla angazhohet të kultivojë vazhdimisht kërkshërinë e natyrshme të fëmijëve/të rinjve për të nxënë si dhe të zhvillojë kompetencat për të mësuar”. (MASHT, 2011b:20)

Për ngritjen e cilësisë së të nxënësve është planifikuar edhe aplikimi i disa formave të vlerësimit për lehtësimin e punës së pjesëmarrësve në proces si dhe marrjen e informacioneve të nevojshme të cilat duhet të jenë në funksion të mësimdhënies dhe nxënies. Brenda Kurrikulës përfshihet Vlerësimi i brendshëm - vlerësimin në nivel klase dhe vlerësimin në nivel shkolle i cili organizohet nga mësimdhënësit dhe autoritetet e shkollës, si dhe Vlerësimin e jashtëm i cili bëhet me qëllim të verifikimit të cilësisë së vlerësimit në nivel klase, shkolle apo komune i cili organizohet nga autoritetet qendrore të arsimit ¹(MASHT, 2011c)

Për mbledhjen e të dhënave, analizimin, interpretimin e tyre dhe marrjen e vendimit për individ apo grup të caktuar vlerësimi paraqet hallkën kryesore në procesin mësimor.

Format e vlerësimit të cilat mund të planifikohen për t'u realizuar në shkollë janë vlerësimi diagnostifikues, klasifikues, formues, përmbledhës, i kontekstit, i burimeve, i procesit, i produktit, i brendshëm, i jashtëm dhe vetëvlerësimi.

¹Shih tek Korniza e Kurrikulës e Arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës fq. 49-53

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

Ideja, për të hulumtuar vlerësimin si proces është një ndër problematikat që përfshinë procesin mësimor në përgjithësi sepse duhet të jetë në funksion të mësimdhënies dhe të nxënësve cilësor. Për procesin e të nxënësve të efektshëm faktori kryesor konsiderohet të jetë mësimdhënësi për planifikim dhe realizim të strategjive të mësimdhënies, plotësim të informacioneve, mbledhjen e të dhënave, analizimin dhe interpretimin e tyre si dhe për marrjen e vendimit për individ apo grup të caktuar.

Vlerësimi Formues duhet të jetë pjesë përbërëse e hartimit të planit mësimor, përmes aplikimit të të cilit arrihet lehtësimi i punës së mësimdhënësve, informimi i saktë për nxënësit e po ashtu edhe i prindërve për përparësitë - mangësitë rreth të nxënësve të tyre dhe arritjen e eliminimit të gabimeve të mundshme.

Në studime të ndryshme thuhet se Vlerësimi Formues shërben për të mbledhur informata si dhe për të korrigjuar më pas punën në secilën fazë të procesit të mësimdhënies dhe nxënies. (Murchan, Shiel & Vula, 2011)

Rëndësia e përdorimit të Vlerësimit Formues në klasë, për të udhëzuar përmirësimin në mësimdhënie dhe nxënie, ka një histori të gjatë dhe të pasur në arsim. Në fakt, vlera e Vlerësimit Formues u identifikua gati katër dekada më parë. Në librin e tyre me ndikim, Manual mbi Vlerësimin Formues dhe Përmbledhës të mësimin të Studentëve, Benjamin Bloom, Thomas Hastings, dhe George Madaus (1971) i përshkruan të mirat e ofruara nxënësve përmes informacioneve kthyesë në të mësuarit e tyre, përmes Vlerësimit Formues në klasë. (Andrade & Cizek 2010)

Qëllimi i kësaj fushe studimi është hulumtimi i problematikës së vlerësimit të nxënësve në mënyrë sistematike përmes planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues (për Nxënie)

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

gjatë procesit të të nxënit është argumentim i punës së suksesshme të mësimitdhënësit për të nxënit e qëndrueshëm dhe arritje cilësore. “Mësimitdhënësit kanë bërë një raport për efektet pozitive të praktikave të Vlerësimit Formues pas planifikimit dhe organizimit të mësimeve, vendosjen e objektivave të qarta të të nxënit, përqëndrim i nxënësve në të nxënë jo thjesht si pjesëmarrës, por përfshirjen e të gjithë nxënësve përmes vetë-vlerësimit dhe angazhimit të nxënësve në përgjithësi” (Braid, 2012)

Punimi i temës së doktoraturës “Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues si komponente të rëndësishme” do të trajtojë rëndësinë e planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues (për Nxënie) në klasa për ngritjen e cilësisë në të nxënë. Pajisja e nxënësit me informata të nevojshme motivuese, atraktive ose këshilluese për të nxënit në mënyrë sistematike duhet të realizohet për t’i larguar nxënësit nga të nxënit e vazhdueshëm vetëm për notën dhe krahasimin me të tjerë.

Aplikimi i Vlerësimit Formues (për Nxënie) në shkolla nga ana e mësimitdhënësit ndikon drejtpërdrejt në motivim dhe bashkëveprim me nxënë, njohjen e arritjes së shkallës së suksesit për nxënie cilësore të qëndrueshme, për një komunikim e bashkëpunim të mirë me prindër, si dhe për riplanifikim të nevojshëm nga ana e mësimitdhënësit. “Vlerësimi Formues është një proces i cili përdoret nga mësimitdhënësit dhe nxënësit gjatë mësimitdhënies që siguron FEEDBACK, për të rregulluar mësimitdhënien dhe të nxënit e vazhdueshëm, për të përmirësuar arritjet e nxënësve prej rezultateve të synuara mësimore.” (Popham, 2008:5). Nxënësit do të shprehin gatishmërinë e bashkëpunimit për punë cilësore

në grup, që të arrihet motivimi i brendshëm për punë cilësore – kreative si dhe motivimi për të nxënë të suksesshëm.

Sipas Thompson & William (2008) “mësimdhënësi i cili në mënyrë të vetëdijshme përdor vlerësimin për të përkrahur mësimnxënien, e pranon këtë informatë, e analizon dhe merr vendime të cilat i adresohen kuptimeve dhe keqkuptimeve që janë zbuluar”. (Murchan, Shiel & Vula, 2011b:19)

Teoria e kësaj teze te doktoraturës është mbështetur në rezultatet e hulumtimit empirik të cilat u realizuan me drejtorët e shkollave, mësimdhënësit, dhe nxënësit e tri shkollave të Komunës së Gjakovës në Kosovë përmes pyetësorëve me mësimdhënëse, intervistave individuale me drejtorë e mësimdhënëse, intervistave në fokus grupe me nxënës dhe vëzhgimet në klasa, për të cilat rezultate është bërë edhe analizimi i të dhënave.

Përcaktimi teorik i nocioneve bazë

Studiues të ndryshëm janë munduar të japin shpjegime të shumta rreth nocioneve të cilat do të sqarohen si: nxënës, të nxënë, vlerësim, Vlerësim Formues, motivim i nxënësve. Meqenëse këto nocione do t'i takojmë gjatë tërë punimit do të sqarohen në përmasa të ngushta.

Nocioni nxënës - Nxënës konsiderohet ai fëmijë i cili nga përditshmëria familjare kalon në një rregull në bankat shkollore ku krijon aftësi “personi i cili mëson një temë apo aftësi: nxënës i shpejtë” (Soanes & Stevenson, 2005:996) dhe kontribuon në të nxënit, bashkëpunimin, krijimin e rregullave. Krijon bashkëpunim me shokët, vetëdijësohet për të nxënit dhe kryerjen e detyrave me rregull, zhvillon aftësitë individuale, për të lexuarit dhe të shkruarit, zhvillon të menduarit kritik dhe bëhet një planifikues i mirë i kohës.

Nocioni 'të nxënë' - Është një shkathtësi të cilën mund të arrijnë të gjithë, një veprimtari e pandërprerë e përfitimit të përvojës dhe e ndryshimeve të qëndrueshme

“proces nëpërmjet të të cilit nxënësi ose çdo njëri fiton njohuri, shprehi e shkathtësi gjatë procesit mësimor nëpërmjet fjalës së gjallë të mësimdhënësit, instruktorit, edukatorit ose çdo elementi të jashtëm në rolin e tyre si dhe nëpërmjet librit, punës në prodhim, stërvitjes ushtarake, mjedisit që e rrethon, jetës në organizatë, në kolektiv etj. Dhe nga ana tjetër, mëson t'i zbatojë njohuritë në punime të ndryshme teorike e praktike, në prodhim dhe në stërvitjen ushtarake, në jetë, kontrollon punën e vet dhe e ndreq atë” (Osmani, 1983:475)

por të cilën shkathtësi duhet ushtruar përmes të lexuarit të revistave e librave të ndryshëm, shkuarjes në trajnime të ndryshme me qëllim të nxënësve të njohurive të reja, komunikimit dhe bashkëpunimit me të tjerë, efekti i procesit të nxënësve shfaqet në përfitimin, zgjerimin, thellimin e njohurive dhe përvetësimin e shkathtësive e shprehive “Aftësia për të nxënë është po aq e rëndësishme kur përballesh me të metat, sa ç'është edhe kur feston sukseset. Në fund të fundit, qëllimi moral dhe agjentët e ndryshimit e vënë secilin mësimdhënës në një plan tjetër, ku njeriu mund të gjejë kuptimin vetjak në një përpjekje të përbashkët” (Fullan, 2002:165)

Sipas pragmatistëve “Të mësuarit ndodh kur njeriu angazhohet në zgjidhjen e problemeve; për më tepër, zgjidhja e problemeve mund të gjendet në një larmi të madhe lëndësh dhe situatash”. (Orstein & Hunkins, 2003:52)

Të mësuarit dhe të nxënësve mund të konsiderohen si sinonime, pasi të dy fjalët kanë arritjen e një qëllimi. Kjo veprimtari zhvillohet gjatë gjithë jetës. “Mësoj – mësuar apo kryesisht Britanike. Learnt 1. “fiton ose kërkon njohuri të mjeshtërisë (për diçka) nga studimi, përvoja apo nga ligjërimi i dikujt: ata kanë filluar të mësojnë frëngjisht, ajo po mëson të luajë në piano, ne mësojmë nga përvoja” (Soanes & Stevenson, 2005:996)

Të nxënësve konsiderohet si “përvetësimi i njohurive apo tendencat e sjelljes si rezultat specifik në jetën e një individi. Është shquar nga ndryshimet e sjelljes në sate të motivimit

(dëshirat, nevojat, gjendja e ndryshueshme psikologjike e një individi).” (Crystal, 2000:637)

Procesi i të nxënësve duhet të jetë kënaqësi për nxënësit, përmes këtij procesi mësimdhënës duhet të bëhet model për nxënësin, duke lënë përshtypje të mira tek ata dhe të nderohet me respekt gjithmonë.

Nocioni vlerësim - Fjala vlerësim është përcaktimi i vlerës së efekteve të një veprimi, metode të të mësuarit, të një lloji të organizimit të punës së caktuar etj., me anën e normave përkatëse, të kriterëve të caktuara ose të elementeve objektive. Vlerësim i njohurive – përcaktimi i shkallës sasiore dhe cilësore të njohurive të përfituara nga ana e nxënësve e studentëve, etj. nga lënda e caktuar në bazë të kriterëve dhe të formave vlerësuese të posaçme. (Nushi, 1987)

“Vlerësimi ka të bëjë me çdo lloj veprimtarie dhe instrumenti që përdoret për të gjykuar për punën dhe arritjet e nxënësve... Vlerësimi, në këtë mënyrë, ka të bëjë me teknikat që mund të përdoren për t’u kujdesur për përparimin e nxënësve për rezultate të caktuara mësimore” (Musai, 2003:244)

Sipas Salviaand Yssldyke vlerësimi është “...proces i mbledhjes së të dhënave në mënyrë që të merren vendime për një individ apo një grup të caktuar”. (Murchan, Shiel & Vula, 2011:15)

Sipas Gipps (1994) vlerësimi paraqet “... një varg metodash të përdorura për matjen e performancës dhe arritjes së nxënësve duke përfshirë testimin, provimet, vlerësimet e punës praktike, vlerësimin me gojë, vlerësimet me bazë në klasë, të udhëhequra nga mësimdhënësit”. (Murchan, Shiel & Vula, 2011i:15)

Sipas Assessment reform group (2002) vlerësimi "...është proces i kërkimit dhe interpretimit të provave nga nxënësit dhe mësime dhënësit e tyre për të vendosur se ku janë nxënësit, ku duhet të arrijnë ata dhe si të arrijnë atje më së miri". (Murchan, Shiel & Vula, 2011j:15)

Mendimi i marrë nga McInnis dhe Divlin, 2002 për vlerësimin u drejtohet mësime dhënësitve dhe gjithë atyre që janë të kyçur në procesin mësimor duke u thënë se "Vlerësimi duhet t'u komunikojë mësime dhënësitve se si ta bëjnë mësime dhënësin më efektive. Vlerësimi është një komponent i pandarë dhe i rëndësishëm i të gjithë procesit të mësime dhënësit dhe të nxënësve" (Marsh, 2009:72)

Vlerësimi i cili aplikohet për qëllime mësimore i shërben pozitivisht pjesëmarrësve në procesin e të nxënësve i cili "siguron një feedback për përpërimin e nxënësve; siguron një informacion për efektshmërinë e mësime dhënësit; efektshmërinë e materialeve mësimore; u siguron nxënësve një feedback për përpërimin e tyre; motivon nxënësit; vlerëson gatishmërinë e nxënësve për nxënie të mëtejme". (Hyseni, Mita, Salihaj, & Pupovci, 2003:184)

Nocioni Vlerësim Formues (Vlerësim për Nxënie) – Bloom (1969) thotë se "Vlerësimi formativ shërben për të mbledhur informata kthyesë si dhe për të korrigjuar më pas punën në secilën fazë të procesit të mësime dhënësit dhe mësimnxënies" (Murchan, Shiel, & Vula, 2011k:19)

Vlerësimi Formues është: procesi i shpalimit dhe kuptimit se çfarë nxënësit dinë në mënyrë që të zgjidhet rruga më e mirë e të nxënësve (Greenstein, 2010)

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

Vlerësimi për nxënie ndryshon nga vlerësimi i të nxënit sepse informacioni i mbledhur në mënyrë sistematike rreth punës së nxënësve përdoret, për t'i ndihmuar nxënësit që ta përmirësojnë punën e tyre. (Murchan, Shiel & Vula, 2011) Pra, në klasat ku mësimdhënësi mbledh informacione gjatë procesit mësimor, duke e planifikuar në mënyrë të vazhdueshme vlerësimin e nxënësve nëse kanë përparuar ose jo, janë klasat më efektive në të cilat vërehet ndryshimi i rezultatit. (Callahan, 2006)

Me aplikimin e Vlerësimit Formues arrihet mbikqyrja e përparimit të nxënësve gjatë procesit të të nxënit e po ashtu sigurohet dhënia e feedbackut për të lehtësuar të nxënit e tyre për përmirësimin e tij. (Murchan, Shiel & Vula, 2011) “Vlerësimi Formues mbikëqyr ecurinë, procesin, përparimin e programeve, projekteve, të nxënësve, të mësimdhënësve, siguron një feedback për të sjell përmirësime” (Hyseni, Mita, Salihaj & Pupovci, 2003:185)

Vlerësimi duhet të planifikohet me kujdes dhe të ketë si qëllim kryesor përmirësimin e të nxënit të nxënësve duke arritur të zhvillojë tek ata një performancë të mirë në arritjen e të nxënit të qëndrueshëm dhe cilësor. (Shahini, 2013)

“Ka si synim të nxisë të nxënë të mëtjshëm të nxënësve. Ai mund t’ia arrijë qëllimit, duke u siguruar nxënësve vërejtje konstruktive e komente të dobishme, duke i dhënë informacion mësimdhënësit, duke e ndihmuar, gjithashtu, të plotësojë më mirë nevojat e nxënësve për nxënie të mëtjshme. Në mënyrë tipike, ky vlerësim synon të identifikojë gabimet, të metat dhe vështirësitë në punën e nxënësve dhe t’u jepet ndihmë atyre” (Musai, 2003:245)

Vlerësimi informues realizohet në shkolla për nxënësit me qëllim të marrjes së informacioneve të nevojshme rreth nxënësve për përparimin apo rënien e suksesit të tyre në mënyrë të vazhdueshme. (Demiraj, 2000)

Nocioni motivim i nxënësve – si pjesë e rëndësishme e procesit të të nxënit konsiderohet motivimi i cili konsiderohet se “është gjendje e brendshme shpirtërore që gjallëron, drejton

dhe mbështet sjelljen”. (Woolfolk, 2011:376), po ashtu konsiderohet se paraqet arsyen për një sjellje të caktuar “është një nga bazamentet e suksesit të njeriut e aq më tepër në shkollë, kur ai e shtyn atë drejt suksesit në diplomimin e tij”. (Peshkepia, 2012:154) Tek secili person "motivimi...krijon situata, reagime dhe emocione pozitive e negative” (Kaza, 2009:61)

Nxënësit duhet të motivohen duke i bindur që mësimi ka vlerë, duke krijuar një mjedis të këndshëm pune e po ashtu duke u paraqitur modele të mira që nxënësit të formohen sipas tyre në mënyrë që ata të mbështeten gjithmonë në pozitiven. (Garo, 2002) “Përmes motivimit të brendshëm individi tregon aftësi, ndihet i sigurt dhe kompetent në hapësirën ku vepron”, kurse në “motivimin e jashtëm individët marrin pjesë në veprimtari të caktuara jo me interes real, por të tërhequr nga një qëllim përfitimi”. (Kaza, 2009: 62)

Sipas disa psikologëve të cilët kanë shpjeguar motivimin, disa njerëz ndiejnë një nevojë të fortë për të arritur sukses në një fushë të caktuar dhe punojnë shumë për të arritur synimin në veprimin e planifikuar. Sipas Teorisë së vlerësimit konjitiv thuhet se nëse nxënësit marrin informacion kthyes që rrit zotësinë tek ata, motivimi i brendshëm do të rritet, pra feedbacku që përcillet tek nxënësit duhet që të nxjerrë në pah zotësinë që ka filluar rritje tek nxënësit si ndryshim pozitiv. (Woolfolk, 2011:382)

Sipas Teorisë psikologjike të të mësuarit dhe motivacionit shpjegohet se besimi në vetvete për qëllimet personale dhe vlerat e saj për një arritje në të nxënë duhet të mbështetet në dy pyetje të drejtpërdrejta: “A mund të kem sukses” dhe “A dua të kem sukses dhe pse?” (Musai, 2003:754). Përmes kësaj teorie arrijmë në një përfundim se nxënësit mund të motivohen në mësim duke i përqëndruar në veprimtarinë e të nxënës në mënyrë të

vazhdueshme, për t'i dhënë përgjigje pozitive këtyre pyetjeve se janë të arritshme dhe secili nga nxënësit mund të arrijë suksesin e dëshiruar përmes punës dhe angazhimit.

Po ashtu kuptohet se nxënësit nxiten përmes vlerësimit që ta organizojnë punën e tyre duke mësuar atë që kërkohet nga ata në atë mënyrë që të dalin sa më të suksesshëm. (Musai, 1996)

1.2. Organizimi i përmbajtjes së kapitujve

Ky studim, përkundër angazhimit, punës dhe sfidave të ndryshme ka arritur që t'i tejkalojë me sukses duke mbledhur të dhëna të mjaftueshme dhe t'i analizojë ato.

Në kapitullin e parë, “Hyrja” trajtohet përshkrimi i situatës i cili përmbledh faktorët të cilët kontribuojnë në të nxënit e qëndrueshëm dhe reflektimin cilësor, ku si faktorë me rëndësi në procesin mësimor është edhe vlerësimi, shqyrtohet përcaktimi teorik i nocioneve bazë ku jepen sqarime më të hollësishme për secilin nga nocionet si: nocioni nxënës, të nxënë, vlerësim, Vlerësim Formues, motivim i nxënësve, duke sqaruar secilën nga fjalët kyçe të temës të cilat i takojmë gjatë gjithë studimit dhe organizimit të përmbajtjes së kapitujve.

Në kapitullin e dytë, trajtohet shqyrtimi i literaturës për planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues, i cili është mbështetur në një numër të madh teorish të marra nga shumë autorë, të bëra në vite të ndryshme të studimeve; qëllimi dhe faktorët për arritjen e një të nxëni cilësor, roli i kurrikulës si faktor i të nxënit për rregullimin e procesit mësimor – duke analizuar edhe qasjen bihejvioriste ndaj vlerësimit. Vazhdon me përshkrimin e shkollës – faktor i të nxënit të nxënësve me programin e saj, për të arritur tek nxitja e

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

nxënësve për arritjen e një rezultati pozitiv; mësimdhënësi – faktor kyç i të nxënit duke iu ofruar mundësi përmirësimi nxënësve në të nxënit e tyre; ndikimi i metodave të mësimdhënësit për motivimin e nxënësve përmes aplikimit të Vlerësimit Formues; nxënësi – faktor i të nxënit dhe përgatitja e nxënësit për arritjen e rezultateve pozitive në të nxënë, duke arritur tek vlerësimi në procesin e të nxënit si faktor pozitiv. Rëndësia e përshkrimit bie në vlerësimin si proces në ndryshimin e formës së të mësuarit të nxënësve i bazuar në kontroll e matje njohurish, për të arritur tek motivimi i nxënësve në të nxënit e tyre përmes aplikimit të Vlerësimit Formues.

Trajtohet nevoja e planifikimit të më shumë formave të vlerësimit - aplikimi i Vlerësimit Formues dhe Vlerësimit Përmbledhës, vlerësimin si faktor ndikues në motivimin dhe rimotivimin e nxënësve, trajtohet koncepti i mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve për ndryshimin, krahasimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues (për nxënie), ku me rëndësi është trajtimi i vlerësimit, i bazuar në matje e kontroll njohurish për sigurimin e informacionit rreth përparimit apo ngecjes së nxënësve, planifikimin dhe realizmin e kriterëve të suksesit, vëzhgimi i nxënësve për punën që e realizojnë për një sukses më të mirë, komentet përshkruese si tregues të saktë për anët e forta dhe të dobëta të nxënësit. Më pas vërehet edhe kompletimi i portfolios së nxënësve dhe vlerësimin e saj, duke arritur që nxënësit t'i bëjmë përgjegjës për arritjet e tyre, vëzhgimet në klasë, informacionet e marra nga prindërit, vetëvlerësimi - vlerësimi i ndërsjellë mes nxënësish dhe ndikimi i metodave të mësimdhënies në motivimin dhe rimotivimin e nxënësve gjatë procesit të të nxënit. Në fund të këtij kapitulli arrijmë në sigurimin e informacioneve të qëndrueshme e cilësore përmes aplikimit të Vlerësimit Formues në bashkëpunimin mes mësimdhënësve,

prindërve dhe nxënësve për ndryshimin, krahasimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues në arritjen e një të nxëni të suksesshëm.

Në kapitullin e tretë, trajtohet metodologjia e përdorur në studim - sa cilësore, po ashtu dhe sasiore, ndërlidhëse dhe eksperimentale me nxënës të klasave fillore, si dhe nevoja për hulumtimin e këtij studimi. Objekti i hulumtimit është bërë me qëllim të përcaktimit të shkollave dhe kampionit për marrjen e të dhënave sa më të sakta të nevojshme; janë përcaktuar detyrat e hulumtimit për të arritur tek mbledhja e literaturës dhe analizimi i studimit që do të realizohet gjatë studimit. Arrihet tek qëllimi pse duhet realizuar një hulumtim të tillë, parashtrimi i problemit si dhe rëndësia e studimit për planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues në shkolla në eliminimin e vështirësive të ndryshme, për të arritur tek ndryshimet e nevojshme. Trajtohen objektivat e hulumtimit me qëllim të argumentimit të punës së suksesshme të mësimeve në bashkëpunim me prindër, shtrohen pyetjet kërkimore me hipotezat dhe variablat, të cilat janë planifikuar për identifikimin e vështirësive të ndryshme në procesin e të nxënit. Trajtohen po ashtu metodat kërkimore të përdorura, përcaktohet popullata dhe kampionimi i studimit i përzgjedhur në tri shkolla fillore të Komunës së Gjakovës, hartohen instrumentet që përdoren në hulumtim: pyetësi për mësimeve, intervista me drejtorë, intervista e gjysmëstrukturuar e realizuar individualisht me mësimeve, intervista gjysmëstrukturuar e realizuar në fokus grupe me nxënës si dhe vëzhgimi në orë mësimore. Trajtohen kufizimet e metodologjisë, hartimi dhe historiku i kërkimit duke përshkruar fazat e kërkimit, procedurën dhe hartimin e instrumenteve të kërkimit, ku arrihet tek mbledhja dhe

analiza e të dhënave të marra nga hulumtimi, dhe konsiderata etike për personat e përfshirë në hulumtim.

Në kapitullin e katërt, trajtohen rezultatet e hulumtimit, duke treguar besueshmërinë e instrumenteve dhe planin e analizës për hulumtim. Rezultatet hedhin dritë të mëtejme mbi kundërshtitë e vazhdueshme në studimet arsimore dhe ndërkulturore, mbi përvojat e planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues. Kërkimet empirike që parashtrihen në këtë studim tregojnë se planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues krijon shumë përfitime në procesin e të nxënës, duke përfshirë një produktivitet të lartë, performancë më të mirë dhe një cilësi që do të vazhdojë gjatë. Kërkimet e analizuara tregojnë se nxitja rreth realizimit të këtyre qëllimeve shoqërohet me mësimdhënie dhe nxënie cilësore në procesin mësimor. Këtu prezentohen rezultatet e gjetjeve në shkolla të pyetësorit, intervistave me drejtorë, nxënës e mësimdhënës dhe vëzhgimi në klasë. Ky punim synon të tregojë se përdorimi i shumë formave të vlerësimit e në veçanti aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë në procesin e të nxënës.

Në kapitullin e pestë, trajtohen të dhënat e studimit rreth mendimeve që marrim nga mësimdhënësit, drejtorët dhe nxënës rreth përparësive të aplikimit të Vlerësimit Formues, për punën që e realizojnë mësimdhënësit në klasë përmes kësaj forme të vlerësimit, disa shembuj pozitivë për punën e suksesshme në klasat e vëzhguara ku aplikohet Vlerësimi Formues, ndërlidhja e anës teorike me të dhënat e dala nga hulumtimi, si dhe disa analiza dhe përfundime të nxjerra si rezultate nga shtatë hulumtime të tjera të realizuara krahas studimit doktoral për Vlerësimin Formues të publikuara brenda dhe jashtë shtetit.

Në kapitullin e gjashtë, trajtohen përfundimet dhe arrijmë tek rekomandimet të cilat i drejtojmë për MASHT, shkollën, mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit të cilat kanë për qëllim plotësimin dhe ndryshimin në procesin mësimor, duke përfshirë format e ndryshme të vlerësimit, po ashtu përfshirjen e të gjithë nxënësve në përmirësimin e të nxënësve përmes aplikimit të Vlerësimit Formues.

Rekomandimet janë me interes në përdorimin e më shumë formave të vlerësimit gjatë punës në klasë, të realizohet një vëzhgim i mirë i punës me nxënësit në klasë dhe në familje. Të bëhet planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve mësimore në klasë dhe jashtë saj si ndihmë në njohjen dhe analizimin e të dhënave që marrim nga nxënësit për të arritur tek një vlerësim bindës për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin mësimor.

Shtojcat:

Shtojca 1 - ku paraqitet pyetësi, pyetjet e intervistës për drejtorë, pyetjet e intervistës për nxënësit, pyetjet e intervistës me mësimdhënësit si dhe plani i vëzhgimit në klasë;

Shtojca 2 – ku paraqitet grafiku i analizës së pyetësorëve;

Shtojca 3 – ku paraqiten transkriptet e intervistave të realizuara me drejtorë, nxënësit, mësimdhënësit dhe vëzhgimet në klasë.

Kapitulli II. Shqyrtimi i literaturës për planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues

Qëllimi i këtij kapitulli është i lidhur drejtpërdrejt me hipotezat dhe pyetjet kërkimore që ka ngritur ky studim. Është mbështetur në një numër të madh teorish, pasi këto teori kanë dhënë sqarime të rëndësishme për të shpjeguar rreth kurrikulës, shkollës, nxënësit e mësimdhënësit si faktorë të rëndësishëm në procesin e të nxënës, duke vazhduar tek vlerësimi në përgjithësi. Studimi në vazhdim trajton rëndësinë e planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues si pjesë e rëndësishme e procesit mësimor në motivimin dhe rimotivimin e nxënësve për të arritur tek një të nxënë të qëndrueshëm dhe cilësor.

2.1. Qëllimi dhe faktorët e të nxënës

Për organizimin e mësimi rilindësit japin mendime e ide të ndryshme, për brezin e ri; mendojnë se duhet të jenë më të arsimuar se brezi paraprak, me qëllim që të jenë në hap me kohën duke arritur që të përparojnë në mënyrë të vazhdueshme me qëllim të ngritjes së nivelit të të nxënës në shkollë. (Koliqi, 2002) Sipas Aleksandër Xhuvanit, qëllimi i të nxënës për nxënësit është përfitimi i diturive, me qëllim që tek nxënësit të arrijë zhvillimin e fuqive mendore dhe fizike. (Rexhepagiq, 1970) Arritja e një të nxënës të qëndrueshëm e cilësor tek nxënësit konsiderohet të jetë qëllimi kryesor në procesin mësimor. “Dija është memorie sociale, një lidhje me të kaluarën; por ajo është edhe shpresë sociale, një investim për të ardhmen” (Tarifa, 2012:37) prandaj, përmes të nxënës nxënësit arrijnë të organizojnë botën e tyre në atë mënyrë që të ketë kuptim për ta. Si faktorë për plotësimin e nevojave të shkollës dhe fitimin e përvojave të reja të të nxënës në shkollë është me rëndësi fuqizimi i

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

një bashkëpunimi në mes prindërve, mësimeve dhe nxënësve me qëllim që të sigurohen informacione apo të dhëna lidhur me të veçantat e secilit nxënës për t'i kontribuar përparimit të nxënësve në procesin mësimor.

Planifikimi dhe realizimi i programit të shkollës si faktor i të nxënësve cilësor, kontribuon në ambientimin e nxënësve në shkollë, arritjen e synimit dhe objektivave përmes përdorimit të literaturës shtesë nga ana e mësimeve, për të arritur aftësimin e nxënësve në punë e jetë. Që të arrihen rezultatet e pritura për suksesin pozitiv të nxënësve gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor është me rëndësi të bëhet një vlerësim në mënyrë sistematike, përmes aplikimit të formave të ndryshme të vlerësimit, e në veçanti Vlerësimit Formues për aktivitetet e realizuara në shkollë dhe jashtë saj. Sipas mendimit të Clarke, vlen të theksohet se "Vlerësimi Formues nuk është vetëm për strategjitë aktuale, por të konstatojë njohuritë formuese që kanë ndodhur pas gjetjes. Është për të përcjellur më tej përparimin e të mësuarit të nxënësve gjatë procesit mësimor". (Keeley, 2008:11)

Si faktor me rëndësi i procesit të të nxënësve konsiderohet forma e komunikimit, bashkëveprimit dhe vlerësimit të nxënësve nga ana e mësimeve e cila është një nxitje për ta "vlerat komunikative mësimeve – nxënës mbeten, njohuritë e marra shndërrohen në formim kulturor dhe eksperiencë dhe nuk kujtohen e nderohen ashtu siç kujtohen e nderohen marrëdhëniet". (Bojaxhi, 2004:20) Nuk mbahen mend njësitet mësimore për një kohë të gjatë, por kujtohet forma e komunikimit të mësimeve, bashkëpunimi e bashkëveprimi me nxënësve, si dhe aplikimi i formave të ndryshme të vlerësimit në situata të ndryshme mësimore.

Është e rëndësishme që edhe prindërit të jenë pjesë e shkollës, duke u ftuar dhe motivuar nga ana e mësimitdhënësve për t'u përfshirë në aktivitete të ndryshme shkollore dhe jashtëshkollore, për t'i kontribuar pozitivisht procesit mësimor dhe të nxënësve. Gjithashtu është me rëndësi që ata të njihen me suksesin – mosuksesin e fëmijëve të tyre përmes komunikimit direkt në takime të ndryshme apo indirekt përmes fletore të nxënësve me komente nxitëse apo këshilluese nga ana e mësimitdhënësit.

Për një punë cilësore dhe arritjen e vlerave në procesin e të nxënësve duhet të aplikohen format e ndryshme të vlerësimit, partneriteti mes faktorëve bashkëpunues nga menaxhmenti i shkollës, mësimitdhënësit, familja dhe komuniteti, ndërsa në të kundërtën nga mungesa e bashkëpunimit të ndonjërit nga këto hallka bashkëpunuese bën që ky proces të mos funksionojë si duhet, apo të dështojë plotësisht.

2.2. Roli i Kurrikulës – si faktor në të nxënësve

Korniza e Kurrikulës rregullon procesin e gjithëmbarshtëm të mësimin, është një plan afatgjatë i cili bëhet për arritjen e qëllimit dhe objektivave të dëshiruara “Qëllimi i kurrikulës është emancipimi i shoqërisë”. (Orstein & Hunkins, 2003:14)

Po ashtu duhet të planifikohen disa kritere duke u bazuar në shumë burime të përcaktuara, që të plotësohet qëllimi i kurrikulës “Kurrikula duhet të marrë parasysh nevojat dhe zërat e auditorit, gjykimet intuitive dhe parandjenjat e mësimitdhënësit, si dhe nevojat dhe interesat e nxënësve” (Orstein & Hunkins, 2003:18).

Sipas konstruktivistëve duhet të vëzhgohen anët e forta dhe të dobëta të nxënësve lidhur me njohuritë e mëparshme, të cilat kryesisht fokusohen në qëndrueshmërinë e

informacioneve të ndryshme tek nxënësit rreth të mësuarit për temat e ndryshme
mësimore. “Konstruktivistët e mbështesin vlerësimin për nxënie – Vlerësimin Formues dhe
vetëvlerësimin, në krahasim me vlerësimin e të mësuarit - Vlerësimin Përmbledhës”
(Vlerësimi i të mësuarit konstruktivist)²

Doll vë në dukje se “çdo shkollë ka një kurrikulë të planifikuar të pranuar zyrtarisht”, por
ajo ka edhe “një të tillë të paplanifikuar, jozyrtare dhe të fshehtë” që duhet të merret
parasysh. Kurrikula e planifikuar zyrtare përqëndrohet tek qëllimet, objektivat, lënda dhe
organizimi i mësimdhënies, kurrikula e paplanifikuar jozyrtare ka të bëjë me veprimin e
ndërsjellë psikologjik ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve veçanërisht me ndjenjat,
qëndrimet dhe sjelljet e tyre” (Esse pedagogjie)³

Sipas studiuesve të ndryshëm kuptojmë se kurrikula duhet të hartohet nga vetë
mësimdhënësit. Bazuar në mendimet e Doll dhe Olivia kuptojmë se mësimdhënësi luan
rolin kryesor në hartimin e saj; në përkufizimin që i bën Djui përvojës dhe arsimimit
tregohet se “kurrikula përfaqëson të gjitha përvojat që fëmijët përfitojnë nën udhëzimin e
mësimdhënësve.” (Fusha e kurrikulës)⁴

Nxënësit dhe mësimdhënësit do të jenë përfituesit më të mirë, nëse arrihet që të
planifikohet dhe realizohet vlerësimi në bazë të kurrikulës. “Zbatimi i vlerësimit bazuar në
kompetencat e përcaktuara me Kornizën e Kurrikulës, do t’u mundësojë mësimdhënësve
dhe shkollës që të jenë të saktë dhe të besueshëm në vlerësimin e arritjeve të nxënësve në
të gjitha shkallët e shkollimit të tyre”. (MASHT, 2011d:49)

²Vlerësimi i të mësuarit konstruktivist, marrë më 15 shkurt

2015 nga: <http://etec.cilt.ubc.ca/510wiki/EvaluationConstructivistLearning>

³ Esse pedagogjie, marrë më 17 gusht 2015 nga: <http://www.slideshare.net/AndiKullolli/ese-pedagogjie>


⁴Fusha e kurrikulës marrë më 17 gusht 2015 nga: <http://slidegur.com/doc/96884/fusha-e-kurrikulws-1>

Në Kurrikulën shkollore është e rëndësishme të synohet që zgjedhja e përmbajtjeve mësimore të plotësojë interesat dhe dëshirat e nxënësve duke e bërë të mësuarin motivues, të përfshihen lëndët e nevojshme shkencore e shoqërore, përmbajtjet mësimore, të përcaktohet niveli arsimor dhe përvojat e mësimdhënësve, numri i nxënësve, metodat e mësimdhënies dhe të mësuarit, si dhe vlerësimi si fazë e rëndësishme dhe delikate në procesin mësimor.

“Kur flasim për kurrikulën shkollore, kemi parasysh në radhë të parë, kurrikulën kombëtare të shkollës, por kurrikulë specifike ka edhe çdo shkollë, mbështetur fuqimisht në kurrikulën kombëtare dhe në specifikat e saj. Kurrikula fillon me planifikimin, si fazë e parë, duke vazhduar me zbatimin e kurrikulës dhe vlerësimin e kurrikulës”. (Kraja, 2006:180)

Kurrikula shkollore mund të plotësohet nga ana e drejtorisë së shkollës në bashkëpunim me mësimdhënësit për lëndët e nevojshme mësimore si lëndë zgjedhore ose plotësuese, apo plotësimit të përmbajtjeve të nevojshme, duke i kontribuar të nxënësve “shkolla mund ta plotësojë kurrikulën. Atë mund ta plotësojë drejtoria arsimore rajonale, duke shtuar lëndë, tema apo kapituj të veçantë në lëndë të veçanta që e gjykon drejtoria e shkollës” (Kraja, 2006:185), por kurrikula mund të plotësohet edhe nga ana e prindërve dhe komunitetit nëse e mendojnë si të nevojshme ndonjë plotësim apo ndryshim duke i kontribuar pozitivisht procesit të të nxënësve. Është me rëndësi që të nxënësve të orientohet drejt plotësimit të objektivave të matshme për të ndërtuar njohuri të reja, duke u vlerësuar dhe zbatuar ajo që mësohet për një integrim të shkollës me jetën. Një ndërlidhje mes objektivave, përmbajtjes, metodave dhe vlerësimit sjell tek një planifikim dhe realizim i plotë i procesit mësimor.

Figura 1.1: Modeli i bashkëveprimit nga Taba (Brady, 1995, p 81)



Mendimet edukative – arsimore⁵ (Veness, November 2010)


Nëse analizojmë qasjen bihejvioriste ndaj arsimit vërejmë se “Bihejvioristët besojnë se kurrikula duhet të organizohet në mënyrë të tillë që nxënësit të provojnë sukses në përvetësimin e përmbajtjes”. (Orstein & Hunkins, 2003:154).

Për mësimdhënien dhe të mësuarit bihejvioristët i kanë menduar dhe analizuar dhe disa përbërës, si mësimin e drejtpërdrejtë, të mësuarit e përsosur, mësimin e drejtuar dhe mësimin sistematik, të cilët janë menduar për situata të ndryshme të të mësuarit dhe arritjen e rezultateve pozitive.

Modeli i Tyler-it i paraqet thujse njëjtë qëllimet e mësimdhënies që duhet të arrihen duke përzgjedhur dhe analizuar se çfarë duhet të mësohet, duke organizuar përmbajtjen dhe veprimtaritë që janë të nevojshme për t’u realizuar përmes kritereve të parapara. (Marsh, 2009)

⁵Mendimet edukative – arsimore marrë më 12 mars 2015 nga: <http://educational-reflections.blogspot.com/2010/11/when-teachers-are-asked-to-develop.html>

Figura 1.2 Parimet e Tyler-it - Qëllimet arsimore që duhet të arrihen



(Marsh, 2009:30)

Tyler i kushton vëmendje të gjitha parimeve, duke filluar nga planifikimi dhe realizimi i kriterëve sipas nevojave dhe kërkesave të nxënësve, arritja e objektivave nga secili nxënës, të organizohet përvoja e të nxënit për arritjen e qëllimeve të caktuara duke i ndihmuar nxënësit në procesin e të nxënit. Ndërsa për parimin e fundit Vlerësimin, Tyler mendon se nxënësit duhet të vlerësohen në mënyrë sistematike duke mbledhur informacione në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha lëndët mësimore pra, duke aplikuar Vlerësimin Formues.

Cronbach mendon se Tyleri ka zbuluar Vlerësimin Formues, ku paraqet mendimin e tij duke qartësuar se “Tyleri theksonte se vlerësimi ka të bëjë me mbledhjen e provave për ndryshimet e shkaktuara në sjelljen e nxënësve dhe kjo mbledhje provash nuk duhet të jetë e kufizuar vetëm me provimet me laps e letër”. (Marsh, 2009:31)

Figura 1.3 Përbërësit e procesit mësimor sipas autoriteteve të sotme: metoda bihejvioriste e mësimdhënies dhe të mësuarit.

Mësimi i drejtpërdrejtë Modeli i Rosenshainit	Të mësuarit e përsosur Modeli i Bllokut dhe Andersonit
1. <i>Shpallni objektivat e të mësuarit.</i> Filloni mësimin me një paraqitje të shkurtërtë objektive. 2. <i>Përsëritni.</i> Bëni përsëritje të shkurtër të të mësuarit të kaluar ose të kërkuar. 3. <i>Paraqitni materialet e reja.</i> Materialet e reja paraqitni në hapa të vegjël të njëpasnjëshëm. 4. <i>Shpjegoni.</i> Jepni udhëzime dhe shpjegime të qarta e të hollësishme. 5. <i>Ushtroni.</i> Zhvilloni praktikë aktive me të gjithë nxënësit. 6. <i>Udhëzoni.</i> Udhëzoni nxënësit në fillim të praktikës; zhvilloni punë në klasë. 7. <i>Kontrolloni të kuptuarit.</i> Bëni disa pyetje; vlerësoni kuptimin e mësimit nga nxënësit. 8. <i>Jepni informacion.</i> Jepni informacion dhe bëni korigjime në mënyrë sistematike. 9. <i>Vlerësoni ecurinë.</i> Gjatë orëve të praktikës siguron nivelin 80 përqind e më shumë të suksesit të nxënësve. 10. <i>Përsëritni dhe testoni.</i> Lini vend për përsëritje dhe testim.	1. <i>Qartësoni.</i> Shpjegojuni nxënësve çfarë u kërkohet të mësojnë. 2. <i>Informoni.</i> Jepni mësim duke u mbështetur në shpjegimin për tërë grupin. 3. <i>Paratestoni.</i> Jepni një veprim <i>formues</i> mbi bazën askush gabim; nxënësit mund të kontrollojnë përgjigjet e tyre. 4. <i>Gruponi.</i> Në bazë të rezultateve, ndajeni klasën në grupe të përparura dhe të prapambetura (80 përqind vlerësohet përvetësim). 5. <i>Pasuroni dhe korigjoni.</i> Jepni grupit të përparuar mësim pasurues; jepni praktikë/ushtrime korigjuese grupit të prapambetur. 6. <i>Mbikqyrni.</i> Mbikqyrni ecurinë e nxënësve; ndryshoni sasinë e kohës së mësimdhënies dhe të mbështetjes për çdo grup sipas madhësisë dhe ecurisë së grupit. 7. <i>Testoni më pas.</i> Bëjeni një provim përmbledhës grupit të prapambetur. 8. <i>Vlerësoni punën.</i> Të paktën 75 përqind e nxënësve duhet të arrijnë zotërimin në testin e përgjithshëm. 9. <i>Rimësoni.</i> Nëse jo, përsëritni procedurat duke nisur me mësimin korigjues (grupe të vogla studimore, kujdestari individuale, materiale mësimore shtesë, detyra mësimore shtesë, literaturë plotësuese, praktikë, ushtrime).
Mësimi i drejtuar: Modeli i Hanterit	Mësimi sistematik:^a Modeli i Gudrit dhe Brofit
1. <i>Përsëritja.</i> Përqëndrohuni tek mësimi i mëparshëm; kërkojuni nxënësve të përmbledhin pikat kryesore. 2. <i>Parashikimi.</i> Përqëndrojeni vëmendjen e nxënësit tek mësimi i ri; nxisni interesin për materialet e reja. 3. <i>Objektivi.</i> Shpallni qartë çfarë do të mësohet; përcaktoni racionalen dhe si do të	1. <i>Përsëritja.</i> Përsëritni konceptet dhe shprehjet lidhur me detyrat e shtëpisë; jepni ushtrime përsëritëse. 2. <i>Zhvillimi.</i> Nxiti të kuptuarit e nxënësve, jepni shembuj, shpjegime dhe demonstrime 3. <i>Vlerësoni të kuptuarit.</i> Bëni pyetje, zhvilloni praktikë të kontrolluar. 4. <i>Puna në klasë.</i> Jepni punë të pandërprerë

jetë e dobishme. 4. <i>Informimi</i>. Identifikoni njohuritë dhe shprehjet e nevojshme për të mësuar mësimin e ri; paraqitni materialet në etapa të njëpasnjëshme. 5. <i>Modelimi</i>. Jepni disa shembuj ose demonstrime gjatë gjithë mësimin. 6. <i>Kontrolli i të kuptuarit</i>. Mbikqyrni punën e nxënësve para se të përfshihen në veprimtaritë për mësimin; kontrolloni nëse i kuptojnë udhëzimet ose detyrat. 7. <i>Praktika e drejtuar</i>. Bëni herëpashere pyetje ose probleme dhe kontrolloni përgjigjet e nxënësve. Përsëri mbikqyrni nëse i kuptojnë pyetjet. 8. <i>Praktika e pavarur</i>. Caktoni punë ose praktikë të pavarur kur, sipas arsyetimit tuaj, është e sigurtë që nxënësit mund të punojnë vetë duke hasur pengesën më të vogël dhe sepse e kanë kuptuar mësimin.	në klasë; angazhoni çdo nxënë; ruani interesimin. 5. <i>Përgjegjshmëria</i>. Kontrolloni punën e nxënësve. 6. <i>Detyrat e shtëpisë</i>. Caktoni rregullisht detyra shtëpie; jepni probleme përsëritëse. 7. <i>Përsëritje të posaqme</i>. Bëni përsëritje javore për të kontrolluar dhe rritur përvetësimin; bëni përsëritje mujore për të ruajtur dhe rritur më tej përvetësimin.
--	--

(Orstein & Hunkins, 2003:156 - 157).

Të katër modelet e mësimdhënies dhe të mësuarit janë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi të mirëfilltë mësimor. Tek secila metodë vërehet planifikimi i Vlerësimit Formues ku parashihet përsëritja gjatë gjithë vitit shkollor, rimësimi, kontrolli i të kuptuarit, angazhimi i të gjithë nxënësve në faza të ndryshme të orës mësimore. Planifikimi dhe realizimi i njërit model ose të katër modeleve mësimore sipas teoricientëve duket se na drejton në më shumë vëmendje për planifikim dhe realizim të Vlerësimit Formues në ngritjen e cilësisë për një të nxënë pozitiv, të qëndrueshëm e cilësor për nxënësit.

2.3. Shkolla – faktor i të nxënë të nxënësve

Programi i shkollës duhet të jetë i fuqishëm pozitiv dhe gjithpërfshirës për procesin e të nxënë, i hartuar para fillimit të vitit shkollor dhe i bazuar në Kornizën e Kurrikulës, por

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

nëse është e nevojshme shkolla mund të bëjë edhe ndryshime në hartimin e plan - programit. Si pjesë përbërëse e PZSHH (Planit Zhvillimor të Shkollës) duhet të jetë edhe vlerësimi i nxënësve, pra si pjesë e saj duhet që të parashihen edhe format e integritit të Vlerësimit Formues. Për t'u kuptuar qartë nga nxënësit dhe prindërit e tyre, vlerësimi duhet të jetë shumëdimensional dhe i përqëndruar në zhvillimin shoqëror, emocional dhe në zhvillimin njohës. Qëllim kryesor i Planit Zhvillimor të Shkollës duhet të jetë përfshirja e të gjitha palëve në interes, përmirësimi i punës në shkollë, përmirësimi i rezultateve të nxënësve dhe ngritja e cilësisë në të nxënësit e tyre, duke planifikuar të nxënë të suksesshëm dhe mësimdhënie cilësore. (Nagavci, 2012:18)

Figura 1.4 Përmirësimi i të nxënësit në shkollë

Fusha e cilësisë: Përmirësimi i vlerësimit të nxënësve						
Karakteristikat e cilësisë: Profesionalizimi i mësimdhënësve						
Prioritetet: Arritja e rezultateve më të mira nga nxënësit						
Synimet	Aktivitetet	Përgjegjësitë	Kostoja	Resurset	Afatet kohore	Monitorues
Zbatimi i standardeve të Vlerësimit sipas UA nr. 490/2011	Organizimi i trajnimeve për VpN	Drejtoresha dhe Facilituesit shkollor	E paraparë me buxhetin e shkollës	Doracakët dhe materialet tjera	Deri në qershor 2013	Kordinatori për zhvillim profesional në shkollë

(Nagavci, 2012:20)

Lidhja e shkollës me familjen për komunikim rreth nxënësve duhet të fillojë që në fillim të vitit shkollor, duke krijuar në shkollë disiplinë mësimore si nga ana e mësimdhënësve ashtu edhe e nxënësve për t'i kontribuar pozitivisht procesit të të nxënësit.

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

“Në kuadrin e bashkëpunimit mes shkollës dhe komunitetit, shkolla duhet të iniciojë e para fillimin, rritjen dhe forcimin e komunikimit me familjet rreth të gjitha kërkesave me të cilat përballlet edukimi, konkretisht vetë shkolla. Komunikimi duhet të realizohet veçanërisht për probleme të tilla si programe shkollore, procesin mësimor edukativ ... pa lënë pas dore komunikimin rreth përparimit të fëmijëve” (Lika, 2001:38)

Programi i shkollës duhet të ketë si qëllim që punët e saj t’i sistematizojë dhe organizojë në mënyrë perfekte duke nxitur aktivizimin mendor të nxënësve, edukimin dhe arsimimin e tyre e jo t’i lihen rastësisë, andaj “me shkollë dhe me mësim, jo vetëm që nxënësi mund të arsimohet në një drejtim të caktuar, por dhe të bëhet transformimi rrënjësor i shoqërisë njerëzore”. (Rexhepagiq, 2002:163) Kur mësimdhënësit bashkojnë forcat me nxënësit e tyre në procesin e Vlerësimit Formues, partneriteti i tyre gjeneron me rezultate të fuqishme të të mësuarit. Mësimdhënësit bëhen më efektivë, nxënësit bëhen të angazhuar në mënyrë aktive, dhe të dy të bëhen qëllimisht nxënës të shkathtë në realizimin e qëllimit të tyre. (Moss & Brookhart, 2009) Detyrë e shkollës dhe mësimdhënësve është që fëmijët të edukohen dhe arsimohen përmes komunikimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, duke e ndihmuar njëri - tjetrin.

Në shkollat tona ka edhe nxënës me vështirësi në të nxënë, vonesa në të menduar, në të dëgjuar apo paafësi fizike. Vlerësimi i nxënësve të tillë duhet të planifikohet dhe realizohet në mënyrë të kujdesshme. Për mbarëvajtjen e procesit edukativo – mësimor duhet të mendohet se si të tejkalohen dhe të plotësohen vështirësitë duke i’u përshtatur nevojave të nxënësve duke organizuar punë individuale me këta nxënës, duke i integruar në klasa të rregullta si të barabartë me nxënësit tjerë por edhe duke i kushtuar kujdes pak më të veçantë uljes së tyre sipas nevojave që kanë. Mësimdhënësit dhe prindërit duhet të kontribuojnë në tejkalimin e vështirësive të ndrryshme duke dhënë dhe marrë informacione të sakta dhe të mjaftueshme për nxënësit.

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

Gjithashtu për nxënësit e një niveli më të lartë të të nxënësve me inteligjencë të ndryshme me prirje në letërsi, art, matematikë, fizikë e lëndë tjera është i nevojshëm motivimi përmes metodave të ndryshme që të marrin pjesë në gara të ndryshme mes klasave, shkollave, qyteteve, regjioneve të cilët nxënës mund të identifikohen përmes aplikimit të Vlerësimit Formues dhe atij Përmbledhës. Nëse mbështetemi në modelin e vlerësimit sipas Stafëlbimit vërejmë se si vlerësohen nxënësit sipas vlerësimit të produktit ku mendon se ”mund të sigurohen të dhëna që tregojnë se kurrikula e shkencës e planifikuar për nxënësit e talentuar të shkencës, i ka ndihmuar nxënësit të realizojnë me sukses objektivat e programit” (Orstein & Hunkins, 2003:490)

Një shkollë efektive duhet të arrijë qëllimet, objektivat dhe detyrat e caktuara, të ketë një mësimdhënie efektive përmes personelit të kualifikuar.

“Shkollat efektive kanë një mjedis klase që është nxitës për të nxënë. Kjo d.m.th. interesimi i prindërve ndaj shkollës dhe njohurive që iu siguron ajo, marrëdhënie pozitive mësimdhënës – nxënës dhe mësimdhënës – drejtues shkolle; kanë objektiva të qarta që duhet të arrihen nga nxënësit për çdo lëndë apo mësimdhënës, u japin rëndësi aftësive bazë që duhet të përvehtësojë nxënësi, kanë objektiva të qarta të procesit të mësimdhënies dhe organizojnë një këqyrje të vazhdueshme të arritjeve të nxënësve” (Bojaxhi, 2004:379)

Përmes planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues arrijmë një nivel të mësimdhënies dhe nxënies së një shkolle efektive duke bërë ndërhyrje për të nxënë të qëndrueshëm, arritje cilësore gjatë procesit të të nxënësve, bashkëpunim të ndërsjellë mes stafit mësimor, familjet e nxënësve dhe me komunitetin. Mësimdhënësit duhet të përcaktojnë objektivat specifike dhe kriteret e vlerësimit të cilat duhet t’i arrijnë nxënësit. “Kriteri i vlerësimit tregon se me ç’mënyrë do të gjykohet nëse aftësia e synuar është arritur në mënyrë të kënaqshme. Po qe se kriteri përmbushet nga nxënësit, atëherë ju gjykoni se objektivi është arritur” (Muka, 1997:33)

Shkolla si institucion duhet t'u ofrojë nxënësve salla e kabinete të ndryshme të pajisura me mjete të nevojshme në mënyrë që secili nxënës të jetë aktiv, kreativ dhe krijues varësisht prej moshës së tij. Nxënësi do ta mbajë mend më gjatë nëse vlerësohet në mënyrë sistematike për mësimet e marra në mënyrë teorike dhe i ofrohet mundësia që të bëjë një ndërlidhje me punë praktike.

Shkolla duhet të krijojë një klimë të ngrohtë e mikpritëse për të gjithë duke filluar nga nxënësit, prindërit e komuniteti dhe të gjejë rrugë për t'iu ofruar mundësi për t'u angazhuar në veprimtari të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj. Mund të ofrojë një kuti të sugjerimeve duke i respektuar opinionet e tyre që të bëhet puna më efektive me nxënësit. Përmes kësaj kutie nxënësit, prindërit dhe të tjerë mund të shkruajnë komente të ndryshme si: falenderime e sygjjerime të ndryshme për realizimin ose mosrealizimin e planprogramit të shkollës, kohën të cilën e kalojnë nxënësit atje si dhe për ndryshimet që mendojnë se do t'i sjellin shkollës pozitivitet dhe ngritje të cilësisë në procesin e të nxënës.

2.3.1.Mësimdhënësi – faktor kyç i procesit të të nxënës

Mësimdhënësi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve i cili përmes një menaxhimi të suksesshëm të klasës krijon një rregull dhe redukton gabimet e mundshme duke organizuar kohën dhe mënyrën e të nxënësve. “Menaxhimi i mësimi ka të bëjë me drejtimin dhe organizimin e veprimtarive të tilla të të nxënës, duke synuar që të maksimalizohet përfshirja produktive e nxënësit në mësim”. (Musai, 2003:201) Është i dobishëm komunikimi i hapur, nxitës, i matur, i qartë e bashkëpunues me nxënësit, përmes teknikave të ndryshme të mësimdhënies për një mjedis produktiv pune.

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

Ngritja e cilësisë në procesin e të nxënësve arrihet po ashtu përmes kthimit të informacionit nga ana e mësimit dhe plotësimit të karakteristikave në kohën e duhur për nxënësit. Kthimi i informacionit përmes Vlerësimit Formues ka për qëllim komunikimin me prindër dhe që nxënësve t'u ofrojë mundësinë e përmirësimit të të nxënësve përmes aktiviteteve të shumta në klasë në lëndë të ndryshme mësimore.

“Ekziston mundësia për të hartuar aktivitete të Vlerësimit Formues për të nxënësit të mësuarit dhe zhvillimin formues ku nxënësit do të mund të përfshihen, duke bërë të mundur përdorimin e aktiviteteve formuese nga ana e mësimit, për të lehtësuar punën e nxënësve.

Të mendohet se çfarë nxënësit po mundohen të mësojnë;

Të provohet nga gjërat e jashtme dhe të mësohet nga gabimet;

Mendoni se për çfarë ata duan të mësojnë;

Të diskutohet për tema që nuk i kuptojnë.

....

Reflekto mbi nevojat e tyre të të mësuarit” (Irons, 2008:20)

Disa prindër nuk e konsiderojnë si të domosdoshme përfshirjen e tyre në shkollë, andaj mësimit duhet të organizojë dhe realizojë një plan për të përfshirë prindërit dhe faktorët tjerë si partnerë për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve në shkollë duke i informuar rregullisht për punën që realizojnë në klasë. Ky informim arrihet përmes komunikimit me prindër për sjelljen dhe suksesin e nxënësve, duke kërkuar dhe ndihmën e prindërve në raste të caktuara për të arritur ndryshime pozitive në klasë.

Prandaj është e domosdoshme që këta partnerë prind – mësimit – komunitet të kenë kontakte të kohëpaskohshme në mënyrë që mësimit të njohin stilet e komunikimit të familjeve të tyre dhe të kuptojnë në veçanti qëllimet e prindërve që kanë për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, në mënyrë që të arrijnë t'i ndihmojnë përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit. (Lika, 2001) Përmes shkrimit të komenteve pozitive ose negative në fletore të nxënësve, bisedave individuale, në çifte apo grupe në mënyrë të organizuar,

prindërit, e po ashtu edhe mësimeve, zgjerojnë horizontin e njohurive duke u informuar për nevojat, përparimin, prirjet dhe talentet e fëmijëve – nxënësve të tyre. Mësimeve duhet të arrijë të realizojë një kontakt pozitiv me prindërit, pra një komunikim të mirëfilltë, në mënyrë sistematike, duke aplikuar Vlerësimin Formues përmes shkrimeve të ndryshme në fletoret e nxënësve, mbajtjes së dosjes së nxënësve, shkrimit të të gjitha karakteristikave për secilin nxënës në veçanti. Dosja e nxënësit duhet të përmbajë shënime për personalitetin e nxënësit nga ana e prindërve si dhe të plotësohet me shënime tjera nga ana e mësimeve gjatë vëzhgimeve në klasë. Vizatimet e punimet e kryera nga vetë nxënësit, të plotësuara me komente të ndryshme përmes Vlerësimit Formues nga ana e mësimeve në mënyrë sistematike për arritshmërinë, janë po ashtu faktorë në ngritjen e cilësisë në të nxënë. Këto shënime janë të rëndësishme për nxënësin, familjen dhe për përcjelljen e shkrimeve të plota nga klasa në klasë, e në veçanti përcjellja e informatave të mjaftueshme për personalitetin e nxënësit dhe zhvillimin e tij psikomotorik në klasat më të larta gjatë gjithë procesit mësimor. Mësimeve duhet ta kuptojë se është më e lehtë që ta menaxhojë një orë mësimore nëse me dashamirësi pranon që në procesin mësimor të ftojë në klasë një prind për të treguar një përvojë. Të thërrasë dikë nga komuniteti që të tregojnë diçka që lidhet me profesionin e tyre dhe njësinë që do të mësojnë nxënësit në klasë, ku fëmijët mund të mësojnë mjaft për profesione të ndryshme dhe punën të cilën e bëjnë ata, ndërsa prindërit marrin një përvojë ditore për fëmijët e tyre, duke parë punën në klasë se si bashkëpunojnë, si sillen ata në klasë me bashkëmoshatarët e tyre gjatë orëve mësimore.

Do të ishte lehtësuese për mësimdhënësin nëse edhe prindërit do të vëzhgonin fëmijët dhe të bënin një vlerësim real, si për fëmijën e tyre ashtu edhe për nxënësit tjerë gjatë një ore mësimore; pra prindërit duhet ta kuptojnë se shkolla është e gatshme t'i pranojë ata si pjesë të pandashme nga shkolla në diskutime dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme që paraqiten gjatë procesit mësimor. Nëse funksionon në rregull bashkëpunimi me prindërit, edhe vështirësitë e ndryshme vijnë deri te një zgjidhje e lehtë. "Mësimdhënësit duhet të jenë të përgatitur që t'u përgjigjen pyetjeve të ngritura nga prindërit sa i përket procedurave të notimit, arsyet pse fëmijët e tyre nuk po përparojnë aq sa duhet, si t'i ndihmojnë nxënësit në shtëpi, arsyet për mbajtjen e testeve mbarështetërore, përveç testeve shkollore, dhe çfarë nënkuptojnë notat dhe si të interpretohen pikët". (Shermis & Di Vesta, 2011:9)

Prindërit duhet të nxiten për pjesëmarrje në shkollë, në aktivitetet praktike që drejtohen tek fëmijët e tyre, të informohen me kohë për vendimet të cilat i merr mësimdhënësi apo shkolla, në mënyrë që të vazhdojë bashkëpunimi dhe mbështetja ndaj njëri – tjetrit. Tek fëmijët ngjallen shpresa pozitive për ide të reja dhe organizimin e drejtë të procesit mësimor, duke punuar së bashku në veprimtari të ndryshme dhe krijimin e marrëdhënieve të ngrohta për bashkëpunim në klasë. Nëse menaxhimi i klasës realizohet me sukses, një gjë e tillë përmirëson bashkëpunimin mes nxënësve dhe arrin që t'i motivojë ata për mësim produktiv e cilësor. (Spahiu, 2003)

Përveç përmbajtjeve të programit mësimor, çelës i suksesit për mësimdhënësin është edhe raporti me nxënësit tek të cilët duhet të reflektojë gjithmonë dashuri dhe pozitivitet, me gjithë personalitetin e vet, duke ndikuar në drejtimin e nxënësve dhe zhvillimin e tyre të mëtutjeshëm, në mënyrë që t'i nxisë ata të pyesin dhe të japin përgjigje, duke zhvilluar tek

nxënësit të menduarit për të realizuar procesin e të nxënit aktiv dhe cilësor. (Zylfiu, 1980)

Sipas Black & Harrison vlen të theksohet se në një klasë ku Vlerësimi Formues është në qendër, mësimdhënësit ndërveprojnë më shpesh dhe në mënyrë efektive me nxënësit e tyre mbi një bazë në një mënyrë sistematike, duke e aplikuar çdo ditë, për të promovuar të nxënit e tyre. (Keeley, 2008).

Mësimdhënësit duhet të jenë të përgatitur që mësimin ta zhvillojnë në klasë dhe jashtë saj, duke organizuar aktivitete të ndryshme me nxënës për t'iu ngjallur imagjinatën, kureshtjen, kreativitetin, që të përmirësojnë arritjet e tyre akademike gjatë procesit të të nxënit. Që procesi i të nxënit të ecë përpara dhe të jetë i suksesshëm, në shkollë duhet të ndihet një atmosferë frymëzuese ku mësimdhënësit – nxënësit – prindërit të aktivizohen në mënyrë efektive të punojnë edhe përmes aktiviteteve të lira.

Nxënësit ndryshojnë mes vete në mënyrë të konsiderueshme si për nga fiziku, personaliteti i tyre e po ashtu edhe për nga angazhimi i tyre në aktivitetet shkollore e jashtëshkollore. Po ashtu, interesimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme, gjatë punës arsimore, paraqitet në shkallë të ndryshme gjatë procesit të të nxënit në përgjithësi.

Një lloj i të mësuarit përmes aktiviteteve të lira është të mësuarit hulumtues, nëse nxënësit i nxjerrim jashtë në natyrë për shëtitje apo ekskursion. Ata kanë mundësi të mbledhin insekte të ndryshme, lloje të bimëve për të punuar herbariume të ndryshme; shëtitjet rreth lumenjve e liqeneve; vizitë objekteve të ndryshme si muze, teatro, galeri të arteve të cilat shërbejnë si motiv për procesin e të nxënit dhe ndërlidhjen e mësimit teorik me atë praktik. Shëtitja në natyrë si aktivitet i lirë mund t'i shërbejë procesit të të nxënit, ngase nxënësit informohen për natyrën në përgjithësi si dhe për kujdesin që duhet të kemi ndaj saj.

Organizimi i kuizeve të diturisë në mes klasave dhe shkollave të ndryshme, marrja pjesë në konkurrim me instrumente të ndryshme, në recitale, në grupe këndimi, sporte të ndryshme, në mënyrë që përmes këtyre aktiviteteve të lira t'i kontribuojnë pozitivisht procesit të të nxënësve.

Punimet e bëra nga vetë fëmijët gjatë orëve mësimore mund të vlerësohen dhe të ekspozohen nëpër klasa dhe korridore të shkollës, duke u paraqitur si vlera pozitive të të nxënësve.

2.3.2. Ndikimi i metodave të mësimdhënies në motivimin dhe rimotivimin e nxënësve


Metodat e mësimdhënies paraqesin një grumbull të njohurive, aftësive dhe shkathtësive që duhet të zotërojnë nxënësit për përmbushjen e sukseshme të pritshmërive të përgjithshme. Forma e motivimit të nxënësve duhet të ndryshojë varësisht prej moshës së nxënësve dhe kohës së veprimit gjatë vitit shkollor. "Bihejvioristët flasin për shpërblimet dhe ndëshkimet si ndikim madhor në të nxënësve. Është e qartë se sjellja mund të fokusohet drejt një shpërblimi ose tutje një ndëshkimi". (Education, October 2010)⁶

Brenda klasës mund të planifikohet nga mësimdhënësi motivimi i nxënësve bazuar në suksesin dhe personalitetin i tyre përmes aplikimit të Vlerësimit Formues, ku vërejmë edhe pesë mënyra të ndryshme që tregojnë se procesi i Vlerësimit Formues mund të aplikohet në klasë. Planifikimi dhe realizimi i këtyre mënyrave na drejton në një të nxënë të qëndrueshëm dhe cilësor, pasi për ndryshime të nevojshme për një klimë të ngrohtë e bashkëpunuese në klasë ofrohen mundësi të shumta, duke filluar nga ndërlidhja e njësive të

⁶Çfarë Motivimi është dhe pse është e rëndësishme në situata klase, marrë më 5 qershor 2015 nga <http://www.shabait.com/categoryblog/3200-what-motivation-is-and-why-it-is>

kaluara me ato të ardhmet, aplikimi i teknikave të ndryshme mësimore me nxënës, për të arritur tek rregullimet e përshtatshme mësimore.

Figura 2.1 Procesi i Vlerësimit Formues



(Popham, 2011:21)


Varësisht nga dëshira dhe prirja që secili nxënës ka për lëndën mësimore, motivohet që të arrijë sukses në atë lëndë duke ia shtuar dëshirën përmes aktiviteteve dhe komenteve pozitive për arritje të larta. ”Shpesh vlerësimi mund të shtojë motivimin e nxënësve, edhe pse mësimdhënësi mund të mos e theksojë atë me vetëdije si një nxitje për të punuar më shumë”. (Marsh, 2009:72) Ky motivim mund të realizohet edhe përmes një aktiviteti konkurrues mes nxënësve në gjetjen e informacioneve të rëndësishme për njësinë e radhës përmes metodës JiTT (Just in time), ku nxënësve u jepen detyrë paraprake për njësinë e

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

radhës. Pra, të mësuarit në kohën e duhur bazohet në punën që nxënësit bëjnë në shtëpi si parapërgatitje për orën pasardhëse mësimore, ku nxënësit vijnë të pajisur me informacione për njësinë e radhës. (Shahini, 2013)

Nga hulumtimi i realizuar me nxënës me sukses mesatar dhe nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm përmes metodës JiTT arrijmë të kuptojmë se nxënësit:

Grafiku 4.1 Ndikimi i metodave të reja në suksesin e nxënësve




(Mejzini, M. & Buza, V., 2014)

Ndërsa e kundërta ndodh me nxënësit e shkëlqyeshëm të cilët punojnë me metoda tradicionale të cilët nuk kanë marrë informacione paraqarkë për njësinë e radhës.

Grafiku 4.2. Metodatat tradicionale në të nxënit enxënësve

Nxënësit me sukses të shkëlqyer që kanë punuar me metodatat tradicionale:



(Mejzini, M. & Buza, V., 2014)

Përmes kësaj metode nxënësit bëjnë ndërlidhjen e njohurive paraprake me njohuritë e reja që mësojnë, kurse mësimdhënësit i ofron një vështrim të rregullt në përparimin e nxënësve drejt mësimin të thelluar. Arrihet një marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes mësimdhënësit me nxënës përmes shkrimit të komenteve nxitëse dhe korrigjuese për të gjitha aktivitetet e planifikuara, përmes të cilave ndikohet pozitivisht në motivimin, rimotivimin dhe shtimin e vetëbesimit tek nxënësit në procesin e të nxënit.

Detyrë e mësimdhënësve është mbajtja e një ditari vlerësues në të cilin shkruhen të gjitha informacionet e mbledhura në mënyrë sistematike për përvetësimin e njohurive të nxënësve në të gjitha lëndët mësimore, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me shokët – shoqet, plotësimi i detyrave të shtëpisë, pajisja me mjete mësimore të nevojshme si dhe rezultatet e vlerësimit. Sipas Gaston Mialaret: "T'ia bësh të njohur nxënësit rezultatet që ka arritur, do të thotë të shfrytëzosh me efikasitet energjitë e tij, sepse në këtë mënyrë atij i transmetohet një informacion për të përmirësuar procesin e të nxënit" (Vuji, 2012:156)

Për të arritur përmirësimin në procesin e të nxënës ndikon planifikimi i punës së
mësimdhënësve për motivimin dhe rimotivimin e nxënësve se:

- çfarë duhet të dinë;
- çfarë duhet kuptuar;
- çfarë janë në gjendje të bëjnë;
- çfarë duhet të shtojnë;
- çfarë duhet të ndryshojnë etj.

Të gjitha këto arrihen nëse mësimdhënësit arrijnë të planifikojnë punën dhe të arrijnë të
realizojnë vëzhgim në mënyrë sistematike, duke marrë informacione nga vetë nxënësit, nga
prindërit, duke përcjellur dhe vlerësuar dosjet, punën në realizimin e detyrave të ndryshme
si dhe të nxisin tek nxënësit të bëjnë vetëvlerësim për punën e tyre të realizuar në mënyrë
sistematike.

2.3.3. Nxënësi – faktor i të nxënës

Fëmijët në familje mësojnë hapat e parë në jetë për të biseduar, respektuar, vlerësuar,
vetëvlerësuar, po ashtu fitojnë njohuritë e para për shoqërinë në tërësi.

Si prindërit, ashtu edhe mësimdhënësit, duhet të mendojnë që nxënësit gjatë procesit
mësimor të ndjehen të lumtur, të sigurt dhe të vlerësuar në mënyrë që të sjellin një përvojë
pozitive “...nxënësit duhet të ndjejnë se ata përkasin, se ata kanë një farë autoriteti, se
jetojnë ndjenjën e lirisë dhe se kanë kënaqësi nga procesi i të nxënës” (Bojaxhi, 2004:187),
pra për arritjet e tyre të suksesshme e pozitive të vlerësohen në mënyrë sistematike përmes
Vlerësimit Formues, të ndjehen të mbështetur për ndryshimin të cilin duhet ta bëjnë në jetë
për zhvillimin e plotë. “Nxënësit të cilët mbesin prapa, në fillim do ta kenë tepër të vështirë

ta kthejnë kohën prapa. Për këtë arsye, Bloom theksoi se Vlerësimi Formues duhet të fokusohet në qëllimet e mësimi për një njësi mësimore dhe ndoshta do të ndodhë vetëm pas një jave ose dy të kohës së mësimdhënies” (Andrade & Cizek, 2010:114)

Nxënësit duhet të jenë menaxhues të mirë të kohës, të përgatitur për procesin mësimor duke qenë sa më aktiv në të nxënë, ndërsa kur nisen për në shkollë duhet të jenë të përgatitur me mjetet e nevojshme mësimore, me informacione bazë dhe me detyrat e shtëpisë të plotësuara për një të nxënë sa më kualitativ, që të arrihet tek rezultatet pozitive që të tregojnë për arritjet e të tyre të qëndrueshme. (Rot & Radonjiq, 1983) Kthimi i informacionit nga ana e mësimdhënësve me aplikimin e Vlerësimit Formues bën që nxënësit të arrijnë të nxënë më cilësor përmes motivimit të tyre për përmirësimin e të nxënës të qëndrueshëm e cilësor, ndërsa me kthimin nga shkolla nxënësit duhet të pajisen me informacione të nevojshme shtesë, përmes shprehisë së mirë të studimit.

Fëmijët duhet formuar nga ana e prindërve në atë mënyrë që t’i qëndrojnë para çdo problemi deri në zgjidhjen e tij. “Nëse një fëmijë ndihet mirë për vete, për atë që është dhe çfarë mund të arrijë, atëherë ata janë në gjendje të marrin mbi vete rrezikun e domosdoshëm për të depërtuar te të tjerët dhe për të komunikuar në atë mënyrë që i forcon dhe ndërton raportet”. (Hall, 2003):63) Fëmijët të cilët janë nxënës të suksesshëm dhe moralisht të fortë mundohen që motivimin dhe stabilitetin që kanë ta përcjellin edhe tek moshatarët e tyre, me qëllim të largimit të vështirësive të ndryshme.

Nxënësit duhet të jenë të gatshëm për ndryshime pozitive, duke filluar nga ambienti ku mësojnë, marrjen e vendimeve, të jenë mendjehapur, të mbështeten mbi fakte e prova si dhe të hapur për përballjen me sfida të ndryshme të cilat i presin gjatë gjithë procesit

mësimor. “Nxënësi duhet të ndjejë besim në kryerjen e detyrës ose në shfaqjen e aftësisë që i kërkohet, të ketë dëshirën për të mësuar, dhe të ndjejë se ajo çka i kërkohet të kryejë, është psikologjikisht e kënaqshme”. (Orstein & Hunkins, 2003:186). Duke pasur parasysh se të gjithë fëmijët kanë nevojë për vëmendje e mbështetje, një arritje e mirë do të ishte motivimi i nxënësve nga ana e mësimitdhënësve dhe prindërve që të jenë më të vendosur në arritjen e qëllimit pozitiv të tyre - të përmirësojnë të nxënë.

2.4. Vlerësimi në procesin e të nxënë si faktor pozitiv

Vlerësimi është një nga mjetet më të fuqishme që të arrihet motivimi i nxënësve për të mësuar në mënyrë të shpejtë, në një rrugë të përhershme për të ndryshuar formën e të mësuarit drejt ngritjes apo rënies së suksesit. Përmes vlerësimit, mësimitdhënësi ndërton një pasqyrë për nevojat e të nxënë të nxënësve dhe planifikon të ardhmen në mënyrë sistematike. Vlerësimi i drejtë nga ana e mësimitdhënësit i motivon nxënësit në një stimulim të nxitjeve të brendshme, për të arritur tek një të nxënë të suksesshëm, i cili nxënësve u siguron një feedback si nxitje për përpërim të mëtejshëm. Vlerësimi duhet të jetë informacion i besueshëm, i dobishëm e po ashtu edhe bindës, ku përmes tij arrihet të ndërtohet dhe një partneritet me nxënësit nga ana e mësimitdhënësve, me qëllim të mbështetjes së përbashkët për të arritur një ndryshim të nevojshëm pozitiv në të nxënë. Vlerësimi më i shpeshtë dhe më i dukshëm në procesin mësimor është Vlerësimi Përmbledhës i cili më së shpeshti është përdorur për të parë se sa kanë mësuar nxënësit në fund të një njësie apo kapitulli mësimor. Aplikohet nga ana e mësimitdhënësve dhe me

qëllim të motivimit të nxënësve për përcaktimin e tyre rreth profesionit të ardhshëm, në të ardhmën e afërt.

Vlerësimi duhet të planifikohet dhe realizohet nga ana e mësimeve me kujdes të veçantë e në mënyrë të paanshme, duke qenë transparent për të gjithë nxënësit, varësisht nga arritjet që kanë. Po ashtu, për përmirësimin e të nxënësve është e rëndësishme mënyra e mbledhjes së të dhënave për secilin nxënës dhe mënyra e interpretimit të tyre sipas fushave të caktuara që të jenë sa më të plota.

Figura 3.1 Format e vlerësimit – Vlerësimi Formues dhe Vlerësimi Përmbledhës

Llojet e vlerësimit

	Përmbledhës (ViN)	Formativ (VpN)
Qëllimi	Për të gjetur se çfarë dinë nxënësit, kuptojnë dhe mund të bëjnë. Për të matur progresin që ata kanë bërë	Për të ndihmuar nxënësit gjatë procesit të të nxënësve (përmirëson të nxënësve)
Faza	Përfundimtar (pas procesit të të nxënësve)	Në vazhdimësi – gjatë procesit të të nxënësve
Shembuj	Teste dhe provime	Pyetje, informata kthyesë (me shkrim dhe me gojë) Vlerësimi i ndërsjellë dhe vetëvlerësimi
Kontrollimi	Mësimeve dhe vlerësuesit e jashtëm	Mësimeve dhe nxënësit

(Vula, 2012:14)

Qëllimi i vlerësimit është që të marrim informacione nga nxënësit rreth njohurive të tyre, pra të vërehen përparësitë dhe mangësitë që nxënësit kanë në tema apo lëndë të caktuara dhe t'u ofrojnë ndihmë për të ngritur nivelin e njohurive dhe aftësive, aty ku ata kanë nevojë.

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

“Duke siguruar informacion për të kuptuarit e nxënësve në lidhje me qëllimet, objektivat, dhe standardet, Vlerësimi Formues ndihmon mësimdhënësin që të drejtojë mësimdhënien e tij drejt një efektiviteti më të madh dhe bën përshtatje udhëzuese përgjegjëse. Në këtë mënyrë mësimdhënsi dhe vlerësimi gërshetohen”. (Greenstein, 2010:6)

Vlerësimi është një proces sistematik i cili në mësimdhënien efektive luan një rol tepër të rëndësishëm që fillon me vëzhgimin, identifikimin e qëllimeve të caktuara, përmbushjen e objektivave të zhvillimit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë si dhe përfundon me një gjykim në lidhje me qëllimet e rezultatet që janë arritur. “Vlerësimi është përcaktimi nëse informacioni është përpunuar apo jo, në mënyrë të tillë që të bëhet i përshtatshëm për zgjidhjen e një detyre a problemi. Ai përputhet mjaft me ekuilibrimin.” (Orstein & Hunkins, 2003:161)

Vlerësimi duhet të jetë i përkryer dhe të përputhet me stilin e ri të mësimdhënies duke u fokusuar në vetë-studim të nxënësit dhe të zbatimit në punën praktike, po ashtu qëllimet mësimore të jenë të lidhura ekskluzivisht me fitimin e njohurive përmes motivimit të tyre për një të mësuar efektiv rreth përmirësimit të të nxënësit e nxënësve. Mund të përdoret edhe si formë e krahasimit në mes nxënësve, për të realizuar një formë rangimi të nxënësve sipas suksesit të arritur, për t’i njoftuar vetë nxënësit me atë sukses, po ashtu përdoret edhe për t’i njoftuar prindërit me suksesin e fëmijëve të tyre të arritur në periudha të ndryshme gjatë vitit shkollor. Vlerësimi Formues konsiderohet të jetë i suksesshëm për përmirësimin e suksesit të nxënësve e po ashtu edhe të përmirësimit të mësimdhënies nga ana e mësimdhënësve. (Popham, 2008) Është me rëndësi që njohuritë e fituara nga përmbajtjet teorike në lëndë të ndryshme mësimore nxënësit t’i ndërlidhin me përvojën dhe mësimet praktike, përmes aplikimit të Vlerësimit Formues në mënyrë sistematike e veçanërisht


përmes vlerësimit të ndërsjellë e vetëvlerësimit, duke i kontribuar pozitivisht procesit të të nxënësve.

2.4.1. Vlerësimi i bazuar në matje e kontroll njohurish

Vlerësimi ofron informata të dobishme për përmirësimin e mësimdhënies, e po ashtu edhe përmirësimin e të nxënësve. Ideja e matjes së progresit të nxënësve në procesin e të nxënësve, për të përcaktuar se si dhe çfarë duhet të mësojnë ata ka filluar të paktën që nga koha e Sokratit e vazhdon edhe sot.

Shumë herë mendohet se si të arrihet deri tek një përfundim i një vlerësimi të saktë për nxënës gjatë vitit shkollor. Vlerësimi është një aspekt thelbësor i procesit mësimor, i cili përdoret për të mbledhur informacione për të bërë gjykime dhe marrjen e vendimeve për çështje arsimore.

Figura 3.2 Nivelet e vlerësimit



➤ Arsyetimi, planifikimi, analizimi, gjykimi dhe mendimi kreativ

➤ Zbatimi i fakteve, parimeve, procedurave të cilat mund të realizohen

➤ Riprodhimi i fakteve, rregullave, termave, ose i një procedure të thjeshtë

(Kadriu, 2012:11)

Vlerësimi i efektshëm është i mundur të bëhet nëse realizohen objektivat e planifikuara të vlerësimit në mënyrë të qartë dhe aplikohen teknikat e duhura për mbledhjen e informacionit. Nga ana e mësimeve duhet të jetë e planifikuar që para fillimit të vitit të ri shkollor i gjithë plani i zbatueshëm mësimor, duke u fokusuar në tre fusha: njohës, emocional dhe psikomotor, e po ashtu edhe aplikimi i formave të vlerësimit që synohet të arrihen varësisht nga mosha e nxënësve. Procesi i vlerësimit ndodh para, gjatë dhe pas procesit mësimor. Para fillimit të mësimit është i nevojshëm për dy arsye pozitive që mësimeve të njohin karakteristikat, nevojat, aftësitë e nxënësve; si dhe për arsye të planifikimit të mësimit. Gjatë procesit mësimor është i nevojshëm që mësimeve të përdorin vlerësimin për marrjen e vendimeve që janë të lidhura me zbatimin e programit mësimor, të drejtuarit e klasës të nxënësve dhe përparimi i tyre në të gjitha fushat. Ndërsa, vlerësimi i cili realizohet pas përfundimit të procesit mësimor ka për qëllim që të japë përfundimet lidhur me arritjet dhe përparimin e nxënësve, si dhe planifikimin për përmirësimin e mësimit në vitin e ardhshëm.⁷

Kërkesat e mësimeve mund të jenë të ndryshme rreth realizimit të planprogramit mësimor dhe rezultateve që ata presin nga nxënësit. Të gjitha informacionet duhet të përcillen në mënyrë sistematike me qëllim të përcaktimit të nivelit të aftësive, njohurive dhe shprehive të fëmijëve duke u mbështetur në matjen, kontrollimin, gjykimin e të dhënave që të arrihet deri tek një vlerësim i njohurive të nxënësve të cilëve duhet t'u kushtohet një kujdes i veçantë. Duket se vlerësimi në procesin mësimor është shumë i

⁷Manual inspektimi i plotë i shkollës marrë më 5 nëntor 2014 nga:
<http://www.vet.al/files/ligje%20etj/manuali%20inspektimi%20i%20plote%20i%20shkolles.pdf>

rëndësishëm në çdo fazë të procesit mësimor dhe se merr dhe jep informacion për të gjithë ata që janë të përfshirë në këtë proces.

Sipas disa teoricienëve, ndodh që vlerësimi të mos planifikohet dhe realizohet sipas hapave të paraparë, por mund t'i lihet rastësisë ose të realizohet vetëm në fund të të nxënësve. Sipas Steikut: “Vlerësimi i arsimit vazhdon të varet nga vëzhgimi rastësor, synimet e nënkuptuara, normat intuitive dhe gjykimi subjektiv”, (Orstein & Hunkins, 2003:486) dhe se mbron idenë se të gjithë vlerësuesit duhet të bëjnë matje dhe gjykime e po ashtu të mbajnë qëndrime dhe të raportojnë për të gjitha të dhënat që kanë lidhje me atë që vlerësohet. Pra, vlerësuesit duhet që të gjykojnë rreth informacionit të marrë për të arritur tek raportimi i informacioneve rreth të dhënave të analizuara në mënyrë sistematike. Për të arritur tek një vlerësim i tillë i kompletuar, duke i shërbyer pozitivisht procesit të të nxënësve, nevojitet që në planifikimin mësimor të përfshihet Vlerësimi Formues.

2.4.2. Vlerësimi - faktor motivues në të nxënësve e nxënësve

Motivimi i nxënësve varet nga dëshira dhe përgatitja e vetë nxënësve për t'u ballafaquar me punën, i cili mund të arrijë tek shpërblimi me koment apo notë të mirë, ose të dënimi me punë të shtuar, qoftë në klasë apo shtëpi, për detyrën e realizuar. Vlerësimi konsiderohet se është një komponentë thelbësore e po ashtu e rëndësishme në procesin mësimor si atë të mësimdhënies e po ashtu në të nxënësve të qëndrueshëm të nxënësve. “Sipas studiuesve dhe mësimdhënësve, motivimi i nxënësve drejt qëllimeve të caktuara është një ndër detyrat kryesore të mësimdhënies” (Përlala, 2010:84) Vlerësimi arrin që mësimdhënësve t'u sigurojë informacion të mjaftueshëm për identifikimin e problemeve të ndryshme se ku

nxënësit kanë ndonjë ngecje, në mënyrë që të arrihet përmirësimi gjatë të nxënësve të tyre. Arrin që mësuesin të t'i ndihmojë në planifikim për arritje të larta në ngritjen e cilësisë në të nxënë, e po ashtu rreth motivimit të nxënësve për përparimin në fusha të ndryshme. Është një mjet përmes të cilit shkolla arrin që në mënyrë sistematike të jetë në kontakt të vazhdueshëm edhe me prindërit. Mbi të gjitha, mësuesin arrijnë gjithashtu të identifikojnë punën e tyre duke u bazuar në rezultatin e nxënësve për të bërë përmirësimin e cilësisë së mësimit në raste të nevojshme dhe të nxënësve për një shkollë efektive. Po ashtu, mund të arrijnë të bëjnë gjykime dhe të arrijnë në marrjen e vendimeve për përmirësimin e të nxënësve të nxënësve dhe ngritjes së suksesit të tyre.

Vlerësimi duhet të jetë një proces i hapur, ku nxënësve duhet të informohen për kriteret e vlerësimit për shqyrtim e ndryshim si dhe për rezultatin e arritur. Mësuesin duhet ta pranojnë idenë për Vlerësimin Formues se është një proces dhe jo provë. (Popham, 2008) Këtë proces të planifikuar mësuesin duhet ta përdorin duke u bazuar në prova për të rregulluar atë që është e nevojshme për nxënësve, duke u munduar ta plotësojnë në momente të caktuara. I gjithë ndryshimi mund të ndodhë duke u bazuar në punën që nxënësve kanë realizuar në kohën e duhur dhe nëse e kuptojnë qëllimin pse është i rëndësishëm vlerësimi. Popham beson se “të gjithë mësuesin duhet ta përdorin këtë proces sepse, nëse aplikohet mirë, Vlerësimi Formues do të përmirësojë të nxënësve e nxënësve”. (Popham, 2008:13)

Vlerësimi duhet të ndodhë duke u bazuar në planifikimin e kriterëve, aftësitë komunikuese, përpjekjet e nxënësve, aftësitë që ata kanë në transferimin e informacioneve.

Si mënyrë e motivimit të nxënësve, siç sugjerohet nga Grupi i Reformave të Vlerësimit (1999), ndonëse vlerësimi mund të sigurojë mundësi motivuese për nxënësit, ka nevojë që t'i jepet rëndësi mundësisë për ndikim demotivues nga vlerësimi. (Irons, 2007)

Nga hulumtimi i Natriello (1987) dhe Crooks (1988) dhe nga Black and Wiliam (1998a) thuhet se të mësuarit themelor është i mundur nëse mësime dhënësit në praktikën e tyre mësimore në klasë aplikojnë Vlerësimin Formues (Wiliam, Lee, Harrison & Black, 2004)

Vlerësimi Formues i cili përdoret në baza ditore gjatë mëimit në klasë është e kundërta e Vlerësimit Përmbledhës që realizohet në bazë të shqyrtimit të suksesit të nxënësve në mënyrë periodike. Vlerësimi Formues është i dizajnuar për të ndihmuar mësime dhënësin në përcaktimin e asaj që nxënësit dinë, për t'i ndihmuar nxënësit në krijimin e materialit më të përshtatshëm, dhe të informojnë më mirë në të mësuarit e tyre. Vlerësimi Formues sipas Popham arrin që t'i ndihmojë mësime dhënësit dhe nxënësit, pasi që mësime dhënësit mund të realizojnë shpjegim më të mirë, e po ashtu edhe tek nxënësit ndikon pozitivisht që të mësojnë më mirë dhe të arrijnë tek përmirësimi i të nxënit më lehtë. (Popham, Transformative Assessment, 2008)

Mësime dhënësit mund të përdorin në Vlerësimin Formues vëzhgime, fletë pune, pop-kuize, përdorimin e revistave, projekteve dhe të provimeve. Ky lloj vlerësimi është kritik nga pikëpamja në klasë, për shkak se aplikohet në mënyrë të vlefshme ditë pas dite.

2.5. Planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues (për nxënie) dhe Vlerësimit

Përmbledhës (i të nxënit)

Duke u nisur nga faktet e qarta se të dy këto forma të vlerësimit janë të nevojshme për procesin e rregullt mësimor, atëherë është i nevojshëm dhe planifikimi dhe aplikimi i të dy formave të vlerësimit. Është me rëndësi që t'i kushtohet kujdes të dy formave të vlerësimit pasi shërbejnë për të arritur të bëhet matja, gjykimi, konkludimi dhe arritja tek rezultatet e të dhënave për të gjithë nxënësit nga ana e vlerësuesve apo mësimdhënësve.

Vlerësimi Formues është i kundërt me Vlerësimin Përmbledhës sepse Vlerësimi Formues aplikohet për vlerësimin rreth përparimit të nxënësve në të nxënit e tyre, ndërsa Vlerësimi Përmbledhës tregon arritjet në përfundim të një njësie mësimore për një periudhë të caktuar. Pra Vlerësim Formues është për të nxënë, ndërsa Vlerësimi Përmbledhës është i të nxënit. Sipas mendimit të ekspertit të vlerësimit Paul Black: "Kur kuzhinieri shijon supën është Vlerësimi Formues; kur konsumatori shijon supën, është Vlerësimi Përmbledhës".

Pasi Vlerësimi Formues aplikohet për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të një veprimtarie në proces është kuzhinieri (mësimdhënësi) i cili mund të arrijë përmirësimin e shijes së supës (cilësinë e të nxënit të nxënësve), kurse në Vlerësimin Përmbledhës si punë e përfunduar konsiderohet konsumatori (nxënësi) i cili e shijon supën e gatshme të cilën e servon mësimdhënësi për qëndrueshmërinë e të nxënit të tyre. (Vlerësimi Formues)⁸

Sipas Susan Brokhartit, e cila spjegon rëndësinë e të dy formave të vlerësimit ku tregon se aplikimi i të dy formave të vlerësimit Formues dhe Përmbledhës e kanë të njëjtin qëllim, prandaj Vlerësimi Formues bazohet në njohuritë dhe aftësitë që nxënësit i kanë marrë në

⁸ Vlerësimi Formues marrë më 14 mars 2015 nga: <http://edglossary.org/formative-assessment>

një periudhë të caktuar për t'i përcjellur tek Vlerësimi Përmbledhës, për të marrë notën.

(Çka është Vlerësimi Formues)⁹

Vlerësimi Formues duhet të planifikohet në forma të ndryshme dhe në mënyrë sistematike për kontrollimin e njohurive për njësi të vetme mësimore apo për kapituj në lëndë të ndryshme mësimore ku sipas Gronlund dhe Lin për Vlerësimin Formues mendojnë se "u jep mundësinë mësimdhënësve dhe të tjerëve të përfshirë në vlerësim, jo vetëm të përcaktojnë çfarë pasojash të synuara po realizohen, por edhe të konstatojnë dhe të shqyrtojnë praninë e pasojave të pasynuara". (Orstein & Hunkins, 2003:483).

Planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Përmbledhës realizohet për të arritur tek një përfundim i përgjithshëm i të nxënit. Qëllim kryesor i Vlerësimit Përmbledhës konsiderohet se është e nevojshme që t'u mundësohet palëve të përfshira të arrijnë të nxjerrin përfundime për të funksionuar kurrikula ose një element i saj sa më mirë. (Orstein & Hunkins, 2003) Vlerësimi përmbledhës apo me notë është po ashtu rezultat i punës së nxënësit dhe mësimdhënësit, bashkëpunimit dhe vështirësive që ka shkolla me familjen duke arritur tek një harmonizim i punës së tyre të përbashkët. (Kraja, 2006)

Me matjen e njohurive të nxënësve dhe vlerësimin e tyre vetëm me notë nuk arrijmë t'i bëjmë ata më të shkathtë ose më të mençur por vetëm do të tregojmë se sa kanë arritur nxënësit, pra arrijmë tek një rezultat i përgjithshëm si Vlerësim Përmbledhës.

⁹ Çka është vlerësimi Formues, marrë më 17 janar 2015 nga:

<http://www.ascd.org/publications/books/111005/chapters/Section-1@-What-Is-Formative-Assessment%C2%A2.aspx>

Në vend të vlerësimit vetëm me notë është më mirë të jepen këshilla të dobishme për nxënësin duke i informuar dhe ndihmuar tek cila njësi apo lëndë mësimore kanë nevojë më shumë për plotësim të njohurive dhe si mund të shtojnë ato njohuri. Këto arrihen duke caktuar objektivat, duke dhënë komente të ndryshme nga mësimdhënësit, duke marrë informacion kthyes nga prindërit, realizimin e vetëvlerësimit nga vetë nxënësit dhe vlerësimit të ndërsjellë mes nxënësve.

Qëllimi i aplikimit të dy formave të vlerësimit është që të arrihet nga nxënësit të tregojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre, ndërsa mësimdhënësit të identifikojnë në mënyrë specifike se çfarë rezultate kanë arritur nxënësit. Po ashtu, mësimdhënësit mund të analizojnë se çfarë aftësi të tjera u duhen nxënësve që t'i ndryshojnë apo plotësojnë dhe të planifikojnë hapat e arritshëm për nxënësit në vazhdim.

Figura 3.3 Mundësitë që ofrojnë Vlerësimi Formues dhe Vlerësimi Përmbledhës

	VpN (Vlerësimi Formues)	ViN (Vlerësimi Përmbledhës)
Pse vlerësojmë?	u mundëson mësimdhënësve të përcaktojnë hapat e ardhshëm për përparim të të nxënësve	të vërtetojë ose t'i informojë prindërit ose palët tjera të interesit për rezultatet e të nxënësve
Çfarë vlerësohet?	Përparimi i secilit nxënës dhe kërkesat e të nxënësve në raport me rezultatet e të nxënësve sipas kurrikulës	Niveli që mund të arrijë secili nxënës për t'i zbatuar konceptet bazë, njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e lidhura me rezultatet e të nxënësve sipas kurrikulës
Me cilat metoda?	Një varg metodash në forma të ndryshme që e bëjnë të dukshëm të kuptuarit dhe shkathtësinë e nxënësve	Një varg metodash në forma të ndryshme që vlerësojnë të dyja, produktin dhe procesin

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

Sigurimi i cilësisë	Saktësia dhe qëndrueshmëria e vëzhgimeve, dhe interpretimi i të nxënësve: • i qartë, pritje të detajuara të të nxënësve; • i saktë, shënime të hollësishme për informatat kthyesë për secilin nxënës	Saktësia dhe qëndrueshmëria, dhe gjykime të drejta të bazuara në të dhëna të cilësisë së lartë • i qartë, pritje të detajuara të të nxënësve; • i drejtë dhe raportim i saktë Përmbledhës
Shfrytëzimi i informacioneve	Sigurojnë për çdo nxënës informata përshkruese për të nxënësit e tij/saj të mëtejshëm • ndryshojnë mësimdhënien vazhdimisht duke kontrolluar ku janë nxënësit në raport me rezultatet kurrikulare • sigurojnë për prindërit apo kujdestarët informata kthyesë përshkruese për të nxënësit e fëmijëve të tyre dhe u japin atyre ide për mbështetje	• tregojnë nivelin e të nxënësit të secilit nxënës • sigurojnë bazën për diskutime ose për përkrahje • raportim të drejtë, të saktë dhe informim të detajuar i cili mund të shfrytëzohet për të vendosur për qëllime të ardhshme.

(Murchan, Shiel & Vula, 2011:c:23)

Nga 60 pjesëmarrës të 25 shteteve gjatë një mbledhjeje përruese në Austin, Texas të vitit 2006 FAST SCASS qëllim i takimit të tyre katërditor ishte që të arrijnë një marrëveshje për një përkufizim për Vlerësimin Formativ. Ata arrijnë tek një përkufizim në gjetjet të cilat i realizuan gjatë hulumtimeve se Vlerësimi Formativ ka për qëllim të përmirësojë cilësinë e të nxënësit të nxënësve. FAST SCASS arrijnë në përkufizimin e mëposhtëm se:

(Popham, 2008)


”Le të shikojmë tiparet kyçe të definimit të FAST SCASS

- Vlerësimi Formues është një proces, jo ndonjë test i veçantë
 - Nuk përdoret vetëm nga mësimdhënësit, por nga të dy nga mësimdhënësit edhe nga nxënësit
 - Vlerësimi Formues zë vend gjatë mësimdhënies
 - Siguron feedback vlerësues për mësimdhënësit dhe nxënësit
 - Funksioni i këtij feedbacku është që të ndihmojë mësimdhënësit dhe nxënësit që të bëjnë përshtatje të cilat do të përmirësojnë arritjet e nxënësve të qëllimeve të synuara kurrikulare”.
- (Popham, 2008:5)

Qëllimi i planifikimit dhe realizimit të të dy formave të vlerësimit e në veçanti i Vlerësimit Formues është njohja me vështirësitë e nxënësve gjatë vitit shkollor, kontrollimi dhe tejkalimi i atyre vështirësive në lëndë të ndryshme. ”Vlerësimi për nxënie u mundëson mësimdhënësve të marrin informacione të qarta se si ndodh të nxënit tek secili nxënës në mënyrë individuale”. (Murchan, Shiel & Vula, 2011:20) Vlerësimi duhet të jetë transparent, i drejtë, me qëllim të arritjes tek nxjerrja e rezultatit pozitiv mbi suksesin e të nxënit të nxënësve.

Nga grafiku i mëposhtëm kuptojmë ndërlidhjen në mes të tre llojeve të vlerësimeve – Vlerësimit Formues, atij standard, dhe një sistemi gjithëpërfshirës vjetor të vlerësimit. Objektivat mësimore të vlerësuara shpesh në klasë nga Vlerësimit Formues të ndërtuara drejt objektivave afatgjata të adresuara nga vlerësimi standard periodik. Të dhënat standarde informojnë mësimdhënien dhe të nxënit që ndodh përpara vlerësimit vjetor, që kthehet në vitet e mëvonshme në mësimdhënie, të nxënë dhe vlerësim. Vlerësimet më të shpeshta ndërtojnë dhe mbështesin njëri-tjetrin, për ta mbajtur dhe dërguar përpara të nxënit si proces.

Figura 3.4 Vlerësimet standarde për të nxënit e nxënësve (Marrëdhëniet e ndërsjella në mes vlerësimit formues, të pjesshëm dhe atij vjetor.)



(Sistemet e vlerësimit – Rregulla e pikës së referimit)¹⁰

Vlerësimet standarde janë teste të cilat mbahen gjatë gjithë vitit shkollor për t’u dhënë mësimdhënësve dhe prindërve feedbackun menjëherë, se si dhe sa nxënësit kanë arritur.

Përdorimi i rregullt i vlerësimit standard është parë nga të tjerët si një mjet për të arritur ngritje të cilësisë së nxënësve.

2.6. Vlerësimi Formues faktor pozitiv dhe ndikues në motivimin - rimotivimin e nxënësve

Vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e planeve të punës së mësimdhënësve, aktiveve profesionale dhe shërbimeve profesionale të shkollës. Popham i porositi mësimdhënësit se nëse dëshirojnë që nxënësit e tyre të arrijnë më shumë në të nxënë, atëherë duhet të përdorin Vlerësimin Formues. (Popham, 2008)

¹⁰Sistemet e vlerësimit – Rregulla e pikës së referimit; marrë më 7 mars 2015 nga: http://datause.cse.ucla.edu/ba_comprehensive.php

Viteve të fundit kanë ndryshuar mendimet nga ana e mësimitdhënësve si dhe prindërve rreth vlerësimit, po ashtu të nxënësve ka filluar të ndryshohet pasi ata janë angazhuar drejtpërdrejt në vetëvlerësim dhe vlerësim të ndërsjellë mes nxënësve duke u deleguar atyre një përgjegjësi. Vlerësimi Formues

”Synon të përkrahë nxënësit të arrijnë kompetencat kryesore duke iu treguar se ku janë sa i përket rezultateve mësimore të parapara. Bazohet në atë që t’i vetëdijësojë nxënësit dhe t’i bëjë pjesëmarrës në përcaktimin e rezultateve mësimore, kritereve të cilësisë dhe treguesve personalë të suksesit. Nxënësit mësojnë se çka duhet të bëjnë që të arrijnë ato rezultate të vendosura mësimore dhe si të arrihet atje”. (MASHT, 2011:76)

Një numër i vogël i mësimitdhënësve kanë filluar të planifikojnë dhe zbatojnë strategji të shumëllojshme në mësimitdhënien e tyre të përditshme, po ashtu të planifikojnë forma të ndryshme vlerësimi me kriteret e suksesit. Një prej strategjive që mund të përdoret me nxënësit është “Plus, minus dhe çka më tej” e cila strategji i ndihmon nxënësit që të arrijnë të vlerësojnë veten nëse i kanë arritur kriteret e suksesit, po ashtu ka për qëllim që nxënësit t’i vendosin vetes një objektiv se çfarë duan dhe çfarë duhet të ndryshojnë në të mësuarit e tyre të mëtejshëm për ngritjen e suksesit të tyre¹¹

Në klasë vlerësimi duhet të ndryshohet duke realizuar vlerësim të vazhdueshëm në mënyrë sistematike për pjesëmarrjen aktive të nxënësve në të gjitha fazat e orës mësimore, orientim drejt përmirësimit të të nxënësve dhe vetëbesim tek nxënësit.

Aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon pozitivisht në klasë, duke i ndihmuar si nxënësit ashtu edhe mësimitdhënësit:

- që të jenë të informuar dhe të përqëndruar në qëllimin e punës së tyre;

¹¹Strategjitë për të theksuar informatën kthyesë marrë më 15 qershor 2015


nga: http://www.assessmentforlearning.edu.au/professional_learning/peer_feedback/peer_strategies_enhance.html#1

- t'i bëjë të përgjegjshëm të gjithë nxënësit në ndërtimin e aftësive themelore për të arritur tek të mësuarit e një niveli të lartë;
- t'i nxitë të dy palët e përfshira në proces si mësimdhënësit, po ashtu edhe nxënësit të bashkëpunojnë drejt përmbushjes së qëllimit;
- t'i motivojë nxënësit më tepër drejt një angazhimi më të madh për kryerjen e detyrave;
- të sigurojë vlerësim sistematik dhe të saktë që paraqet përparimin – ngecjen e nxënësve.

Vërehet se këto strategji ndihmojnë të nxënësit, ndikojnë pozitivisht në motivimin ose rimotivimin e nxënësve gjatë procesit të të nxënësit si dhe arrihet të raportohet nëse ka ndodhur ndryshim pozitiv në të nxënësit e nxënësve dhe me çfarë efekti është realizuar. Këto ndryshime ndodhin pas planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve të përshtatshme që të ndërmerren hapat e ardhshëm për përmirësimin apo zvogëlimin e gabimeve të mundshme. Besohet se motivimi i nxënësve, krijimi i vetëbesimit tek ata dhe përfshirja aktive e nxënësve në procesin e të nxënësit janë faktorë kryesorë që mund të ndikojnë rreth përparimit të tyre në mënyrë të efektshme, dhe se vështirësitë e mundshme do të përmirësohen duke shfrytëzuar teknika efektive të vlerësimit. "Nxënësit punojnë më gjatë, më fort dhe me më shumë energji dhe intensitet kur janë të motivuar, sesa kur nuk janë. Me fjalë të tjera, motivimi i ndihmon individët që ta mposhtin inercinë."¹²

¹²Çfarë motivimi është dhe pse është e rëndësishme në situata klase; marrë më 5 qershor 2015 nga: <http://www.shabait.com/categoryblog/3200-what-motivation-is-and-why-it-is>

Figura 4.1 Mundësitë pozitive që ofron aplikimi i Vlerësimit Formues



(Murchan, Shiel & Vula, 2011:24)


Vlerësimi Formues ndikon në punën ekipore të nxënësve duke i bërë ata më përgjegjës në detyra, të shoqërueshëm, duke i ndarë idetë e tyre mes vete, si dhe duke e ndihmuar njëri tjetrin në zbrazëtitat që arrijnë t'i vërejnë përmes ushtrimeve të vetëkontrollit apo vlerësimit të ndërsjellë.

Mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të përforcojnë materialin e mësuar më parë për të arritur tek motivimi për përmbajtjen apo njësinë e re që do të mësojnë, pra për të arritur tek një ndërlidhje e njësive mësimore, duke u zhvilluar në të gjitha aftësitë e të nxënësit.

Tek tabela e paraqitur më poshtë vërehet një sistem i formës së Vlerësimit Formues se si arrijnë të drejtojnë mësimdhënësin dhe nxënësin drejt punës së tyre. Qëllimi i tyre është që t'i largohet mospërputhjes së tyre gjatë punës së përbashkët, andaj mësimdhënësi mundohet

që të ndihmojë nxënësit për të arritur qëllimet me anë të sistemeve të Vlerësimit Formues, ndërsa tek nxënësi është me rëndësi që të rritet angazhimi për aplikimin e punës më efektive përmes pyetjeve ku jam, si jam unë duke e bërë dhe ku do të arrij më tej?

Figura 4.2 Sistemi efektiv i aplikimit të Vlerësimit Formues



(Frey & Fisher, 2011:3)

2.7. Bashkëpunimi i mësimeve në shkollë për aplikimin e Vlerësimit Formues dhe Vlerësimit Përmblidhës për sigurimin e informacionit rreth përparimit apo ngecjes së nxënësve

Udhëheqësia e shkollës, mësuesit e prindërit duhet të kenë një pasqyrim për rrjedhën e të mësuarit në shkollë, të arriturat e nxënësit si dhe bashkëpunimin mes tyre. Ky pasqyrim arrihet nga raportet të cilat kërkohen nga mësuesit për të arriturat apo vështirësitë që kalojnë gjatë periudhave të ndryshme shkollore gjatë vitit. Mësuesit duhet të planifikojnë aktivitete të ndryshme që të thjeshtësojnë të mësuarit, me qëllim që nxënësit të komunikojnë për atë që dinë rreth të nxënësit pasi "Vlerësimi Formues karakterizohet nga një cikël i tillë: gjetja e vështirësive – interpretim – përmirësim" (Përlala, 2010:176) Për të arritur tek e gjithë kjo, bëhet vëzhgim i situatave të ndryshme mësimore dhe arrihet të bëhet një përshkrim më i hollësishëm rreth situatave të caktuara mësimore, me qëllim të eliminimit të vështirësive për një ngritje të cilësisë në procesin e të nxënësit. Mbahen shënime nga vëzhgimet e brendshme, të cilat i shërbejnë qoftë komunikimit me prindër, e po ashtu raportimit ndaj vëzhguesve dhe vlerësuesve të jashtëm të procesit mësimor. Këto vëzhgime bëhen për formën e planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore si dhe vlerësimin e tyre përmes formave të ndryshme, me qëllim të ngritjes së cilësisë në të nxënë.

Për të arritur mbledhjen e të dhënave për nxënësit rreth përparimit apo ngecjes së tyre në lëndë të ndryshme mësimore dhe eliminimit të gabimeve të mundshme, atëherë është i nevojshëm aplikimi i Vlerësimit Formues në mënyrë sistematike nga ana e mësimeve. Për të vërejtur nëse arrijtjet e nxënësve janë duke ecur në mënyrë pozitive mësuesi duhet t'i motivojë dhe angazhojë nxënësit përmes detyrave dhe

hulumtimeve të ndryshme që të arrihet tek ndryshimi i nevojshëm dhe rezultati i duhur.

Komentet e shkruara nga ana e mësimeve në forma të ndryshme për realizimin e detyrës, qoftë motivuese ose këshilluese për situatën e nxënësit, shërbejnë për njoftim ndaj nxënësit, prindërve dhe gjithë atyre që janë të përfshirë në procesin e të nxënës. Feedbacku mund të shkruhet edhe në formën e një raporti drejtuar prindërve i cili duhet të tregojë saktësisht dhe duke u mbështetur në fakte për pikat e forta dhe të dobëta të nxënësit, e po ashtu edhe formën se si mund të ndihmohet ai nxënës. (Spahiu, 2003)

Sipas studiuesit Glaser, i cili mendon se duhet të përdoren kriteret në metodat e reja të vlerësimit si pjesë e rëndësishme e procesit të të nxënës, këto kriteret i ndan në shtatë faza të arritshme për një vlerësim të plotë për nxënësit në përgjithësi.

Kriteri i parë është "Rritja e mundësisë për arsimim", ku sipas këtij kriteri mendohet që t'u jepet mundësia të gjithë nxënësve për vijimin e shkollimit dhe zhvillimit të tyre.

Kriteri i dytë "Vlefshmëria logjike e vijuese" mendohet që të gjithë mësimeve të kenë një bashkëpunim mes vete rreth formës së mësimeve të tyre, pra gjetjes së formës më të mirë e cila ndikon në të nxënës sa më cilësor të nxënësve.

Kriteri i tretë "Transparenca dhe të qenit i hapur" nënkupton që të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor të jenë të hapur mes vete rreth komunikimit të të gjitha vështirësive apo përparësive gjatë punës, qoftë mësimeve mes vete, mësimeve me nxënësit, mësimeve me prindër, mësimeve me mësimeve, prindërit me fëmijët e tyre, prindërit me prindër si dhe nxënësit mes vete.

Kriteri i katërt ”Vetëvlerësimi” - Ky kriter parashihet të aplikohet që në klasën e parë apo dhe në institucionin parashkollor, ku nxënësit bëhen të pavarur rreth gjykitimit për arritjet e veta, e po ashtu dhe krahasimit me të tjerët.

Kriteri i pestë ”Vlerësimi i situatës shoqërore” - Përmes zbatimit të këtij kriteri arrihet të kuptohet puna individuale e nxënësit dhe bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me të tjerët. Arrihet që nxënësit të motivohen dhe të përqëndrohen për të kryer punë të suksesshme në çifte apo grupe të vogla, duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë në mes vete dhe arritjen e një suksesi të plotë.

Kriteri i gjashtë ”Zgjerimi i gamës së detyrave dhe realizimi i shprehive në një situatë” është thuajse plotësim i kriterëve të tjera, ku secilit nxënës duhet t’i ofrohet një shans për planifikimin dhe realizimin e detyrave, krijimin e shprehive dhe përgjegjësi në mënyrë efektive dhe sa më të saktë.

Kriteri i shtatë dhe i fundit ”Shtrirja dhe përfshirja” paraqet përfshirjen e gjithë objektivave, metodave, formave të të nxënësve e deri tek arritja e qëllimit përmes komunikimit të rezultateve. (Orstein & Hunkins, 2003:501-502)

Të gjitha këto kriterë na tregojnë se vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë sistematike gjatë gjithë procesit mësimor që të arrihet tek një përfundim se a ka qenë mësimdhënësi një drejtues e menaxhues i mirë i gjithë procesit, ndërsa nga ana e nxënësve a është kuptuar, si dhe sa është kuptuar i gjithë materiali i nevojshëm.

2.7.1. Kriteret e suksesit – planifikimi dhe zbatimi i tyre

Vlerësimi planifikohet dhe aplikohet në procesin mësimor me qëllim të identifikimit të vështirësive specifike në të nxënit sistematik të nxënësve. Me qëllim që nxënësve t’iu lehtësohet puna në të nxënit e suksesshëm nga ana e mësimdhënësve është e nevojshme të përdoren forma të ndryshme vlerësimi si dhe strategji të ndryshme për të kapërcyer vështirësitë që ata kanë. Kriteret e suksesit i’u shërbejnë mësimdhënësve dhe nxënësve për të kuptuar çka duhet të arrijnë brenda orës mësimore, se sa është arritur të mësohet për atë orë apo një njësi mësimore, kapitull apo një lëndë të caktuar. Janë të lidhura ngusht me qëllimet e të nxënit të cilat është e rëndësishme të shkruhen në bashkëpunim me nxënësit. ”Kriteret e suksesit ndihmojnë mësimdhënësin të vendos nëse nxënësit e tij kanë arritur në fakt objektivat dhe qëllimin e mësimi. Në të njëjtën kohë, kriteret e suksesit u përgjigjen në pyetjen e njëjtë nga pikëpamja e nxënësit: ”Si do ta di nëse kam arritur qëllimin e mësimi?” (Nikqi, 2012:26)

Planifikimi dhe realizimi i kriterëve të suksesit ndihmon nxënësit që të pavarësohen në punën e tyre. Mësimdhënësi arrin të japë feedbackun që për nxënësin janë të nevojshme t’i aplikojë për të arritur tek përmirësimi i të nxënit dhe të arrij të bëjë një vetëvlerësim për arritjet e tij, po ashtu mësimdhënësi vëren nëse nxënësit kanë vështirësi apo e kanë arritur plotësisht qëllimin e të nxënit. Kriteret e suksesit nuk duhet të jenë në formë pyetjesh e as në formë të përgjithësuar si: ”Kush bën pjesë në organizmat njëqelizorë dhe shumëqelizorë”, por të jenë në formë të qartë si: ”Klasifiko dhe emëro organizmat njëqelizor dhe shumëqelizor” (Murchan, Shiel & Vula, 2011:d:35)

Përmes planifikimit dhe aplikimit të kriterëve të suksesit arrihet një bashkëpunim ndërmjet mësimeve me nxënës, zbatimit të stileve të ndryshme të mësimit nga ana e mësimeve si dhe stile të ndryshme të të nxënës nga nxënësit që nxisin drejt realizimit të një qëllimi të caktuar.

Të gjitha kriteret e suksesit na dërgojnë tek e njëjta pyetje për nxënësit ”Si do ta di nëse kam arritur qëllimin e të nxënës”? (Murchan, Shiel & Vula, 2011e:35), për të marrë përgjigje është e nevojshme të kuptohet se a janë arritur të realizohen dhe plotësohen kriteret e suksesit – a ka arritur nxënësi të plotësojë qëllimin e të nxënës.

2.7.2. Vëzhgimi i nxënësve gjatë orëve mësimore dhe dhënia e feedbackut (informacionit kthyes) në mënyrë sistematike për anët e forta dhe të dobëta të nxënësit

Feedbacku i mbështetur në kriteret e suksesit i siguron nxënësve se ata duhet të bëjnë përpjekje që të arrijnë në përmirësim dhe sukses. Si pikë fillestare e studimit të Dylan Williamit dhe Paul Blackut për Vlerësimin Formues është feedbacku, për të cilin kanë thënë se përmirëson cilësinë e të nxënësve nëse bazohet në qëllimin e të mësuarit dhe kriteret e suksesit. (Curriculum, 2009) Vëzhgimi në klasë duhet të jetë sa më objektiv, duke u mbështetur shumë pak në opinione të tjerëve, por duke u mbështetur shumë në fakte, pra duke i vëzhguar dhe regjistruar ato që shihen. Vëzhgimi i nxënësve dhe dhënia e informacionit kthyes është një ndër format e motivimit të nxënësve nga ana e mësimeve për arritjen e një suksesi të mirë në procesin e të nxënës, me qëllim të identifikimit të nivelit të shkallës së arritjes së nxënësve nga ana e mësimeve, e cila

arrihet nga komunikimi mes tyre në shkollë. “Feedback-u i mësimdhënësit efektiv fokusohet në vendosjen e kriterëve të sukseshme dhe u tregon studentëve çfarë kanë arritur dhe ku duhet të përmirësohen. Në parim, feedback-u jep sugjerime specifike për mënyrën se si ai përmirësim mund të arrihet”. (Vlerësimi për të nxënë)¹³


Dhënia e detyrave dhe kontrollimi i tyre nga ana e mësimdhënësve me një informacion kthyes të hollësishëm për nxënësit si dhe kryerja e detyrave nga nxënësit, siguron nxënësit që të jenë në dijeni se sa kanë arritur të kuptojnë informacionet e reja apo të rikujtojnë informacionet e marra më parë. Feedbacku, kur përdoret si pjesë e një sistemi të vlerësimit formues, është një mënyrë e fuqishme për të përmirësuar arritjet e nxënësve. Feedback në vetvete megjithatë, është më pak i dobishëm. Sipas John Hattie dhe Helen Timperley “Feedback nuk ka efekt në një vakum; që të jetë i fuqishëm në efektin e tij, duhet të ketë një kontekst të të nxënësit se për cilat reagime drejtohet” (Frey & Fisher, 2011:2). Mund të realizohet gjatë orëve mësimore përmes mbajtjes së shënimeve për secilin nxënës brenda klasës në lëndë të ndryshme mësimore, ku vëzhgohen dhe këshillohen për detyrat që duhet të kryejnë individualisht, në çifte apo në grupe. “Vlerësimi formues, bëhet aktivitet kryesor përmes të cilit mësimdhënësit arrijnë të monitorojnë se sa mirë ata janë duke mësuar diçka dhe, nëse është e nevojshme, do të përcaktojnë se si mund të rregullojnë të nxënësit e tyre” (Popham, 2008:29) Nxënësit e dinë se çfarë kërkohet prej tyre gjatë të nxënësit, po ashtu edhe mësimdhënësit e planifikojnë se çfarë duhet të kërkojnë nga nxënësit për një të nxënë të suksesshëm. Gjatë vëzhgimit vërehen nxënësit që kanë ndonjë vështirësi e cila

¹³ Vlerësimi për të nxënë; marrë më 17 mars 2015 nga:
http://www.assessmentforlearning.edu.au/professional_learning/intro_to_afl/introduction_key_questions.html

mund të tejkalohet nëse kërkohet nga ata ndihmë për të arritur tek përmirësimi i nevojshëm, duke i bërë pyetje vetes se “A është një përshtatje e nevojshme, dhe, nëse po, çfarë duhet të jetë si rregullim?” (Popham, 2008:23), Atëherë e kuptojnë se a mund të arrijnë dhe si mund të arrijnë tek përmirësimi i nevojshëm për një sukses më të mirë. Vëzhgohen sjelljet e nxënësve me nxënës të tjerë brenda dhe jashtë klasës, bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me fëmijët - nxënësit tjerë gjatë lojës, kryerjes së detyrave të ndryshme, ofrimit të ndihmës për punë të caktuara.

Komentet përshkruese mbështeten në kriteret e suksesit të cilat duhet të planifikohen së bashku me nxënësit. “Feedbeku formues është çdo informacion, proces apo aktivitet i cili jepet me qëllim të përshpejton të mësuarit të studentëve të bazuar në komentet që lidhen me të dyja aktivitetet e vlerësimit formues ose të vlerësimit përmbledhës.” (Irons, 2007:7) Mund të jepen në formë gojore apo të shkruar, por gjithmonë duhet të jenë pozitive në formë këshilluese apo nxitëse, pavarësisht nga suksesi apo vështirësitë e paraqitura tek nxënësi.

Figura 5.1 Informatat kthyesë që janë dhënë nga mësimdhënësit para trajnimit:



(Rama, 2012:29)

Informatat kthyesë, të cilat duhet t'u jepen nxënësve sipas Vlerësimit Formues, që ata të kuptojnë se çfarë kanë realizuar mirë, çfarë duhet të përmirësojnë dhe si mund ta realizojnë atë për ta.


Figura 5.2 Informatat kthyesë të dhëna nga mësuesit pas trajnimit



(Rama, 2012:29)

Informatat kthyesë janë një pjesë shumë e rëndësishme e të nxënësve, të cilat lejojnë nxënësin për të kuptuar nëse ata janë në rrugën e duhur. Dhënia e informatës kthyesë mundëson diagnostikimin e përparësive apo vështirësive me të cilat ballafaqohen nxënësit gjatë procesit të nxënies dhe siguron të zbulojë arsyet të cilat i sjellin ato vështirësi gjatë nxënies.

Figura 5.3 Mendimet e nxënësve për informacionin kthyes



(Përmirësimi i të nxënit nëpërmjet vlerësimit, Prishtinë, 2012, fq.30)

Komentet apo informacionet kthyes shërbejnë për komunikim të drejtëpërdrejtë me nxënësit dhe komunikim të tërthortë me prindër për informimin e tyre rreth ngritjes apo rënies së rezultateve.

(Rama, 2012:30)

Komentet e dhëna përmes informacionit kthyes shërbejnë për komunikim direkt me nxënësit dhe komunikim indirekt me prindër për informimin e tyre rreth ngritjes apo rënies së rezultateve të fëmijëve të tyre. Ato duhet të jenë mbështetëse për nxënësit, të drejtuara drejt përmirësimit të punës së tyre, të përqëndruara në punën e realizuar të nxënësit – e jo në vetë nxënësin, të shkruhen në mënyrë sistematike - të vazhdueshme si dhe është e rëndësishme që të jepen në kohën dhe momentin e duhur. Në të kundërtën, nëse feedbacku jepet në formën negative nxënësit nuk mund të kuptojnë saktësisht se ku duhet të

përmirësohen dhe si, e po ashtu edhe prindërit nuk mund ta dinë se si t'i ndihmojnë fëmijët e tyre.


Dhënia e komenteve nga ana e mësimitdhënësve konsiderohet si ndihmë për nxënësit përmes informacionit kthyes, me ç'rast nxënësi do të bindet se sa e ka kuptuar informacionin e ri ose a ndien nevojë për përsëritje të informacionit.

“Informata kthyesë e përcjellur me notë nuk ka efekt në përmirësim, pasi që nxënësi e shikon vetëm notën dhe injoron komentin dhe bën krahasimin me notën e shokut/shoqes që ka afër dhe nuk i jep rëndësi komentit. Mirëpo, nëse informatat kthyesë jepen vetëm me koment atëherë nxënësi do të përqëndrohet në përmbajtjen e komentit dhe do të punojë drejt përmirësimit. Hulumtimet tregojnë (Black & William, 1998), se kur informatat kthyesë jepen vetëm me koment, ka përmirësim të suksesit të nxënësve: Vlerësimi me notë, nuk ka përmirësim në sukses; Vlerësimi me komente dhe notë, nuk ka përmirësim; Vlerësimi me komente ka përmirësim deri në 30%.” (Murchan, Shiel & Vula, 2011f:43)

Feedbacku duhet të thuhet ose shkruhet në mënyrë specifike, të individualizuar dhe me orientim pozitiv për nxënësin - në formë përshkruese të theksuar, e jo në formën e përgjithshme. Studiuesi Valerie Shute 2008 tha: “Informacioni i komunikohet nxënësit pasi që ka për qëllim ndryshimin e të menduarit apo sjelljen e tij apo saj për qëllimin të përmirësimit të të nxënësit” (Marzano, 2010:3) Feedbacku duhet t'i japë nxënësit mundësi të reagojë në kohën dhe momentin e duhur. Është e mirëseardhur nëse shkruhet në formë efektive dhe më të gjatë, tregohet në hollësi ku janë gabimet, si duhet të arrihet deri tek forma e përmirësimit të tyre, si dhe të jetë në përshtatshmëri me kriteret e përcaktuara më parë. Shprehjet duhet të zgjidhen nga ana e mësimitdhënësve në mënyrë të kujdesshme, duke treguar saktë arritjet e nxënësve. Po ashtu është me rëndësi që të orientohen nxënësit drejt përmirësimeve të nevojshme që janë të nevojshme, pra drejt përmirësimeve që duhen bërë duke i eliminuar shprehjet e shkurtra. (Kraja, 2006) Nëse komentet shkruhen në formë të shkurtër si: shumë mirë, pak më pastër, pak më mirë, shumë bukur, bukur, mirë, të lumtë

etj., konsiderohen si komente joefektive - jo nxitëse dhe nuk tregojnë se çfarë duhet të përmirësohet.

Figura 6.1 Qëllimi i kriterëve të suksesit për procesin e të nxënit



Vlerësimi për të nxënit (Vlerësimi Formues)¹⁴

Vlerësimi Formues dhe komentet përmes kthimit të informacionit duhet të ofrojnë mundësi pozitive në të mësuarit e nxënësve, nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimin mes nxënësve

¹⁴Vlerësimi për të nxënit (Vlerësimi Formues); marrë më 14 prill 2015 nga: http://www.gwaea.org/iowacorecurriculum/docs/AssessmentForLearning_LitReviewFinal.pdf

dhe mësimdhënësve, duke rritur eksperiencën në të mësuarit e nxënësve dhe motivimin e tyre. (Irons, 2007) Feedbacku duhet të shkruhet në formë të qartë, të saktë, të matur, të jetë efektiv, përshkrues, i individualizuar, e po ashtu nxënësve t'u japë mundësi që të reagojnë në situata të ndryshme, duke i shkruar në formë më të gjatë. Ato mund të shkruhen në këtë formë si p.sh. 'ke dhënë një shembull të mirë', 'ke realizuar shumë mirë përdorimin e shenjave të pikësimit', 'fokusohu në krahasimin e numrave', 'shkruaj më pastër radhën tjetër', 'shkruaj shkronjat më bukur', 'filloje fjalinë me shkronjë të madhe', 'aplikoje rregullën e dhënë', 'respekto shenjat e pikësimit', 'shkruaj sipas kriterëve të suksesit', etj. "Një studim nga Stuart Yeh (2008) zbuloi se nxënësit të cilët kanë marrë feedbackun kanë përfunduar me saktësi më shumë punë se nxënësit të cilët nuk kanë marrë feedbackun" (Marzano, 2010:5)

Studiuesit Kluger dhe DeNisi në vitin 1996 në 38% të studimeve kanë gjetur se feedbacku sjell një efekt negativ në arritjet e nxënësve. Sqarojnë me saktësi se informacioni feedbacku në formë negative nuk sjell ndonjë efekt pozitiv në procesin e të nxënësve dhe nuk u jep mundësi nxënësve që të dinë se si të përmirësohen. (Marzano, 2010:5)

Figura 6.2 Shembuj nga feedback-u i dobishëm për detyrën me shkrim të Anës

Komente të mundshme nga mësimdhënësi	Ç'është më e mira e këtij feedback-u
Fjalitë jote të mëdha dhe ajo përmbajtëse janë të qarta dhe shkojnë mirë bashkë.	Këto komente përshkruajnë arritjen në bazë të kriterëve për atë detyrë. Ato i tregojnë nxënësit që ti ke vërejtur këto karakteristika specifike dhe i ke lidhur ato me kriteret për punë të mirë.
Ke përdorur shumë detaje. Unë numëroj shtatë gjëra të ndryshme që ty të pëlqejnë rreth qenve.	

Paragrafi yt më bën të pyes veten se a ke një qen i cili është lozonjar, i fortë, i lezetshëm dhe ledhatues. A mendove për qenin tënd gjatë shkrimit të paragrafit? Kur shkruan për gjërat që di, shkrimi tingëllon shpesh real si në këtë rast.	Ky koment veçanërisht mund të jetë i nevojshëm për një nxënës i cili më herët nuk ka qenë i suksesshëm në procesin e shkrimit. Komenti identifikon strategjinë që nxënësi ka përdorur për shkrim, dhe pohon se ka qenë një strategji e mirë. Vëreni se “shkrimi shpesh tingëllon i sinqertë” mund të jetë anglishte më e mirë, por “real” është ndoshta më e qartë për këtë nxënës të klasës së katërt.
Arsyet tuaja janë të gjitha për qentë. Lexuesit do të duhej të dinin se si janë macet. Ata s’kanë si ta kuptojnë nga paragrafi yt nëse macet janë për shembull; lozonjare. Kur krahason dy gjëra, shkruaj për të dyja gjërat të cilat po i krahason.	Ky feedback konstruktiv kritikon një karakteristikë specifike të kësaj pune, shpjegon arsyen për kritikën, dhe sugjeron se ç’duhet bërë rreth saj.
A e kontrollove drejtshkrimin tënd? Shiko në mund të gjesh dy fjalë të shqiptuara keq.	Këto komente për stilin dhe mekanikën nuk reflektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë objektivin e mësimit, i cili është për paragrafët. Sidoqoftë, ato (komentet) lidhen me aftësitë e rëndësishme të shkrimit. Se a janë ato të duhura do të varej fuqishëm nga shqiptimi, stili/përdorimi, dhe imazhi i zgjedhjes së fjalëve në objektivin afatgjatë të mësimit.
Feedback-u për të bërë fjalinë temë një pistë më të fortë më së miri mund të bëhet si një demonstrim. Në konferencë, tregoji nxënësit për fjalinë temë me dhe pa “Ja pse” dhe pyete atë se cila fjali mendon që lexohet më rrjedhshëm dhe pse. Pyete mos “Ja pse”-ja shton ndonjë gjë që i nevojitet fjalisë. Mund ta sjellesh në pah faktin që këto fjalë tingëllojnë më mirë në fjalinë përmbyllëse.	

(Udhëheqja arsimore)¹⁵

¹⁵Udhëheqja arsimore; marrë më 15 gusht 2015 nga: <http://www.ascd.org/publications/educational-leadership/dec07/vol65/num04/Feedback-That-Fits.aspx>

Në këtë tabelë vërejmë shumë komente efektive që secili nga mësuesit mund t'iu shkruajë nxënësve për detyrën e realizuar. Komentet janë këshilluese dhe nxitëse, të cilat tek nxënësi ngjallin emocione pozitive drejt realizimit të suksesshëm të detyrës duke e kuptuar nxënësi saktë se çfarë duhet të ndryshojë dhe si duhet të bëjë përmirësimin. Përmes identifikimit të problemit, përmirësimit të tij arrijmë tek realizimi i objektivave dhe qëllimit për një të nxënë të qëndrueshëm e cilësor të nxënësve.

2.7.3. Portfolio e nxënësit

Portfolio paraqet një grumbullim të punimeve të performancës së nxënësve gjatë gjithë kohës, ku nxënësit reflektojnë në rritjen dhe përparimin e tyre në fusha apo lëndë të ndryshme, ku fokusi kryesorë është vetëpërmirësimi. Një portfolio është një "antologji e qëllimshme, sistematike e punës së nxënësit gjatë kohës që përfshin pjesëmarrjen e nxënësve në mbledhjen e përmbajtjes, dëshmitë e nxënësve në vetëreflektim, kriteret për përzgjedhjen, kriteret për të gjykuar vlerën. (Callahan, 2006:28)

Përmes portfolios arrihen shumë përfitime për nxënësit, pasi mund të sigurohen në mënyrë efektive informacione të nevojshme si në shkenca e po ashtu në lëndën e matematikës. Mund të bëhet komunikim me prindërit rreth pikave të forta apo të dobëta të nxënësit dhe të nxënësve të tyre, po ashtu arrihet që të inkurajohen nxënësit në marrjen e përgjegjësisë për të mësuarit e tyre. (Hamm & Adam, 2009)

Në portfolio mblidhen punimet më të mira të përzgjedhura nga vetë nxënësi si vetëvlerësim i punës, "Duke përdorur një portfolio për vlerësimin, nxënësit i lejon që të vetë-monitorohet rreth të mësuarit të tij, por ajo gjithashtu mësuesit i jep mundësi

për të parë rritjen dhe zhvillimin në formën e një projekti”.¹⁶ Kjo i lejon mësimdhënësit që të ketë një pasqyrim të plotë rreth punës së nxënësit, për të arritur tek një vlerësim i plotë si dhe përfshin prindërit në kontrollimin e të nxënësit të fëmijëve të tyre.

Është e rëndësishme që në planifikimin e procesit mësimor gjatë vlerësimit t’i kushtohet rëndësi mbledhjes së informacioneve të punuara me shkrim nga nxënësit si dokumentim i punës së përbashkët mësimdhënëse – nxënës dhe bashkëpunimit e bashkëveprimit në mes nxënësve. Sipas Arter & Spandel portfolio është:

“Një ‘koleksion’ i qëllimshëm i punimeve të nxënësit që tregon për përpjekjet, përparimin dhe të arriturat e tij në një fushë mësimore të caktuar. Ky ‘koleksion’ duhet të përfshijë pjesëmarrjen e nxënësit në përzgjedhjen e përmbajtjes së dosjes (portfolios), udhëzimet për përzgjedhje dhe kriterin e vlerësimit, për të dëshmuar meritat dhe dëshmitë e vetë-reflektimit të nxënësit”. (Murchan, Shiel & Vula, 2011g:52)

Punimet e realizuara nga nxënësit janë reflektim i punës së pavarur të nxënësve, të cilat ruhen nëpër dosje individuale të përgatituara me emër dhe mbiemër të secilit nxënës. Ato përmbajnë temën, datën si dhe komentet e shkruara nga mësimdhënësi. Portfolio ka për qëllim grumbullimin e të dhënave për të treguar atë që nxënësit dinë, realizojnë dhe që mund të arrijnë me kalimin e kohës, duke reflektuar në mënyrë të vazhdueshme në zhvillimin dhe përmirësimin e tyre personal e profesional. Forster & Masters kanë thënë se portfolio “... përbëhet prej pjesëve të provave. Sa më shumë prova të përshtatshme, nxjerrja e përfundimeve për nivelin e arritshmërisë së nxënësit në një fushë mësimore është më e vlefshme” (Murchan, Shiel & Vula, 2011h:52) Vlerësimi i portfolios nga ana e mësimdhënëse bëhet për rezultatin e arritur në mënyrë që nxënësit të pavarësohen në mbledhjen e shënimeve dhe vetëvlerësimin e punës së tyre, krahasuar me shokët dhe shoqet.

¹⁶Qëllimet e vlerësimit të portfolios; marrë më 10 gusht 2015 nga:
<http://www.ehow.com/about5103845purposes-portfolio-assessment.html>

Varësisht prej lëndës mësimore plotësohet portfolio e nxënësit, bazuar në kriteret e përcaktuara nga mësimdhënësit e nxënësit së bashku. P.sh., në lëndën e gjuhës shqipe nxënësit do të mbledhin në portfolion e tyre:

- Përmbajtjen - çka përmban portfolio;
- Komente, analizë dhe ilustrime të tregimeve të ndryshme;
- Vetëvlerësimin i cili realizohet përmes pyetjeve: Çfarë mësova?, Çfarë kuptova mirë?, Çfarë më nevojitet ende të mësoj? Ku më nevojitet përmirësimi?;
- Zgjedhjen e disa paragrafeve për t'i shkruar si dhe përshkrimin e komenteve për to;
- Listën e gjërave që nuk janë kuptuar, me qëllim të rishikimit, që të arrihet përsëritja e tyre dhe të kuptohen;
- Numërimin e gjërave që më së miri i ka kuptuar;
- Shpjegimin çka ka mësuar dhe cila pjesë i pëlqeu.

Vlerësimi i portfolios nxit nxënësit për një komunikim më të lirë dhe më të afërt me mësimdhënësit e tyre, që të tregojnë një rezultat të suksesshëm në punën e tyre.

2.7.4. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë

Nëse bazohemi tek mendimi pedagogjik për vetëvlerësimin, arrijmë në një përfundim se:

”Vetëvlerësimi është shkalla më e lartë që njihet deri më sot në zhvillimin e procesit të të nxënës aktiv e krijues, është momenti kur nxënësi përpqet, me ndihmën e mësimdhënësit, që të njohë arritjet e tij, pikat e forta e të dobëta dhe mundësitë që ka për të plotësuar mangësitë e për të çuar përpara sukseset në drejtim të vetëformimit shkencor dhe etiko moral”. (Vuji, 2012:19)

Vetëvlerësimi realizohet para, gjatë dhe pas procesit mësimor, kur nxënësit i nevojitet që t'i kontrollojë dhe vlerësojë njohuritë e veta momentale, për të arritur tek zhvillimi i vetvetes në fusha të ndryshme. Vetëvlerësimi i motivon nxënësit që të mbajnë përgjegjësi

për të nxënit e tyre, po ashtu arrin që t'i nxitë ata për vetë-monitorim, vetëvlerësim dhe vlerësim të ndërsjellë. (Vlerësimi për të nxënë)¹⁷

Vetëvlerësimi i ndihmon të gjithë personat që t'i vërejnë lëshimet apo gabimet gjatë të nxënit, duke fituar ide më të qarta se si t'i ndihmojnë vetes për t'u orientuar në përmirësimin e të nxënit. Sipas teorisë së Benduras, i cili konsiderohet që ka një qëndrim kognitiv, duke u mbështetur në pikpamjen tradicionale të të nxënit të nxënësve, vetëvlerësimi përfshin faktorët njohës siç janë ”**pritjet** (çfarë do të nxjerr unë duke punuar kështu?), **qëllimet** – (unë dua ta mbaroj këtë për të bërë diçka tjetër) ... dhe **vlerësimi i vetvetes** – (nuk jam aq mirë tek kjo, kështu që do ta shmang atë). (Musai, Psikologji edukimi - zhvillimi, të nxënë, mësimdhënia, 1999:209) Këta faktorë na ndihmojnë që të arrijmë tek një vlerësim i drejtë dhe i saktë për nxënësit, duke arritur që ata të bindin vetveten përmes kthimit të informacionit tek vetja, pra aplikimit të Vlerësimit Formues si plotësim i qëllimit për një të nxënë cilësor.

”Vetëvlerësimi përfshin metanjohtjen—procesi i të qenit i vetëdijshëm dhe i reflektimit në të nxënit vetjak. Aftësitë vetëvlerësuese përfshijnë pyetje, reflektime, zgjidhje të problemeve, analiza krahasuese efektive si dhe aftësinë për të ndarë mendimet me të tjerët në shumë mënyra”. (Vlerësimi në kurrikulën e shkollës fillore)¹⁸

Vetëvlerësimi mund të aplikohet nga nxënësit e të gjitha moshave dhe niveleve të ndryshme të aftësisë. Po ashtu është i mundshëm të realizohet në të gjitha fushat e të

¹⁷Vlerësimi për të nxënë; marrë më 19 maj 2015 nga:
[http://www.assessmentforlearning.edu.au/professional_learning/intro_to_afl/introduction_key_questions.htm](http://www.assessmentforlearning.edu.au/professional_learning/intro_to_afl/introduction_key_questions.html)
[l](http://www.assessmentforlearning.edu.au/professional_learning/intro_to_afl/introduction_key_questions.html)

¹⁸Vlerësimi në kurrikulën e shkollës fillore; marrë më 5 shtator 2015 nga:
<http://www.ncca.ie/uploadedfiles/publications/assess%20%20guide.pdf>

nxënit. Për të arritur tek realizimi i një vetëvlerësimi është e nevojshme që të kemi parasysh disa masa organizative të karakterit teknik të një niveli të lartë. Metodatat e mësimdhënies të jenë në harmoni me metodatat e të nxënit, duke krijuar një bashkëpunim në mes të mësimdhënësit me nxënësin. Mësimdhënësi duhet të dijë se çfarë do të bëjë konkretisht gjatë orës mësimore dhe çfarë kërkon nga nxënësit që të dinë. Po ashtu, vetëvlerësimi duhet të përcaktojë qartë pozitën e mësimdhënësit dhe të nxënësit, të organizuar në baza shkencore gjatë orëve mësimore. (Vuji, 2012)

Sipas mendimit të Stobart dhe Gipps (1997) “Metanjohtë është procesi i të qenit i vetëdijshëm në të nxënit vetjak: nxënësit e mirë monitorojnë të nxënit e tyre dhe proceset e tyre të të menduarit me anë të vetë-monitorimit. Ajo fokuson vlerësimin e nxënësve në performancën e tyre më tepër sesa në krahasimin e tyre me të tjerët, për çfarë ne e dimë që i ngjan më shumë ruajtjes së motivimit”.(Vetëvlerësimi)¹⁹

Vlerësimi i ndërsjellë përdoret pas mbarimit të veprimtarisë së orës apo ditës ku nxënësit japin mendime të ndryshme për punën e shokut. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë u japin nxënësve më shumë përgjegjësi për të arriturat e tyre dhe realizohen kur nxënësit vlerësojnë përparimin e vetvetës apo përparimin e shokëve të tyre. Është me rëndësi që të jenë pjesë e planit ditor të mësimdhënësve, duke u bazuar në kritere të suksesit që të arrihet reflektimi i një rezultati pozitiv e cilësor në të nxënit e nxënësve. (MASHT, Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë, 2012)

¹⁹Vetëvlerësimi; marrë më 20 gusht 2014 nga:
http://cass.welbni.org/downloads/27/213_86_Self%20Assessment-pdf.pdf

2.8. Koncepti i mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve mbi ndryshimin, krahasimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues për të nxënë të suksesshëm

Prindërit dhe familja janë njohësit më të mirë të fëmijës, pasi secili fëmijë ka personalitetin dhe veçantitë e tij. Kuptohet se lidhja kryesore e marrjes dhe dhënies së informacioneve për fëmijët – nxënësit janë familja dhe prindërit për sjellje, veprime të ndryshme me anëtarët e tjerë të familjes, loja me bashkëmoshatarë etj. Motivimi për marrjen – dhënien e informacioneve arrihet përmes komunikimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga prindërit tek mësimdhënësit, përmes formës së komunikimit gojor ose me shkrim.

Mësimdhënësit kanë përgjegjësi të mëdha ndaj nxënësve në shkollë. Ata në mënyrë të suksesshme dhe të efektshme arrijnë që të planifikojnë dhe realizojnë metoda të mësimdhënies, nxënies si dhe forma të ndryshme të vlerësimit. Përmes planifikimit të objektivave rreth aktiviteteve të përcaktuara për ndërveprimet që ata kanë me nxënësit është i nevojshëm përqëndrimi dhe bashkëpunimi mes tyre, për arritjen e një qëllimi të përbashkët për një të nxënë cilësor.

Është i mirëpritur ndryshimi të cilin mësimdhënësit planifikojnë të realizojnë gjatë procesit të të nxënit në shkolla përmes aplikimit të disa formave të vlerësimit. Popham mendon se është me rëndësi të arrihet tek ky definicion për Vlerësimin Formues: “Vlerësimi formues është një proces i planifikuar në të cilin vlerësim arrihet evidentimi i statusit të nxënësve i cili përdoret nga mësimdhënësit për të rregulluar procedurat e vazhdueshme mësimore apo nga nxënësit për të rregulluar taktikat e tyre aktuale të të nxënit”. (Popham, 2008:6)

Aplikimi i Vlerësimit Formues arrin të sjellë rezultate, si për nxënësit ashtu edhe për mësimdhënësit, pasi nxënësit marrin informacione rreth të nxënit të tyre, ndërsa

mësimdhënësit rreth mësimdhënies së tyre. Këto informacione përcillen edhe tek prindërit, përmes komunikimit dhe bashkëpunimit direkt ose indirekt, ku mund të kërkohej dhe ndihma e tyre për të ngritur nivelin e njohurive dhe cilësinë në të nxënë tek fëmijët - nxënësit.

Ndryshimet që vihen nga mësimdhënësit në bashkëpunim me nxënësit në klasë janë tipari kryesor i punës efektive në klasë, që ndihmon në përmirësimin e arritjeve të nxënësve.

Sipas të gjitha të dhënave, komunikimi dhe bashkëpunimi me prindër për ngritjen e cilësisë në gjithë procesin mësimor është shumë i rëndësishëm. Qëllimi i komunikimit me prindër është që të arrihet një përshkrim i realitetit dhe një njohje për punën që realizohet në shkollë nga ana e nxënësve dhe mësimdhënësve, me qëllim që të arrihet tek një vlerësim i përbashkët dhe pa mëdyshje për nxënësit. Mësimdhënësi duhet të vëzhgojë punën e nxënësve në vazhdimësi, pra të përcjellë dhe hulumtojë rreth nevojave e kërkesave të nxënësve, të mbledhë të dhënat për të arritur tek raportimi i rezultateve, që prindërit të kuptojnë informacionet rreth fëmijëve të tyre.

Vlerësimi Formues ua bën të mundur mësimdhënësve dhe prindërve që të zhvillojnë një kuptim më të mirë rreth procesit të ndryshimit dhe për të gjetur se: çfarë funksionon, çfarë jo dhe pse? Vlerësimi Formues “është ai tip vlerësimi që shërben për të mësuar nëse po procedojmë mirë me mësimdhënien tonë dhe se çfarë duhet të bëjmë më tutje. Ai bëhet në një kohë që gjykohej më e përshtatshme nga mësimdhënësi ... nuk kanë synim kryesor vënien e notave” (Garo, 2002:288) Kjo ua mundëson mbledhjen e njohurive për të nxënë, për të përmirësuar planet në vazhdim të projektit dhe zbatimin e tij.

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

Vlerësimi në klasë mund të realizohet në disa forma: përmes vëzhgimit dhe diskutimit të rregullt me nxënësit, përmes vlerësimit të aktiviteteve në klasë dhe detyrave të shtëpisë, përmes monitorimit të vazhdueshëm, duke përshtatur mësimdhënien, përmes krahasimit të arritshmërisë në mes të nxënësve dhe me standardet e kërkuara, duke zhvilluar aftësi të ndryshme tek nxënësit përmes aplikimit të Vlerësimit Formues.

Kapitulli III: Metodologjia e studimit

Metodologjia e studimit përshkruhet në mënyrë të detajuar gjatë këtij kapitulli. Pyetjet kërkimore të cilat marrin përgjigje gjatë zhvillimit të temës studimore kanë për qëllim të zbulojnë marrëdhëniet në mes të përgatitjes së nxënësve, reflektimit cilësor dhe Vlerësimit Formues.

Për të mundësuar marrjen e të dhënave të mjaftueshme dhe analizimin e tyre është përdorur metodologjia mikse - metoda sasiore dhe cilësore për të parë marrëdhëniet në mes të përgatitjes së nxënësve, reflektimit cilësor dhe Vlerësimit Formues.

Gjatë analizës së të dhënave metoda cilësore është më e theksuar, pasi përmes intervistave me drejtorë, mësime, nxënës dhe vëzhgimit në klasë vërejmë në mënyrë më të qartë aplikimin e formës së Vlerësimit Formues.

3.1.Nevoja për këtë studim

Ideja, për hulumtimin e problematikës së aplikimit të vlerësimit në klasa e veçanërisht aplikimit të Vlerësimit Formues ka filluar nga përvoja ime si mësime për disa vite, puna e përbashkët me kolegë dhe prindër rreth eliminimit të dobësive për përmirësimin e punës së nxënësve në mënyrë sistematike për arritjen e një të nxëni cilësor të tyre, si dhe dëshira për të ushtruar këtë profesion në vazhdimësi.

Vlera në çdo sistem arsimor arrihet nga vlerësimi pasi është proces i mbledhjes, gjykit, interpretimit të të dhënave dhe marrjes së një vendimi për një person të caktuar. Përdorimi i më shumë formave të vlerësimit në procesin mësimor luan një rol të rëndësishëm në arritjet e nxënësve në nivele të ndryshme të shkollimit të tyre. Me gjithë ndryshimet e bëra në sistemin arsimor për një të nxënë të qëndrueshëm e cilësor, edhe sot vërehet se

mësimdhënësit, përkundër angazhimit dhe punës së palodhshme, ende përcaktojnë arritjet dhe kurorëzimin e punës së nxënësve vetëm përmes aplikimit të Vlerësimit Përmbledhës. Nga analiza e të dhënave në një hulumtim të realizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës në vitet 2007/2008 vërejmë se Vlerësimi Formues nuk aplikohet mbi bazën e qëllimeve që planifikohen nga Vlerësimi Formues, por aplikohet vetëm Vlerësimi Përmbledhës për t'i notuar nxënësit në ditar, si rezultat i vlerësimit me gojë në tabelë dhe me teste. (Instituti Pedagogjik i Kosovës)²⁰

3.2. Objekti i hulumtimit

- Hulumtimi i realizuar në tri shkolla fillore të Komunës së Gjakovës: “Zekeria Rexha”, “Selman Riza” dhe “Zef Lush Marku”.
- Përfshirja e drejtorëve të të tri shkollave;
- Përfshirja e mësimdhënësve të klasave të I-ra deri në V-ta;
- Përfshirja e nxënësve të klasave të I-ra deri në V-ta;
- Hulumtimi realizohet përmes hartimit të pyetësorit për të gjithë mësimdhënësit e të tri shkollave, intervista gjysmë e strukturuar me drejtorët e shkollave; intervista individuale me një numër të caktuar mësimdhënësish, intervista gjysmë e strukturuar me një numër të caktuar nxënësish, e realizuar në fokus grupe si dhe realizimi i vëzhgimit në klasa, nga klasa I-rë – V-të;

²⁰Instituti Pedagogjik i Kosovës; marrë më 10 maj 2015 nga: <http://www.masht.gov.net/advCms/documents/prezantimi.ppt.2.pdf>

- Nxjerrja e të dhënave për të tri shkollat e Komunës së Gjakovës: “Zekeria Rexha” Gjakovë, “Selman Riza” paralagje e qytetit, “Zef Lush Marku” Brekoc - Komuna e Gjakovës - Kosovë, për planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues në klasë.
- Analizë e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve të hulumtimit përmes programit SPSS;
- Analizë e të dhënave nga pyetësi i ndarë në dy nivele;
- Analizë e të dhënave përmes tabelave duke i renditur përgjigjet e marra nga drejtorët, mësimmshënësit e nxënësit.

3.3. Detyrat e hulumtimit

- Grumbullimi i literaturës për trajtimin e problemit;
- Sqarimi i nocioneve bazë për temën e hulumtimit;
- Metodologjia;
- Shpjegimi i rëndësisë së aplikimit të disa formave të vlerësimit në shkollë;
- Pasqyrimi i angazhimit të mësimmshënësve për aplikimin e Vlerësimit Formues dhe njohja e prindërve me vlerësimin e fëmijëve – nxënësve;
- Formulimi i pyetësorëve për marrjen e informacioneve se si dhe sa planifikohet dhe aplikohet Vlerësimi Formues nga ana e mësimmshënësve në shkollat tona;
- Formulimi i pyetjeve për intervistën e gjysëmstrukturuar me drejtorët e shkollave;
- Formulimi i pyetjeve për intervistën individuale me disa prej mësimmshënësve;
- Formulimi i pyetjeve për intervistën e gjysëmstrukturuar me disa prej nxënësve;

- Formulimi i kriterëve për realizimin e vëzhgimit në klasa;
- Paraqitja dhe interpretimi i rezultateve në mënyrë grafike përmes programit SPSS.

Duke u bazuar në rezultatet e nxjerra vijmë te përfundimet dhe rekomandimet për fuqizimin e planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues nëpër shkollat tona.

3.4. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i realizimit të hulumtimit është sigurimi i informacioneve të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për nxënësit, duke arritur të zgjerojë gjetjet nga studime të ndryshme për matjen e diturive përmes aplikimit të formave të ndryshme të vlerësimit, në veçanti aplikimit të Vlerësimit Formues drejt arritjes së një vlerësimi të saktë.

Qëllimi i studimit është të hulumtojë arritjen e një të nxëni motivues dhe produktiv të nxënësve në mënyrë sistematike përmes aplikimit të Vlerësimit Formues për një të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektim cilësor në shkolla.

Nëse mbështetemi tek studimi i Cowie dhe Bell (1996) kuptojmë se të dy arrijnë tek një definim se aplikimi i Vlerësimit Formues nga ana e mësimitdhënësve dhe nxënësve ndikon në ngritjen e cilësisë së të nxënit të nxënësve. (Bell & Cowie, 2002)

3.5. Parashtrimi i problemit

Shoqëria jonë është ende në proces ndryshimi. Disa nga format e vlerësimit të cilat janë të planifikuara për t'u realizuar në shkollë janë vlerësimi diagnostifikues, formues, përmbledhës, i brendshëm dhe i jashtëm, me qëllim të përcaktimit të arritjeve të nxënësve

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

për një periudhë të caktuar si tremujor apo gjysmëvjetor. Përkundër ndryshimeve që janë bërë në sistemin arsimor në Kosovë shkollat tona ende nuk kanë ndonjë strategji të veçantë për planifikimin dhe aplikimin e disa formave të vlerësimit, si një ndër hallkat kryesore në procesin mësimor dhe të nxënësve të cilësor të nxënësve. Metodat tradicionale të vlerësimit që aplikohen edhe në ditët e sotme nuk janë të mjaftueshme, vlerësimet të cilat realizohen në shkolla gjatë procesit mësimor kryesisht janë ai përmblendhës, i brendshëm dhe i jashtëm. Duhet të theksojmë se fokusin kryesor të punimit e përbën puna e mësimitdhënësve në shkolla, vlerësimi i njohurive të nxënësve përmes aplikimit të formave të ndryshme të vlerësimit e në veçanti planifikimi dhe aplikimi Vlerësimit Formues për të nxënë e nxënësve.

Punimi përqendrohet në matjen e punës së mësuesve në shkollë se a e kuptojnë Vlerësimin Formues, sa dhe si e zbatojnë atë gjatë procesit mësimor dhe pikëpamjet e tyre për të identifikuar shkallën e arritjes së njohurive që nxënësit kanë rreth mësimave për të ofruar ndihmë në rastet e nevojshme. Njohja e Vlerësimit Formues nga ana e mësimitdhënësve dhe pikëpamja e tyre rreth aplikimit të vlerësimit është i rëndësishëm pasi në Kosovë, sipas të dhënave nga Basic Education Program, 151 shkolla nga 16 komuna kanë qenë të përfshira në trajnim për vlerësimin deri në vitin 2012, ku 4000 mësimitdhënës janë trajnuar për Vlerësimin Formues dhe 272 janë fasilitatorë shkollorë të vlerësimit. Ndërsa, sipas MASHT deri në vitin 2015 duhet të trajnohen të gjithë mësimitdhënësit e Kosovës për planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues në shkolla.

Pikëpamjet dhe qëndrimet e mësimitdhënësve luajnë rol të rëndësishëm në procesin mësimor, duke realizuar vlerësimin e nxënësve në mënyrë sistematike. Sado që

mësimdhënia dhe të nxënit të jenë të rëndësishme, vlerësimi konsiderohet si hallka kryesore për të marrë njohuri rreth të nxënit të nxënësve, e po ashtu në mbajtjen aktive të tyre gjatë gjithë procesit mësimor, ku mësimdhënësit duhet të paraqesin qëndrimet e tyre pozitive si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga ana e nxënësve.

Për të arritur këtë studim u ndërtuan objektiva, për të matur pretendimet se:

Vlerësimi Formues ndikon në të nxënit e qëndrueshëm dhe arritje cilësore të nxënësve gjatë procesit të të nxënit, sepse janë mësimdhënësit ata që reflektojnë dije dhe njohuri tek nxënësit e tyre, përmes qëndrimeve e natyrave të ndryshme, ku si rrjedhojë reflektojnë punën e tyre të përditshme dhe të palodhshme edukative. Studiuesit Black and Williams arrijnë në përfundim se Vlerësimi Formues e përmirëson të nxënit e nxënësve (Popham, 2008b)

Planifikimi i mësimit duhet të realizohet duke marrë për bazë edhe Vlerësimin Formues (për nxënie) si përshtatje në nevojat individuale të nxënësve dhe motivimin e tyre, e po ashtu si lehtësim i punës së mësimdhënësve në të kuptuarit e përparësive dhe mangësive të nxënësve, duke angazhuar nxënësit në eliminimin e vështirësive dhe mangësive në mënyrë sistematike. Vlerësimi Formues u ofron nxënësve mundësi të mira që njohuritë e reja të cilat i marrin t'i praktikojnë pa ndonjë ndëshkim dhe nëse bëjnë gabime nuk rrezikohen që të marrin notë të dobët ose të ulin notën që kanë marrë më parë. (Driscoll & Wood, 2007)

3.6. Rëndësia e studimit për aplikimin e Vlerësimit Formues në shkolla

Ky studim është i rëndësishëm duke u nisur nga fakti se vlerësimi është pjesa më e rëndësishme dhe më delikate e procesit mësimor.

Nëse u referohemi të dhënave të literaturës, vërejmë se ky studim është i rëndësishëm sepse në Kosovë ka shumë pak studime në këtë fushë dhe po ashtu kërkimet për Vlerësimin Formues luajnë një rol të rëndësishëm në procesin mësimor.

Ky studim është i rëndësishëm sepse analizon planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues në shkolla i cili ndikon në motivimin dhe rimotivimin e nxënësit, ngase arrihet të planifikohen dhe realizohen kriteret e suksesit nga ana e mësimitdhënësit në bashkëpunim me nxënësit, për të arritur së bashku në një cak - për arritjen e një të nxëni cilësor.

Përmes këtij studimi kuptohet se si arrihet tek sigurimi i informacioneve të mjaftueshme dhe të qëndrueshme nga ana e mësimitdhënësve për nxënësit, eliminimi i dobësive të mundshme, përmirësimi i punës së nxënësve në mënyrë sistematike, e po ashtu edhe riplanifikimi i mësimit nga vetë mësimitdhënësit. Vlerësimi Formues është shumë i rëndësishëm në procesin mësimor i cili nëse kuptohet, planifikohet dhe aplikohet mirë duke u zbatuar me shkathtësi, sjell dobi për të gjithë mësimitdhënësit dhe nxënësit.

(Popham, 2008)

Studimi mundëson rrugën për arritjen e informimit të prindërve nga ana e mësimitdhënësve në lidhje me vlerësimin e fëmijëve të tyre në mënyrë sistematike, pasi të arriturat e tyre ndryshojnë në faza të ndryshme gjatë zhvillimit të tyre akademik. Analizohet edhe mundësia e komunikimit dhe bashkëpunimit me prindër për sjelljet dhe të nxënit e nxënësve që të arrihet një bashkëpunim i mirëfilltë përmes formave të ndryshme të

bashkëpunimit rreth ngritjes së cilësisë në të nxënë, si dhe paraqitjes së përparësive dhe mangësive të cilat duhet të eliminohen gjatë procesit mësimor.

Gjetjet e këtij studimi shërbejnë si ndihmë për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit, me qëllim të arritjes së një të nxëni të qëndrueshëm cilësor, përmes aplikimit të Vlerësimit Formues. Po ashtu, gjetjet shërbejnë si qasje pozitive për udhëheqësit e Drejtorive të Arsimit, udhëheqësit e shkollave, mësimdhënësit e prindërit, për të arritur tek realizimi i ndryshimeve të mundshme pozitive në procesin mësimor përmes realizimit të Vlerësimit Formues në shkolla.

3.7. Objektivat e hulumtimit

Me anë të objektivave të këtij studimi synohet që:

- Të verifikohet shkalla e aplikimit të Vlerësimit Formues nëpër shkolla;
- Të kuptohet se a ndikon aplikimi i Vlerësimit Formues në përmirësimin e të nxënit të nxënësve;
- Të kuptohet se a planifikohen kriteret e suksesit;
- Të argumentohet puna e suksesshme e mësimdhënësve përmes aplikimit të Vlerësimit Formues;
- Të argumentojnë mësimdhënësit nëse arrijnë të kuptojnë se a ka nevojë për një rifreskim të njësive mësimore;
- Të tregojnë se a realizohet komunikimi me prindër në mënyrë më efektive për përmirësimin e të nxënit;

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

- Të kuptohet dëshira e nxënësve për të marrë komente të bukura me shkrim ose me gojë;
- Të tregojnë nxënësit formën se si vlerësohen;
- Të argumentohen anët pozitive të aplikimit të Vlerësimit Formues për nxënie të qëndrueshme dhe cilësore;
- Të argumentohen anët negative të aplikimit të Vlerësimit Formues për nxënie të qëndrueshme dhe cilësore.

Përmes këtyre matjeve do të arrijmë të bëjmë të kuptueshme dhe bindëse idenë se planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues në shkollat tona nga ana e mësimeve ndihmon tek arritja e një Vlerësimi Përmbledhës për secilin nxënës, pa asnjë mëdyshje.

3.8. Pyetjet kërkimore

1. A është i rëndësishëm aplikimi i disa formave të vlerësimit, e në veçanti i Vlerësimit Formues për nxënie të qëndrueshme dhe të arritura cilësore gjatë procesit mësimor?
2. A e njohin mësimeve formën e Vlerësimit Formues?
3. Cilat janë përparësitë e aplikimit të Vlerësimit Formues në të nxënësit cilësor të nxënësve?
4. Cilat janë mangësitë e aplikimit të Vlerësimit Formues në të nxënësit cilësor të nxënësve?
5. A ndikon aplikimi i Vlerësimit Formues në kontrollimin dhe përmirësimin e njohurive të nxënësve dhe njoftimin e prindërve për suksesin e nxënësve?

6. A ndikon aplikimi i Vlerësimit Formues në kontrollimin dhe përmirësimin e njohurive të nxënësve dhe njoftimin e prindërve për mosesuksesin e nxënësve?
7. A mund të arrihet përmirësim i suksesit të nxënësve përmes aplikimit të Vlerësimit Formues në shkollë?
8. A arrijnë mësuesit të komunikojnë dhe bashkëpunojnë me prindërit përmes fletoreve të nxënësve?

3.9. Hipotezat kërkimore

1. Zbatimi i Vlerësimit Formues në shkollë ndikon në të nxënë të qëndrueshëm, reflektim cilësor, strukturimin e mësimit, rritjen e cilësisë së komunikimit me prindër, përmirësimin e të nxënë.
2. Zbatimi i pjesshëm i Vlerësimit Formues në shkollë ndikon në të nxënë të qëndrueshëm.
3. Zbatimi i pjesshëm i Vlerësimit Formues në shkollë ndikon në reflektim cilësor.
4. Informimi i nxënësve përmes Vlerësimit Formues ndikon në strukturimin e mësimit.
5. Informimi i nxënësve përmes Vlerësimit Formues ndikon në rritjen e cilësisë së komunikimit me prindër.
6. Informimi i nxënësve përmes Vlerësimit Formues ndikon në përmirësimin e të nxënë.

Bazuar në pyetjet kërkimore dhe hipotezat e kërkimit të lartëshënuara arrijmë tek formulimi variabla.

3.10 Variabla

Janë përdorur dy lloje të variablave në këtë studim: variabla e pavarur dhe variabla e varur.

Variabla e pavarur – Vlerësimi Formues, mësimdhënësit

Variabla e varur – përgatitja e nxënësve, reflektimi cilësor

Të dy variablat paraqesin marrëdhënie koncepti.

Meqenëse përgatitja e nxënësve dhe reflektimi cilësor për të nxënë e qëndrueshëm kryesisht varen nga Vlerësimi Formues dhe nga mësimdhënësit, themi se “përgatitja e nxënësve dhe reflektimi cilësor” janë variabli i varur. Pra, variabli që prodhon ndryshime në variablin tjetër quhet “variabël i pavarur”, kurse variabli që ndikohet nga ai i pari quhet “variabël i varur”. (Kocani, 2009)

3.11. Metodatat e hulumtimit

Ky lloj hulumtimi zbatohet për herë të parë në Kosovë, prandaj hulumtuesja e ka konsideruar se është i domosdoshëm përdorimi i metodave të kombinuara sasiore dhe cilësore, metoda të cilat janë zbatuar në studime të ndryshme dhe janë cilësuar si të përshtatshme për konstatimin real gjatë studimit të dukurive të ndryshme. Të dhënat e hulumtimit të cilat janë nxjerrë përmes zbatimit të metodës cilësore kanë plotësuar opinionin e mësimdhënësve, të cilët kanë qenë pjesë e studimit sasior.

- **Analiza deskriptive-përshkruese** – me anë të kësaj metode pas studimit të anës teorike arrijmë tek analiza dhe përshkrimi i të dhënave të nxjerra nga hulumtimi për të dhënat rreth objektit të hulumtimit.
- **Analiza komparative – krahasuese.** – Përmes kësaj metode bëhet krahasimi i mendimeve të drejtorëve, mësimdhënësve dhe nxënësve nëpër shkolla për mendimet e tyre rreth

planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues në procesin e të nxënit në shkollë dhe zbatimit të tij në klasë.

- **Analiza statistikore.** – Me anë të kësaj metode arrihet tek përpunimi i rezultateve të nxjerra nga hulumtimi për interpretimin tyre.

Përmes metodave të përdorura hulumtuesja është munduar të nxjerrë në pah gjendjen reale në shkollë edhe pas trajnimit pothuaj të të gjithë mësimitdhënësve në shkollat e Kosovës për rëndësinë e planifikimit dhe aplikimit të disa formave të vlerësimit, e në veçanti të Vlerësimit Formues dhe atij Përmbledhës.

Për të arritur tek një definicion rreth hulumtimit mund të mbështetemi tek mendimi i Pole dhe Lampard ku thonë se “Hulumtimi nuk është diçka që ndodh vetvetiu. Ai duhet të ketë gjithmonë një qëllim... hulumtimi duhet të na japë njohuri që janë të shëndosha, të mbrojtshme dhe të dobishme”. (Matthews & Ross 2010:9)

3.12. Metoda kërkimore e përdorur

Një element i rëndësishëm që i dallon metodat mes vete është se metodat sasiore janë deduktive, ndërsa metodat cilësore janë induktive. Mund të ndodhë të zgjidhen dy mënyra të ndryshme të mbledhjes së të dhënave sasiore me anë të një pyetësi, punës me të dhëna dytësore, e po ashtu të mbledhen të dhënat cilësore përmes intervistës gjysmë të strukturuar individuale me mësimitdhënës dhe me nxënës, e realizuar në grupet e fokusit, si dhe vëzhgimin me pjesëmarrje në orë mësimore në lëndë të ndryshme. Përdorimi i më shumë mënyrave për të mbledhur të dhënat për t’iu përgjigjur pyetjeve të hulumtimit mund të ndihmojë në verifikimin dhe vlefshmërinë e të dhënave. (Matthews & Ross, 2010)

Analiza e të dhënave dytësore u bazua në rishikimin dhe shqyrtimin e literaturës dhe në analizimin e informacioneve të pasqyruara, ku janë shfletuar një sërë studimesh, raportesh dhe strategji për problematikat që lidhen me vlerësimin, e në veçanti aplikimin e Vlerësimit Formues në vende të ndryshme gjatë procesit mësimor.

Përmes procesit të trekëndëzimit u realizua metoda e kërkimit cilësor, me ç'rast u mbledhën të dhëna duke përdorur teknika të ndryshme si vëzhgimi në klasa, intervista gjysmë e strukturuar, metoda e kërkimit sasior përmes aplikimit të pyetësorit me 19 pyetje dhe analiza e përmbajtjes përmes numërimit të ideve të ndryshme të shkruara. Këto metoda u realizuan me drejtorë, mësimdhënës e nxënës për të vërejtur se a aplikohet Vlerësimi Formues, sa dhe si aplikohet kjo formë vlerësimi; përparësitë, mangësitë si dhe qëndrueshmëria e të nxënësve cilësor të nxënësve në procesin mësimor përmes vlerësimit të nxënësve.

3.13. Popullata e studimit

Popullata e përfshirë në hulumtim janë personat e lidhur drejtëpërdrejt me procesin mësimor. Si popullatë nga të gjitha shkollat e Komunës së Gjakovës janë përzgjedhur tri shkolla fillore të Komunës së Gjakovës - “Zekeria Rexha” – Gjakovë, “Selman Riza” – Dardani (paralagje e qytetit të Gjakovës) si dhe “Zef Lush Marku” – Brekoc – Komuna e Gjakovës. Andaj, themi se studimi nuk mund të përgjithësohet, pasi është realizuar vetëm në Komunën e Gjakovës dhe të dhënat vlejné vetëm për këtë komunë. Kampioni në hulumtim nga shkollat e përzgjedhura fillore janë drejtorët, mësimdhënësit dhe nxënësit me të cilët është realizuar hulumtimi.

Në shkollën “Zekeria Rexha” është intervistuar drejtoresha, 29 mësimdhënës janë anketuar me pyetësor, 5 mësimdhënës janë intervistuar individualisht, 25 nxënës janë intervistuar në fokus grupe me nga 5 nxënës dhe vëzhgim të orës mësimore në 10 klasë – me nga 2 klasë secila paralele (I, II, III, IV dhe V-të).

Në shkollën “Selman Riza” është intervistuar drejtori, 14 mësimdhënës janë anketuar me pyetësor, 5 mësimdhënës janë intervistuar individualisht, 25 nxënës janë intervistuar në fokus grupe me nga 5 nxënës dhe vëzhgim të orës mësimore në 5 klasë – me nga 1 klasë secila paralele (I, II, III, IV dhe V-të).

Në shkollën “Zef Lush Marku” është intervistuar drejtori, 11 mësimdhënës janë anketuar me pyetësor, 5 mësimdhënës janë intervistuar individualisht, 25 nxënës janë intervistuar në fokus grupe me nga 5 nxënës dhe vëzhgim të orës mësimore në 5 klasë – me nga 1 klasë secila paralele (I, II, III, IV dhe V-të).

Realizimi i metodave të ndryshme me personat kyç ndihmon në argumentimin e anëve pozitive të aplikimit të Vlerësimit Formues për nxënie cilësore, analizën për përparësitë e aplikimit të Vlerësimit Formues për të nxënëit e qëndrueshëm, paraqitjen e mangësive, nëse nuk aplikohet Vlerësimi Formues, si dhe ndihmon në nxjerrjen e përfundimeve dhe rekomandimeve përkatëse.

3.14. Kampionimi

Me qëllim të mbledhjes së të dhënave statistikore të hulumtimit të karakterit sasior u përzgjedh një kampion – 1) kampioni i mësimdhënësve, ku përmes anketimit është përdorur teoria e probabilitetit si përfaqësues i popullatës. “Zgjedhja e kampionit është zgjedhja e disa rasteve nga një grup i madh rastesh të mundshme”. (Matthews & Ross, 2010:153) Me qëllim të mbledhjes së të dhënave cilësore u përzgjedh si kampion – 1) kampioni i drejtorëve, 2) kampioni i mësimdhënësve, 3) kampioni i nxënësve dhe 4) vëzhgimi në klasa. Bazuar në kërkimet cilësore studiuesit bazohen kryesisht tek intervistat me persona të ndryshëm dhe arrijnë të propozojnë kampionimin e qëllimshëm apo kampionimin pa probabilitet i cili ka për qëllim të realizojë kampion rastesh të zgjedhura që hulumtuesit t’i japë më shumë mundësi, me qëllim që në mënyrë më të thelluar të arrijë të eksplorojë pyetjen hulumtuese. (Matthews & Ross, 2010)

Tabela 1 Numri i kampionit për hulumtim

Shkolla fillore	Vendi	Pyetësor	Intervista me drejtorë	Intervista me mësues	Intervista me nxënës	Vëzhgimi në klasë
Shkolla "Z. Rexha"	Gjakovë	29	1	5	25	10
Shkolla "S. Riza"	Paralagje e qytetit të Gjakovës	14	1	5	25	5
Shkolla "Z. L. Marku"	Brekoc Komuna e Gjakovës	11	1	5	25	5
Të përfshirë në hulumtim		54	3	15	75	20

Siç shihet edhe nga tabela, për realizimin e këtij hulumtimi janë realizuar metodat mikse të hulumtimit ku:

Si kampion për metodën sasiorë janë përzgjedhur $29 + 14 + 11$ mësimdhënës për plotësimin e pyetësorit që gjithsej përbëjnë 54 mësimdhënës në të tri shkollat.

Si kampion për metodën cilësore për realizimin e intervistave janë intervistuar:

1 + 1 + 1 drejtorë, përmes intervistës individuale, që përbëjnë 3 drejtorët e të tri shkollave.

5 + 5 + 5 mësimdhënës nga klasa e I-rë deri në të V-të përmes intervistës individuale, që përbëjnë 15 mësimdhënës të të tri shkollave.

25 + 25 + 25 nxënës nga klasa e I-rë deri në të V-të përmes intervistës të ndarë në fokus grupe në të tri shkollat, që përbëjnë 75 nxënës

10 + 5 + 5 vëzhgime në klasa nga klasa e I-rë deri në të V-të, që përbëjnë 20 vëzhgime në klasa në të tri shkollat.

Këto lloje kampionimi janë aplikuar në këtë studim, pasi është parë si i përshtatshëm për të siguruar larmi informacioni dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore dhe hipotezave, i cili studim prezanton karakteristikat e kërkuara.

3.15 Instrumentet e kërimit

Në funksion të mbledhjes së informacioneve, sipas pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të këtij studimi, u aplikuan instrumentet e kërimit të paraqitura më poshtë. Për mbledhjen e të dhënave në këtë studim u analizuan tri komponente të cilat janë paraqitur përmes dy grupeve të dhënash. U përdor pyetësi për mësimdhënësit, i administruar nga kërkuesja ballë për ballë me mësimdhënësit me vetadministrim, intervista e realizuar individualisht me mësimdhënësit, intervista e realizuar me nxënës në fokus grupe, intervista e realizuar me drejtorë si dhe vëzhgimi në klasa:

1. *Pyetësi për mësimdhënësit e 3 shkollave fillore të Komunës së Gjakovës që analizon nivelin e planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues*

2. *Intervista me drejtorët e të tri shkollave, e cila analizon diskutimet që ata realizojnë me mësimdhënësit gjatë takimeve të ndryshme rreth aplikimit të formave të ndryshme të vlerësimit*
3. *Intervista në fokus grupe me nxënësit e të gjitha klasave, e cila analizon planifikimin e kriterëve të suksesit, komentet që ata marrin nga ana e mësimdhënësve me gojë ose me shkrim*
4. *Intervista individuale me mësimdhënësit, e cila analizon argumentimin e punës së mësimdhënësve rreth planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues në klasa*
5. *Vëzhgimi në klasa që analizon realizimin e Vlerësimit Formues në klasa, planifikimi i kriterëve të suksesit dhe realizimi i tyre me nxënësit, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi, vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë mes nxënësish, shkrimi i komenteve nxitëse e korrigjuese nga ana e mësimdhënësve për ngritjen e cilësisë në të nxënë.*

Nga pikëpamja e metodologjisë, për këtë studim janë përdorur një tërësi metodash sasiore e cilësore, si:

1. *Anketimi* – Pyetësi është përdorur në këtë studim me qëllim të marrjes së informacioneve të ndryshme nga ana e mësimdhënësve për njohjen e Vlerësimit Formues dhe aplikimit në mënyrë sistematike të kësaj forme të vlerësimit, me qëllim të ngritjes së cilësisë në të nxënësit e nxënësve. U jep mundësi pjesëmarrësve të japin informacionet e nevojshme për çështje të studimit rreth planifikimit dhe aplikimit të formave të ndryshme të vlerësimit, komunikimin që e realizojnë me kolegë e prindër, ndikimin që ka Vlerësimi Formues në përmirësimin e të nxënësit të nxënësve dhe njohjen e shkallës së suksesit të tyre;

2. Intervista gjysëm e strukturuar, e realizuar individualisht me të tre drejtorët e shkollave është hartuar me qëllim të marrjes së të dhënave nga vetë drejtorët për punën që planifikohet dhe realizohet në shkollat e tyre. Si një diskutim gjysëm i strukturuar është organizuar me qëllim që të paraqesë një tërësi të dhënash rreth sfidave të cilat kanë të bëjnë me punën që mësimmshënësi realizon në klasë, kritereve që ata përdorin për kontrollimin dhe vlerësimin e nxënësve, në mbledhjet e realizuara me prindër a debatohet për suksesin e përgjithshëm të nxënësve, për kriteret e vlerësimit apo për vlerësimin e sjelljes së nxënësve;

3. Intervista me nxënës në fokus grupe e realizuar në grupe me 5 - 6 nxënës të klasave të ndryshme nga klasa e I-rë deri në klasën e V-të, është hartuar në këtë studim me qëllim të marrjes së të dhënave nga nxënësit rreth formës së punës që realizohet në klasat e tyre. Si një diskutim gjysëm i strukturuar dhe i organizuar me nxënës u jep mundësi pjesëmarrësve të flasin për një sërë çështjesh sipas mënyrës së tyre rreth komenteve që ata marrin me shkrim ose me gojë, komunikimin që realizojnë prindërit me mësimmshënësit e tyre, formën e komunikimit dhe arsyen e komunikimit, nëse kriteret e suksesit shkruhen nga mësimmshënësi i tyre apo në bashkëpunim me vetë nxënësit dhe se si ndihen ata kur vlerësohen me notë dhe me fjalë;

4. Intervista gjysëm e strukturuar e realizuar individualisht me mësimmshënësit e ciklit të ulët të të tria shkollave është hartuar në këtë studim me qëllim të marrjes së informacioneve të drejtpërdrejta nga ana e mësimmshënësve. Intervista i kushton një hapësirë të rëndësishme veprimeve të mësimmshënësve në drejtim të sugjerimeve rreth mënyrave të ndryshme të punës në klasë me qëllim të motivimit të nxënësve. Kjo u ofron

mundësi mësimdhënësve që të japin të dhëna të mjaftueshme për përparësitë dhe mangësitë që ka planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues, se a janë nxënësit të motivuar për të nxënë cilësor, përmes realizimit të Vlerësimit Formues në klasë, se a e japin mësimdhënësit informacionin kthyes me shkrim apo me gojë për nxënësit e tyre gjatë kryerjes së detyrave në lëndë të ndryshme mësimore;

5. *Vëzhgimi (pjesëmarrja) në orë mësimore është realizuar në të tria shkollat nga vetë studiuesja, me qëllim të vëzhgimit, pasi vëzhgimi në disa raste mund të përbëjë metodën e plotësimit të të dhënave (Pendavinji, 2008) që mësimdhënësit kanë thënë gjatë plotësimit të pyetësorit dhe dhënies së përgjigjeve gjatë intervistës për format e vlerësimit që realizojnë në klasë me nxënësit e tyre. Vëzhgimi synon ndërlidhjen e informacioneve me atë që veprojnë në klasë, gjatë procesit mësimor me nxënësin, rreth motivimit të nxënësve për një të nxënë të qëndrueshëm e cilësor, të cilat ndërlidhen me pyetjet e hulumtimit.*

Nga këta mësimdhënës të ciklit të ulët, drejtues shkollash të shkollave fillore të Komunës së Gjakovës janë përzgjedhur 54 mësimdhënës, 3 drejtues shkollash, 15 mësimdhënës, 75 nxënës si dhe vëzhgime në 20 klasë nëpër orë mësimore në lëndë të ndryshme, nga klasa e I-rë – V-të. Me këto subjekte është kryer intervista gjysëm e strukturuar me të tre drejtuesit e shkollave, intervista gjysmë e strukturuar individualisht me 15 mësimdhënës dhe një anketim me një grup prej 54 mësimdhënësish. Subjekte të kërkimit ishin edhe 75 nxënës, ku u organizua intervista gjysmë e strukturuar në fokus grupe.

3.16 Kufizimet e metodologjisë

Ky punim ka një fokus të gjërë shqyrtimi për procesin e vlerësimit që paraqet hallkën kryesore në procesin e të nxënësve për mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave, për marrjen e vendimit për një nxënës apo grup nxënësish, të cilët duhet të jenë aktivë dhe të suksesshëm gjatë procesit mësimor.

Pyetësi për mësimdhënësit nuk ka ndonjë shkallë të caktuar ku të anketuarit mund të qarkojnë përgjigjen e përshtatshme apo të plotësojnë përgjigje tjetër.

Prania e pakët e punimeve të ngjashme në këtë fushë mund të bëjë rrugëtimin e këtij punimi në terrene të pashkelura më parë, duke bërë të domosdoshëm ballafaqimin e gjetjeve të këtij punimi me punime të tjera në të ardhmen, si e vetmja mënyrë për të testuar vlefshmërinë e tij.

Edhe pse ky punim ka karakter longitudinal (gjatësor) duke u fokusuar në shkakësinë për një periudhë 10 vjeçare të pasluftës në Kosovë, vetë periudha e marrë në analizë nuk mund të konsiderohet si një e tërë në kontekstet dhe zhvillimet që e kanë përbërë atë. Në këtë rast do të ishim më të sigurt mbi “ngrirjen” kontekstuale të shkakësisë, duke pasur guxim për të hedhur një sërë hipotezash mbi zhvillimet e pritshme në të ardhmen.

3.17. Hartimi i kërkimit

Në Kosovë janë organizuar dhe realizuar mjaft trajnime të ndryshme, e ndër ta edhe trajnimi për aplikimin e Vlerësimit Formues nëpër shkolla, porse ka mungesë të studimeve për vlerësimin, e në mënyrë të veçantë studime që ndalen në planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues nga ana e mësimdhënësve në shkolla.

Ky studim ofron mundësi të re për të bërë një vlerësim më të thelluar, pasqyron rëndësinë e aplikimit edhe të këtij lloj vlerësimi në procesin mësimor, duke u bazuar në teoritë të cilat paraqiten nga shumë teoricienë si dhe në përvojat e disa mësimdhënësve të huaj. Po ashtu, vlerëson efektivitetin e mësimdhënies, mënyrën e dhënies së informacioneve nga ana e mësimdhënësve për të nxënit dhe arritjet e nxënësve gjatë procesit mësimor.

3.18. Historiku i kërkimit - përshkrimi i fazave të kërkimit

Kërkimi filloi me përzgjedhjen e fushës së studimit në fillim të vitit 2011. Përvoja e mëparshme si dhe realizimi i mikrotezës në nivel master, eksperiencia si mësimdhënëse, trajnimet dhe studimet e ndryshme më kanë ndihmuar që të hulumtoj në thellësi procesin mësimor, dhe të eksploroj rëndësinë e aplikimit të formave të ndryshme të vlerësimit e në veçanti aplikimin e Vlerësimit Formues në procesin e të nxënit. Fusha e Vlerësimit është shumë e gjerë, në nivel botëror janë realizuar shumë studime që kanë në fokus përmirësimin e procesit mësimor, me qëllim të ngritjes së cilësisë në të nxënë, ndërkohë që në Kosovë janë të pakta studimet në fushën e Vlerësimit, e në veçanti të Vlerësimit Formues.

Faza e parë e kërkimit u fokusua në rishikimin e literaturës. Në këtë fazë përqëndrimi u vu në gjetjen e kërkimeve të ngjashme, për t'u njohur me gjetjet dhe kornizat teorike të studimeve ekzistuese.

Në fazën e dytë, u realizua diskutimi me profesionistë të fushës së Vlerësimit për të riorientuar qëllimin dhe objektivat e studimit, si dhe për të specifikuar pyetjet kërkimore rreth nisjes së studimit.

Gjatë fazës së tretë të kërkimit u bë përcaktimi i metodave të kërkimit, instrumentave të kërkimit dhe popullatës për t'u përfshirë në hulumtim. U analizuan me kujdes informacionet e mbledhura në fazën e parë dhe të dytë duke u bazuar në qëllimin e kërkimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezave të ngritur në fillim të studimit. Bazuar në pyetjet kërkimore është përzgjedhur analiza komparative - krahasuese që të arrihet tek krahasimi i mendimeve të drejtorëve, mësimeve dhe nxënësve nëpër shkollë për planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues në procesin e të nxënësve në shkollë, analiza deskriptive - përshkuese që të arrijmë tek analiza dhe përshkrimi i të dhënave të nxjerra nga hulumtimi si dhe metoda statistikore që të arrihet tek përpunimi i rezultateve të nxjerra nga hulumtimi dhe interpretimi i tyre.

Në fazën e katërt u përpiluan dhe u realizuan pyetësorët me mësimeve, intervista me drejtorë, mësimeve dhe nxënësi dhe vëzhgimi në klasa. Më pas realizohet analizimi i të dhënave të mbledhura.

Faza e fundit e studimit konsiston në nxjerrjen e diskutimeve për gjetjet dhe rekomandimeve të përgjithshme për institucionet përkatëse dhe për kërkime të mëtejme.

3.19. Procedura.

Ky hulumtim ka filluar të zbatohet me dhënien e lejes paraprake nga Drejtoria për Arsim në Kuvendin Komunal të Gjakovës, me qëllim që ky hulumtim të zbatohet në ambientet e shkollave me mësimeve dhe nxënësi të përzgjedhur, duke pasur parasysh që të mos pengohet procesi mësimor.

Janë përzgjedhur tri shkolla fillore të kësaj komune “Zekeria Rexha” Gjakovë, “Selman Riza” paralagje e qytetit të Gjakovës dhe “Zef Lush Marku” fshati Brekoc, Komuna e Gjakovës.

Pas marrjes së lejes nga Drejtoria e Arsimit në Gjakovë është mbajtur takim me drejtorët e shkollave pjesëmarrëse në hulumtim për njoftimin e tyre rreth plotësimit të pyetësorëve nga ana e mësimdhënësve, realizimit të intervistave gjysmë të strukturuar individuale me drejtorë dhe mësimdhënës, si dhe intervistave me nxënësit në fokus grupe, po ashtu edhe vëzhgimit në orët mësimore nëpër shkollat e tyre.

Mësimdhënësit janë njoftuar nga drejtorët e shkollave përkatëse për pjesëmarrje në hulumtim, ku po ashtu janë pajisur me informacione rreth qëllimit të hulumtimit dhe procedurës hulumtuese. Drejtorët, mësimdhënësit dhe nxënësit kanë treguar gatishmëri të lartë për bashkëpunim. Numri i pjesëmarrësve në shkollat fillore ka qenë 54 mësimdhënës për plotësimin e pyetësorit, 3 drejtorë për intervistë individuale, 75 nxënës për intervistë gjysmë të strukturuar në fokus grupe, 15 mësimdhënës për intervistë individuale dhe 20 klasa për vëzhgim të orëve mësimore. Nxënësit, mësimdhënësit si pjesëmarrës në intervistë dhe klasat për vëzhgim janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme.

Andaj themi se ky hulumtim nuk mund të përgjithësohet, pasi është realizuar vetëm në Komunën e Gjakovës.

3.20. Hartimi i instrumenteve të kërkimit

Pyetësi është zgjedhur si qasje për të fituar informacione të detajuara rreth aplikimit të Vlerësimit Formues. Përbëhet prej pyetjesh me opione të ndryshme - rrethim të një apo

më shumë përgjigjeve të sakta. Pyetësi përfshin pyetje për mësimdhënësit rreth sqarimit se a e kuptojnë, planifikojnë dhe realizojnë Vlerësimin Formues, sa e zbatojnë këtë formë të vlerësimit në klasë; planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues a ndikon në të nxënësit e qëndrueshëm dhe cilësor të nxënësve, a i ndihmon nxënësit në përmirësimin e të nxënësit, kjo formë e vlerësimit a ndihmon në komunikim dhe bashkëpunim me prindërit, etj.

Qëllimi i realizimit të intervistave është marrja e informacioneve në formë më të detajuar, të drejtpërdrejtë e konkrete për të parë nga afër nëse realizohet planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues i cili i shërben në këtë mënyrë arritjes së qëllimit të studimit dhe realizimit të objektivave të tij.

Intervistat gjysmë të strukturuar janë zgjedhur si një qasje për të fituar informacion më të thellë rreth një numri të madh çështjesh të rëndësishme, duke përcjellë edhe reagimet e mësimdhënësve. Intervistat janë më fleksibël në mbledhjen e informacionit për një kontekst dhe ngjarje të caktuar duke paraqitur qëndrimet, përvojat dhe realitetin e shprehur nga pjesëmarrësit. Intervistat në formë individuale dhe gjysmë të strukturuar, me pak ndërhyrje të kërkueses (intervistueses) i krijojnë pjesëmarrësve (drejtorëve, mësimdhënësve dhe nxënësve) në hulumtim hapësirën e nevojshme për të folur për problemin në fjalë.

Në intervistat individuale dhe gjysmë të strukturuar pyetjet janë të specifikuar, vetë intervistuesi i kryen intervistat dhe është i lirë të hyjë në një dialog me të intervistuarit. Vëzhgimi në klasa ndihmon në marrjen e drejtpërdrejtë të informacioneve se si zhvillohet puna në klasë me nxënësit. Vërehen angazhimet e mësimdhënësit me nxënësit, afërsia në mes tyre, mënyra tradicionale apo bashkëkohore e punës, bashkëpunimi në mes të nxënësve,

planifikimi – mosplanifikimi i kriterëve të suksesit dhe realizimi i tyre, komentet e dhëna me gojë ose me shkrim, fletoret dhe dosjet - portfoliot e nxënësve, vlerësimi, vlerësimi i ndërsjellë dhe vetëvlerësimi i nxënësve.

3.21 Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të anketuarit janë informuar se pyetësi do të jetë anonim, do t'u marrë kohë për disa minuta për plotësim dhe të dhënat e tyre do të shfrytëzohen vetëm për efekt studimi.

Për intervistat është realizuar forma me shkrim me drejtorët dhe mësimdhënësit, në mënyrë individuale, ndërsa në intervistat e realizuara me nxënës në fokus grupe të cilat janë regjistruar është përdorur një diktofon që i lejon kërkueses të përqendrohet në drejtimin e diskutimit dhe jo në mbajtjen e vazhdueshme të shënimeve.

Kjo është menduar për një regjistrim të saktë të intervistës me mësimdhënësin e nxënës, duke mbrojtur si studiuesin ashtu edhe mësimdhënësin me nxënësin. Përdorimi i diktofonit është opsional për nxënësin që në fillim të intervistës, ku janë informuar se do të regjistrohen me qëllim të kursimit të kohës dhe besueshmërisë së informacioneve.

Përpara fillimit të intervistës mësimdhënësit dhe nxënësit janë informuar për studimin dhe qëllimin e tij. Është theksuar ruajtja e anonimitetit të plotë dhe konfidencialitetit gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, gjatë analizimit të tyre dhe mbajtja e shënimeve për reagimet e mësimdhënësve.

Procesi i analizimit të të dhënave fillon aty ku ka përfunduar mbledhja e të dhënave. Kjo fazë e studimit pasohet nga përgatitja e të dhënave për përpunimin e tyre kompjuterik.

Përpunimi statistikor përfshin teknika të cilat lejojnë një analizë të detajuar të të dhënave.

Teknika e përdorur për përpunimin dhe analizimin e të dhënave sasiore të mbledhura nga anketimi i referohet analizës deskriptive - përshkruese dhe për përpunimin e të dhënave është përdorur programi kompjuterik SPSS.

Bazuar në pyetjet dhe hipotezat e kërimit të dhënat janë përpunuar duke i analizuar në thellësi edhe përmes renditjes së të dhënave sipas dy niveleve:

Shpërndarja e vlerave në nivelin e lartë është bërë në 3 vlera - të larta nga 81 – 100%; vlera të mesme nga 66 – 80% dhe vlera të ulëta nga 50 – 65%;

Shpërndarja e vlerave në nivelin e ulët është bërë në 3 vlera – të larta nga 36 – 49%; vlera të mesme nga 21 – 35%; në vlera të ulëta nga 1 – 20%.

Ndërsa për analizimin e të dhënave cilësore përdoret metoda tabelare e renditjes së të dhënave nga përgjigjet, duke i renditur nga shumë përgjigje për një pyetje deri tek më pak përgjigje për të njëjtën pyetje.

3.22 Konsiderata etike

I gjithë hulumtimi është realizuar me përpikëri të lartë. Janë respektuar parimet etike dhe profesionale për të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim, duke i bërë ata që të ndihen të respektuar dhe të jenë pjesë e këtij hulumtimi me vullnet të plotë, duke respektuar vullnetin dhe dëshirën e tyre për të vazhduar ose jo hulumtimin. Është mbrojtur anonimiteti i plotë i tyre në këtë hulumtim, duke i larguar ata nga çfarëdolloj presioni eventual.

Kapitulli IV. Hulumtimi empirik - Rezultatet e analizës së të dhënave

4.1. Prezentimi i gjetjeve – në shkollë

Gjetjet e studimit realizohen përmes analizës së pyetësorëve e cila fillon me të dhënat rreth trajnimeve të kryera të mësimeve, gjë që ka për qëllim të kuptojë nëse mësuesit janë trajnuar për planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues. Vazhdon me formën e vlerësimit që mësuesit e aplikojnë në klasa, si e kuptojnë vlerësimin dhe si i vlerësojnë nxënësit në klasë, qëllimin pse ata bashkëpunojnë me kolegët e tyre, cila formë e vlerësimit i motivon më shumë nxënësit për të nxënë, në çka ndikon aplikimi i Vlerësimit Formues, në cilat lëndë e aplikojnë më shumë këtë formë vlerësimi, çka arrijnë të kuptojnë tek nxënësit dhe për kë janë të rëndësishme format e ndryshme të vlerësimit, në çka ndikon komunikimi me prindër përmes Vlerësimit Formues, si dhe mendimet e tyre rreth planifikimit të kriterëve të suksesit për aplikimin e Vlerësimit Formues.

Të dhënat nga anketimi i mësimeve:

Nga të dhënat arrijmë të kuptojmë se janë të anketuar gjithsej 54 mësues të tri shkollave të Komunës së Gjakovës: “Zekeria Rexha” me 29 mësues, “Selman Riza” me 14 mësues dhe “Zef Lush Marku” me 11 mësues. Të gjithë të anketuarit janë mësues të ciklit të ulët, duke filluar nga klasa e I-rë deri në klasën e V-të. Po ashtu, këta mësues i janë përgjigjur 19 pyetjeve me shumë korrektësi.

1. Trajnimet e juaja të kryera janë:

Nga 54 mësuesit e anketuar marrim të dhëna se ata kryesisht kanë trajnime të ndryshme të kryera:

Tabela 1.1 Trajnimi i mendimit kritik për lexim dhe shkrim

1.1 Zhvillimi i MKLSH-së					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja e përmblodhur
Valid	nuk është trajnuar	19	35.2	35.2	35.2
	është trajnuar	35	64.8	64.8	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Nga pyetësi del se 64.8% prej mësimdhënësve tregojnë se e kanë të kryer trajnimin për Mendimin Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit i cili është pothuajse një ndër trajnimet kryesore për mësimdhënësit, në të cilin ata bazohen për organizimin e strukturës së orës mësimore duke filluar nga format e punës, metodat, objektivat, aktivitetet si dhe vlerësimin që e aplikojnë me nxënësit e tyre gjatë procesit mësimor.

Tabela 1.2 Trajnimi për Mësimdhënës Mentor

1.2 Mësimdhënës Mentor					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja e përmblodhur
Valid	nuk është trajnuar	35	64.8	64.8	64.8
	është trajnuar	19	35.2	35.2	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Nga pyetësi del se 35% e mësimdhënësve tregojnë se e kanë të kryer trajnimin për Mësimdhënës Mentor, trajnim i cili i përgatit mësimdhënësit për pranimin e studentëve për të kryer praktikën e tyre në orë mësimore gjatë katër viteve të studimit dhe mësimin e tyre si mësimdhënës të ardhshëm.

Tabela 1.3 Trajnimi i Vlerësimit Formues (për nxënie)

1.3 Vlerësimi Formues (për nxënie)					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja e përmbledhur
Valid	nuk është trajnuar	16	29.6	29.6	29.6
	është trajnuar	38	70.4	70.4	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Ndërsa, vetëm për trajnimin Vlerësimi Formues nga 54 mësimdhënësit në anketim arrijmë të kuptojmë se 70.4% prej tyre kanë të kryer këtë trajnim dhe e njohin si një formë të rëndësishme të vlerësimit gjatë gjithë procesit mësimor.

Tabela 1.4 Trajnimi i Edukimit për të Drejtat e Fëmijës

1.4 Edukimi për të Drejtat e Fëmijës					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja e përmbledhur
Valid	nuk është trajnuar	25	46.3	46.3	46.3
	është trajnuar	29	53.7	53.7	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Nga të dhënat e pyetësorit del se 53.7% prej mësimdhënësve tregojnë se e kanë të kryer trajnimin Edukimi për të Drejtat e Fëmijës, i cili kryesisht i orienton mësimdhënësit rreth të drejtave të nxënësit në shkollë dhe përgjegjësive që nxënësit kanë në shkollë dhe jashtë saj për realizimin e detyrave të ndyshme.

Tabela 1.5 Trajnimi Hap pas Hapi

1.5 Hap pas hapi					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja e përmbledhur
Valid	nuk është trajnuar	35	64.8	64.8	64.8
	është trajnuar	19	35.2	35.2	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Nga pyetësi del se 35.2% prej mësimehënësve e kanë të kryer trajnimin Hap pas Hapi, trajnim i cili i orienton mësimehënësit rreth punës me nxënësit, që nga klasa e parë për planifikimin dhe realizimin e procesit të të nxënës përmes integritit të të gjitha lëndëve mësimore rreth temave të ndryshme mësimore.

Tabela 1.6 Trajnime të tjera

1.6 Shëno nëse ke përgjigje tjetër					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja e përmblodhur
Valid	nuk ka tjetër	37	68.5	68.5	68.5
	ka tjetër	17	31.5	31.5	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Ndërsa, 31.5% nga mësimehënësit tregojnë se kanë të kryera edhe trajnime të tjera, trajnime të cilat nuk janë të specifikuar rreth ndonjë teme të caktuar apo të veçantë për procesin e të nxënës.

Referuar vlerave mesatare rezulton se:

- 1) Nivelin më të lartë mësimehënësit e kanë tek kryerja e trajnimit të Vlerësimit Formues, ndërsa
- 2) Nivelin më të ulët e kanë trajnimet Mësimehënës Mentor dhe Hap pas Hapi.

Si konkluzion, duke përfshirë tendencat në nivelin e ulët, të mesëm dhe të lartë, rezulton se mësimehënësit në shkollë kanë shumë trajnime të kryera e po ashtu kanë mjaft njohuri rreth ngritjes së cilësisë në procesin e të nxënës tek nxënësit që mund të ndodhë në shkollë,

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

	ka përgjigje	1	1.9	1.9	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Nga këto përgjigje të mësimdhënësve arrijmë të kuptojmë se përqindja më e madhe e mësimdhënësve kanë mjaft njohuri se planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues gjatë procesit mësimor ndikon pozitivisht në përmirësimin e të nxënësve të nxënësve, kryerjen e detyrave me rregull si dhe në motivimin e nxënësve për nxënie cilësore.

Referuar vlerave mesatare rezulton se:

- 1) Në nivelin më të lartë mësimdhënësit tregojnë se komunikimi me prindër realizohet për motivimin e nxënësve për nxënie cilësore - kanë vleratë larta; për përmirësimin e të nxënësve

të nxënësve - kanë vlera të mesme; kryerjen me rregull të detyrave të shtëpisë - kanë vlera të ulëta, ndërsa

2) Në nivelin e ulët mësimit thonë se komunikimin me prindër e realizojnë për bashkëpunim me nxënësve - kanë vlerat e larta.

Si konkluzion, nga analiza e të dhënave arrihet të kuptohet se komunikimi me prindër kryesisht realizohet për motivimin e nxënësve për nxënie cilësore dhe për përmirësimin e suksesit të nxënësve.

19. Sa jeni dakord me supozimet e më poshtme?

Tabela 19.1 Aplikimi i disa formave të vlerësimit ndikon pozitivisht në procesin mësimor

19.1 Aplikimi i disa formave të vlerësimit ndikon pozitivisht në procesin mësimor					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja e përmbledhur
Valid	plotësisht dakord	41	75.9	75.9	75.9
	jam dakord	13	24.1	24.1	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Nga pyetësi del se mësuesit tregojnë se janë plotësisht dakord se aplikimi i disa formave të vlerësimit ndikon pozitivisht në procesin mësimor, pasi 75.9% e mësuesve pajtohen për këtë përgjigje.

Tabela 19.2 Aplikimi i Vlerësimit Formues motivon nxënësit për nxënie cilësore

19.2 Aplikimi i VF ndikon në motivimin e nxënësve për nxënie cilësore					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja e përmbledhur
Valid	plotësisht dakord	32	59.3	59.3	59.3
	jam dakord	21	38.9	38.9	98.1
	pjesërisht dakord	1	1.9	1.9	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Nga pyetësi del se mësimdhënësit tregojnë se janë dakord që aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në motivimin e nxënësve për nxënie cilësore, pasi 59.3% e mësimdhënësve janë plotësisht dakord me këtë përgjigje.

Tabela 19.3 Aplikimi i disa formave të vlerësimit ndikon në motivimin e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm

19.3 Aplikimi i VF ndikon në motivimin e të nxënit të qëndrueshëm të nxënësve					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja e përmbledhur
Valid	plotësisht dakord	29	53.7	53.7	53.7
	jam dakord	23	42.6	42.6	96.3
	pjesërisht dakord	2	3.7	3.7	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Nga pyetësi del se mësimdhënësit tregojnë se janë plotësisht dakord që aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në motivimin e të nxënit të qëndrueshëm të nxënësve, pasi 53.7% e mësimdhënësve janë plotësisht dakord me këtë përgjigje, 42.6% prej mësimdhënësve janë dakord me pyetjen, ndërsa 3.7% prej tyre janë pjesërisht dakord me pyetjen.

Nga këto të dhëna arrijmë të kuptojmë se përqindja më e madhe e mësimdhënësve janë plotësisht dakord se aplikimi i Vlerësimit Formues në klasë ndikon në motivimin e të nxënësve të qëndrueshëm të nxënësve.

Tabela 19.4 Për aplikimin e Vlerësimit Formues a mendoni se duhet planifikuar

kriteret e suksesit

19.4 Mendoni se duhet planifikuar kriteret e suksesit për aplikimin e VF					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja e përmblodhur
Valid	plotësisht dakord	31	57.4	57.4	57.4
	jam dakord	21	38.9	38.9	96.3
	pjesërisht dakord	2	3.7	3.7	100.0
	Total	54	100.0	100.0	

Nga pyetësi del se mësimdhënësit tregojnë se janë plotësisht dakord që për aplikimin e Vlerësimit Formues në klasa duhet të planifikohen kriteret e suksesit, pasi 57.4% e mësimdhënësve na japin këtë përgjigje.

Referuar vlerave mesatare rezulton se:

1) Në nivelin më të lartë mësimdhënësit tregojnë se aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon pozitivisht në procesin mësimor - kanë vlera të mesme, ndërsa kjo formë e vlerësimit ndikon në motivimin e nxënësve për nxënie cilësore, se duhet planifikuar kriteret e suksesit për aplikimin e suksesshëm të Vlerësimit Formues dhe se ndikon në të nxënësve të qëndrueshëm të nxënësve - kanë vlera të ulëta.

Si konkluzion, nga të dhënat e marra themi se përgjigjet e pyetjes 19 i forcojnë përgjigjet e pyetjes së 18 dhe na bindin që Vlerësimi Formues nëse aplikohet në klasat tona sjell sukses në motivimin e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe cilësor.

Për të analizuar të dhënat në mënyrë më të thelluar për varësinë e variablave, realizohet dhe një korelacion në mes disa pyetjeve dhe përgjigjeve të mësimdhënësve.

Tabela 20.1 Korelacioni mes pyetjes 11.2 me 16.1

Korelacioni			
		11.2 nxënësit janë të motivuar për punë në klasë	16.1 nxënësin
11.2 nxënësit janë të motivuar për punë në klasë	Pearson Correlation	1	.329*
	Sig. (2-tailed)		.015
	N	54	54
16.1 nxënësin	Pearson Correlation	.329*	1
	Sig. (2-tailed)	.015	
	N	54	54

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

Të dhënat e marra nga ana e mësimdhënësve tregojnë se në bazë të korelacionit të

Pearsonit ($r=0.329$) dhe sipas tabelave 11.2 dhe 16.1 del se mësimdhënësit mendojnë se aplikimi i formave të ndryshme të vlerësimit është i rëndësishëm për përmirësimin e të nxënit të nxënësve dhe se nxënësit janë të motivuar për punë në klasë për kryerjen e detyrave që u takojnë.

Referuar vlerave mesatare në korelacionin e realizuar mes disa pyetjeve dhe përgjigjeve të marra nga mësimdhënësit rezulton se:

- 1) Në nivelin më të lartë mësimdhënësit tregojnë se nxënësit janë të motivuar për punë
 - kanë vlera të larta, ndërsa format e ndryshme të vlerësimit janë të rëndësishme për nxënësin - kanë vlera mesatare.

Tabela 20.2 Korelacioni mes pyetjes 11.3 me 18.1/18.2

Korrelacioni				
		11.3 janë të motivuar nxënësit dhe prindërit	18.1 përmirësimi n e të nxënit të nxënësve	18.2 kryerjen me rregull të detyrave të shtëpisë nga nxënësit
11.3 janë të motivuar nxënësit dhe prindërit	Pearson Correlation	1	.385**	.430**
	Sig. (2-tailed)		.004	.001
	N	54	54	54
18.1 përmirësimin e të nxënit të nxënësve	Pearson Correlation	.385**	1	.455**
	Sig. (2-tailed)	.004		.001
	N	54	54	54
18.2 kryerjen me rregull të detyrave të shtëpisë nga nxënësit	Pearson Correlation	.430**	.455**	1
	Sig. (2-tailed)	.001	.001	
	N	54	54	54
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).				

Të dhënat e marra nga ana e mësimdhënësve tregojnë se në bazë të korrelacionit të

Pearsonit ($r=0.385$, $r=0.430$, $r=0.455$) dhe sipas tabelave 11.3, 18.1 dhe 18.2 del se mësimdhënësit kanë mjaftë njohuri për anët pozitive që sjell komunikimi me prindër përmes aplikimit të Vlerësimit Formues, por megjithatë ky komunikim realizohet pjesërisht.

Referuar vlerave mesatare në korelacionin e realizuar mes disa pyetjeve dhe përgjigjeve të marra nga mësimdhënësit rezulton se:

- 1) Në nivelin më të lartë mësimdhënësit tregojnë se komunikimi me prindër realizohet për përmirësimin e të nxënit të nxënësve - kanë vlera mesatare; realizohet me rregull për kryerjen e detyrave të shtëpisë - kanë vlera të ulëta, ndërsa
- 2) Në nivelin më të ulët mësimdhënësit thonë se me vlerësimin që realizojnë janë të motivuar nxënësit dhe prindërit - kanë vlera mesatare.

Tabela 20.3 Korelacioni mes pyetjes 17.1 me 18.1/18.2

Correlations				
		17.1 me shkrim (përmes fletores së nxënësit)	18.1 përmirësimi n e të nxënësve	18.2 kryerjen me rregull të detyrave të shtëpisë nga nxënësit
17.1 me shkrim (përmes fletores së nxënësit)	Pearson Correlation	1	.491**	.320*
	Sig. (2-tailed)		.000	.018
	N	54	54	54
18.1 përmirësimin e të nxënësve	Pearson Correlation	.491**	1	.455**
	Sig. (2-tailed)	.000		.001
	N	54	54	54
18.2 kryerjen me rregull të detyrave të shtëpisë nga nxënësit	Pearson Correlation	.320*	.455**	1
	Sig. (2-tailed)	.018	.001	
	N	54	54	54
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).				
*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).				

Të dhënat e marra nga ana e mësimdhënësve tregojnë se në bazë të korelacionit të Pearsonit ($r=0.491$, $r=0.455$, $r=0.320$) dhe sipas tabelave 17.1, 18.1, 18.2 del se mësimdhënësit kanë mjaft njohuri për anët pozitive që sjell komunikimi me nxënës dhe prindër përmes shkrimit të informacionit kthyes në fletoren e nxënësit, por megjithatë realizohet pjesërisht shkrimi i komenteve nxitëse apo këshilluese nga ana e mësimdhënësve në fletoret e nxënësve.

Referuar vlerave mesatare në korelacionin e realizuar mes disa pyetjeve dhe përgjigjeve të marra nga mësimdhënësit rezulton se:

1) Në nivelin më të lartë mësimdhënësit tregojnë se komunikimi me prindër realizohet për përmirësimin e të nxënësve - kanë vlera mesatare; realizohet me rregull për

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe me shkrim përmes fletore të nxënësit - kanë vlera të ulëta.

Tabela 20.4 Korelacioni mes pyetjes 10.1-10.7 me pyetjen 19.1 – 19.4

Correlations												
		10.1 forcon motivimin e nxënësve	10.2 ndihmon nxënësit të përmirësohe n	10.3 zhvillon tek nxënësi kapacitetet për vetëvlerësim	10.4 identifikon të arriturat e nxënësve	10.5 fokusohet në atë se si mësojnë nxënësit	10.6 është pjesë e planifikimit efektiv	10.7 përkrah të kuptuarit e qëllimeve dhe kritereve	19.1 aplikimi i disa formave të vlerësimit ndikon pozitivisht në procesin mësimor	19.2 aplikimi i VF ndikon në motivimin e nxënësve për nxënie cilësore	19.3 aplikimi i VF ndikon në motivimin e të nxënëtit të qëndrueshë m të nxënësve	19.4 mendoni se duhet planifikuar kriteret e suksesit për aplikimin e VF
10.1 forcon motivimin e nxënësve	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	1 54	.106 .444 54	-.081 .561 54	.324 [*] .017 54	.157 .257 54	.135 .332 54	.217 .116 54	.013 .925 54	-.119 .390 54	.038 .785 54	.154 .266 54
10.2 ndihmon nxënësit të përmirësohen	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.106 .444 54	1 54	.090 .517 54	.489 ^{**} .000 54	.267 .051 54	.428 ^{**} .001 54	.307 [*] .024 54	-.017 .905 54	.182 .188 54	.000 1.000 54	.018 .900 54
10.3 zhvillon tek nxënësi kapacitetet për vetëvlerësim	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	-.081 .561 54	.090 .517 54	1 54	-.057 .682 54	.309 [*] .023 54	.231 .093 54	.324 [*] .017 54	-.014 .920 54	-.243 .076 54	-.071 .609 54	.029 .835 54
10.4 identifikon të arriturat e nxënësve	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.324 [*] .017 54	.489 ^{**} .000 54	-.057 .682 54	1 54	.364 ^{**} .007 54	.455 ^{**} .001 54	.222 .106 54	-.064 .645 54	-.065 .642 54	-.130 .348 54	-.128 .356 54
10.5 fokusohet në atë se si mësojnë nxënësit	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.157 .257 54	.267 .051 54	.309 [*] .023 54	.364 ^{**} .007 54	1 54	.457 ^{**} .001 54	.286 [*] .036 54	-.268 [*] .050 54	-.203 .141 54	-.084 .547 54	-.137 .324 54
10.6 është pjesë e planifikimit efektiv	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.135 .332 54	.428 ^{**} .001 54	.231 .093 54	.455 ^{**} .001 54	.457 ^{**} .001 54	1 54	.262 .055 54	-.222 .106 54	.014 .918 54	-.033 .813 54	-.109 .434 54
10.7 përkrah të kuptuarit e qëllimeve dhe kritereve	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.217 .116 54	.307 [*] .024 54	.324 [*] .017 54	.222 .106 54	.286 [*] .036 54	.262 .055 54	1 54	-.043 .756 54	-.035 .802 54	.228 .098 54	-.033 .815 54
19.1 aplikimi i disa formave të vlerësimit ndikon pozitivisht në procesin mësimor	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.013 .925 54	-.017 .905 54	-.014 .920 54	-.064 .645 54	-.268 [*] .050 54	-.222 .106 54	-.043 .756 54	1 54	.283 [*] .038 54	.266 .052 54	.380 ^{**} .005 54
19.2 aplikimi i VF ndikon në motivimin e nxënësve për nxënie cilësore	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	-.119 .390 54	.182 .188 54	-.243 .076 54	-.065 .642 54	-.203 .141 54	.014 .918 54	-.035 .802 54	.283 [*] .038 54	1 54	.337 [*] .013 54	.144 .297 54
19.3 aplikimi i VF ndikon në motivimin e të nxënëtit të qëndrueshëm të nxënësve	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.038 .785 54	.000 1.000 54	-.071 .609 54	-.130 .348 54	-.084 .547 54	-.033 .813 54	.228 .098 54	.266 .052 54	.337 [*] .013 54	1 54	.372 ^{**} .006 54
19.4 mendoni se duhet planifikuar kriteret e suksesit për aplikimin e VF	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.154 .266 54	.018 .900 54	.029 .835 54	-.128 .356 54	-.137 .324 54	-.109 .434 54	-.033 .815 54	.380 ^{**} .005 54	.144 .297 54	.372 ^{**} .006 54	1 54

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).
 **. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Të dhënat e marra nga ana e mësimdhënësve tregojnë se në bazë të korrelacionit të Pearsonit ($r=0.324$) tregojnë se aplikimi i Vlerësimit Formues arrin të forcojë motivimin e nxënësve, por pjesërisht arrin të identifikojë të arriturat e nxënësve, ($r=0.489$, $r=0.428$, $r=0.307$) tregon se i ndihmon nxënësit të përmirësohen, por nuk arrin të identifikojë të arriturat e nxënësve, nuk është pjesë e planifikimit efektiv dhe nuk përkrah të kuptuarit e qëllimeve dhe kritereve;

($r=0.309$, 0.324) tregon se i zhvillon tek nxënësit kapacitetet për vetëvlerësim, ndërsa nuk fokusohet në atë se si mësojnë nxënësit dhe nuk i përkrah të kuptuarit e qëllimeve dhe kritereve;

($r=0.324$, $r=0.364$, $r=0.455$) del se gjysma e mësimdhënësve arrijnë të identifikojnë të arriturat e nxënësve dhe të përkrahin të kuptuarit e qëllimeve e kritereve përmes aplikimit të Vlerësimit Formues, ndërsa më pak prej tyre tregojnë se nuk është pjesë e planifikimit efektiv;

($r=0.457$, $r=0.286$, $r=-0.268$) mësimdhënësit tregojnë se aplikimi i Vlerësimit Formues nuk fokusohet në atë se si mësojnë nxënësit, pjesërisht mendojnë se është pjesë e planifikimit efektiv, ndërsa gjysma e tyre arrijnë të identifikojnë të arriturat e nxënësve dhe të përkrahin të kuptuarit e qëllimeve e kritereve, gjë që bie në kundërshtim me të dhënat se një numër i madh prej tyre tregojnë se aplikimi i disa formave të vlerësimit ndikon pozitivisht në procesin mësimor;

($r=0.283$, $r=0.380$) del se aplikimi i disa formave të vlerësimit ndikon pozitivisht në procesin mësimor, ndërsa një numër më i vogël nga mësimdhënësit mendojnë se ndikon në motivimin e nxënësve për nxënie cilësore dhe se duhet të planifikojnë kriteret e suksesit;

($r=0.337$) del se pak më shumë se gjysma e mësimdhënësve tregojnë se janë plotësisht dakord se aplikimi i Vlerësimit Formues motivon nxënësit për nxënie të qëndrueshme dhe cilësore;

($r=0.372$) del se pak më shumë se gjysma e mësimdhënësve tregojnë se janë plotësisht dakord se aplikimi i Vlerësimit Formues motivon nxënësit për nxënie të qëndrueshme dhe mendojnë se duhet planifikuar kriteret.

Referuar vlerave mesatare në korelacionin e realizuar mes disa pyetjeve dhe përgjigjeve të marra nga mësimdhënësit rezulton se:

- 1) Në nivelin më të lartë mësimdhënësit tregojnë se aplikimi i Vlerësimit Formues forcon motivimin e nxënësve për të nxënë cilësor, zhvillon tek nxënësit kapacitetet për vetëvlerësim - kanë vlera të larta; ndihmon nxënësit të përmirësohen - kanë vlera mesatare; aplikimi i Vlerësimit Formues përkrah të kuptuarit e qëllimeve dhe kriterëve, identifikon të arriturat e nxënësve - kanë vlera të ulëta;
- 2) Në nivelin më të ulët aplikimi i Vlerësimit Formues është pjesë e planifikimit efektiv, ndikon në motivimin e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm - kanë vlera të larta; mësimdhënësit janë dakord se duhet planifikuar kriteret e suksesit për aplikimin e Vlerësimit Formues, aplikimi i Vlerësimit Formues motivon nxënësit për nxënie cilësore - kanë vlera mesatare; mësimdhënësit janë dakord se aplikimi i formave të ndryshme të vlerësimit ndikon pozitivisht në procesin mësimor, fokusohet në atë se si mësojnë nxënësitkanë - vlera të ulëta.

Si konkluzion, nga të dhënat e marra dhe analiza e të dhënave sipas tabelave 10.1, 10.2, 10.3, 10.4, 10.5, 10.6, 10.7, 19.1, 19.2, 19.3 dhe 19.4 vërejmë se aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon pozitivisht në procesin mësimor për nxënie të qëndrueshme dhe cilësore, duke arritur që nxënësit të bëjnë dhe vetëvlerësim, por megjithatë kjo formë vlerësimi realizohet pjesërisht.

Për të analizuar rankimin përfundimtar të aplikimit të Vlerësimit Formues në shkolla, u

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

përdorën rezultatet e përfituara nga rankimi i vlerave mesatare në nivelin e lartë me vlerë të lartë 81% - 100%, të mesme 66% - 80% dhe të ulët 50% - 65%; si dhe nivelin e ulët me vlerë të lartë 36% - 49%, të mesme 21% - 35% dhe të ulët 1% - 25%.

Analiza e intervistave të realizuara me drejtorët, nxënësit si dhe mësimdhënësit

Përveç rezultateve të fituara përmes pyetësorëve në vijim do të shohim edhe analizën e intervistave gjysëm të strukturuar, të realizuara me drejtorët, nxënësit si dhe mësimdhënësit e shkollave të Komunës së Gjakovës. Po ashtu, paraqitet vëzhgimi i realizuar në klasë në të tri shkollat, duke filluar nga klasa I-rë – V-të. Këto rezultate janë nxjerr duke paraqitur pyetjet së bashku me përgjigjet e kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve nga ana e drejtorëve, nxënësve dhe mësimdhënësesve, e më pas duke i nxjerr të përbashkëtat në mes të tri shkollave – shkollës në qytet “Zekeria Rexha”, shkollën në paralagje të qytetit “Selman Riza” dhe shkollën në fshatin Brekoc “Zef Lush Marku”, Komuna e Gjakovës.

5.2 Intervista e realizuar me drejtorë. Përgjigjet janë të renditura sipas numrit të përgjigjeve të dhëna nga drejtorët, nga numri më i madh i përgjigjeve deri tek më i vogli.

Tabela 1.1.1 Përgjigjet e drejtorëve të kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve

	Shkollat “Z. Rexha”, “S. Riza”, “Z. L. Marku”
Pyetjet e intervistës me drejtorë	Përgjigjet e kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve të drejtorëve
1. Në 5 vitet e fundit, ju dhe mësimdhënësit në shkollën tuaj a keni kryer ndonjë trajnim të organizuar për vlerësimin?	- Vlerësimi për nxënie
2. Çka kontrollojnë dhe vlerësojnë mësimdhënësit tek nxënësit?	- Zgjidhjen e situatave problemore - Të kuptuarit e asaj që mësohet - Hartojnë instrumente për vlerësimin e nxënësve - Duke analizuar të arrijnë tek konkludimi - Të krijojnë aftësi tek nxënësit për krijime origjinale
3. Cilat forma vijuese të kontrollimit i përdorin mësimdhënësit?	- Kontrollim me gojë (pyetje me gojë) - Kontrollimi praktik (portfolio, punime të ndryshme) - Kontrollim me shkrim (ese, detyra kontrolluese, teste, detyra me shkrim etj)
4. Mësimdhënësit në shkollën tuaj, a punojnë në përputhje me kriteret për vlerësim apo secili mësimdhënësi ka kriteret e veta?	- Mësimdhënësit mundohen të krijojnë një sistem vlerësimi për të lidhur mësimdhënien e tyre me të nxënësit e nxënësve - Secili mësimdhënësi përdor kritere bazuar në nivel shkolle
5. Gjatë tri viteve të fundit shkollore, kontrollimi dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve, a ka qenë temë diskutimi e mbledhjes së këshillit të mësimdhënësve në tremujore, gjysmëvjetor dhe në mbarim të vitit shkollor?	- Për suksesin e përgjithshëm të nxënësve - Për atë se çka kontrollohet dhe vlerësohet - Për vlerësimin e sjelljes së nxënësve - Niveli i të nxënësit të nxënësve - Rezultatet që arrihen në gjysmëvjetor, fundvit - Për kriteret e vlerësimit

Në tabelën e mësipërme me intervistën e realizuar me drejtorët e të tri shkollave “Z. Rexha”, “S. Riza” dhe “Z. L. Marku” del se drejtorët dhe mësimdhënësit e kanë të kryer trajnimin “Vlerësimi për nxënie”, pra e njohin formën e planifikimit të Vlerësimit Formues dhe rendësinë e tij. Pra, kanë njohuri të mjaftueshme për rendësinë dhe dallimin e Vlerësimit Formues nga Vlerësimit Përmbledhës si dhe plotësimin që i bëjnë njëri vlerësim tjetrit. Po ashtu, ata kanë fituar shkathtësi të reja për zbatimin e proceduarve të ndryshme të vlerësimit. Të tre drejtorët mendojnë se mësimdhënësit në shkollat e tyre mund të zbatojnë strategji të ndryshme të vlerësimit në mësimdhënien e tyre, pasi kanë njohuri të ndryshme rreth realizimit të të nxënësve cilësor të nxënësve, njohuri që kanë marrë edhe përmes trajnimeve të ndryshme. Pra, e njohin formën e planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues me përparësitë që sjell për nxënësit në procesin mësimor, si dhe Vlerësimit Përmbledhës si vlerësim përfundimtar. Nga përgjigjja e përbashkët e të tre drejtorëve është se nga vëzhgimi që u kanë bërë mësimdhënësve në orë mësimore thonë se mësimdhënësit realizojnë vlerësim për nxënësit në mënyrë sistematike, përmes pyetjes me gojë, me shkrim, përmes kontrollimit të detyrave të ndryshme të realizuara në klasë dhe shtëpi, si dhe testeve në lëndë të ndryshme mësimore. Po ashtu, tregojnë se mësimdhënësit planifikojnë dhe realizojnë punime të ndryshme me nxënës të cilat i vlerësojnë në mënyra të ndryshme.

Nga intervista me të tre drejtorët del se mësimdhënësit mundohen që të krijojnë vetë një sistem të përshtatshëm vlerësimi, duke u bazuar në kriteret në nivel shkolle, duke bërë një ndërlidhje në mes mësimdhënies së tyre të suksesshme dhe të nxënësve cilësor të nxënësve.

Po ashtu, ata tregojnë se kontrollimi dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve ka qenë temë diskutimi shpeshherë gjatë mbledhjeve të realizuara me këshillat e mësimeve të mbajtura në tremujore, gjysmëvjetor apo në përfundim të vitit shkollor, gjatë gjithë kohës. Së bashku me mësimeve kanë diskutuar gjithashtu edhe rreth sjelljeve të nxënësve, nivelin e të nxënësve, për atë se çka kontrollohet dhe vlerësohet në periudha të ndryshme si dhe rezultatet që nxënësit kanë arritur gjatë të nxënësve të tyre në procesin mësimor.

Ndërsa, drejtori i shkollës “S. Riza” tregon se të gjithë mësimeve e kësaj shkolle gjatë planifikimit të planit ditor në fletoret e tyre duhet të planifikojnë edhe kriteret e suksesit për çdo njësi mësimore që do ta realizojnë me nxënësit e tyre. Ai mendon se kriteret e suksesit duhet të planifikohen së bashku me nxënësit, në përputhje me planin mësimor, për të arritur ngritje në cilësinë e të nxënësve të tyre.

Ndërsa, për planifikimin dhe realizimin e Vlerësimit Formues drejtorët e të tri shkollave tregojnë se nuk kanë realizuar ndonjë diskutim në veçanti nëse kjo formë e vlerësimit i motivon nxënësit për të arritur të nxënë më të mirë dhe nëse ndryshon aplikimi i tij në ngritjen e rezultatit të nxënësve në shkollë. Po ashtu, ata tregojnë se kjo formë e vlerësimit aplikohet deri diku nga ana e mësimeve në shkollat e tyre, pasi gjatë monitorimit që ata u bëjnë mësimeve në klasa vërehet realizimi i Vlerësimit Formues vetëm në disa klasa ku i vërehen më lehtë nxënësit që kanë vështirësi në mësim apo nxënësit që janë më të sigurt në përgjigjet e tyre.

5.3 Intervista e realizuar me nxënës. Përgjigjet janë të renditura sipas numrit të përgjigjeve të dhëna nga nxënësit, nga numri më i madh i përgjigjeve deri tek më i vogli.

Tabela 2.1.1 Përgjigjet e nxënësve të kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve

	Shkollat “Z. Rexha”, “S. Riza”, “Z. L. Marku”
Pyetjet e intervistës me nxënës	Përgjigjet e kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve të nxënësve
1. Çka është vlerësimi?	- Nota 5 - Kur të vlerëson mësimdhënësja me notë - Matja e njohurive të nxënësve - Që ta kuptojmë të gjithë se ku kemi arritur - Kur mësimdhënësja na thotë me gojë ose na shkruan me fjalë të ndryshme positive ose negative - Të lumtë - Marrim përgjigje se ne mund të jemi edhe më të mire
2. A ju shkruan mësimdhënësja komente me fjalë në fletore?	- Vetëm nota - Edhe nota edhe fjalë - Të lumtë - 5 - Komentet mësimdhënësja na jep me gojë dhe me shkrim - Lëvdata dhe qortime
3. Në cilat lëndë vlerësoheni më shumë përmes Vlerësimit Formues (me fjalë)?	- Gjuhë shqipe - Matematikë - Edukatë figurative - Edukatë qytetare - Njeriu dhe natyra - Punëdore - Histori - Edukatë muzikore - Edukatë fizike
4. Cilat janë komentet që ju i merrni nga mësimdhënësi juaj gjatë kryerjes së ndonjë detyre në klasë apo kryerjen e detyrave të shtëpisë?	- Të lumtë - Të lumtë - 5 - Shkruaj më bukur - Përmirësoje shkrimin

	- Shkrimi shumë i bukur - Të lumtë dora e vogël - Mos bëj shumë gabime - Vazhdo kështu - Bukur - Je yll - Bravo - Tre yje dhe zemër - Duhet të mësosh më shumë - 5 me yll - Respekto shenjat e pikësimit - Të lumtë (emrin) - 5 - Dy yje dhe zemër - Lexo më shumë - 5 me zemër - Krenohem me ty - Mos fshij me gomë
5.A ndjeheni mirë kur merrni komente me shkrim dhe a mësoni më shumë pas lëvdatave ose kritikave që merrni nga mësimdhënësja?	- Ndihej mirë kur marr notë dhe fjalë - Po, ndihej shumë mirë - Ndihej i/e lavdëruar - Ndihej krenar kur mësimdhënësja thotë vazhdo kështu - Nota është kryesore - Vërej më lehtë gabimet e mia - Më ndihmojnë të jem më i kujdesëm si lëvdatat po ashtu edhe kritikën - Ndihej mirë, sepse mund t'i përmirësoj gabimet më lehtë - Ndihej më i fortë kur marr notë - Më pëlqen kur më shkruan 'të lumtë dora e vogël' - Ndihej më mirë kur marr note, sepse mbyllet në ditar - Më ndihmojnë t'i mbaj mësimet në mend më gjatë - Krenohem para prindërve
6. Kriteret e suksesit për diktim apo detyra tjera mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë apo kërkon ide edhe nga ju (nxënësit) që t'i shkruani bashkë?	- Na thotë me gojë - I shkruan mësimdhënësi/ja - Mësimdhënësi/ja kërkon ndonjëherë ide nga ana jonë për kritere të suksesit

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

	- Mësimdhënësja na vë vetëm notën - Mësimdhënësja na thotë gjithmonë të njëjtat kritere të suksesit
7. Cilat janë kriteret e suksesit që i shkruan apo ju thotë mësimdhënësja se duhet arritur ju që të keni një të nxënë të suksesshëm?	- Mos bëj gabime - Shkruaj saktë fjalët njëren pas tjetrës - Respekto shkronjën e madhe pas pikës - Përdori drejt shenjat e pikësimit - Shkruaj pastër - Kujdes shkrimin - Mos bëj më shumë se tre gabime - Thjeshtë vetëm kryejmë detyrën dhe marrim notën - Mëso më shumë - Dëgjo me kujdes - Përdor drejt shkronjën “ë” në fund të fjalëve
8. Si komunikojnë prindërit tuaj me mësimdhënësin/sen?	- Vijnë në shkollë - Vetëm në mbledhje të prindërve - Mësimdhënësja i thërret sipas nevojës - Flasin me telefon - Prindërit vijnë në shkollë ditën e konsultimeve - Prindërit vijnë nëse ka ndonjë problem - Marrin informacione përmes informatës kthyes nga fletoret
9. A i përcjellin prindërit fletoret tuaja për leximin e komenteve të ndryshme dhe cilat janë këshillat e tyre për ju fëmijët?	- Prindërit na thonë: mëso më shumë, ushtro më shumë, përmirësoje notën, vazhdo të mësosh - E shohin notën dhe nuk shkruajnë por flasin me mësimdhënësen - Prindërit vijnë në shkollë të takohen me mësimdhënësen - Prindërit i lexojnë komentet dhe e thërrasin mësimdhënësen - Prindërit vetëm i lexojnë komentet

Në tabelën e mësipërme për pyetjen e parë "Çka mendoni se është vlerësimi"? janë marrë përgjigje thuajse të njëjta në të tria shkollat, por që ndryshojnë nga klasa në klasë. Sipas këtyre përgjigjeve del që nxënësit e kuptojnë se çfarë është vlerësimi. Por karakteristikë

është se të gjithë nxënësit edhe pse kanë njohuri për vlerësimin nuk japin përgjigje të plota por shumë prej tyre japin përgjigje të shkurtëra duke thënë “nota 5”. Përgjigje të plotë marrim vetëm nga disa nxënës duke na treguar se është matje e njohurive të tyre, apo arritjet që i kanë për një periudhë të caktuar.

E përbashkëta e nxënësve të të tri shkollave është se nxënësit kryesisht vlerësohen me notë dhe se shumë rrallë marrin komente nga mësimmshënësit e tyre të cilat janë të shkurtra dhe të pamjaftueshme për përmirësimin e të nxënëit të tyre dhe se ato komente janë kryesisht me gojë.

Nga intervista del se nxënësit vlerësohen me fjalë, duke marrë edhe komente, kryesisht vetëm në lëndët gjuhë shqipe dhe matematikë. Sipas përgjigjeve të nxënësve vërehet se vlerësimi kryesisht bëhet për ato dy lëndë mësimore thuhet vetëm ato dy lëndë janë të rëndësishme duke mos llogaritur që këto dy lëndë kryesore janë në ndërlidhje dhe me të gjitha lëndët tjera për ngritjen e cilësisë në të nxënë.

Nxënësit tregojnë se për realizimin e detyrave në klasë apo kryerjen e detyrave të shtëpisë kryesisht nuk marrin komente me shkrim, por marrin komente me gojë të cilat janë shumë të shkurtra. Komente si: bravo, bukur, të lumtë, të lumtë - 5, të lumtë dora e vogël, krenohem me ty, - këto komente janë të pamjaftueshme për orientimin e nxënësve për një të nxënë të suksesshëm dhe përmirësimin e të nxënëit të tyre. Tek disa klasa si lëvdatat ashtu edhe qortimet jepen në formë pak më të detajuar, por të cilat janë në numër shumë të vogël në krahasim me numrin e klasave që i kanë shkollat dhe se nuk janë të mjaftueshme apo të qarta për nxënësit.

Nga kjo kuptojmë se e përbashkëta e tri shkollave është se komentet me gojë ose me shkrim, edhe pse shumë të përshtatshme, orientuese dhe këshilluese si formë e Vlerësimit Formues, nuk aplikohen në formë të rregullt por aplikohen rrallë në të tria shkollat. Në klasat ku aplikohet Vlerësimi Formues nxënësit janë më komunikativë dhe i njohin vështirësitë apo përparësitë që kanë në lëndë të ndryshme.

Nxënësit po ashtu tregojnë se ndihen shumë mirë kur marrin komente dhe kanë dëshirë të marrin komente të mira nga mësimdhënësi i tyre ose edhe kritika të cilat i orientojnë ata në përmirësimin e të nxënit të tyre. Po ashtu, ata thonë se do të ndihen mirë dhe krenarë para shokëve, mësimdhënësve dhe prindërve të tyre nëse marrin komente të tilla.

Pra, e përbashkëta e nxënësve në disa nga klasat e të tri shkollave është se ata ndihen mirë kur marrin komente nxitëse apo këshilluese nga ana e mësimdhënësve të tyre. Por, kishte edhe nga nxënësit që janë përgjigjur se kanë dëshirë të marrin vetëm nota, pasi ato janë vendimtare për suksesin përfundimtar të tyre, porse numri i nxënësve të tillë ishte më i vogël.

Në pyetjen e gjashtë marrim përgjigje nga nxënësit se kryesisht mësimdhënësja kriteret i thotë me gojë që të shkruajmë bukur, të mos bëjmë shumë gabime apo që të kemi kujdes me shkrimin, nganjëherë mësimdhënësja i tregon me gojë apo i shkruan kriteret e suksesit dhe në tabelë, ndërsa shumë rrallë kërkohet nga nxënësit që të japin mendime dhe ide të ndryshme rreth të shkruarit të kriterëve të suksesit.

Nga pyetja e shtatë marrim përgjigje nga nxënësit se kryesisht kriteret e mësimdhënësja janë të shkurtra dhe se këto kritere zakonisht përsëriten në të gjitha detyrat, gjë që tek nxënësit nuk sjell ndonjë motivim.

E përbashkëta e të tri shkollave është se një përqindje jo shumë e madhe e mësimeve nxënësve i shkruajnë kriteret e suksesit bashkë me nxënësit, të cilat kriteret i orientojnë saktë nxënësit drejt plotësimit të saktë të detyrës, në mënyrë që të arrijnë cilësi në të nxënësit e tyre të suksesshëm.

Nga intervista po ashtu marrim përgjigje të ndryshme se prindërit komunikojnë me mësimeve nxënësit përmes formave të ndryshme si ato të drejtpërdrejta po ashtu edhe formës së tërthortë të komunikimit. Porse format më të shpeshta të komunikimit janë në mbledhje të prindërve dhe bisedave me telefon për informatat e ndryshme rreth procesit të të nxënësit të nxënësve.

E përbashkëta e të tri shkollave është se prindërit të cilët kanë marrë informacione të sakta për fëmijët e tyre përmes informatës kthyesë nuk e kanë pasur të nevojshme që të shkojnë në shkollë shumë shpesh, sepse janë informuar saktë për përparësitë apo mangësitë e fëmijëve të tyre përmes të dhënave të shkruara në fletore. Kjo është e pamjaftueshme që prindërit të marrin informacione të nevojshme rreth fëmijëve të tyre për përparimin apo rënien e suksesit të fëmijëve të tyre, pasi janë numër i vogël i klasave ku jepet feedbacku më shpesh dhe në mënyrë të saktë.

Në pyetjen e nëntë janë marrë po ashtu përgjigje të ndryshme nga nxënësit se prindërit i përcjellin fletoret dhe notat ose komentet që i shkruan mësimeve nxënësi, por komunikimin me mësimeve nxënësit e bëjnë kryesisht përmes telefonit ose vizitave në shkollë për nevojat të ndryshme ose vetëm në mbledhje të prindërve.

E përbashkëta e të tri shkollave është se prindërit i përcjellin fletoret e nxënësve, por nuk kthejnë ndonjë koment për notën apo rreth informatës kthyesë, shkruajnë vetëm

nënshkrimin e tyre se e kanë pare fletoren. Pra, nuk e shohin si të nevojshme komunikimin me mësimdhënësin përmes fletores rreth përparësive apo mangësive të fëmijëve të tyre në shkollë. Komentet e prindërve u drejtohen me gojë vetëm fëmijëve të tyre, kryesisht komente këshilluese që të mësojnë më shumë, ta përmirësojnë notën apo të vazhdojnë në të njëjtën formë të punës.

Në të tri shkollat: “Z. Rexha”, “S. Riza” dhe “Z. L. Marku” vërehet se nuk ka ndonjë komunikim të mirëfilltë me shkrim në mes prindërve dhe mësimdhënësve përmes informacioneve kthyesë në fletore. Edhe pse është i nevojshëm një komunikim i tillë ku nxënësi i vëren përparësitë dhe mangësitë e tij, prindi merr informacione rreth fëmijës së tij dhe është komunikim më i shpejtë rreth përparimit apo ngecjes së fëmijëve – nxënësve rreth suksesit, ende nuk realizohet një komunikim i tillë.

5.4. Intervista e realizuar me mësimehënës. Përgjigjet janë të renditura sipas numrit të përgjigjeve të dhëna nga mësimehënësit.

Tabela 3.1.1 Përgjigjet e mësimehënësve të kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve

	Shkollat “Z. Rexha”, “S. Riza”, “Z. L. Marku”
Pyetjet e intervistës me mësimehënës	Përgjigjet e kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve të nxënësve
1. Qëllimi i vlerësimit është:	- Nxënësi ta kuptojë veten - Nxënësi të vihet në garë me të tjerët - Të kuptohet niveli i nxënësve - Të arrihet tek qëllimi - Dëshmi për të tjerë
2. A mendoni se aplikimi i Vlerësimit Formues në klasë sjell rezultat pozitiv në ngritjen e cilësisë në të nxënësit e nxënësve?	- Po ka sjell - Po ka sjell rezultat pozitiv në klasë - Aplikimi i teknikës së semaforit ka qenë ndihmë - Ngjyrat e semaforit kanë ndihmuar nxënësit dhe në mësimehënësit
3. Cilat janë komentet që ju si mësimehënës i jepni nxënësve gjatë kryerjes së ndonjë detyre në klasë apo kryerjen e detyrave të shtëpisë?	- Je si yll - Të lumtë - Të lumtë - 5 - Krenohem me ty - Të lumtë dora - Bravo - Bukur - Të lumtë dora e vogël - Lexo më shumë - Përpiku pak më tepër - Duhet të mësoh më shumë - Respekto shenjat e pikësimit - Shkrimi shumë i bukur - Vazhdo kështu - Përmirësoje shkrimin - Mos bëj shumë gabime - Mos fshij me gomë
4. Informata kthyesë (feedbacku) a ka ndikim më të madh pozitiv tek nxënësit me sukses të mirë, mesatar apo tek nxënësit me sukses më të dobët?	- Sukses tek nxënësit e mirë - Sukses tek nxënësit mesatarë - Sukses tek nxënësit që u është shkruar feedbacku në fletore

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

	- Nxënësit informohen më shpejt për ngritjen apo rënien e suksesit - Prindërit informohen rreth ngritjes apo rënies së suksesit të fëmijëve të tyre - Ka ndikim tek të gjithë nxënësit, nëse prindërit i përcjellin rregullisht fletoret e fëmijëve të tyre
5. A mund të aplikohet Vlerësimi Formues në të gjitha lëndët apo vetëm në lëndët kryesore? Në cilat lëndë e aplikoni ju më shumë?	- Gjuhë shqipe - Matematikë - Edukatë figurative - Edukatë qytetare - Njeriu dhe natyra - Punëdore - Histori - Edukatë muzikore - Edukatë fizike
6. Kriteret e suksesit për diktim apo detyra të tjera ju si mësimdhënës i thoni me gojë, i shkruani në tabelë apo kërkonit ide edhe nga nxënësit që t'i shkruani bashkë në tabelë?	- Kriteret i them me gojë si: shkruani bukur dhe pastër; mos bëni shumë gabime; kini kujdes me shkrimin e shkronjave dhe fjalëve në fjali; respekto shenjat e pikësimit - Nxënësit i dinë kriteret sepse janë të njëjtat - Kriteret e suksesit lidhen me rezultatet mësimore - I shkruaj dy ose tri kriteret e suksesit në tabelë - I ndihmojnë nxënësit në vetëvlerësim - Ndonjëherë i shkruaj në tabelë - Ndonjëherë kërkoj ide nga nxënësit
7. A ndihmon planifikimi i kriterëve të suksesit në planifikimin tuaj ditor si dhe a mund të arrini më lehtë tek vlerësimi i nxënësve?	- Nuk ka ndonjë ndryshim në vlerësimin e nxënësve - Nuk ndihmon shumë në Vlerësimin Përmbledhës - Në planifikimin ditor na humb më shumë kohë - Nëse planifikohen kriteret e suksesit, nxënësit arrijnë sukses më shpejt - Nxënësit arrijnë të vlerësojnë veten dhe shokët - Edhe ne mësimdhënësit arrijmë të vlerësojmë punën tonë

Në tabelën e mësipërme nga mësimdhënësit marrim përgjigje se me anë të vlerësimit arrijmë të përcjellim tek nxënësit se në çfarë niveli të njohjes janë nxënësit, të garojnë nxënësit mes vete rreth njohurive që kanë në lëndë të ndryshme mësimore, të arrihet tek qëllimi i mësimdhënies dhe të nxëniti të suksesshëm; po ashtu arrihet që të njoftohen dhe prindërit për suksesin apo mossuksesin e fëmijëve të tyre.

Nga intervista me mësimdhënësit e të tri shkollave del se në disa nga klasat ku aplikohet Vlerësimi Formues ka filluar të vërehet rezultat pozitiv në suksesin e nxënësve si dhe në planifikimin - riplanifikimin e mësimdhënësve P.sh., me aplikimin e teknikës së semaforit në klasë është bërë njohja e njohurive të nxënësve më mirë nga vetë nxënësit dhe mësimdhënësit. Në momentin e tregimit të shenjës së kuqe nga ana e nxënësve kuptohet se kanë treguar që nuk e kanë kuptuar mësimin, apo që nxënësi ka vështirësi në të kuptuarit e atyre njohurive. Nëse nxënësit kanë treguar shenjën e verdhë kuptohet se nxënësi e ka kuptuar mësimin, por që ka nevojë për më shumë informata shtesë. Nëse nxënësit kanë treguar shenjën e gjelbër kuptohet që nxënësi është munduar të mësojë më shumë, apo që e ka kuptuar mësimin. Përmes aplikimit të kësaj teknike mësimdhënësit tregojnë se kanë arritur sukses më të mirë në klasat e tyre, sepse e kanë kuptuar më lehtë se cilët nxënës kanë nevojë që të ushtrojnë më shumë për të arritur tek ngritja e suksesit në të nxëniti e tyre.

Po ashtu, nga intervista del se këta mësimdhënës tregojnë se me planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues kanë filluar të vërejnë se për cilat njësi mësimore është e nevojshme që të bëjnë një riplanifikim apo përsëritje me nxënësit që kanë vështirësi.

Ndërsa disa mësime ndërkohë nuk japin ndonjë përgjigje rreth ndryshimeve që u ka sjellë aplikimi i Vlerësimit Formues, ku nënkuptohet se nuk e aplikojnë në klasat e tyre.

Nga përgjigjja e pyetjes së tretë nga mësime ndërkohë e të tri shkollave marrim përgjigje nga mësime ndërkohë se kryesisht komentet i japin me gojë, por ato janë shumë të shkurtra.

Komentet të cilat ata i japin janë si: bravo, bukur, të lumtë, të lumtë - 5, të lumtë dora e vogël, krenohem me ty, janë komente të pamjaftueshme për orientimin e nxënësve dhe përmirësimin e të nxënë të tyre për arritjen e një të nxënë të suksesshëm e cilësor. Po ashtu, ato shkruhen shumë rrallë me shkrim në mënyrë pak më të detajuar.

Nga kjo kuptojmë se e përbashkëta e mësime ndërkohëve të të tri shkollave është se komentet me gojë ose me shkrim që duhet të planifikohen dhe aplikohen si formë orientuese dhe këshilluese e Vlerësimit Formues, edhe pse janë shumë të përshtatshme, nuk aplikohen në formë të rregullt, por aplikohen shumë pak në të tri shkollat. Në klasat ku aplikohet Vlerësimi Formues mësime ndërkohëve tregojnë se nxënësit janë më komunikativë, mund të bëjnë vetë vlerësim për veten, e po ashtu edhe vlerësim të mirë për shokët e tyre, thuaja në të gjitha lëndët. Po ashtu, nga feedbacku arrijnë sukses më të mirë kryesisht nxënësit e mirë dhe ata mesatarë. Po ashtu, mësime ndërkohëve tregojnë se nga feedbacku nxënësit informohen për saktësinë apo gabimet e bëra tek detyra, po ashtu informohen edhe prindërit saktësisht rreth suksesit apo mosesuksesit në punë e detyra për fëmijët e tyre. Mësime ndërkohëve, po ashtu, tregojnë se nëse prindërit i përcjellin fletoret e fëmijëve të tyre në mënyrë sistematike, edhe nxënësit me sukses më të dobët arrijnë sukses pozitiv në të nxënë të tyre, gjë që ndodh shumë rrallë.

E përbashkëta nga mësimdhënësit del se përmes kujdesit nga ana e mësimdhënësit në shkollë, shkrimin e komentit të saktë në fletoren e nxënësit dhe përcjellja, e po ashtu kthimi i atij komenti – feedbacku nga ana e prindit, sjell rezultat pozitiv në ngritjen e cilësisë në procesin e të nxënës.

Mësimdhënësit mendojnë se Vlerësimi Formues mund të aplikohet vetëm në lëndët gjuhë shqipe dhe matematikë. Ndonjëherë disa nga ata japin komente me fjalë edhe në lëndën e edukatës figurative. Nga e përbashkëta në mes të tri shkollave vërehet se vlerësimi kryesisht bëhet me note, ndërsa Vlerësimin Formues e planifikojnë dhe aplikojnë për ngritjen e cilësisë në të nxënësve vetëm në lëndë kryesore, si gjuhë shqipe dhe matematikë. Në lëndët e tjera mësimore nuk e aplikojnë, për shkak të arsyeve të ndryshme si: plani mësimor i ngarkuar, ora mësimore e shkurtër me 40 minuta për realizimin e formave të ndryshme të vlerësimit, kontrollimi i detyrave merr shumë kohë, e arsye të tjera.

Nga intervista me mësimdhënësit marrim përgjigje se kryesisht mësimdhënësit kriteret i thonë me gojë dhe se janë pothuajse të njëjtat kriteret të suksesit që aplikohen në të dy lëndët mësimore.

Kriteret e suksesit të cilat i përdorin gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme janë: shkruani bukur dhe pastër, mos bëni shumë gabime, kini kujdes me shkrimin e shkronjave dhe fjalëve në fjali, respekto shenjat e pikësimit.

Mësimdhënësit tregojnë se nganjëherë i shkruajnë kriteret e suksesit edhe në tabelë, ndërsa rrallë kërkohen që të marrin mendime dhe ide të ndryshme rreth të shkruarit të kriterëve të

suksesit nga nxënësit, pasi mendojnë se i ndihmojnë nxënësit që të arrijnë tek vetëvlerësimi.

E përbashkëta e të dhënave nga mësimdhënësit e të tri shkollave është se nga shtatë klasat ku vërehet planifikim, aplikimi dhe shkrimi i kriterëve të suksesit nga ana e mësimdhënësve së bashku me nxënësit arrihet të precizohen më lehtë se çka kërkon mësimdhënësi dhe çka duhet të arrijë nxënësi.

Porse edhe në këto klasa vërehet se kriteret shkruhen në formën e përgjithshme, pa e saktësuar se sa gabime u lejohen nxënësve që të arrijnë tek një notë e caktuar.

Mësimdhënësit tregojnë përmes intervistës se kryesisht nuk ka ndonjë ndryshim në vlerësimin e përgjithshëm të nxënësve përmes planifikimit të kriterëve të suksesit, si dhe u humb shumë kohë në planifikimin ditor.

Por ata mendojnë se planifikimi i kriterëve të suksesit përmes Vlerësimit Formues ndihmon në vetëvlerësimin e punës së tyre, i vetëdijëson nxënësit që mund të vetëvlerësojnë veten e tyre në mësimet si dhe ngritjen e suksesit në të nxënë.

Nga mësimdhënësit e të tri shkollave: “Z. Rexha”, “S. Riza” dhe “Z. L. Marku” arrijmë të kuptojmë se një pjesë e vogël e mësimdhënësve i planifikojnë dhe aplikojnë kriteret e suksesit sipas Vlerësimit Formues nëpër klasat e tyre, ndërsa pjesa dërrmuese nuk i planifikojnë dhe aplikojnë për arsye të ndryshme të cilat nuk janë të qëndrueshme.

5.5 Rezultate nga vëzhgimi i realizuar në klasa në tri shkollat fillore: “Z. Rexha”, “S. Riza” dhe “Z. L. Marku” nga klasa e I-rë deri në të V-të

Tabela 4.1.1 Vëzhgimet në klasë të kategorizuara sipas numrit të përgjigjeve

	Shkollat “Z. Rexha”, “S. Riza”, “Z. L. Marku”
Vëzhgimi i realizuar në tri shkollat fillore	Komunikimi me nxënës dhe vlerësimi i tyre në orë të ndryshme mësimore
Vëzhgimi tek klasat e para	Kontrollim i detyrave të shtëpisë Përsëritje e mësimi Jepen sqarime të përgjithshme Komentet e mësimdhënësve me gojë: mirë, shumë mirë bukur vazhdo kështu ngrite zërin vazhdo kështu, ke harruar një vijë mos e harro vijën e lakuar. Komentet e mësimdhënëses me shkrim: mirë shumë mirë ju lumtë.
Vëzhgimi tek klasat e dyta	Kontrollim i detyrave të shtëpisë Përsëritje – diskutim Lexim dhe aktivitete Komentet e mësimdhënësve me gojë: mire, shumë mirë bravo shumë bukur ndalu pak tek presja ngadal – mos u ngut Komentet e mësimdhënëses me shkrim: Shumë bukur Mirë Të lumtë
Vëzhgimi tek klasat e treta	Kontrollim i detyrave të shtëpisë Përsëritje e mësimi

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

	Vendosja e kriterëve të suksesit: Pa asnjë gabim, të lumtë Me një gabim - 5 Me më shumë se tri gabime - 4 Mbi gjashtë gabime - 3 e më poshtë Përdoren kartona me ngjyra – teknika semafori E gjelbër – e kupton nxënësi E verdhë – ka vështirësi nxënësi E kuqe – nuk e kupton nxënësi Komentet e mësimitdhënësve me gojë: Mirë Këq Plotëso Bukur Shkruaj më mirë Vazhdo Shumë mirë
Vëzhgimi tek klasat e katërta	Diskutim – përsëritje Vendosja e kriterëve të suksesit: Lexim i rrjedhshëm Lexim i saktë i të gjitha shkronjave e fjalëve Respektim i shenjave të pikësimit Komentet nga mësimitdhënëset me gojë: Shumë mirë Mirë Në rregull Të lumtë Faleminderit Lexo më rrjedhshëm Ndrysho përfundimin Nuk i ke respektuar shenjat e pikësimit
Vëzhgimi tek klasat e pesta	Pyetje – përgjigje Vendosja e kriterëve të suksesit: Komente mendimin (ngjarjen) Argumente mendimin (ngjarjen) Komente nga mësimitdhënëset me gojë: Mirë Shumë mirë

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

	Bëre gabim Kujdes Gabove Aha Po Vazhdoje në shtëpi Plotësoje
--	--

Në tabelën e mësipërme për vëzhgimin e klasave nga e I-ra e deri në të V-të në të tri shkollat vërehet se mësimdhënësit mundohen të aplikojnë Vlerësimin Formues në klasat e tyre. Tek disa vërehet aplikimi i kësaj forme të vlerësimit dhe komentet jepen me shkrim, por që janë në formë të përgjithshme. Në disa klasa komentet jepen me gojë, por në mënyrë më të saktë për nxënësit rreth vazhdimin të detyrës apo përmirësimit të gabimeve, por që në fund vlerësohen me notë. Vlerësimi me notë për klasën e parë nuk është shumë i nevojshëm, pasi si për nxënësit, ashtu edhe për prindërit e tyre, është më i qartë e po ashtu edhe motivues shkrimi i komenteve të ndryshme këshilluese apo nxitëse për të arritur një të nxënë të suksesshëm.

Mësimdhënësit vërehen që janë shumë të kujdesshëm me nxënësit gjatë orës mësimore, porse nuk e aplikojnë Vlerësimin Formues tek nxënësit, pasi i japin vetëm disa komente të përgjithshme me gojë. Ndërsa, në asnjërën nga fletoret e testit nuk shkruhet asnjë koment por vetëm vlerësohen me notë.

Tek vëzhgimi i klasave të II-ta në të tri shkollat vërehet se mësimdhënësit e aplikojnë Vlerësimin Formues në klasën e tyre ku aplikohet kjo formë e vlerësimit dhe realizohen aktivitete të ndryshme si diskutim, lexim, përgjigje me gojë dhe me shkrim, ku po ashtu

nga ana e mësimitdhënësës komentet jepen me gojë dhe shkrim. Nxënësit ndihen shumë të motivuar për mësim dhe janë shumë aktivë.

Po ashtu, tek klasa tjetër nxënësit janë aktivë dhe realizojnë aktivitete të ndryshme si:

lexim, formulojnë pyetje dhe japin përgjigje rreth tekstit, ecin nëpër klasë dhe diskutojnë.

Komentet nga ana e mësimitdhënësës jepen me gojë, si për aktivitetet e po ashtu edhe për

lexim, por të cilat jepen në mënyrë më të saktë për nxënësit rreth realizimit apo

mosrealizimit të detyrës. Këtu vërehet edhe planifikimi i një kriteri të suksesit nga ana e

mësimitdhënësës “respekto shenjat e pikësimit” i cili u thuhet nxënësve me gojë para se të

fillojnë të lexojnë në mënyrë që të kuptohet se afërsisht sa gabime janë bërë gjatë leximit

nga nxënësi. Ky kriter nuk është shumë i theksuar që nxënësit të arrijnë të bëjnë një

vetëvlerësim për veten e tyre apo që mësimitdhënësi të arrijë të bëjë një vlerësim të saktë për

nxënësit, por na bën të kuptojmë që së paku në formë të përgjithësuar aplikohen kriteret e

suksesit në këtë klasë.

Po ashtu, vërehet rregulli dhe disiplina gjatë gjithë orës mësimore, po ashtu leximi dhe

diskutimi me disa nga nxënësit rreth tregimit. Por planifikimi dhe aplikimi i formave të

ndryshme të vlerësimit mungon, e në veçanti i Vlerësimit Formues, pasi nuk kishte ndonjë

kriter se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në fund të orës mësimore, e po ashtu edhe komente

të ndryshme për përgjigje të sakta apo të gabueshme.

Tek vëzhgimi i klasave të III-ta në të tri shkollat bie në sy një klasë ku mësimitdhënësja e

aplikon Vlerësimin Formues në klasën e saj - mësimitdhënësja kishte planifikuar të

realizonte diktim – ajo vendos tri kriteret të suksesit, të cilat duhet që t’i arrijnë nxënësit.

Detyra e nxënësve ishte që të realizonin vlerësim të ndërsjellë, ku duhej që t’i numëronin

gabimet dhe të shkruanin komente rreth detyrës së realizuar. Mësimdhënësja në fund i vlerëson edhe me notë, por që e kishte më të lehtë, pasi lexonte vetëm numrin e gabimeve dhe komentet e nxënësve të shkruara për njëri-tjetrin.

Klasa tjetër realizon diktim, vendos kritere vetëm me gojë, por që nuk tregojnë ndonjë saktësi për vlerësim. Vërehet se Vlerësimi Formues nuk aplikohet në formën e duhur, pasi mësimdhënësja nuk u thotë asnjë koment nxënësve në përfundim të diktimit. Gjithashtu nuk i vlerëson as me notë si Vlerësim Përfundimtar. Pra, disa gjëra vërehen se nuk realizohen në mënyrë të rregullt, që të informojnë nxënësit dhe prindërit për përparësitë apo ngecjet e nxënësve gjatë diktimit.

Në klasën e fundit të vëzhguar, mësimdhënësja mundohet të tregojë aktivitetet që përdor rreth aplikimit të kësaj forme të vlerësimit, porse në disa raste vërehet se nuk aplikohet në mënyrë të rregullt. Edhe pse vërehet aplikimi i teknikës së semaforit, teknikë e cila e ndihmon mësimdhënësen që ta kuptojë nëse nxënësi e ka kuptuar mësimin apo jo, mungojnë shpjegimet e qarta dhe komentet e sakta rreth detyrave të realizuara nga nxënësit.

Tek vëzhgimi i klasave të IV-ta në të tri shkollat nuk realizohet aplikimi i Vlerësimit Formues që nga fillimi i orës mësimore, dhënia e detyrave si dhe vlerësimi i nxënësve. Ndërsa gjatë vëzhgimit në klasën e dytë të po të njëjtës, mësimdhënësja e aplikon Vlerësimin Formues në klasën e saj përmes planifikimit të kritereve dhe zbatimit të tyre me nxënës. Mësimdhënësja kishte planifikuar të realizonte leximin e një tregimi të ri, duke e ndarë në 4 paragrafe si dhe nxënësit në katër grupe që ta lexojnë dhe komentojnë tekstin. Ajo vendos tri kritere të suksesit të cilat duhej t'i arrinin nxënësit. Detyra e nxënësve ishte

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

që të bëjnë pyetje dhe të japin përgjigje, të shkruajnë rreth tregimit dhe të realizojnë vlerësim të ndërsjellë, duke numëruar gabimet dhe të shkruanin numrin e gabimeve.

Komentet të cilat i jep mësimdhënësja me gojë dhe me shkrim janë: shumë mirë, faleminderit, lexo më rrjedhshëm si dhe nuk i ke respektuar saktë shenjat e pikësimit me më shumë detaje.

Në shkollën tjetër mësimdhënësja vërehet gjatë gjithë realizimit të orës mësimore se përdor aktivitete, detyra, pyetje e përgjigje me të gjithë nxënësit rreth planifikimit dhe aplikimit të kësaj forme të vlerësimit. Planifikohen kriteret e suksesit, angazhohen të gjithë nxënësit që të jenë aktivë me komentet e tyre, realizohet komunikim me të gjithë nxënësit, komentet jepen nga mësimdhënësja me gojë dhe me shkrim, në mënyrë më të detajuar rreth punës së realizuar nga nxënësit. Mësimdhënësja përmes punimeve dhe fletoreve të nxënësve tregon se si i shkruan komentet për nxënësit, të cilat i drejtohen edhe prindërve. Pra, e dëshmon se e aplikon Vlerësimin Formues e sidomos me nxënësit të cilët janë mesatarë dhe të dobët në mësim, me qëllimin e mirë që t'i motivojë ata për të nxënë të suksesshëm.

Ndërsa, në shkollën ku ora fillohet me diktim rreth një faqe, nuk përcaktohet ndonjë kriter nga ana e mësimdhënëses. Mësimdhënësja i përcjell nxënësit gjatë të shkruarit dhe në fund u jep detyrë që të bëjnë një vlerësim të ndërsjellë për t'i kontrolluar gabimet shoku shokut, duke e përcjell tekstin në libër. Pas numërimit të gabimeve nxënësit duhet të marrin fletoret e veta dhe të rishkruajnë tekstin qartë e pa gabime, duke e përcjell në libër renditjen e fjalëve dhe shenjat e pikësimit.

Tek vëzhgimi i klasave të V-ta në të tri shkollat vërehet se aplikimi i Vlerësimit Formues që nga fillimi i orës mësimore, realizimi i aktiviteteve të ndryshme, dhënia e detyrave si dhe vlerësimi i nxënësve nuk realizohet në asnjë nga fazat e orës mësimore.

Gjatë vëzhgimit në të katër klasat e V-ta mësimdhënëset realizojnë metoda të ndryshme pune, i aktivizojnë nxënësit në forma të ndryshme të punës, por mungon planifikimi i kritereve të suksesit dhe realizimi i tyre me nxënës në orë të ndryshme mësimore.

Një nga mësimdhënëset e cila realizon dy aktivitete me nxënës, po ashtu kishte shkruar kriteret e suksesit në tabelë të propozuara nga nxënësit, por që nuk kishin ndonjë sqarim të saktë rreth leximit apo realizimit të detyrës me shkrim. Ata së bashku vendosin dy kritere të suksesit “komento mendimin (ngjarjen) dhe argumento mendimin (ngjarjen)”, të cilat kritere nuk janë të saktësuara se çka nxënësit duhet të arrijnë në fund për tu vlerësuar me komente të ndryshme apo me notë. Ndërsa në shkollat tjera, përkundër punës së tri mësimdhënëseve, vërehen shumë mangësi rreth planifikimit dhe realizimit të Vlerësimit Formues.

Komentet të cilat i japin mësimdhënëset me gojë dhe me shkrim në të tri shkollat kryesisht janë: shumë mirë, mirë, gabove, kujdes, plotëso, vazhdoje në shtëpi; komente të cilat janë me pak apo shumë pak detaje për përmirësimin e detyrës apo vazhdimin e detyrës në të njëjtën formë.

Nga vëzhgimi del se e përbashkëta e të tri shkollave është se Vlerësimi formues aplikohet pjesërisht nga ana e mësimdhënësve. Edhe në klasat ku aplikohet kjo formë e vlerësimit ka

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

mangësi e vështirësi për planifikimin dhe aplikimin e rregullt për një të nxënë motivues e
cilësor të nxënësve.

Kapitulli V. Diskutime mbi gjetjet

“Mësoji-ni kanë thënë t’urtëtë, fëmijënë t’uaj, të dinë më shumë se ju, se ata janë për një
kohë më tej nga koha juaj”

(Rexhepagiq, Sami Frashëri dhe Pedagogjia e Rilindjes Kombëtare, 2005:38)

Në këtë kapitull përshkruhen gjetjet kryesore të lidhura me teoritë dhe studimet tjera mbi fushën e hulumtimit. Qëllimi kryesor i këtij studimi është evidentimi i problemeve të ndryshme që shfaqen në procesin mësimor për planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues në shkolla. Gjatë studimit janë përdorur metoda sasiore dhe cilësore për mbledhjen e të dhënave që ta çojnë studimin drejt përgjigjeve të sakta mbi pyetjet e adresuara.

Ky seksion prezanton diskutimet mbi rezultatet që kanë dalë përmes analizës për çështjet kryesore të studimit, anketës me anë të pyetësorit, intervistave individuale me mësimdhënës, intervistave gjysmë të strukturuar, të realizuara me nxënës në fokus grupe, si dhe vëzhgimit në orët mësimore në 20 klasa të të tri shkollave. Konkludimet mbi gjetjet e këtij studimi do të shërbejnë për paraqitjen e rekomandimeve përkatëse.

Nga ana teorike e prezentuar në kapitujt e mësipërm vërehet se planifikimi dhe aplikimi i formave të ndryshme të vlerësimit, e në veçanti të Vlerësimit Formues, sjell në klasa një klimë të ngrohtë, bashkëpunimi mes mësimdhënësit, me nxënësit dhe prindërit, e po ashtu edhe një vlerësim të drejtë dhe të plotë për nxënësit.

Në vendin tone vërehet një mungesë e studimeve të tilla për vlerësimin në përgjithësi, edhe pse gjithmonë nga ana e mësimdhënësve theksohet se vlerësimi në periudha të ndryshme gjatë vitit shkollor është pjesa kyçe e procesit mësimor.

Aktualisht vendi ynë përballë me problematika të ndryshme në procesin mësimor, si ngritjen profesionale të mësimdhënësve, planifikimin dhe mbajtjen e trajnimeve të

ndryshme, përfshirë dhe trajnimin për Vlerësimin Formues, ndërtimin e kurrikulave në nivel shkolle, planin e ngarkuar mësimor, pesha e rendë e çantës së nxënësit e vështirësi të tjera.

Nga të dhënat e studimit arrijmë të kuptojmë se qëllimi kryesor është arritur për mbledhjen e të dhënave të mjaftueshme për procesin e mësimdhënies rreth njohjes së aftësive të nxënësve nga ana e mësimdhënësve përmes vlerësimit – e në veçanti aplikimit të Vlerësimit Formues. Këto të dhëna janë arritur përmes mbledhjes së informacioneve të mjaftueshme në mënyrë sistematike, nëse mësimdhënësit arrijnë t'i motivojnë nxënësit për një të nxënë të qëndrueshëm dhe të arritura cilësore tek nxënësit.

5.1. Të dhënat e studimit për mendimet rreth përparësive të aplikimit të Vlerësimit Formues

Përmes anketës – pyetësorit me mësimdhënë, intervistës me drejtorë, intervistës së realizuar në fokus grupe me nxënës dhe intervistës me mësimdhënë është realizuar studimi nga i cili është arritur tek mbledhja e informacioneve më të detajuara për planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues në shkollë nga ana e mësimdhënësve dhe rezultatet pozitive që sjell kjo formë e vlerësimit në të nxënësit e nxënësve.

Rezultatet flasin se në të tri shkollat mësimdhënësit janë të trajnuar, bazuar në të dhënat tek tabela 1.3 dhe kanë mjaft njohuri për ndryshimet pozitive tek nxënësit që sjell planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues për të nxënësit cilësor dhe të qëndrueshëm të tyre. Sipas të dhënave të marra nga tabela 3.1 për vlerësimin, mësimdhënësit tregojnë se nënkuptojnë të arriturat, matjen e njohurive të nxënësve, përmbledhjen e njohurive të fituara për një

periudhë të caktuar dhe se vlerësimi është vetë dija e nxënësit. Sipas tabelës 5.1 për sa i përket bashkëpunimit që mësime ndihmësit kanë mes vete, pra me kolegët e tyre për të nxënë e nxënësve, shumë prej tyre kanë thënë se takimet mes tyre më shumë realizohen me qëllim të diskutimit dhe zgjidhjes së problemeve të ndryshme me nxënë, të planifikimit dhe realizimit të planit mësimor.

Pjesa më e madhe e tyre tregojnë tek tabela 7.3 se forma e vlerësimit e cila i motivon nxënësit për punë të suksesshme është aplikimi i Vlerësimit Formues dhe Vlerësimit Përmblidhës gjatë procesit të të nxënë. Motivimi sipas tabelës 8.1 arrihet duke u mbështetur në mënyrë sistematike në vlerësimin individual të nxënësit për marrjen e informacioneve, për të arritur tek një vlerësim përfundimtar për përmirësimin e të nxënë të nxënësve.

Përsa i përket pyetjes se në çka ndikon aplikimi i Vlerësimit Formues, shumë nga mësime ndihmësit tek tabela 10.1 mendojnë se ndikon në forcimin e motivimit të nxënësve; sipas tabelës 9.1 ndihmon përmirësimin e të nxënë të tyre, ku sipas të dhënave nga kjo tabelë arrijmë t'i përgjigjemi pyetjes së shtatë kërkimore dhe vërtetohet hipoteza e gjashtë; sipas të dhënave nga tabela 10.3 zhvillon kapacitetet për vetëvlerësim tek nxënësit. Nga tabela 9.2 mësime ndihmësit tregojnë se nxënësit arrijnë të kuptojnë shkallën e suksesit të tyre; sipas tabelës 10.4 një numër më i vogël i mësime ndihmësve mendojnë se aplikimi i kësaj forme të vlerësimit identifikon të arriturat e nxënësve; dhe nga të dhënat e tabelës 9.3 kuptojmë se aplikimi i kësaj forme të vlerësimit ndikon pozitivisht në komunikimin dhe bashkëpunimin me prindër, ku sipas të dhënave nga kjo tabelë arrijmë t'i përgjigjemi pyetjes së pestë dhe gjashtë kërkimore dhe vërtetohet hipoteza e pestë.

Nga studimi rezulton se tek tabela 16.1 mësimdhënësit tregojnë se aplikimi i formave të ndryshme të vlerësimit janë të rëndësishme për nxënësin; nga të dhënat e tabelës 16.5 kuptojmë se një numër i madh i mësimdhënësve tregojnë se janë të rëndësishme për zhvillimin psikomotorik të nxënësve gjatë gjithë procesit mësimor; tek tabela 17.2 mësimdhënësit tregojnë se takimet me prindër realizohen individualisht, ndërsa tek të dhënat e marra në tabelën 17.3 kuptojmë se këto takime realizohen në tremujore.

Po ashtu, një përqindje më e vogël e mësimdhënësve tek tabela 16.2 tregojnë se këto forma të ndryshme vlerësimi janë të rëndësishme për prindërit, nga tabela 18.1 mësimdhënësit tregojnë se komunikimi me prindër është me rëndësi dhe që ndikon në përmirësimin e të nxënit të nxënësve e dhënë e cila vërteton hipotezën e pestë, ndërsa nga tabela 18.3 kuptojmë se ky komunikim ndikon dhe në motivimin e nxënësve për nxënie cilësore. Pra, nga këto të dhëna arrijmë të kuptojmë se janë një numër i madh i mësimdhënësve që mendojnë se janë të rëndësishme për nxënësit, ndërsa një numër më i vogël prej tyre që mendojnë pozitivisht se aplikimi i formave të ndryshme të vlerësimit ndikon në ngritjen e cilësisë përmes komunikimit dhe bashkëpunimit me prindër.

Nga të dhënat e marra përmes hulumtimit tek tabela 18.3 arrijmë të kuptojmë se mbi 80% e mësimdhënësve tregojnë se Vlerësimi Formues ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve për nxënie cilësore dhe në përmirësimin e të nxënit të tyre, ku sipas të dhënave nga kjo tabelë arrijmë t'i përgjigjemi pyetjes së parë kërkimore dhe vërteton hipotezën e gjashtë. Po ashtu, nga tabela 18.2 kuptojmë se kjo formë vlerësimi ndikon pozitivisht në kryerjen me rregull të detyrave të shtëpisë, ndërsa nga tabela 18.4 kuptojmë se aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në bashkëpunimin mes nxënësve.

Po ashtu, nga të dhënat përmes intervistës me nxënës tek tabela 2.1.1 arrijmë të kuptojmë se nxënësve më shumë u pëlqejnë komentet me gojë ose me shkrim dhe ndihen shumë mirë para shokëve, mësimeve dhe prindërve të tyre kur marrin notë dhe fjalë apo vetëm fjalë, pasi mendojnë se e vërejnë më lehtë se ku i kanë gabimet në detyra, në mënyrë që të arrijnë për t'i përmirësuar ato.

Pra, përqindja më e madhe e pjesëtarëve në hulumtim, duke u bazuar në informacionet që kanë për planifikimin dhe realizimin e Vlerësimit Formues tek tabela 19.2 dhe 19.3, tregojnë se aplikimi i disa formave të vlerësimit në klasë, përfshirë Vlerësimin Formues, ndikon në motivimin e nxënësve për nxënie të qëndrueshme dhe cilësore të nxënësve.

Po ashtu, nga tabela 19.4 dhe nga intervista me mësimeve arrijmë të kuptojmë se mësimeve tregojnë se planifikimi i kriterëve të suksesit për aplikimin e suksesshëm të Vlerësimit Formues dhe dhënia e komenteve me gojë apo me shkrim ndikon pozitivisht në gjithë procesin e të nxënësve, ku sipas të dhënave nga kjo tabelë arrijmë t'i përgjigjemi pyetjes së tetë kërkimore.

5.2. Të dhënat për punën që realizohet në klasë përmes Vlerësimit Formues

Një numër i madh i mësimeve, sipas të dhënave nga tabela 8.5, tregojnë se e aplikojnë këtë formë vlerësimi në klasat e tyre në mënyrë sistematike, porse sipas tabelës 4.3 ata tregojnë se e përdorin notën edhe fjalët në të njëjtën kohë si vlerësim për nxënës, pra arrijmë të kuptojmë se mësimeve i realizojnë të dy format e vlerësimit në të njëjtën kohë me nxënës në klasë, e cila nuk është formë e saktë e komunikimit, sepse nuk sjell ndonjë ndryshim pozitiv tek të nxënësve e nxënësve. Mund të ndërliqemi me anën

teorike se vlerësimi me komente dhe notë në të njëjtën kohë nuk ka përmirësim të dukshëm për nxënësit, ndërsa vlerësimi vetëm me komente për detyrën e realizuar ka përmirësim deri në 30%.” (Murchan, Shiel & Vula, 2011)

Nga të dhënat arrijmë të kuptojmë se teknikat dhe instrumentet që mësime dhënësit i aplikojnë për të arritur deri tek marrja e informacioneve të mjaftueshme rreth njohurive që nxënësit kanë arritur në periudha të ndryshme për të arritur tek Vlerësimi Përmbledhës, kryesisht sipas tabelës 6.2 dhe 6.4, tregojnë se aplikojnë pyetjet me gojë dhe me shkrim, po ashtu edhe sipas tabelës 6.1 mësime dhënësit tregojnë se kryesisht janë testet të cilat aplikohen pothuajse në të gjitha lëndët mësimore.

Nga të dhënat sipas tabelës 11.1 arrijmë të kuptojmë se vetë mësime dhënësit janë të motivuar për më shumë punë në klasë dhe shtëpi, ndërsa nga tabela 12.6 arrijmë të kuptojmë se e aplikojnë Vlerësimin Formues pothuajse në të gjitha lëndët mësimore. Sipas të dhënave nga tabela 14.1 kuptojmë se kjo formë vlerësimi aplikohet tek secila njësi, duke planifikuar kriteret e suksesit së bashku me nxënësit, ndërsa tek tabela 16.1 kuptohet se mësime dhënësit arrijnë të kuptojnë nëse nxënësit e kanë kuptuar ose jo mësimin me të cilën vërtetohet hipoteza e katërt, prandaj arrijmë të kuptojmë se nëse mësime dhënësit i bashkojnë forcat e tyre me nxënësit në procesin e Vlerësimit Formues, partneriteti i tyre do të ketë rezultate të fuqishme në të mësuarit e nxënësve. (Moss & Brookhart, 2009)

Nga të dhënat përmes tabelës 12.1 arrijmë të kuptojmë se mësime dhënësit tregojnë se Vlerësimi Formues aplikohet kryesisht në lëndën gjuhës shqipe; tek tabela 12.2 mësime dhënësit tregojnë se e aplikojnë në lëndën e matematikës, ndërsa nga të dhënat tek tabela 12.6 nga mësime dhënësit e kuptojmë se ata e aplikojnë në të gjitha lëndët, që

nënkupton se aplikohet pjesërisht. Shumë nga mësime të mësimdhënësve tek tabela 13.1 tregojnë se e aplikojnë Vlerësimin Formues në lëndët kryesore për çdo njësi të re mësimore, ndërsa nga të dhënat e marra tek tabela 13.3 e kuptojmë se një numër më i vogël prej tyre tregojnë se këtë formë vlerësimi e aplikojnë për çdo kapitull. Pra, duke pasur parasysh që për nxënësit është me rëndësi të kuptohet se ku kanë vështirësi, është me rëndësi që Vlerësimi Formues të realizohet edhe në çdo kapitull të kryer, me qëllim të tejkalimit të vështirësive, duke arritur në përmirësimin e të nxënësit të tyre.

Një tjetër indikator me rëndësi për procesin e të nxënësit të suksesshëm të nxënësve janë edhe aplikimi i formave të ndryshme të vlerësimit, e në veçanti Vlerësimit Formues që bëhen në klasë nga mësime të mësimdhënësve. Nga të dhënat kuptohet që një numër i madh i mësime të mësimdhënësve nuk aplikojnë shumë forma vlerësimi. Nga tabela 14.3 kuptojmë se mësime të mësimdhënësve nuk u shkruajnë nxënësve të tyre informatën kthyesë në fletore. Nga të dhënat e marra tek tabela 14.4 kuptojmë se nuk e aplikojnë vlerësimin e ndërsjellë mes nxënësve, ndërsa nga tabela 14.1 marrim të dhëna se nuk i planifikojnë kriteret e suksesit gjatë realizimit të planit të tyre. Pra, nga këto të dhëna arrihet të kuptohet se aplikimi i Vlerësimit Formues nuk aplikohet në masë të duhur dhe se nuk arrihet një komunikim i mirëfilltë me prindërit përmes fletores së nxënësit.

Bie në sy nga të dhënat e marra përmes anketimit tek tabela 15.1 se kuptojmë që një përqindje e madhe e mësime të mësimdhënësve tregojnë se përmes aplikimit të Vlerësimit Formues arrijnë të kuptojnë se nxënësit e kanë kuptuar mësimin apo kanë ndonjë vështirësi në detyra të ndryshme. Nga tabela 15.2 mësime të mësimdhënësve tregojnë se përmes aplikimit të Vlerësimit Formues e kuptojnë se nxënësit kanë nevojë për përsëritje të njësive mësimore

në lëndë të ndryshme dhe nga këto të dhëna vërtetohet hipoteza e gjashtë, ndërsa nga të dhënat e tabelës 15.3 arrijmë të kuptojmë se mësimdhënësit tregojnë se nuk arrijnë ta kuptojnë nëse nxënësit kanë nevojë për një rifreskim apo përsëritje të njësive, që kanë vështirësi apo që nuk e kanë kuptuar fare ndonjë nga njësitë mësimore tek lëndët e ndryshme. Vlen për t'u theksuar pra, se një përqindje e madhe e mësimdhënësve nuk arrijnë ta planifikojnë dhe aplikojnë Vlerësimin Formues në klasë ose e aplikojnë në formë jo të duhur, pasi nuk arrijnë të marrin informacione për njohuritë që nxënësit i kanë arritur gjatë të nxënësve të tyre, rreth vështirësive që kanë apo për përmirësimet e nevojshme që duhet t'i bëjnë në kohën e duhur. Lidhur me anën teorike, arrijmë të kuptojmë se për përmirësimin e mësimdhënies nga ana e mësimdhënësve dhe ngritjes së cilësisë në të nxënësve është me rëndësi planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues (Popham, 2008)

Sa i përket vlerësimit, të gjithë mësimdhënësit tregojnë se qëllimi i aplikimit të vlerësimit është që nxënësi të kuptojë veten, të vihet në garë me shokë si dhe nota të mbetet dëshmi për të tjerë, ndërsa se si mësimdhënësit e realizojnë vlerësimin tregojnë se kryesisht e aplikojnë vlerësimin me notë dhe komente së bashku.

Përmes intervistës të realizuar individualisht me mësimdhënësit tek tabela 3.1. arrijmë tek të dhënat se studimi ka për qëllim argumentimin e punës nga ana e mësimdhënësve rreth planifikimit dhe riplanifikimit të punës së tyre. Po ashtu, përmes aplikimit të formave të ndryshme të vlerësimit arrihet në ngritjen e suksesit për të nxënë të qëndrueshëm dhe cilësor të nxënësve. Nga këto të dhëna arrihet të vërtetohet hipoteza e katërt, ku mësimdhënësit mund të arrijnë të bëjnë një ristrukturim të mësimdhënies.

Mësimdhënësit edhe tek intervista tregojnë se aplikimi i Vlerësimit Formues ka sjell rezultat pozitiv në procesin mësimor, e në veçanti aplikimi i teknikës së semaforit përmes tri ngjyrave, ku nxënësit arrijnë të tregojnë nëse e kanë kuptuar mësimin apo kanë nevojë për përsëritje të njësive mësimore.

Nga të dhënat përmes intervistës arrijmë të kuptojmë se komentet të cilat mësimdhënësit u japin nxënësve me gojë apo me shkrim, për realizimin e detyrave të ndryshme janë: je si yll, të lumtë, të lumtë - 5, krenohem me ty, të lumtë dora, bravo, bukur, lexo më shumë, përpiku më tepër, respekto shenjat e pikësimit, shkrimi shumë i bukur, vazhdo kështu, përmirësoje shkrimin, mos bëj shumë gabime, si dhe mos fshi me gomë. Këto komente duken që janë të përgjithshme pra, jo të specifikuara mirë dhe të paqarta për nxënësit, për t'i drejtuar në përmirësimin e detyrës dhe kryesisht jepen në lëndën e gjuhës shqipe dhe matematikës, ndërsa në lëndët tjera më pak ose nuk i japin fare. Lidhur me anën teorike të sipërpërmendur, bazuar në mendimin e Gaston Mialaret, i cili thotë se është me rëndësi që nxënësve t'u transmetohet rezultati i arritur në mënyrë efikase, me qëllim të përmirësimit të nxënësve të tyre (Vuji, 2012), po ashtu tregojnë se kjo formë vlerësimi ka ndikim pozitiv më shumë tek nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm dhe nxënësit mesatarë, të cilët janë më të motivuar për punë. Po ashtu, tregojnë se arrijnë ndryshim pozitiv në veçanti nxënësit të cilët marrin komente të shkruara në fletore, pasi vetë nxënësit informohen drejtpërdrejt, tregojnë se i ndihmojnë nxënësit në vetëvlerësim, e po ashtu informohen edhe prindërit e tyre, qoftë për rënien apo ngritjen e suksesit të fëmijëve të tyre, duke përcjellur rregullisht shkrimet në fletore. Nga kjo përgjigje e mësimdhënësve arrihet të vërtetohet hipoteza e parë dhe e pestë.

Mësimdhënësit përmes intervistës nga tabela 3.1.1 tregojnë se planifikimi i kritereve të suksesit i ndihmon në realizimin e Vlerësimit Formues, por kryesisht i japin me gojë, pasi janë të njëjtat kritere që i realizojnë pa ndryshuar diçka ku thonë se nxënësit i njohin ato dhe e dinë se çka duhet të bëjnë për realizimin e detyrës. Mësimdhënësit po ashtu tregojnë se planifikimi dhe aplikimi i kritereve të suksesit nuk i ndihmon në planifikimin ditor, ndërsa tek nxënësit nuk arrijnë të realizojnë ndonjë ndryshim pozitiv në ngritjen e cilësisë. Nga të dhënat arrijmë të kuptojmë se aplikimi i Vlerësimit Formues nuk i ndihmon mësimdhënësit në realizimin e Vlerësimit Përmbledhës, e po ashtu u merr shumë kohë në planifikimin ditor, duke mos arritur të vetëvlerësojnë dhe rishikojnë punën e tyre me nxënës. Lidhur me anën teorike themi se përcaktimi i objektivave dhe kritereve të suksesit – vlerësimit nga ana e mësimdhënësve na drejton në punën që duhet të arrijnë nxënësit për të përmbushur ato kriteret dhe të arrijnë objektivat. (Muka, 1997)

Nga të dhënat e studimit përmes tabelës 17.2 arrijmë të kuptojmë se mësimdhënësit tregojnë se komunikimi me prindër realizohet përmes takimeve individuale me prindër, ndërsa nga tabela 17.3 kuptojmë se komunikimi realizohet gjatë mbledhjeve me prindër të realizuara në tremujore. Prej të dhënave po ashtu nga tabela 17.4 del se mësimdhënësit tregojnë se arrijnë të komunikojnë me prindërit përmes bisedave telefonike, ndërsa nga tabela 17.1 kuptojmë se arrijnë të komunikojnë me prindërit me shkrim përmes fletorese nxënësve që rezulton se një përqindje e vogël prej tyre që realizojnë Vlerësimin Formues pasi nuk arrijnë të komunikojnë me komente përmes fletorese të nxënësit. Përmes të dhënave nga kjo tabelë arrijmë t'i përgjigjemi pyetjes së dytë dhe të tretë kërkimore se edhe zbatimi i pjeshëm i Vlerësimit Formues ndikon në të nxënësit e qëndrueshëm të

nxënësve dhe reflektim cilësor. Lidhur me anën teorike kuptohet se bashkëpunimi në mes të mësimitdhënësve dhe prindërvedo të duhej të ishte më i madh dhe jo vetëm për çështje teknike, pramund të themi se shkolla duhet të planifikojë objektiva të qarta rreth mësimitdhënies, të nxënësve, motivimit e bashkëpunimit mes mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve për një mjedis të ngrohtë mësimesor dhe të efektshëm për arritjet e nxënësve (Bojaxhi, 2004)

Pas diskutimit për të dhënat tjera edhe përmes intervistës me drejtorët e të tria shkollave nga tabela 1.1.1 kuptojmë se edhe drejtorët janë të trajnuar dhe kanë njohuri të mjaftueshme për Vlerësimin Formues dhe të mirat që sjell aplikimi i tij në procesin e të nxënësve. Nga të dhënat arrijmë të kuptojmë se drejtorët kontrollojnë në shkollat e tyre se çka mësimitdhënësve vlerësojnë tek nxënësve e tyre, se si i zgjidhin situatat problemore në klasa, a krijojnë tek nxënësve aftësi për krijime origjinale gjatë shkollimit të tyre. Po ashtu, drejtorët tregojnë se i përcjellin mësimitdhënësve gjatë punës se çfarë kriteresh dhe forma vlerësimi i aplikojnë me nxënësve e tyre në klasë.

Po ashtu, nga të dhënat përmes intervistës me drejtorë arrijmë të kuptojmë se drejtorët tregojnë që temë diskutimi gjatë mbledhjeve të këshillit të mësimitdhënësve zakonisht janë suksesi i përgjithshëm i nxënësve, forma e kontrollimit të njohurive dhe sjelljes së nxënësve, niveli i arritjes dhe rezultateve për të nxënësve e nxënësve dhe kriteret e suksesit që ata aplikojnë në klasat e tyre.

Nga të dhënat e të tre drejtorëve tek tabela 1.1.1 arrijmë të kuptojmë se gjatë mbledhjeve dhe takimeve që ata kanë në shkollë me mësimitdhënësve nuk arrihet të bëhet ndonjë diskutim nëse aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në motivimin e nxënësve për të nxënë

të suksesshëm. Po ashtu, ata tregojnë se kjo formë vlerësimi nuk aplikohet në mënyrë të mjaftueshme nga mësimdhënësit gjatë procesit mësimor.

Nga intervista gjysmë e strukturuar, e realizuar me nxënës në fokus grupe, arrijmë tek qëllimi për marrjen e informacioneve nëse ata e njohin dhe e aplikojnë Vlerësimin Formues. Përmes kësaj interviste me nxënës nga tabela 2.1.1 arrijmë të kuptojmë se shumë nga nxënësit tregojnë se vlerësimi për ata nënkupton notën, matjen e njohurive të tyre se ku kanë arritur për një periudhë të caktuar, përmes fjalëve apo shkrimeve që ata marrin nga mësimdhënësit e tyre. Nxënësit tregojnë se vlerësohen më shumë me notë ose marrin komente të shkurtra me gojë ose me shkrim si: të lumtë, të lumtë - 5, shkruaj më bukur, përmirësoje shkrimin, shkrimi shumë i bukur, të lumtë dora e vogël, mos bëj shumë gabime, vazhdo kështu, bukur, je yll, bravo, tre yje dhe zemër, si dhe komente të tjera të shkurtra dhe të papërcaktuara për nxënësit. Komentet kryesisht jepen në lëndën e gjuhës shqipe dhe matematikës, ndërsa në lëndët tjera më pak ose nuk i japin fare.

Nga të dhënat e marra gjatë vëzhgimit në klasa tek tabela 4.1.1 vërehet se kontrollohen detyrat e shtëpisë dhe jepen sqarime të përgjithshme për nxënësit rreth punës që do të bëjnë. Komentet me gojë dhe ato të shkruara në disa nga fletoret e nxënësve nga ana e mësimdhënësve ishin të shkurtra ose që nuk kishte komente fare për punën e realizuar. Komentet në një përqindje të madhe ishin: mirë, shumë mirë, bukur, bravo, vazhdo, mirë pra, shumë bukur, ndalu tek presja, lexo më mirë, ngadalë, vazhdo, të cilat komente nuk i takonin formës së dhënies së këshillave nga ana e mësimdhënësve e as formës nxitëse të punës për nxënësit.

Të dhënat e marra nga intervista me nxënës (tabela 2.1.1) dhe vëzhgimi (tabela 4.1.1) e realizuar në klasë, ndërlidhen me të dhënat e marra nga intervista me mësimdhënësit (tabela 3.1.1) se komentet janë kryesisht të shkurtra dhe të përgjithshme, të cilat nuk i drejtojnë nxënësit në një përmirësim konkret të detyrës që duhet të bëjnë.

Kriteret e suksesit të cilat shkruhen nga mësimdhënësit më së shumti janë: mos bëj gabime, shkruaj saktë fjalët njëërën pas tjetrës, respekto shenjat e pikësimit, shkruaj pastër, kujdes shkrimin dhe komente të tjera të cilat janë të përgjithshme pra, jo të specifikuar mirë dhe të paqarta për nxënësit.

Të dhënat na tregojnë se ndërlidhen me të dhënat e marra nga mësimdhënësit se kriteret e suksesit të thëna apo të shkruara në këtë formë të shkurtër apo të përgjithshme nuk i drejtojnë nxënësit drejt detyrës se çka saktësisht duhet të bëjnë për të arritur sukses në detyrën e realizuar.

Arrijmë të kuptojmë përmes intervistës me nxënës tek tabela 2.1.1 se komunikimi në mes prindërve dhe mësimdhënësve realizohet kryesisht përmes vizitës së prindërve në shkollë apo mbledhjeve me prindër, përmes bisedës me telefon, ditës së takimeve me prindër dhe fletoreve të nxënësit.

Pra, nga të dhënat e marra përmes intervistës me nxënës arrijmë të kuptojmë se prindërit kryesisht më tepër e vizitojnë shkollën për komunikim, pasi nuk marrin informacione të sakta nga fletoret rreth punës që bëjnë fëmijët e tyre në klasë. Po ashtu, nxënësit tregojnë se edhe prindërit nuk shkruajnë ndonjë koment në fletoret e fëmijëve të tyre pasi mendojnë se komunikimi më i mirë është takimi me mësimdhënësin.

Pra, nga rezultatet e kësaj interviste arrijmë të kuptojmë se mungon një komunikim i mirëfilltë në mes mësimeve, nxënësve dhe prindërve përmes komenteve në fletoren e nxënësit, si pjesë e Vlerësimit Formues.

Pra, janë marrë informacione të plota nga ana e mësimeve, drejtorëve e nxënësve përmes anketimit, intervistave dhe vëzhgimit se Vlerësimi Formues në shkollë zbatohet pjesërisht.

5.3. Shembuj pozitivë nga disa klasë të vëzhguara, të cilat aplikojnë Vlerësimin Formues

Në klasën e parë të shkollës “Z. L. Marku” mësimeve nuk komenton rreth kritereve të suksesit asgjë, gjatë gjithë orës së gjuhës shqipe i përcjell fëmijët rreth shkrimit të shkronjës “Q, q” dhe komentet nxitëse i jep me gojë si: vazhdo kështu, mirë shumë; dhe këshilluese: mos e harro vijën e lakuar, ke harruar një vijë; të cilat i jep duke i orientuar nxënësit rreth punës së tyre. Këto komente ishin mjaft orientuese për nxënësit, por në fund nga mësimeve bëhet vlerësimi me notë, i cili nuk preferohet për klasën e parë.

Po ashtu, **tek klasa e dytë** në shkollën “S. Riza” nxënësit vërehen që janë më aktivë dhe realizojnë aktivitete të ndryshme brenda orës mësimore: lexim, formulojnë pyetje dhe japin përgjigje rreth tekstit, ecin nëpër klasë dhe diskutojnë. Komentet nga ana e mësimeve kryesisht jepen me gojë si për aktivitet, po ashtu edhe për lexim, të cilat jepen në mënyrë më të saktë për nxënësit rreth realizimit apo mosrealizimit të detyrës. Tek kjo klasë nga ana e mësimeve u thuhet nxënësve me gojë një kriter i suksesit “respekto shenjat e pikësimit” para se të fillojnë të lexojnë në mënyrë që të kuptohet afërsisht se sa gabime

bëhen gjatë leximit nga nxënësi. Ky kriter nuk është shumë i theksuar për nxënësit që të arrijnë të bëjnë një vetëvlerësim për veten e tyre apo që mësimdhënësi të arrijë të bëjë një vlerësim të saktë për nxënësit. Arrijmë të kuptojmë që në këtë klasë së paku në formë të përgjithësuar aplikohen kriteret e suksesit.

Tek **klasa e tretë** në shkollën “Z. Rexha” mësimdhënësjë vërehet se e aplikon Vlerësimin Formues në klasën e saj, pasi u tregon nxënësve se do të realizonin diktim dhe i shkruan në tabelë tri kritere të suksesit të cilat duhej t’i arrinin nxënësit: pa gabime - nota 5, me pesë gabime - nota 4 dhe mbi gjashtë gabime nota 3 e më poshtë. Pas diktimit u thotë nxënësve se do të bëjnë vlerësim të ndërsjellë, ku duhej që t’i numëronin gabimet dhe të shkruanin komente rreth detyrës së realizuar. Pas korrigjimit nga ana e nxënësve mësimdhënësjë në fund i vlerëson edhe me note, por që e kishte më të lehtë pasi lexonte vetëm numrin e gabimeve dhe komentet e nxënësve shkruara për njëri-tjetrin. Po ashtu, në këtë klasë vërejmë se mësimdhënësjë me anën e kalendarit javor, në bashkëpunim me nxënësit, mundohet të tregojë anët e forta apo anët pozitive të nxënësve, përmes aplikimit të Vlerësimit Formues, e po ashtu edhe përmirësimin e anëve më të dobëta tek nxënësit për nxënie të qëndrueshme dhe cilësore.

Në klasën e katërt të shkollës “Zekeria Rexha” mësimdhënësjë e aplikon Vlerësimin Formues në klasën e saj dhe e fillon me leximin e një tregimi të ri, duke e ndarë në 4 paragrafe si dhe nxënësit i ndan në katër grupe që ta lexojnë dhe komentojnë tekstin. Ajo vendos tri kritere të suksesit të cilat duhet që t’i arrinin nxënësit: lexim i rrjedhshëm, lexim i saktë i të gjitha shkronjave e fjalëve dhe respektim i shenjave të pikësimit. Detyra e nxënësve ishte që gjatë apo pas leximit, ata mund të bëjnë pyetje dhe të japin përgjigje, të

shkruajnë rreth tregimit dhe të realizojnë vlerësim të ndërsjellë, duke respektuar kriteret për të shkruar numrin e gabimeve të bëra. Komunikimi realizohet me të gjithë nxënësit. Ndërsa komentet të cilat i jep mësimdhënësja kryesisht me gojë janë: shumë mirë, faleminderit, lexo më rrjedhshëm si dhe ‘nuk i ke respektuar saktë shenjat pikësimi’.

Në klasën e katërt të shkollës “S. Riza” mësimdhënësja vërehet gjatë gjithë realizimit të orës mësimore se bën planifikimin dhe aplikimit e Vlerësimit Formues pasi realizon aktivitete, detyra, pyetje e përgjigje me të gjithë nxënësit. Shkruhen kriteret e suksesit si: gjeni titull për tekstin (ngjarjen) e shkruar, shkruaj qartë dhe pa gabime, ndërsa kriteri i tretë - kujdes në përfundimin e tekstit (ngjarjes). Komunikohet me të gjithë nxënësit që të jenë aktivë me komentet e tyre. Komentet jepen nga mësimdhënësja me gojë dhe me shkrim si: mirë, bukur, të lumtë, ndrysho përfundimin; e kjo e fundit duket në mënyrë pak më të detajuar për detyrën e realizuar nga nxënësit. Mësimdhënësja përmes punimeve dhe fletoreve të nxënësve tregon se si i shkruan komentet për nxënësit të cilat i drejtohen edhe prindërve. Pra, mundohet të dëshmojë se e aplikon Vlerësimin Formues, e sidomos me nxënësit të cilët janë mesatarë dhe të dobët në mësim, me qëllimin e mirë që t’i motivojë ata për të nxënë të suksesshëm dhe mendon se e ka arritur qëllimin e saj – komunikimin me prindër përmes fletores së nxënësit.

Përmes të dhënave nga hulumtimi arrijmë të argumentojmë se me përmirësimin e Vlerësimit në shkollë do të kemi të nxënë të qëndrueshëm e cilësor, pasi në klasat ku vërehet se mësimdhënësit planifikonin dhe realizonin Vlerësimin Formues, kishte bashkëpunim mes nxënësve, ngritje të suksesit tek disa nxënës nga ata me sukses më të dobët – tek arritja në nxënës mesatarë, nga nxënës mesatarë – tek arritja në nxënës të

shkëlqyeshëm, vlerësimi nëpër fletoret e nxënësve me komente këshilluese dhe nxitëse, vlerësim të ndërsjellë mes nxënësish, mbajtja e dosjeve nga nxënësit, të vlerësuara nga mësimdhënësit me komente të ndryshme.

Pra, nga të dhënat e marra në 20 klasët e vëzhguara arrijmë t'iu përgjigjemi pyetjeve kërkimore dhe të vërtetohen hipotezat pasi te 25% e klasëve ku realizohet Vlerësimi Formues vërehet se zbatimi i kësaj forme vlerësimi ndikon pozitivisht në përmirësimin e të nxënit, të nxënit cilësor të nxënësve, të nxënit e qëndrueshëm dhe reflektim cilësor, në strukturimin e mësimdhënies, në ngritjen e cilësisë së komunikimit me prindër, ndërsa te 75% e klasëve ku aplikohet pjesërisht apo nuk aplikohet fare kjo formë vlerësimi arrihet pjesërisht që të nxënit të jetë i qëndrueshëm dhe të ketë reflektim cilësor, andaj është me rëndësi zgjerimi i aplikimit të Vlerësimit Formues edhe në klasë e shkolla të tjera.

5.4. Të dhënat nga pyetësi të paraqitura në dy nivele - nivelin e lartë dhe nivelin e ulët

Për të analizuar diferencën në mes të zbatimit të Vlerësimit Formues në klasa jemi bazuar në të dhënat e marra përmes pyetësit, duke i analizuar në dy nivele të paraqitura në tri vlera: të larta, të mesme dhe të ulëta. Kjo do të thotë se jo të gjithë mësimdhënësit e aplikojnë Vlerësimin Formues, ndërsa disa prej tyre e aplikojnë pjesërisht ose nuk e aplikojnë fare.

Referuar vlerave mesatare rezulton se:

1) Nivelin më të lartë - *mësimdhënësit e kanë të kryer trajnimin e Vlerësimit Formues, se mësimdhënësit e aplikojnë më shumë Vlerësimin Përmbledhës; mësimdhënësit e bëjnë*

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

vlerësimin me notë dhe me fjalë; mësime të tregojnë se bashkëpunimin me kolegë e bëjnë me qëllim të planifikimit dhe realizimit të planit mësimor; mësime të realizojnë si instrument vlerësimi - vlerësimin me teste, vlerësimin me gojë dhe vlerësimin përmes detyrave të shtëpisë; për marrjen e të dhënave të mjaftueshme rreth punës së nxënësve mësime të mbështeten në vlerësimin e nxënësve në mënyrë sistematike që e bëjnë çdo ditë me note; me vlerësimin që bëjnë mësime të janë të motivuar nxënës për punë; se përmes aplikimit të Vlerësimit Formues arrijnë të kuptojnë nëse nxënës e kanë kuptuar mësimin; mësime të tregojnë se komunikimi me prindër realizohet në takime individuale dhe në mbledhjet me prindër në tremujore; mësime të tregojnë se komunikimi me prindër realizohet për motivimin e nxënësve për nxënie cilësore - kanë vlera të larta

1) Nivelin më të lartë - për aplikimin e formave të ndryshme të vlerësimit dhe bashkëpunim për probleme të ndryshme me nxënës; aplikimi i Vlerësimit Formues dhe Përmbledhës në të njëjtën kohë i motivon më shumë nxënës për të mësuar; vlerësimin e punës individuale të nxënësve dhe punës në grupe; mësime të tregojnë se aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në përmirësimin e të nxënësve të nxënësve, e po ashtu edhe që nxënës të njohë shkallën e suksesit të punës së vet; mësime të tregojnë se zhvillon tek nxënës kapacitetet për vetëvlerësim; aplikimi i Vlerësimit Formues forcon motivimin e nxënësve; janë të motivuar mësime të tregojnë se në klasat e tyre e aplikojnë Vlerësimin Formues për çdo njësi mësimore; aplikimi i Vlerësimit Formues realizohet duke planifikuar kriteret e suksesit; aplikimi i formave të ndryshme të vlerësimit janë të

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

rëndësishme për nxënësit, për përmirësimin e të nxënësve; aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon pozitivisht në procesin mësimor – kanë vlera mesatare.

1) Nivelin më të lartë - bashkëpunim për të nxënësve; vlerësimin në tabelë; në komunikimin dhe bashkëpunimin me prindër; identifikon të arriturat e nxënësve; ndihmon nxënësit të përmirësohen; përkrah të kuptuarit e qëllimeve dhe kriterëve; aplikimi i Vlerësimit Formues bëhet në lëndën e gjuhës shqipe; aplikohet në lëndën e Matematikës dhe në të gjitha lëndët mësimore; e aplikojnë në disa aktivitete në orët mësimore; nxënësit arrijnë të vlerësojnë njëri tjetrin duke krahasuar punën e tyre; mësimdhënësit dhe nxënësit japin informatën kthyesë; arrijnë të kuptojnë nëse nxënësit kanë nevojë për përsëritje; ndikojnë në zhvillimin psikomotorik të nxënësve; realizohet me shkrim, përmes fletoreve të nxënësve; kryerjen me rregull të detyrave të shtëpisë; kjo formë e vlerësimit ndikon në motivimin e nxënësve për nxënie cilësore; se duhet planifikuar kriteret e suksesit për aplikimin e suksesshëm të Vlerësimit Formues dhe se ndikon në të nxënësit të qëndrueshëm të nxënësve - kanë vlera të ulëta

Bazuar në të dhënat e nivelit të lartë arrijmë të vërtetojmë të gjitha hipotezat:

- **Kanë vlera të larta** - vërejmë se nuk ka përgjigje të cilat na tregojnë se mësimdhënësit e aplikojnë vërtet Vlerësimin Formues;
- **Kanë vlera të mesme** - vërejmë se ka përgjigje të cilat na tregojnë se disa nga mësimdhënësit e planifikojnë dhe e aplikojnë pjesërisht Vlerësimin Formues, i cili sjell të nxënë të qëndrueshëm e reflektim cilësor në klasa, por që duhet të zbatohet në tërësi;

- **Kanë vlera të ulëta** - vërejmë se ka më shumë përgjigje të cilat na tregojnë se mësimmshënësit e planifikojnë dhe aplikojnë Vlerësimin Formues dhe se ndikon në të nxënëit e qëndrueshëm, reflektim cilësor, strukturim të mësimmshënies, rritjen e cilësisë së komunikimit me prindër dhe përmirësimin e të nxënëit, por janë një numër i vogël i mësimmshënësve që e zbatojnë në klasa.

2) Nivelin më të ulët - *kanë trajnimet mësimmshënës mentor dhe hap pas hapi.*

Mësimmshënësit thonë se me vlerësim kuptojnë të arriturat e nxënësve; mësimmshënësit thonë se aplikimi i Vlerësimit Formues është pjesë e planifikimit efektiv; aplikimi i kësaj forme vlerësimi është pjesë e një planifikimi efektiv; me vlerësimin e bërë janë të motivuar nxënësit dhe prindërit; mësimmshënësit thonë se nxënësit bëjnë vetëvlerësim; mësimmshënësit thonë se përmes aplikimit të Vlerësimit Formues arrijnë të kuptojnë nëse nxënësit kanë nevojë për rifreskim të lëndës; se aplikimi i formave të ndryshme të vlerësimit janë të rëndësishme për dhënien e informatave prindërve; se komunikimi me prindër realizohet përmes bisedës telefonike; se komunikimin me prindër e realizojnë për bashkëpunim mes nxënësve – kanë vlera të larta

2) Nivelin më të ulët - *aplikimi i Vlerësimi Formues, thonë se vlerësimi paraqet matjen e njohurive të nxënësit; aplikimi i Vlerësimit Formues i motivon më shumë nxënësit; aplikimi i Vlerësimit Formues aplikohet në lëndën Njeriu dhe natyra, në lëndën Edukatë qytetare; se Vlerësimi Formues aplikohet për çdo kapitull; po ashtu janë të rëndësishme për përcjelljen e shënimeve të plota të nxënësve në klasat më të larta – kanë vlera mesatare.*

2) Në nivelin më të ulët - *vlerësimi është përmbledhja e njohurive të nxënësit, është dija e nxënësit; në aplikimin e vlerësimit me notë, aplikimi i vlerësimit me fjalë, aplikimin e Vlerësimit Përmbledhës kemi vlerësimin në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit; se aplikimi i Vlerësimit Formues fokusohet në atë se si mësojnë nxënësit në lëndët e shkathtësisë, aplikohet një herë në javë, një herë në muaj, në çdo tremujor, në gjysmëvjetor, përmes librezës së nxënësit dhe testeve - kanë vlera të ulëta*

- **Kanë vlera të larta** - vërejmë se ka përgjigje të cilat na tregojnë se një numër mjaft i madh i mësimitdhënësve nuk e aplikojnë Vlerësimin Formues, pasi nuk arrijnë që të kuptojnë të arriturat e nxënësve, informimin e nxënësve dhe bashkëpunimin me prindër;

- **Kanë vlera të mesme** - vërejmë se mësimitdhënësit nuk e konsiderojnë të rëndësishme bashkëpunimin edhe me kolegë të tyre për përcjelljen e informatave për nxënësit e tyre nga klasa në klasë;

- **Kanë vlera të ulëta** - vërejmë se nuk realizohet saktë shkrimi i komenteve nxitëse dhe që nuk arrijnë të fokusohen në atë se si mësojnë nxënësit.

Arrijmë të nxjerrim konkluzion mes variablash se përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor në procesin mësimor varen nga mësimitdhënësit, se si e planifikojnë dhe realizojnë Vlerësimin Formues në klasat e tyre.

5.4. Ndërlidhja e anës teorike me të dhënat nga hulumtimi

Literatura është mjaft e rëndësishme në kontributin që jep për krijimin e të dhënave të cilat i shërbejnë hulumtimit empirik. Nga e gjithë ana teorike vërejmë se aplikimi i Vlerësimit Formues konsiderohet si pjesë e rëndësishme në procesin mësimor. Shqyrtimi i literaturës ka për qëllim trajtimin e Vlerësimit Formues nga autorë të ndryshëm, për të arritur tek qëllimi i njëjtë – ngritja e cilësisë në të nxënë për të gjithë nxënësit në nivele të ndryshme shkollimi.

Mësimdhënësit e pothuajse të të gjitha shkollave të Kosovës janë trajnuar për formën e planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Përmbledhës dhe Vlerësimit Formues, por aplikimi i kësaj të fundit reflektohet si mangësi në vendin tonë.

Fokusi kryesor i punimit përbëhet në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në aplikimin – mosaplikimin e Vlerësimit Formues në shkollë, nga puna e mësimdhënësve në shkolla, vlerësimi i njohurive të nxënësve nga ana e mësimdhënësve përmes aplikimit të një forme të vlerësimit – gjegjësisht të disa formave të vlerësimit e në veçanti Vlerësimit Formues dhe Vlerësimit Përmbledhës.

Në mënyrë që ky studim t'i shërbejë sa më mirë realizimit të qëllimit, u fokusua në mënyrë specifike në tri shkolla të ndryshme të Komunës së Gjakovës, përfshirë edhe disa hulumtime krahas këtij studimi. Në shkollën më të madhe të qytetit për nga numri i mësimdhënësve dhe nxënësve, “Zekeria Rexha” në Gjakovë, në paralagje të qytetit shkolla “Selman Riza” në Gjakovë dhe në shkollën “Zef Lush Marku” të fshatit Brekoc.

Kjo përzgjedhje e shkollave është bërë me qëllim të verifikimit të punës mësimore në klasa nga ana e mësimdhënësve për të arritur tek shkalla e rëndësisë së planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues nëpër shkolla si një vlerësim sistematik i punës së nxënësve.

Si në çdo kërkim shkencor literatura tregon rëndësinë e saj në kontributin që jep për krijimin e një baze paraprake të dhënash, të cilat i shërbejnë hulumtimit empirik.

Gjithmonë e lidhur ngushtë me qëllimin madhor të studimit, literatura e trajtuar në fokus të saj ka për qëllim njoftimin e mësimdhënësit, nxënësit, prindërve dhe gjithë pjesëmarrësve të tjerë, të përfshirë në procesin mësimor, për rëndësinë që ka planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues gjatë gjithë procesit të të nxënësve. Po ashtu, tregohet se me ndryshimin, përmirësimin dhe plotësimin e vlerësimit përmes shumë formave të vlerësimit arrihet një sukses më i madh për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e të nxënësve. “Në përgjithësi, sa më shpesh të përdoret vlerësimi dhe sa më i shumëllojshëm të jetë ai, aq më i informuar do të jetë mësimdhënësi për notat që duhet t’u vërë nxënësve” (Marsh, 2009:71), sipas të dhënave nga ana teorike, të paraqitura tek figura 1.1, bazuar në modelin e parë të Tylerit, i paraqitur në formë lineare për objektivat, për zgjedhjen e përvojave të të nxënësve, organizimin e përvojave të të nxënësve dhe në fund vlerësimi për të cilin mendon se nxënësit duhet të vlerësohen në mënyrë sistematike e të vazhdueshme pra, duke aplikuar Vlerësimin Formues.

Po ashtu, bazuar dhe tek figura 1.2, paraqitur nga Taba me anë të një analize logjike dhe të qartë për punën e dobishme të mësimdhënësve rreth procesit të të nxënësve, na tregojnë organizimin e mirëfilltë për bartjen dhe kthimin e informacioneve nga njëri veprim tek tjetri për një proces mësimor të kompletuar.

Nëse arrijmë të bëjmë një ndërlidhje të anës teorike, të marrë nga autorë të ndryshëm me të dhënat e marra nga hulumtimi, arrijmë të kuptojmë se plotësimi i objektivave të matshme për një integrim të mësimdhënies me të nxënit e nxënësve përmes ndërlidhjes së objektivave, përmbajtjes, metodave dhe vlerësimit duke i plotësuar me kriteret e suksesit dhe informatën kthyesë për nxënësit dhe prindërit, arrihet tek një planifikim dhe realizim i një procesi të suksesshëm mësimor për ngritjen e cilësisë në procesin e të nxënit.




Figura 7.1

Pra, nëse arrihet që mësimdhënësit të planifikojnë dhe realizojnë kriteret e suksesit, së bashku me nxënësit, për pritjet që duhet nxënësit t'i arrijnë brenda një orë mësimore dhe dhënien e feedbackut këshillues apo nxitës rreth të arriturave të nxënësve, do të përcjellim tek nxënësit dhe prindërit mesazhin për vështirësitë e dala apo arritjet e tyre. Nxënësit me arritje më të ulëta do të jenë më të motivuar për përmirësimin e suksesit, sepse në studimin e realizuar nga Black and William (1998) vërejmë të mirat që i përfshin aplikimi i Vlerësimit Formues. Përmes planifikimit të kriterëve të suksesit dhe dhënien e feedbackut vërehen cilësitë e veçanta të punës së nxënësve, mund të jepen këshilla dhe udhëzime për

përmirësimin e të nxënit të tyre, aftësohen nxënësit për të bërë vetëvlerësim për punën që e realizojnë, e po ashtu u ofrohet një mundësi për të shprehur informacionet e marra duke iniciuar ndërveprimin mësimdhënës - nxënës për ngritjen e cilësisë në të nxënë. (Hall & Burke, 2004)

5.5. Përfundimi për rezultatet nga analiza e të dhënave

Përmes kësaj matjeje, nga të dhënat e marra arrijmë të bëjmë të kuptueshme dhe bindëse idenë se aplikimi i Vlerësimit Formues në shkollat tona ndihmon në arritjen e një Vlerësimi Përmbledhës pa asnjë mëdyshje.

Rezultatet e këtij studimi treguan që përmes të gjitha formave të planifikuara dhe të realizuara për hulumtim duke filluar nga anketimi, intervista me drejtorë, me mësimdhënës e nxënës dhe në fund vëzhgimi në klasa u mendua dhe u arrit që të merrej informacion më i detajuar për rëndësinë e Vlerësimit Formues dhe planifikimin e realizimin e tij në shkolla. Nga analiza e gjetjeve, duke u bazuar në mbledhjen e informacioneve, por edhe analizës së rezultateve, vërehet se rezultatet e hulumtimit në përgjithësi na tregojnë:

- se pjesa më e madhe e të anketuarve nuk e planifikojnë dhe aplikojnë Vlerësimin Formues nëpër klasa;
- se mësimdhënësit, përkundër punës së palodhshme të cilën e realizojnë dhe njohurive që kanë marrë përmes trajnimit për aplikimin e Vlerësimit Formues, ende testojnë dhe gjykojnë për arritjet e nxënësve përmes Vlerësimit Përmbledhës;
- se argumentohet puna e suksesshme e disa mësimdhënësve në realizimin e matjes së njohurive të nxënësve përmes aplikimit të Vlerësimit Formues në mënyrë

sistematike dhe gjykimet që japin për një periudhë të caktuar semestrale,
gjysmëvjetor apo fundvit në disa nga klasat në të tri shkollat;

- se në të tri shkollat pjesërisht aplikohet Vlerësimi Formues;
- se në ato klasa ku vërehej qartë planifikimi i kriterëve të suksesit nga ana e
mësimdhënësve së bashku me nxënësit, thënia me gojë dhe shkrimi i komenteve
nxitëse e korrigjuese, mbajtja e dosjeve nga ana e nxënësve dhe kontrollimi i tyre
nga mësimdhënësit, vlerësimi i ndërsjellë mes nxënësve dhe vetëvlerësimi i
nxënësit:
 - suksesi i tyre ishte më i mirë,
 - nxënësit ishin më të motivuar për punë,
 - mbretëronte atmosferë bashkëpunimi e bashkëveprimi.
- se planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues në klasa sjell rezultat pozitiv në
ngritjen e cilësisë në të nxënësit e nxënësve
- se sistemi arsimor ka mundësi që të arrijë të bëjë ndryshim të suksesshëm nëse
zhvillon procese të rregullta me mësimdhënësit dhe nxënësit, duke iu përgjigjur
kërkesave të nevojshme për ndryshime në klasë e shkollë rreth planifikimit dhe
realizimit të formave të ndryshme të vlerësimit.
- se këto ndryshime mund të realizohen për të arritur një komunikim dhe
bashkëpunim me prindërit për të ndikuar në përmirësimin e të nxënësit të nxënësve si
dhe për ndryshime pozitive e të qëndrueshme.

- se me rritjen e pikave të kontaktit ndërmjet të gjithë partnerëve dhe përmes Vlerësimit Formues arrihet një kontribut i bazuar në mbështetje të nxënësve për një punë të suksesshme vlerësimi.
- në klasat ku nuk aplikohet Vlerësimi Formues mësimdhënësit arsyetohen se nuk arrijnë ta realizojnë Vlerësimin Formues në klasë, sepse kërkon kohë dhe përkushtim më të madh. Përplanifikimit të kriterëve e suksesit u nevojitet më shumë kohë, ndërsa për realizimin e tyre nuk kanë kohë të mjaftueshme, pasi ora është 40 ose 45 minuta dhe nuk mjafton. Dhënien e komenteve me gojë apo me shkrim për nxënësit dhe prindërit mësimdhënësit e kanë të vështirë ta bëjnë, qoftë nga numri i madh i nxënësve në klasë dhe koha e shkurtër për realizimin e planprogramit mësimor. Pra, nuk kanë kushte të mjaftueshme që ta realizojnë në formën e duhur.

Kërkimet në këtë studim kanë treguar se janë nxënësit ata që përfitojnë apo humbin nga pakujdesitë e shumta të cilat ndodhin gjatë planifikimit apo riplanifikimit të mundshëm në procesin mësimor.

Rezultatet e arritura mund të na ndihmojnë të arrijmë të shqyrtojmë çështjet e vlerësimit për nxënësit, duke arritur që aktualisht t'i shërbejmë një sistemi të suksesshëm të arsimit.

Aspirata jonë për këtë lloj bashkëpunimi është për të arritur të mira konkrete në zgjidhjen e suksesshme të planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues.

5.7. Rezultatet nga hulumtimet tjera krahas studimit doktoral të botuara brenda dhe jashtë shtetit

Janë bërë edhe shumë hulumtime tjera krahas këtij studimi në shkolla të ndryshme me mësimdhënës, nxënës e prindër për të arritur tek një përfundim rreth nevojës për planifikim të mirë nga ana e mësimdhënësve dhe realizimit të Vlerësimit Formues me nxënës e prindër.

- Bazuar në projektin kërkimor “Vlerësimi i drejtë i mësimdhënësve çelës i suksesit në procesin e të nxënës - Hulumtimi i Veprimit” ku vëmendje e veçantë i është kushtuar përcaktimit të qëllimit dhe kriterëve të bashku me nxënës, ku përfshihen procesi i të pyeturit, vëzhgimi, vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë në mes të nxënësve. Studimi bazohet në hipotezën: “Planifikimi i kriterëve të suksesit ndikon në arritjet e nxënësve dhe vlerësimin e drejtë të tyre”, i realizuar përmes një vëzhgimi në klasë dhe realizimin e një pyetësi me pyetje të hapura rreth aktiviteteve të mësimdhënësit në procesin e të nxënës për një vlerësim të drejtë për një arritje të suksesshme. (Buza, Vlerësimi i drejtë i mësimdhënësve çelës i suksesit në procesin e të nxënës - Hulumtimi i veprimit , 2014)

Arrijmë në përfundim se aplikimi i disa formave të vlerësimit në klasë është çelës i suksesit për një të nxënë cilësor të nxënësve si proces i identifikimit të fushave të nevojshme për përmirësimin e të nxënës të tyre të vazhdueshëm.

- Bazuar në projektin kërkimor “Format e ndryshme të vlerësimit dhe aplikimi i tyre me qëllim të ngritjes së cilësisë në mësimdhënie e nxënie” dhe duke ditur se vlerësimi është një nga hallkat kyçe për ngritjen e cilësisë në mësim, njëherit paraqet një nga sfidat e mëdha të arsimit në Kosovë, hulumtimi është bazuar në hipotezën “Format e vlerësimit

ndikojnë drejtpërdrejt në nxënie cilësore”. Qëllimi i këtij studimi është që të konstatojmë aplikimin e formave të ndryshme të vlerësimit nga ana e mësimeve nëpër shkollë. Nga rezultati i intervistës vërejmë se mësuesit para kryerjes së trajnimit “Vlerësimi për nxënie” kanë përdorur kryesisht vlerësimin me notë, u diskutua mjaft gjatë me mësuesit për faktin se edhe ata të cilët sot përdorin teknika të ndryshme të vlerësimit, qoftë Vlerësimin Formues apo Vlerësimin Përmbledhës, gjatë punës së tyre kryesisht kanë përdorur vetëm vlerësimin me notë gjatë tërë vitit shkollor. Mësuesit kanë vërejtur se sa më shumë teknika vlerësimi që kanë përdorur në klasë, ka qenë një motivim më i mirë për nxënësit që të nxisin bashkëpunimin mes tyre, të bëhen të vetëdijshëm për gabimet gjatë procesit të të nxënës dhe të arrijnë t’i përmirësojnë ato në qasje pozitive, të ngrenë vetëbesimin, të respektojnë prirjet dhe individualitetin, duke krijuar një klimë mjaft pozitive në klasë. Mësuesit theksojnë se aplikimi i Vlerësimit Formues në mënyrë të ndjeshme ka rritur bashkëpunimin me familjen, duke bërë që ata t’i marrin më saktë informacionet për ngritjen apo ngecjen e fëmijëve të tyre në mësim. Ky fakt ka ndikuar në rritjen e përgjegjësisë së prindërve për kontrollimin e vazhdueshëm të punës së fëmijës së tyre.

Arrijmë në një përfundim se mësuesi rezulton i suksesshëm nëse i njeh pikat e forta e të dobëta të nxënësit dhe arrin që përmes vlerësimit t’i motivojë ata për punë të suksesshme në klasë dhe jashtë saj. (Buza, Shala, & Mejzini, 2012)

- Bazuar në projektin kërkimor “Vlerësimi efektiv i të nxënësve përmes Vlerësimit Formues dhe bashkëpunimit në mes mësimeve dhe prindërve” është bërë hulumtim rreth ndihmës reciproke në mes mësimeve dhe prindërve për arritjen e një vlerësimi të

drejtë dhe real ndaj nxënësve. Hulumtimi është realizuar në një nga shkollat fillore dhe është mbështetur në hipotezën: “Bashkëpunimi mësimdhënës - prindër ndikon në ngritjen e cilësisë në të nxënë dhe vlerësimin e drejtë të nxënësve”. Përmes vëzhgimit në 2 klasa është arritur në përfundim se planifikimi dhe aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në rezultate të qëndrueshme e cilësore tek të nxënit e nxënësve dhe se një partneritet i qëndrueshëm dhe afatgjatë ndihmon nxënësit në ndërtimin e njohurive, shkathtësive dhe shprehive të mira. Në bazë të rezultateve arrijmë në përfundim se aplikimi i shumë formave të vlerësimit në klasë është çelës i suksesit të të nxënit cilësor të nxënësve, si proces i identifikimit të fushave të nevojshme për përmirësimin e të nxënit të tyre të vazhdueshëm. (Buza, 2014)

- Bazuar në projektin kërkimor “Informacioni kthyes (feedbacku) faktor pozitiv dhe ndikues në motivimin - rimotivimin e nxënësve”, ku synimi i këtij punimi është që të analizohet bashkëpunimi i mësimdhënësve me prindër përmes informacionit kthyes (feedbackut) gjatë realizimit të detyrave të ndryshme. Studimi bazohet në hipotezën: “Komunikimi mësimdhënës - prind përmes feedbackut ndihmon nxënësit në të nxënit cilësor”, ku instrumenti i përdorur për të mbledhur të dhëna është pyetësi i realizuar me prindër, ndërsa nga të anketuarit janë marrë të dhëna rreth faktorëve që ndikojnë në motivimin për të nxënit cilësor të nxënësve. Mbështetur në rezultatet e marra përmes hulumtimit me prindër, arrijmë tek një përfundim se komunikimi në mes mësimdhënësve dhe prindërve realizohet sa herë që prindërit kanë nevojë, ndërsa për informacionin kthyes prindërit mendojnë se komentet e mësimdhënësve janë motivuese në përmirësimin e suksesit të fëmijëve. Ky studim ka ndihmuar në vërtetimin e hipotezës se motivimi – rimotivimi i

nxënësve luan një rol të rëndësishëm në shkollë tek të nxënit cilësor të nxënësve përmes shkrimit të komenteve nga ana e mësimitdhënësve përmes informacionit kthyes (feedbackut). (Buza, Informacioni kthyes (feedbacku) faktor pozitiv dhe ndikues në motivimin - rimotivimin e nxënësve, 2015)

- Bazuar në projektin kërkimor “Motivimi i nxënësve për të nxënë përmes aplikimit të Vlerësimit Formues” i cili bazohet në hipotezën “Aplikimi i Vlerësimit Formues në shkollë nga ana e mësimitdhënësve ndikon drejtpërdrejt në motivimin e nxënësve, shkallës e arritjes së suksesit për nxënie cilësore e të qëndrueshme”, arrijmë në një përfundim se arsimi është çelësi i zhvillimit të një vendi dhe se asnjë vend nuk mund të funksionojë pa të, prandaj janë shumë me vend fjalët e thëna nga i madhi Nelson Mandela, i cili ka thënë: “Arsimi është arma më e fuqishme të cilën mund ta përdorni për ta ndryshuar gjithë botën”.²¹

Punimi është bazuar në plotësimin e pyetësorit nga ana e mësimitdhënësve rreth motivimit të nxënësve që bëjnë në klasat e tyre. Nga të dhënat e marra arrijmë në përfundim se aplikimi i Vlerësimit Formues përmes informatës kthyes ndikon në njohjen e arritjes së nxënësve, motivimin e drejtpërdrejtë të nxënësve për përmirësimin e të nxënit cilësor, si dhe bashkëpunimit me prindër për përmirësimin e arritjes së nxënësve. (Buza, Motivimi i nxënësve për të nxënë përmes aplikimit të Vlerësimit Formues, 2015)

- Bazuar në projektin kërkimor “Marrja e informacioneve të nevojshme për nxënësit përmes Vlerësimit Formues dhe ndikimi i saj në të nxënit cilësor”, i cili bazohet në hipotezën: "Aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon në kontrollimin dhe përmirësimin e të nxënit të nxënësve ". Ky studim synon të ofrojë një analizë rreth aplikimit të Vlerësimit

²¹Citim i Nelson Mendelës; marrë më 11 maj 2015 nga:
(<http://www.brainyquote.com/quotes/quotes/n/nelsonmand157855.html>)


Formues nga ana e mësimeve në shkollë, përvetësimin dhe përmirësimin e të nxënësit nga nxënësit si dhe bashkëpunimin me familjen. Është bazuar në intervista me mësime në dy shkollë, ku analizohet puna e tyre përmes formave të vlerësimit që realizojnë në klasë me nxënësit. Prandaj, edhe pse flitet e punohet mjaft për ndryshime në përputhje me kërkesat e shekullit 21, ende është e nevojshme të bëhen ndryshime e plotësime në shkollë për t'u ngritur niveli arsimor i mësimeve dhe nxënësve. Nga hulumtimi i bërë arrijmë të nxjerrim përfundim se aplikimi i sa më shumë formave të ndryshme të vlerësimit ndikon në plotësimin e zbrastërave të mundshme që sjell njëri apo tjetri vlerësim, lehtëson punën e mësimeve, evidenton punën e nxënësit dhe ndihmon në raportimin e punës së tyre tek të tjerët, e në veçanti tek prindërit. Nga rezultatet e arritura përmes të dhënave nxirret një dëshmi se në shkollë ka nevojë për ndryshime të arritshme në procesin mësimor, pra, planifikimin dhe aplikimin e Vlerësimit Formues nga ana e mësimeve, në mënyrë që nxënësit të arrijnë rezultate të mira përmes mësimit të mirë dhe vlerësimit sistematik. (Buza, Marija e informacioneve të nevojshme për nxënësit përmes Vlerësimit Formues dhe ndikimi i saj në të nxënësit cilësor, 2015)

- Bazuar në projektin kërkimor “Përfshirja e prindërve në shkollë ndihmon në menaxhimin e punës në klasë”, theksohet se ky studim hulumton qëndrimin, bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në mes shkollës dhe familjes përmes Vlerësimit Formues, i cili u siguron nxënësve një feedback për përpunimin - ngecjen e tyre, i motivon ata për një të nxënë cilësor, i vlerëson anët e forta të nxënësve duke i orientuar në zhvillimin e tyre. Studimi bazohet në hipotezën: “Komunikimi me prindër realizohet kryesisht për çështjen e

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues

vlerësimit përmbledhës në takimet e organizuara nga shkolla”, marrja e informacioneve është realizuar përmes anketimit lidhur me bashkëpunimin me prindër në periudha të ndryshme gjatë vitit shkollor.

Grafiku 5. Informacionet e mësimeve për Vlerësimin Formues



Grafiku 5

(Buza, Edukatio, 2014)

Këto të dhëna bazuar tek grafiku 6 na tregojnë se aplikimi i Vlerësimit Formues na dërgon në njohjen e nxënësve, ngritje të cilësisë së të nxënësve të tyre përmes bashkëpunimit dhe bashkëpunimit me mësimeve të tjerë dhe me prindërit. Nga rezultatet arrijmë tek një përfundim se komunikimi në mes mësimeve dhe prindërve realizohet vetëm në takimet e organizuara nga shkolla në tremujore, gjysmëvjetor dhe përfundim të vitit shkollor. Nga të gjitha të dhënat e marra përmes pyetësorit arrijmë tek një rezultat se aplikimi i Vlerësimit Formues duhet arritur që të planifikohet dhe realizohet nga ana e

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

mësimdhënësve në të gjitha klasat, për arritjen e një vlerësimi të suksesshëm përmes formave të ndryshme. (Buza, Përfshirja e prindërve në shkollë ndihmon në menaxhimin e punëve në klasë, 2014)

Nga studimet e bëra krahas studimit doctoral, me mësimdhënës e prindër të disa shkollave përmes anketimit, intervistës dhe vëzhgimeve në klasa arrijmë tek rezultatet e studimeve të cilat përfaqësojnë qëndrimet se planifikimi dhe realizimi i Vlerësimit Formues dhe Vlerësimit Përmbledhës janë pjesë, sa e rëndësishme aq edhe e ndjeshme, në procesin mësimor në ngritjen e cilësisë në të nxënë, por të cilat forma aplikohen pjesërisht në procesin mësimor.

Kapitulli VI. Konkludime dhe rekomandime

Bazuar në nevojat që shfaqen nga viti në vit, është me rëndësi të planifikohen strategji për ndryshime të reja të sistemit arsimor, andaj mund të themi se shkolla duhet t'u shërbejë nevojave të shoqërisë dhe të mbështetemi në fjalët e rilindësit Ismail Qemali, i cili ka thënë: “Për të shkuar përpara në rrugën e qytetërimit, kemi nevojë për dituri; dhe për dituri kemi nevojë për mësim.” (Rexhepagiq, Sami Frashëri dhe Pedagogjia e Rilindjes Kombëtare, 2005:125)

Andaj, institucionet e arsimit duhet të punojnë rreth transformimeve të nevojshme në mënyrë që çdo vendim për ndryshime të koordinohet dhe planifikohet nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor, me qëllim të përfitimit pozitiv për të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces.

Në përfundim të këtij studimi rikujtojmë së fokusi qendror i studimit ishte evidentimi i problematikave në procesin mësimor, e në veçanti vështirësitë në procesin e vlerësimit.

Ky studim thekson rëndësinë që kanë hulumtimet e këtij lloji për të treguar punën e palodhshme të mësimdhënësve në shkollë, që përmes formave të ndryshme të arrijnë tek një bashkëpunim i suksesshëm me nxënës e prindër për një të nxënë të qëndrueshëm e cilësor.

Rezultatet e studimit të mbledhura përmes anketimit me mësimdhënës, intervistave me drejtorë, nxënës dhe mësimdhënës, e po ashtu edhe përmes vëzhgimeve të realizuara në klasë u përmbushën me pritshmëritë e rezultuara prej literaturës së shqyrtuar. Studimi thekson se Vlerësimi Formues duhet të planifikohet dhe realizohet në klasë - me qëllim të lehtësimit të punës së mësimdhënësit, motivimit të nxënësve - me qëllim të eliminimit të

dobësive të nxënësve, vëzhgimit të nxënësve në mënyrë sistematike rreth rënies apo përparimit në mësim.

Në këtë punim të doktoraturës është shfrytëzuar një literaturë e bollshme, përvoja e punës me nxënës, fokusimi në objektin e hulumtimit dhe zgjedhja e metodave për realizimin dhe analizën e rezultateve kërkimore - shkencore të hulumtimit. Nga të dhënat arrihet të vërtetohet ana shumëdimensionale e vlerësimit të nxënësve, gjë që ndikojnë në procesin e të nxënësve në përgjithësi.

Studimi i literaturës dhe të dhënat e mbledhura përmes metodës sasiore dhe cilësore theksojnë vëmendjen që duhet t'i kushtohet rezultateve të studimit të mbledhura përmes anketimit me mësimdhënës, intervistave me drejtorë, intervistave në fokus grupe e gjysmë të strukturuar me nxënës, intervistave individuale me mësimdhënës dhe vëzhgimit në klasa. Këto të dhëna të mbledhura theksojnë vëmendjen që i është kushtuar vlerësimit e në veçanti Vlerësimit Formues, si pjesë e rëndësishme e procesit mësimor.

Bazuar në të dhënat e marra përmes intervistës me drejtorët e shkollave kuptojmë se në shkollat e tyre Vlerësimi Formues aplikohet deri diku nga ana e mësimdhënësve dhe se nuk është realizuar ndonjë diskutim i veçantë nëse aplikimi i kësaj forme të vlerësimit i motivon nxënësit për një të nxënë të qëndrueshëm dhe cilësor.

Bazuar në të dhënat e marra përmes intervistës me nxënësit kuptojmë se kryesisht vlerësohen me notë. Nxënësit tregojnë se komentet me gojë apo me shkrim të cilat i marrin nga ana e mësimdhënësve u pëlqejnë, sepse i orientojnë në përmirësimin e të nxënësve të tyre, edhe pse i marrin shumë të shkurtra dhe aplikohen shumë rrallë nga mësimdhënësit e tyre.

Ndërsa komunikimi me prindër realizohet përmes komunikimit me telefon apo vizitave të prindërve në shkollë, pasi mungon shkrimi i komenteve përmes feedbackut nga të dy palët. Bazuar në të dhënat e marra nga mësimdhënësit përmes pyetësorit dhe intervistës, po ashtu plotësuar nga informacionet e drejtorëve dhe nxënësve, themi se mësimdhënësit i japin komentet kryesisht të shkurtra dhe nuk janë shumë orientuese e motivuese për nxënësit dhe informuese për prindërit rreth rezultatit të fëmijëve të tyre. Vërehet se mungesa e bashkëpunimit me prindër përmes feedbackut në fletoren e nxënësit ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e të nxënit të nxënësve.

Mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimit mes mësimdhënësit, nxënësve dhe prindërve ndikon drejtpërdrejt në cilësi më të dobët të mësimdhënies dhe të nxënit të qëndrueshëm e cilësor të nxënësve.

Nga ky studim arrihet në konkludim se Vlerësimi Formues aktualisht realizohet pjesërisht nga ana e mësimdhënësve në shkollë. Përsa i përket mos aplikimit të kësaj forme të vlerësimit, mësimdhënësit arsyetojnë se është e vështirë që të planifikohet dhe aplikohet Vlerësimi Formues në klasë, pasi kërkon më shumë kohë dhe një përkushtim më të madh. Duke llogaritur orën mësimore e cila nuk është e mjaftueshme për përsëritje të njësive paraprake, kontrollim të detyrave të shtëpisë, shpjegim të njësive së re mësimore dhe numrin e madh të nxënësve në klasë, mësimdhënësit thonë se është i pamundur aplikimi edhe i Vlerësimit Formues. Po ashtu, ata theksojnë se planifikimi dhe shkrimi i kritereve të suksesit, realizimi i komenteve me gojë apo me shkrim për secilin nxënëës është i pamundur, pasi nuk mbetet shumë kohë për realizimin e tyre brenda orës mësimore.

Për t'i kontribuar pozitivisht procesit të të nxënit në një shkollë të suksesshme, është e nevojshme të realizohet një vlerësim sistematik përmes formave të ndryshme të vlerësimit në procesin e të nxënit të nxënësve si faktorë të rëndësishëm e të domosdoshëm në procesin e të nxënit, e në veçanti planifikimi dhe realizimi i Vlerësimit Formues.

Qëllimi i këtij hulumtimi trajton çështjen thelbësore në të tri shkollat e Komunës së Gjakovës. Në përgjithësi, nga rezultatet e arritura në këtë studim, përmes të dhënave arrijmë të sugjerojmë se për ndryshime cilësore të sistemit të arsimit është e nevojshme të arrihet fuqizimi i mësimdhënies me planifikim dhe aplikim të Vlerësimit Formues, i cili ndikon në rezultate të qëndrueshme e cilësore tek të nxënit e nxënësve. Të gjithë ata që janë përfshirë në krijimin e kushteve më të përshtatshme për mësimdhënie e të nxënë të suksesshëm, duke u nisur nga institucionet e larta arsimore - Ministria së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjakovë, shkollat, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe anëtarët tjerë kontribues të komunitetit – kanë përgjegjësi të madhe për përmirësimin në vazhdimësi të procesit të të nxënit. E gjithë kjo mund të arrihet përmes planifikimit e realizimit edhe të Vlerësimit Formues si pjesë e rëndësishme dhe delikate për një arsim cilësor.

Është e nevojshme të merret çdo hap pozitiv për uljen e rrethanave negative me të cilat përballen nxënësit dhe mësimdhënësit sot, në mënyrë që të arrihet një ngritje e cilësisë së suksesit të përgjithshëm të nxënësve. Duhet të tregohet kujdes për të ndikuar në mendimet dhe qëndrimet e të gjitha palëve të interesuara.

Prindërit, si faktorë të rëndësishëm në procesin e të nxënit, duhet të motivohen nga ana e mësimdhënësve përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit, që të jenë sa më afër

shkollës në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore, me qëllim të përparimit të fëmijëve të tyre - nxënës.

Prindërit dhe mësime dhënësit, duke qenë shembull i mirë, ndikojnë dhe zhvillojnë tek fëmijët e tyre shprehjet e punës, vetëbesimin dhe argumentimin e punës, që përmes matjeve do të arrijmë të bëjmë të kuptueshme dhe bindëse idenë se aplikimi i Vlerësimit Formues në shkollat tona ndihmon në arritjen e një Vlerësimi Përmbledhës pa asnjë mëdyshje.

Jo çdo herë vlerësohet qëndrimi i prindërve ndaj vlerësimit të punës së mësime dhënësit, me arsyetimin se prindërit nuk e njohin mirë fushën e mësime dhënies, andaj nuk dinë të vlerësojnë nëse mësime dhënësit bëjnë punën e duhur me fëmijët e tyre. Prandaj, shkolla është përgjegjëse për mbështetjen dhe angazhimin e prindërve për një plan konkret veprimi në lidhjen mes shkollës dhe familjes, duke funksionuar si partnerë përmes një bashkëpunimi reciprok për një zhvillim të efektshëm të shkathtësive e shprehive tek fëmijët për zhvillimin e aftësive krijuese dhe të qëndrueshme.

Ky studim jep një hap të parë, por të nevojshëm për të kuptuar se si Vlerësimi Formues duhet të planifikohet dhe aplikohet në arsim në të gjitha lëndët mësimore, në mënyrë sistematike, duke u mirëpritur nga institucionet arsimore.

Pa dyshim që ky studim u përzgjedh ngase është e nevojshme që të bëhen ndryshime të nevojshme në procesin e të nxënës, duke i kontribuar tejkalimit të vështirësive të mundshme në këtë proces.

Qëllimi i këtij studimi është lehtësimi i punës së mësime dhënësit për gjetjen e dobësive të nxënësve, duke i angazhuar ata rreth përparimit, përmes eliminimit të gabimeve, në

mënyrë graduale. Po ashtu, arrihet të bëhet informimi i prindërve në mënyrë sistematike edhe për suksesin, gjegjësisht mossuksesin e nxënësve.

Studimi arriti në përfundimin se vlerësimi i nxënësve në mënyrë sistematike, përmes Vlerësimit Formues si pjesë e pandarë e procesit të të nxënës, duhet të planifikohet e zbatohet në të gjitha shkollat, për t'i kontribuar pozitivisht ngritjes së cilësisë në të nxënës e nxënësve gjatë gjithë procesit mësimor.

Bazuar në shqyrtimin e literatures, siç theksojnë studimet e ndryshme, dhe interpretimit të rezultatit nga ky studim, arrijmë në përfundimin se planifikimi dhe aplikimi i vlerësimit në klasë me të gjithë nxënësit, duke filluar nga ata me sukses më të dobët, me sukses mesatar dhe nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm duhet të jetë motivues për të nxënë të qëndrueshëm dhe cilësor, përfshirë edhe Vlerësimin Formues.

Pra, detyrë parësore e shkollës dhe mësimdhënësve mbetet që të punojnë drejt ndryshimeve, me qëllim që të aplikohen forma të ndryshme të vlerësimit, përfshirë Vlerësimin Formues në klasë, për të arritur orientimin e nxënësve në nxitjen e tyre rreth përmirësimit pozitiv në marrjen e diturive të ndryshme gjatë të nxënës të tyre, të cilat na çojnë në rezultate sa më të mira.

6.1 Rekomandime

Bazuar në analizën e bërë, arrijmë të kuptojmë se nevojitet angazhim dhe përkushtim më i madh nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor, me qëllim të arritjes së një zhvillimi të mirë të sistemit arsimor. Prandaj, arrijmë të paraqesim rekomandimet e mëposhtme:

6.1.1. Rekomandime për MASHT

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë t’i kushtojë kujdes planifikimit dhe realizimit të vlerësimit, duke i kushtuar kujdes të veçantë planifikimit dhe realizimit të Vlerësimit Formues në planet dhe programet mësimore. Është me rëndësi që të gjithë mësimdhënësve t’iu ofrojë mundësi që të përfundojnë trajnimin për “Vlerësimin për nxënie”, për ta planifikuar dhe aplikuar në procesin mësimor. Në mënyrë sistematike të plotësohen strategjitë për Vlerësimin Formues, duke kontribuar në vetëdijësimin e mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve që të jenë aktivë në procesin e të nxënit, me qëllim që të arrijnë të bëjnë ndryshime pozitive në ngritjen e cilësisë në të nxënit e qëndrueshëm dhe përmirësimin e të arriturave të nxënësve.

Një gjë me rëndësi që duhet organizuar nga MASHT-i është ndërtimi i standardeve të reja për fushën e vlerësimit – në veçanti për Vlerësimin Formues duke arritur që të krijohen politika mësimore të përshtatshme për mësimdhënësin – nxënësin, përfshirë edhe prindërit, për ngritjen e cilësisë në procesin e të nxënit.

6.1.2. Rekomandime për shkollën

Të planifikohet vlerësimi nga ana e mësimeve në disa forma që në fillim të vitit shkollor, në mënyrë që t'i jepet përparësi të mësuarit cilësor, e jo të mësuarit sasior. Të arrihet të bëhet një ndërlidhje e suksesshme gjatë procesit mësimor ndërmjet mësimeve, mësimit dhe vlerësimit përmes identifikimit të karakteristikave kryesore të aplikimit të Vlerësimit Formues.

Të koordinojë planifikimin dhe realizimin e vlerësimit nëpër shkolla, përfshirë Vlerësimin Formues në përputhje me Standardet për Vlerësim, duke arritur të bëhet shqyrtimi i metodave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e një rezultati sa më të mirë në procesin mësimor.

Për të ndihmuar dhe kontrolluar punën gjatë procesit të të nxënësve duhet t'i kushtohet kujdes dhe një përkushtim më i madh kontrollimit rreth planifikimit të kritereve të suksesit nga ana e mësimeve.

Për të rritur produktivitetin në arritjet e nxënësve, është me rëndësi të vështrohen ngjashmëritë dhe dallimet mes Vlerësimit Formues dhe Vlerësimit Përmbledhës, me qëllim të arritjes së plotësimi njëri – tjetrit.

6.1.3. Rekomandime për mësimeve

Mësimeve të bëjnë kontrollimin e parashikimeve të nxënësve dhe të përfshijnë në mësim të gjithë nxënësit, që të krijojnë një raport partneriteti me njëri – tjetrin me qëllim që të arrihen të bëhen ndryshime dhe lehtësime, për arritjen e ndryshimeve pozitive të punës në klasë të tyre. Të arrijë komunikim pozitiv me nxënësit, për të parë reagimet e tyre

rreth ndërlidhjes së informacioneve të mëparshme me informacionet e reja, për identifikimin e arritjes së përparësive dhe plotësimit të mangësive në të nxënësit e nxënësve. Roli i tyre mund të jetë si një vëzhgues i mirë gjatë orës mësimore për punën e nxënësit duke analizuar punën e secilit nxënës në vazhdimësi, me qëllim që t'u ofrojnë nxënësve mundësi të dytë për përmirësimin e të nxënësit dhe ngritjes së suksesit përmes planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues në mënyrë sistematike.

Të zbatojnë në praktikë disa forma vlerësimi gjatë punës në klasë, përfshirë Vlerësimin Formues, duke realizuar për nxënësit sqarim, plotësim, orientim ose riorientim rreth të nxënësit të tyre, duke i inkurajuar për punë të pavarur dhe kërkimore.

Të merret me shumë gjëra në të njëjtën kohë – planifikim, kontrollim dhe realizim të procesit mësimor dhe të arrijë në identifikimin e fushave ku nxënësit kanë pengesa dhe të përqendrohen në tejkalimin e tyre sa më të shpejtë.

Mësimdhënësi të jetë menaxhues i mirë dhe lehtësues i orës mësimore, duke i bërë nxënësit eksplorues dhe përgjegjës në punën e tyre mësimore që të shpjegojë dhe t'i vlerësojë ata duke u bazuar në aftësitë e nxënësve dhe duke qenë bindës si për prindërit ashtu edhe nxënësit për vlerësimin të cilin e ka realizuar.

Një pikë e rëndësishme në arritjen e suksesit është që mësimdhënësit të vlerësojnë duke u bazuar në kriteret e suksesit të planifikuar së bashku me nxënësit dhe t'u japin feedbackun i cili ndihmon nxënësit rreth përmirësimit të të nxënësit, duke i njoftuar për hapat në vazhdim. Feedbacku të jetë thënë me gojë apo i shkruar në fletoren e nxënësit në formën nxitëse apo këshilluese, për korrigjimin e gabimit gjatë punës në shkollë, të mos jetë kritik.

Gjithashtu është me interes për ngritjen e suksesit të nxënësit që mësimitdhënësit të tregojnë interesim për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve mësimore në klasë dhe jashtë saj.

6.1.4. Rekomandime për prindër

Prindërit duhet të jenë të vetëdijshëm për bashkëpunimin që duhet të bëjnë me shkollën rreth të nxënës të fëmijëve të tyre duke qenë më aktivë dhe përmes lidhjes me mësimitdhënësit u ofrojnë paranojohuri për fëmijët e tyre, me qëllim të njohjes me të shpejtë të nxënësit nga ana e mësimitdhënëseve. Të marrin pjesë në hartimin dhe vlerësimin e dosjeve, punimeve, hulumtimeve, aktiviteteve të fëmijëve të tyre duke u dhënë fëmijëve sqarime plotësuese.

Të jenë menaxhues dhe lehtësues të punës së fëmijëve, duke i bërë ata eksplorues dhe përgjegjës në punën e tyre mësimore, duke i nxitur fëmijët përmes komenteve që të merren më shumë me aktivitete të ndryshme për ngritjen e cilësisë në të nxënë si: ushtrime në të lexuar me theks dhe rrjedhshmëri të kuptueshme, zgjidhje logjike të detyrave, si dhe aktivitete plotësuese, duke arritur t'i kontrollojnë me përgjegjësi. Të nxisin fëmijët që të jenë të përgjegjshëm për moshën përkatëse, duke qenë të pavarur në kryerjen e detyrave dhe të kërkojnë nga mësimitdhënësit vlerësim sistematik për fëmijët e tyre me fjalë, si dhe me notë.

Të kërkojnë nga mësimitdhënësi i fëmijës së tyre më shpesh shkrime të sakta në fletore për të kuptuar ecurinë e punës së fëmijës, qoftë në ngecjen apo përparimin e tij. Të lexohen komentet e marra me shkrim nga ana e mësimitdhënëseve dhe t'iu përgjigjen rreth

informacionit të marrë përmes komenteve, po ashtu me shkrim si formë e tërthortë e komunikimit dhe bashkëpunimit.

6.1.5. Rekomandime për nxënë

Roli dhe detyra e nxënësve është që të nxiten të jenë të përgjegjshëm sipas moshës përkatëse dhe të jenë të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre, përmes angazhimit në përmirësimin e të nxënit të tyre apo edhe të shokëve, duke qenë vetëkritikë dhe kreativë në punën e tyre.

Të kërkojnë të planifikojnë kriteret e suksesit së bashku me mësimmshënësën e tyre dhe të plotësojnë ato kriteretë planifikuar duke i specifikuar se janë të rëndësishme për ngritjen e cilësisë në të nxënë.

Një hap tjetër për një të nxënë të qëndrueshëm është që nxënësit të përcjellin përparimin vetanak dhe të vetëplanifikojnë se çfarë të bëjnë më tutje, të arrijnë të bëjnë vlerësim dhe vetëvlerësim në mënyrë sistematike, e po ashtu të ndërveprojnë nxënësit mes vete duke qenë në gjendje të bëjnë vlerësim të ndërsjellë mes tyre.

Të jenë të gatshëm që të marrin parasysh komentet e mësimmshënësve dhe prindërve për t'i përmirësuar ato, duke kërkuar sqarime plotësuese për arritjen e një suksesi të plotë. Po ashtu të reflektojnë për punën e tyre duke plotësuar portfoliot me punimet e nevojshme për lëndë të ndryshme mësimore, duke arritur të bëjnë vlerësimin e punës së tyre dhe të mësojnë përmes gabimeve.

Prandaj, kërkime të mëtejshme duhet të ndërmerren për të shqyrtuar mundësitë e planifikimit dhe aplikimit të Vlerësimit Formues nga ana e mësimmshënësve për konceptet e

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

menaxhimit të nxitjes në të nxënit cilësor të nxënësve të motivuar nga ana e
mësimdhënësit.

Bibliografia

- Andrade, L., Heidi & Cizek, J., Gregory. (2010). *Handbook of Formative Assessment*. New York: Routledge.
- Bell, Beverly & Cowie, Bronwen. (2002). *Formative Assessment and Science Education*. New York: Kluwer Academic Publishers.
- Fisher, D., & Frey, N. (2007). *Checking for understanding*. Alexandria, Virginia USA: ASCD.
- Frey, Nancy & Fisher, Douglas. (2011). *The Formative Assessment Action Plan*. USA: ASCD.
- Hyseni, H., Mita, N., Salihaj, J. & Pupovci, D. (2003). *Qeverisja dhe udhëheqja në arsim*. Prishtinë: KEC.
- Mac Naughton, G., & Hughes, P. (2009). *Doing Action Research in Early Childhood Studies*. New York - USA: Open University Press.
- Pasku, V., Peshkatari, M., & Muça, Sh. (2005). *Manual Inspektimi i Plotë i Shkollës - Për inspektorët, drejtuesit e shkollave dhe mësuesit në arsimin parauniversitar*. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe organizatës "Save the Children", Programi për Shqipërinë.
- Rot, Nikolla & Radonjiq, Slavoljub. (1983). *Psikologjia*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Autonome të Kosovës.
- Shermis, D., Mark & Di Vesta, J., Francis. (2011). *Classroom Assessment in action*. United Kingdom: Rowman & Littlefield Publishers.
- William, D., Lee, C., Harrison, Ch., & Black, P. (2004). Teachers developing assessment for learning: impact on student achievement. *Assessment in Education: Principles, Policy & Practice*, 49-65.
- Abdiu, N. (2010). *Mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939)*. Tiranë - Shqipëri: UFO University Press.
- Bojaxhi, A. (2004). *Disiplina në klasën mësimore*. Tiranë: Toena.
- Bojaxhi, A. (2004). *Prindi, mësuesi më i parë dhe më jetëgjatë i fëmijës*. Tiranë - Shqipëri: TOENA.
- Bojaxhi, A. (2009). *Përgatitja e fëmijës dhe shkollimi*. Tiranë - Shqipëri: TOENA.
- Brada, R. (2010). *Didaktika kibernetike*. Prishtinë: Dukagjini.
- Braid, J.-A. (2012). Beliefs and practice in teacher assessment. *Assessment in Education: Principles, Policy & Practice*, 37-41.
- Brookhart, S. M. (2008). Feedback That Fits. *Informative assessment*, 54-59.
- Buza, V. (2014). Përfshirja e prindërve në shkollë ndihmon në menaxhimin e punëve në klasë. *Edukatio 4/2*, 85-91.
- Buza, V. (2014). Vlerësimi efektiv i të nxënësve përmes Vlerësimit Formues dhe bashkëpunimit në mes mësimeve dhe prindërve. *New Challenges and Solutions in Teaching and Coaching and Education Through Sport* (p. 24). Szombathely/Hungary: Foundation and Savaria University Press.
- Buza, V. (2014). Vlerësimi i drejtë i mësimeve çelës i suksesit në procesin e të nxënësve - Hulumtimi i veprimtari. *New Perspectives in Science Education* (p. 324). Florence/Italy: libreriauniversitaria.it edizioni.

- Buza, V. (2015). Informacioni kthyes (feedbacku) faktorë pozitiv dhe ndikues në motivimin - rimotivimin e nxënësve. *EUROPEAN ACADEMIC RESEARCH*, 8134-8147.
- Buza, V. (2015). Marrja e informacioneve të nevojshme për nxënësit përmes Vlerësimit Formues dhe ndikimi i saj në të nxënësit cilësor. *International Journal of Humanities Social Sciences and Education (IJHSSE)*, 33-38.
- Buza, V. (2015). Motivimi i nxënësve për të nxënë përmes aplikimit të Vlerësimit Formues. *Academic Journal of Research and Reflection in Educational, Social and Communication Sciences*, 1-9.
- Buza, V., Shala, F., Rozafa & Mejzini, M. (2012). Format e ndryshme të vlerësimit dhe aplikimi i tyre me qëllim të ngritjes së cilësisë në mësimdhënie e nxënie. *Towards future sustainable development* (p. 127). Shkodër/Albania: University of Shkodra "Luigj Gurakuqi".
- Callahan, C. M. (2006). *Assessment in the Classroom: The Key to Good Instruction*. USA: Prufrock Press.
- Crystal, D. (2000). *Cambrige Encyclopedia*. United Kingdom.
- Curriculum, N. I. (2009). *Assessment for Learning A practical guide*. Northern Ireland: CCEA.
- Demiraj, V. (2000). Planifikimi dhe drejtuesi. *Administrimi & Menaxhimi i Arsimit (Numri 1)*, 97-117.
- Dewey, J. (2003). *Shkolla dhe shoqëria*. Tiranë: Plejad.
- Driscoll, Amy & Wood, Swarup. (2007). *Developing outcomes-based assessment for learner-centered education*. USA.
- Ecclestone, K. (2002). *Learning Autonomy in Post-16 Education*. London and New York: Routledge Falmer.
- Ecclestone, K., Davies, J., Derrick, J. & Gawn, J. (2010). *Transforming Formative Assessment in Lifelong Learning*. New York: Open University Press.
- Eco, U. (2006). *Si shkruhet një punim diplome*. Tiranë - Shqipëri: Dituria.
- Education, M. o. (October 2010). *is and Why It is Important in Classroom Situation*. Eritrea - Ministry of Information.
- Emërllahu, D. (1998). *Bazat e Metodikës së punës Edukative*. Prishtinë: Fakulteti i Mësuesisë i Universitetit të Prishtinës.
- Emërllahu, D. (2001). *Edukata estetike*. Prishtinë: Këshilli i Mësuesisë i Universitetit të Prishtinës.
- Erazmi,. (2008). *Mendimtarët për edukimin - Visari i pedagogjisë botërore*. Tiranë - Shqipëri: Plejad.
- Firestone, A., William, Schorr, Y., Roberta & Monfils, F., Lora. (2004). *The Ambiguity of Teaching to the Test*. New Jersey: Lawrence Erlbaum Associates.
- Fullan, M. (2001). *Kuptimi i Ri i Ndryshimit në Arsim*. Tiranë: SOROS.
- Fullan, M. (2002). *Forcat e ndryshimit*. Tiranë: SOROS.
- Fullan, M. (2005). *Fundamental change - International Handbook of Educational Change*. Netherlands: Springer.
- Garo, S. (2002). *Sfidat e mësimdhënies - metoda, strategji, teknika dhe këshilla praktike për mësuesit fillestarë*. Tiranë: Erik .

- Greenstein, L. (2010). *What teachers really need to know about Formative assessment*. United States: Association for Supervision&Curriculum Development.
- Hall, Kathy & M. Burke, M., Winifred. (2004). *Making Formative Assessment Work - Effective Practice in the Primary*. England: Open University Press.
- Hall, N. J. (2003). *How to help your child succeed at school*. London: Great Britain.
- Hamm, Mary & Adam, Dennis. (2009). *Activating assessment for all students - Innovative Activities, Lesson Plans and Informative Assessment*. United Kingdom: Rowman & Littlefield Education.
- Hayes, D. (2009). *Primary Teaching Today*. New York - USA: Routledge.
- Hopkins, D. (2002). *A teacher's guide to classroom research*. United Kingdom: Open University Press.
- Hoy, K., Wajne & G. Miskel, G., Cecil. (2005). *Educational Administration - Theory, Research, and Practice*. New York - USA: Mc Graw Hill.
- <http://etec.cltl.ubc.ca/510wiki/EvaluationConstructivistLearning>. (2012). *Evaluation Constructivist Learning*. wikipedia.
- Innovation, C. f. (2005). *Formative Assessment Improving learning in Secondary classrooms*. Paris - France: OECD.
- Irons, A. (2007). *Enhancing Learning through Formative Assessment and Feedback*. London&New York: Routledge.
- Irons, A. (2008). *Enhancing Learning through Formative Assessment and Feedback*. USA - Canada: Routledge.
- Islami, H. V. (2012). *Teknologjia mësimore dhe të menduarit kritik*. Prishtinë: Libri shkollor.
- J.S. Brubacher. (2000). *Pedagogët e mëdhenj*. Tiranë - Shqipëri: Toena.
- Kadriu, M. (2012). Zhvillimi i reformave në sistemin e vlerësimit. *Përmirësimi i të nxënësve nëpërmjet vlerësimit*, 11.
- Kaza, N. (2009). *Motivimi dhe mësimdhënia*. Tiranë: GEER.
- Keeley, P. (2008). *Science formative assessment: 75 practical strategies for linking assessment, instruction and learning*. USA: Corwin Press.
- Khandker, R., Shahidur, Koolwal, B., Gayatri & Samad, A., Hussain. (2010). *Handbook on Impact Evaluation - Quantitative Methods and Practices*. Washington: The World Bank.
- Klotz, Audie & Prakash, Deepa. (2008). *Qualitative Methods in International Relations*. New York: Palgrave Macmillan.
- Kocani, A. (2006). *Metodat e Kërkimit Sociologjik*. Tiranë - Shqipëri: Universiteti UFO.
- Kocani, A. (2008). *Udhëzues për Përdorimin e Paketës Statistikore për Shkencat Sociale (SPSS)*. Tiranë: Fshebor.
- Kocani, A. (2009). *Metodat e kërkimit në shkencat sociale*. Tiranë: Ufo University Press.
- Kocani, A. (2009). *Ushtrime me metodat e kërkimit sasior në shkencat sociale*. Tiranë: Ufo University Press.
- Koliqi, H. (2002). *Historia e Arsimit dhe e Mendimit Pedagogjik Shqiptar*. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Kraja, M. (2006). *Pedagogji*. Tiranë: Mileniumi i ri.
- Kraja, M. (2008). *Pedagogji e zbatuar*. Tiranë: GEER.

- Lewis, J. (2004). *Studimi akademik*. Tiranë: CDE.
- Lika, E. (2001). *Roli i shkollës në përfshirjen e prindërve në edukim*. Tiranë.
- Marriott, Niall & Goyder, Hugh. (2009). *Manual for Monitoring and Evaluating Education Partnerships*. Paris - France: International Institute for Educational Planning.
- Marsh, C. J. (2009). *Koncepte thelore për ta kuptuar kurrikulumin*. Tiranë: CDE.
- Marzano, R. J. (2010). *Formative Assessment & Standards - Based Grading*. USA: Marzano Research.
- MASHT. (2007). *Strategjia për zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë*. Prishtinë.
- MASHT. (2011). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*. Prishtinë: MASHT.
- MASHT. (2011). *Përmbledhje mbi Nevojat e Trajnimit të Stafit Menxhues të Arsimit dhe Mësimdhënësve të Matematikës dhe Shkencave Natyrore*. Prishtinë: GIZ.
- MASHT. (2011). *Udhëzues - Kodi Etik për Vlerësimin e Nxënësve*. Prishtinë - Kosovë: BEP.
- MASHT. (2012). *Udhëzues - Standardet e Vlerësimit*. Prishtinë - Kosovë: BEP.
- MASHT. (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë*. Prishtinë.
- MASHT. (2014). *Standardet për shkollat mike për fëmijë*. Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- Matthews, Bob & Ross, Liz. (2010). *Metodat e hulumtimit - udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*. Tiranë: CDE.
- McMahon, M., Simmons, P., Sommers, R., DeBaets, D. & Crawley, F. (2006). *Assessment in science - Practical Experiences and Education Research*. Virginia - USA: NSTA Press.
- Mejzini, M. & Buza, V. (2014). Just - in - time teaching and learning. *2nd Albania International Conference on Education* (pp. 345-355). Tiranë: AICE.
- Miller, B. (2005). *Komunikimi me fëmijë*. Ferizaj - Kosovë: QPEA.
- Miller, B. (2005). *Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit*. Ferizaj - Kosovë: QPEA.
- Minerva, F. F. (2011). *Hyrje në pedagogjinë e përgjithshme*. Tiranë.
- Montesori, M. (2009). *Zbulimi i fëmijës*. Tiranë: Plejad.
- Moss, M., Connie & Brookhart, M., Susan. (2009). *Advancing Formative Assessment in every classroom*. Virginia: ASCD.
- Muka, P. (1997). *Të mësuarit me objektiva me modeli A-94*. Prishtinë.
- Murchan, D., Shiel, G. & Vula E. (2011). *Vlerësimi Formativ*. Prishtinë: Basic Education Program.
- Musai, B. (1996). *Mjeshtritë themelore të mësimdhënies*. Tiranë: Eurorilindja.
- Musai, B. (1999). *Psikologji edukimi - zhvillimi, të nxënët, mësimdhënia*. Tiranë: CDE.
- Musai, B. (2003). *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: CDE.
- Musai, B. (2003). *Metodologji e Mësimdhënies*. Tiranë: Pegi.
- N.Ross, K. (2005). *Educational research: some basic concepts and terminology*. Paris - France: International Institute for Educational Planning - UNESCO.
- Nagavci, A. (2012). Integrimi i Vlerësimit për të Nxënë ne Planin Zhvillimor të Shkollës. *Përmirësimi i të nxënit nëpërmjet vlerësimit*, 18.
- Ndreca, M. (2007). *Fjalorë fjalësh të huaja në gjuhën shqipe*. Tiranë - Shqipëri: TOENA.

- Neergaard, Helle & Ulhøi, P., John. (2007). *Handbook of Qualitative Research Methods in Entrepreneurship*. Massachusetts, USA: Edward Elgar Publishing Limited.
- Nikqi, H. (2012). Kriteret e suksesit dhe rubrikat. *Përmirësimi i të nxënit nëpërmjet vlerësimit*, 26.
- Nushi, P. (1987). *Fjalor i psikologjisë*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Orstein, C., Allan & Hunkins, P., Francis. (2003). *Kurrikula - Bazat, Parimet dhe Problemet*. Tiranë: Instituti i Studimeve pedagogjike.
- Osmani, S. (1983). *Fjalor i pedagogjisë*. Tiranë.
- Overmeyer, M. (2009). *What student writing teaches us - formative assessment in the writing workshop*. USA: Stenhouse Publishers.
- Papworth, M. (2004). *Help Your Teenager Succeed at School*. New York: Continuum.
- Pendavinji, G. (2008). *Nga mbledhja tek analiza statistike e të dhënave*. Korçë - Tiranë: Plejad.
- Përlala, D. (2010). *Psikologjia e edukimit*. Tiranë: Shtëpia Botuese Universitare U.F.O.
- Peshkepia, V. (2012). *Mësimdhënia, mësimnxënia, raporet e tyre me integrimin evropian*. Tiranë: Fan Noli.
- Popham, W. J. (2008). *Transformative Assessment*. USA: Alexandria.
- Popham, W. J. (2011). *Transformative assessment in Action*. USA: ASCD.
- Rama, L. (2012). Informata kthyesë një përvojë e re për mua dhe nxënësit e klasës sime. *Përmirësimi i të nxënit nëpërmjet vlerësimit*, 29-30.
- Rexhepagiq, J. (1970). *Zhvillimi i Arësimit dhe i sistemit shkollor të Kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*. Prishtinë: Rilindja.
- Rexhepagiq, J. (2002). *Tema të zgjedhura dhe bashkëkohore pedagogjike*. Prishtinë: Libri shkollor.
- Rexhepagiq, J. (2005). *Sami Frashëri dhe Pedagogjia e Rilindjes Kombëtare*. Prishtinë: Akaademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.
- Reynolds, E. (2001). *Guiding Young Children A Problem -Solving Approach*. Boston - USA: Mc Graw Hill.
- Schmuck, R. A. (2006). *Practical Action Research For Change*. California - USA: Corwin Press.
- Schumm, J. S. (2005). *Si ta ndihmoni fëmijën për detyrat e shtëpisë*. Tiranë - Shqipëri: Max.
- Shahini, L. &. (2013). *Edukimi i Mësuesve dhe Cilësia e Arsimit - Sfidë globale e shek. XXI*. Tiranë: IRVA Press.
- Shahini, Ladi & Shahini, Johana. (2013). *Të mësuarit në shek. XXI*. Tiranë: IRVA Press.
- Shamiq, M. (2006). *Si shkruhet vepra shkencore*. Shkup: Logosa.
- Si të shkruajmë një punim kërkimor*. (2004). Tiranë: CDE.
- Si të shkruajmë procesi dhe shkrimet funksionale*. (2004). Tiranë: CDE.
- Smith, W., Claire & Cumming, Joy. (2009). *Educational Assessment in the 21st Century*. New York: Springer.
- Soanes, Catherine & Stevenson, Angus. (2005). *Oxford Dictionary of English*. USA.
- Sokoli, L. (2011). *Metodat e kërkimit*. Tiranë: Indtituti i Sociologjisë.
- Spahiu, Y. (2003). Aspekte të komunikimit shkollë-familje. *Administrimi dhe Menaxhimi i Arsimit (Numri 5)*, 205-216.

- Spahiu, Y. (2003). Menaxhimi i klasës, proces që duhet të njihet dhe nga drejtuesit. *Administrimi & Menaxhimi i Arsimit (Numër 4)*, 62-76.
- Tarifa, F. (2012). Kriza e arsimit dhe e qëllimit në universitetin shqiptar. *Academe*, 37.
- Temple, Ch., Crawford, A., Saul, W., Mathews, R., Samuel & Makinster, J. (2006). *Strategji të mësimdhënies dhe të të nxënësve për klasat mendimtare*. Tiranë - Shqipëri: CDE.
- Torrance, Harry & Pryor, John. (1998). *Investigating Formative Assessment*. Philadelphia USA: Open University Press.
- Vanderstoep, W., Scot & Johnston, D., Deirdre. (2009). *Research methods for everyday life*. San Francisco - USA: Jossey-Bass - A Wiley Imprint.
- Vaughn, Lewis & MacDonald, Chris. (2010). *Fuqia e të menduarit kritik*. Tiranë: CDE.
- Veness, D. (November 2010). Models and theories of curriculum design. *Educational Reflections the occasional thoughts of an educational designer*.
- Vuji, M. (2012). *Vetëvlerësimi mësimor*. Tiranë: GEER.
- Vula, E. (2010). *Hulumtimi Veprues në arsim*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Edukimit.
- Vula, E. (2012). Vlerësimi Formativ. *Përmirësimi i të nxënësve nëpërmjet vlerësimit*, 14-17.
- Wellington, J. (2000). *Educational Research*. London - United Kingdom: Continuum.
- Weyers, K. M. (2007). *Si të shkruajmë ese dhe detyra universitare*. Tiranë - Shqipëri: CDE.
- Woolfolk, A. (2011). *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE.
- Zajazi, T. (2003). *Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies*. Shkup: Vinsent Graphic.
- Zuna, D., Afërdita & bashkautorët. (2009). *Partneriteti shkollë-familje-komunitet*. Prishtinë: Libri shkollor.
- Zylfiu, H., Gojani, D., Hajrie & Shala, B., Luljeta. (2013). *Zhvillimi i Udhëheqjes Arsimore - Përmbledhje punimesh*. Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- Zylfiu, N. (1980). *Mendimet pedagogjike dhe humaniste të Naim Frashërit*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Materiale nga interneti

Marrë nga: (<http://www.masht.gov.net/advCms/documents/prezantimi.ppt.2.pdf> - Instituti

Pedagogjik i Kosovës (10 maj 2015: 4)

Marrë nga: <http://etec.ctlt.ubc.ca/510wiki/EvaluationConstructivistLearning> (15 shkurt 2015)

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

Marrë nga: <http://www.slideshare.net/AndiKullolli/ese-pedagogjie> (17 gusht 2015)

Marrë nga: <http://slidegur.com/doc/96884/fusha-e-kurrikulws-1> (17 gusht 2015)

Marrë nga: <http://educational-reflections.blogspot.com/2010/11/when-teachers-are-asked-to-develop.html> (12 mars 2015)

Marrë nga: <http://www.shabait.com/categoryblog/3200-what-motivation-is-and-why-it-is>
(më 5 qershor 2015)

Marrë nga:

<http://www.vet.al/files/ligje%20etj/manuali%20inspektimi%20i%20plote%20i%20shkolles.pdf> (më 5 nëntor 2014)

Marrë nga: <http://edglossary.org/formative-assessment/> (14 mars 2015)

Marrë nga: <http://www.ascd.org/publications/books/111005/chapters/Section-1@-What-Is-Formative-Assessment%C2%A2.aspx> (17 janar 2015)

Marrë nga: http://datause.cse.ucla.edu/ba_comprehensive.php (7 mars 2015)

Marrë nga:

http://www.assessmentforlearning.edu.au/professional_learning/peer_feedback/peer_strategies_enhance.html#1 (15 qershor 2015)

Marrë nga: <http://www.shabait.com/categoryblog/3200-what-motivation-is-and-why-it-is> (5 qershor 2015)

Marrë nga:

http://www.assessmentforlearning.edu.au/professional_learning/intro_to_afl/introduction_key_questions.html (17 mars 2015)

Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të
Vlerësimit Formues

Marrë nga:

http://www.gwaea.org/iowacorecurriculum/docs/AssessmentForLearning_LitReviewFinal.pdf (14 prill 2015)

Marrë nga: <http://www.ascd.org/publications/educational-leadership/dec07/vol65/num04/Feedback-That-Fits.aspx> (15 gusht 2015)

Marrë nga: <http://www.ehow.com/about5103845purposes-portfolio-assessment.html> (10 gusht 2015)

Marrë nga:

http://www.assessmentforlearning.edu.au/professional_learning/intro_to_afl/introduction_key_questions.html (19 maj 2015)

Marrë nga: <http://www.ncca.ie/uploadedfiles/publications/assess%20%20guide.pdf> (5 shtator 2015)

Marrë nga: http://cass.welbni.org/downloads/27/213_86_Self%20Assessment-pdf.pdf (20 gusht 2014)

Marrë nga: (<http://www.brainyquote.com/quotes/quotes/n/nelsonmand157855.html>) (11 maj 2015)

SHTOJCA1

Pyetësor për mësimdhënës

Mësimdhënës të nderuar,

Pyetësi ka për qëllim hulumtimin për punimin e tezës së doktoraturës me temë: "Përgatitja e nxënësve për të nxënë të qëndrueshëm dhe reflektimi cilësor përmes aplikimit të Vlerësimit Formues si komponente të rëndësishme" në Universitetin Evropian të Tiranës – drejtimi Pedagogji në Tiranë, me udhëheqës prof. dr. Petrit Muka.

Pyetësi është anonim dhe ka gjithsej tetëmbëdhjetë pyetje. Mendimet e juaja do të më ndihmojnë në nxjerrjen e rezultateve konkrete për aplikimin e Vlerësimit Formues, i cili i kontribuon pozitivisht procesit mësimor.

Konfidencialiteti: Informacioni i mbledhur në këtë studim do të përdoret vetëm për qëllime të studimit dhe do të trajtohet në mënyrë konfidenciale, të anketuarve do t'u sigurohet anonimitet i plotë.

Mund të kontaktoni:

Violeta Buza

Mob. 044-914-800

E-mail: violetabuza@hotmail.com

Për secilën pyetje ju do të rrumbullakësoni një ose më shumë përgjigje që mendoni se është apo janë të sakta, ose shprehni mendimin tuaj tek pyetjet e hapura. Ndërsa pyetja e tetëmbëdhjetë tek e cila është përdorur shkalla Likert do të vendosni një shenjë tek përgjigjja e saktë.

1. Trajnimet e juaja të kryera janë:

a. Zhvillimi i Mendimi kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit

b. Mësimdhënës mentor

c. Vlerësimi Formues (për nxënie)

d. Edukimi për të drejtat e fëmijës

d. Hap pas Hapi

d. Shëno, nëse ke përgjigje tjetër _____

2. Cilat forma të vlerësimit i aplikoni në klasën tuaj?

a. Vlerësimi përmbledhës (i të nxënit)

b. Vlerësimi formues (për nxënie)

c. Vlerësimi diagnostifikues

d. Shëno, nëse ke përgjigje tjetër _____

3. Çfarë nënkupton për ju vlerësimi?

4. Si i vlerësoni nxënësit tuaj në klasë?

- a. Me notë
- b. Me fjalë
- c. Me notë dhe me fjalë
- d. Shëno, nëse ke përgjigje tjetër _____

5. Komunikimi dhe bashkëpunimi me mësimdhënës (kolegët) realizohet për:

- a. Probleme të ndryshme me nxënës
- b. Planifikimin dhe realizimin e planit mësimor
- c. Të nxënit cilësor të nxënësve
- d. Aplikimin e formave dhe teknikave të ndryshme të vlerësimit
- e. Shëno, nëse ke përgjigje tjetër _____

6. Teknikat dhe instrumentet e vlerësimit që i përdorni për nxënësit në klasën tuaj:

- a. Vlerësimi me teste,
- b. Vlerësimi me gojë
- c. Vlerësim në tabelë
- d. Vlerësim përmes detyrave të ndryshme në fletore (ese, diktim, komentim, detyra kontrolluese, dosja etj.)
- e. Shëno, nëse ke përgjigje tjetër _____

7. Cila formë e vlerësimit e realizuar nga ana juaj i motivon më shumë nxënësit për të mësuar?

- a. Vlerësimi Formues
- b. Vlerësimi Përmbledhës
- c. Vlerësimi Formues dhe Vlerësimi Përmbledhës
- d. Shëno, nëse ke përgjigje tjetër _____

8. Për marrjen e të dhënave të mjaftueshme për nxënësit vlerësimi juaj mbështetet në:

- a. Vlerësimin për punën individuale të nxënësit
- b. Vlerësimin për punën e nxënësit në grup
- c. Vlerësimin vetëm në gjysmëvjetor për nxënësit
- d. Vlerësimin vetëm në fund të vitit shkollor për nxënësit
- e. Vlerësimin sistematik për nxënësit (me notë çdo ditë)
- f. Shëno, nëse ke përgjigje tjetër _____

9. Aplikimi i Vlerësimit Formues ndikon:

- a. Në përmirësimin e të nxënit të nxënësve
- b. Që nxënësi të njihet me punën dhe shkallën e suksesit të tij
- c. Për komunikim dhe bashkëpunim me prindër
- d. Në riplanifikimin tuaj për mësimdhënie të suksesshme
- e. Shëno, nëse ke përgjigje tjetër _____

10. Mendoni se Aplikimi i Vlerësimit Formues në klasë nga ana juaj:

